

Ferat Shala
Sala Berisha-Shala
Bislim Muqa

TREPÇA

*RISTRUKTURIMI,
SFIDAT DHE PERSPEKTIVA*



Ferat Shala
Sala Berisha-Shala
Bislim Muqa

TREPÇA

RISTRUKTURIMI, SFIDAT DHE PERSPEKTIVA

Trepça - Restructuration, défi et perspectives

Trepça - Restructuring, Challenges and Prospective

Prishtinë, 2014

Atlantis 

Për botuesin:

Dr. rer. Nat. Frank KARG

Recensentë:

Prof.dr. Alaudin Kodra

Prof.dr. Bajram Shabani

Redaktor shkencor:

Kemajl Zeqiri

Redaktor gjuhësor:

Arben Veselaj

Disenji:

TICKMEDIA

Shtypi:

Print ILIRI

© Copyright:

Atlantis Développement, Roscoff, France



Dr. Frank Karg

Ideja për ta marrë për botim dorëshkrimin shkencor Trepça - ristrukturimi, sfidat dhe perspektiva, më ka lindur në kohën kur e realizova një vizitë në Kosovë, dy vjet më parë. Gjatë asaj vizite unë jo vetëm që u njoha me “Trepçën”, por mbeta i fascinuar me kurajën dhe përkushtimin e autorëve të këtij studimi, të cilët me tërë qenien e ishin të dhënë në punët menaxhuese të ndërmarrjes “Trepça”. Veç përkushtimit dhe kurajës, ata kishin edhe një dashuri për “Trepçën”, sepse ishin të lidhur me fatin e saj qëkur kishin qenë studentë të gjeologjisë në Mitrovicë.

Duke njohur të kaluarën e ndërmarrjes “Trepça”, vuajtjet dhe sakrificat e minatorëve të saj, të cilat janë të lidhura ngushtë edhe me fatet e vet popullit të Kosovës, si njohës i kësaj fushe, dhe në këtë rast si botues, nuk munda të kapërcej krejt indiferent karshi respektit dhe simpatisë që kam për minatorët, për “Trepçën” dhe për Kosovën.

Transformimi ekonomik që po ndodhë në Kosovë s'do mend se kërkon mobilizim të potencialit shkencor në kërkim të dhënies së ideve dhe premisave më të mira për të ardhmen e industrisë minerare, prandaj jam i lumtur që me anë të këtij libri po më jepet mundësia që sadopak edhe unë ta jap kontributin tim në gjetjen e zgjidhjes më të mirë për të ardhmen e industrisë minerare, prej të cilës edhe varet e ardhmja e vet shtetit të Kosovës.

Studimet dhe kërkimet në fushën e industrisë minerare, pa dyshim, kanë qenë dhe vazhdojnë të mbeten preokupim i vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, për shkak se kjo industri paraqet forcën kryesore të zhvillimit ekonomik të një vendi, por e veçanta e këtij studimi (që më ka cytur ta botoj), është alternativa mjedisore e të ardhmes së "Trepçës" që jepet përmes këtij libri. Si ekspert, dhe në këtë rast si botues, jam i mrekulluar me vizionin e autorëve që kanë për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, në të njëjtën kohë kur "Trepça" mund të ketë eksploatim, prodhimtari dhe afarizëm të suksesshëm.

Botimin e këtij libri e ka mbështetur edhe për faktin se ai prezanton në mënyrë shteruese resurset minerale të Kosovës, mundësitë dhe kapacitetet e industrisë minerare, si dhe jep ide të qarta për ristrukturimin ndërmarrjes "Trepça" nga kushtet e ekonomisë së centralizuar në atë të tregut të lirë.

Me këtë rast do t'ju sugjeroja drejtuesve të "Trepçës" se e ardhmja e saj duhet të bazohet në këto fusha: në prodhimin e metaleve dhe elementeve të rralla; në prodhimin e plehrave bujqësore me kualitet të lartë; në transformimin dhe përdorimin e metaleve në elektronikë dhe në fushën e mbrojtjes; si dhe futjen në funksion të teknologjisë së riciklimit.

FJALA E RECENSENTËVE

“TREPÇA – RISTRUKTURIMI, SFIDAT DHE PERSPEKTIVA”- NJË DOKUMENT SHKENCOR QË SHTRON PËR ZGJIDHJE ÇËSHTJEN “TREPÇA”

Libri “Trepça - ristrukturimi, sfidat dhe perspektiva”, është pa dyshim njëri nga dokumentet më të kompletuara shkencore në 15 vitet e fundit, që i kushtohet pasurive minerale të Kosovës – me theks të veçantë resurseve minerale metalore të plumbit dhe zinkut. Autorët me sukses kanë arritur t’i hulumtojnë, evidentojnë dhe t’i shtrojnë për zgjidhje të gjitha çështjet që preokupojnë kompleksin minerar “Trepça”. Objektivi i autorëve është se, nëpërmjet elaborimit të Planit të Ristrukturimit, mbi bazën e parametrave tekniko – shkencorë dhe ekonomik, ta argumentojnë rëndësinë dhe efektivitetin e kryerjes së investimeve në kompleksin minerar “Trepça”.

Ky libër nxjerr në pah preokupimin legjitim të intelektualëve të shquar të Kosovës dhe përpjekjet e tyre për të demonstruar mundësitë reale të zhvillimit dhe të punësimit në një nga gjigantët e industrisë minerare jo vetëm të Kosovës, por edhe në rang ballkanik dhe më gjerë. Në të trajtohen alternativat për ristrukturimin e kompleksit minerar “Trepça”, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Minierat, në kushtet e ekonomisë së tregut, dhe duke qenë miqësore ndaj mjedisit.

Nga një periudhë veçanërisht e rëndë degraduese, sidomos gjatë viteve ‘90-të, viteve të fundit ka pasur një përmirësim domethënës të prodhimit, pasurimit si dhe të mbështetjes sociale (punësimit). Por, me të drejtë autorët theksojnë se, kompleksi minerar “Trepça”, me strukturën aktuale organizative, statusin dhe strukturën menaxheriale, nuk mund të jetë konkurrues në kushtet e ekonomisë së tregut.

Në këtë libër autorët shtjellojnë me radhë problematikat dhe rrugët e zgjidhjes, që lidhen ngushtë me ristrukturimin e kompleksit minerar "Trepça". Kështu, një kapitull i veçantë i këtij libri trajton gjerësisht konceptin bazë të menaxhimit minerar, duke nisur nga rrjedhat globale dhe ndikimi i tyre në prodhimin dhe konsumin e plumbit dhe të zinkut, çmimet, ofertat dhe kërkesat për xeheror, metal dhe koncentrat të plumbit dhe zinkut.

Një tjetër kapitull, po ashtu, sjell informacione shteruese për gjendjen aktuale të "Trepçës" dhe jepen premisa të zgjidhjes së shumë problemeve. Autorët, në mënyrë mjaft bindëse trajtojnë sfidat me të cilat përballet dhe do të përballet "Trepça": sociale, mjedisore, tekniko - teknologjike dhe ligjore - secila më e rëndësishme se tjetra. Dhe, në përmbledhje të tyre, mendojmë që, pavarësisht se autorët nuk e përmendin, del e qartë që kemi përballje të drejtpërdrejtë me sfidën e besimit që, po të bëhen siç duhet punët, rezultatet do të ishin të mira dhe fitues do të dilnin të gjithë ata që do të kyqeshin në këtë betejë të gjatë dhe të rëndësishme.

Autorët e këtij libri, me shumë të drejtë i kanë kushtuar vëmendje të madhe evidentimit dhe kërkesës për përfitim maksimal të metaleve shoqëruese të xeheve të plumbit (Pb), zinkut (Zn), veçanërisht për arin (Au), argjendin (Ag), bismutin (Bi) dhe kadmiumin (Cd).

Ky libër, po ashtu, trajton në mënyrë tepër profesionale modele të ndryshme të ristrukturimit të "Trepçës". Modeli i preferuar prej autorëve - modeli më i mirë do të ishte ristrukturimi dhe më pas privatizimi i pjesshëm përmes procesit publik-privat me kusht që shteti të mbajë mbi 51% të aksioneve. Natyrisht, alternativat janë të ndryshme, por mendojmë që i plotësojnë kushtet kryesore: shfrytëzimin racional të rezervave, rritjen e prodhimit, rritjen e të ardhurave dhe të punësimit si dhe ruajtjen më të mirë të mjedisit. Ashtu si dhe për modele të tjera, edhe për këtë model përmirësimet ligjore janë të domosdoshme, për t'i kombinuar sa më mirë interesat ekonomike, sociale dhe mjedisore të vendit, me interesat për fitim maksimal të investitorëve (aksionarëve).

Në këtë kuadër, Partneriteti Publiko - Privat (P.P.P.), është formë tepër e mirë që mund të përdoret në kuadër të modelit Privatizim dhe Ristrukturim, me formimin e kompanisë publike - aksionare. Autorët e trajtojnë gjerësisht në studim P.P.P., duke vënë në dukje dhe momentet delikate të këtij bashkëpunimi, ku duhet drejtuar vëmendja e dyanshme.

Studimi "Trepça - ristrukturimi, sfidat dhe perspektiva", ndërkaq, sot po iu ofrohet jo vetëm studiuesve potencialë (studentëve), por edhe institucioneve kërkimore - shkencore, institucioneve qeverisëse të Republikës së Kosovës, sikurse edhe investitorëve potencialë. Dhe kjo po bëhet në kohën e duhur, kur fati i kompleksit minerar "Trepça" dhe në përgjithësi i industrisë minerare, po shtrohet për zgjidhje, brenda procesit kompleks të transformimit të madh ekonomik të vendit tonë.

Ky libër, si asnjë tjetër deri më tani, sjell të dhëna koncize statistikore rreth resurseve minerale të Kosovës; jep një pasqyrë unike komparative (krahasuese) me vendet e rajonit dhe të botës, ndërsa në formë konkluzionesh paraqet vizionin e autorëve për perspektivën e industrisë minerare të Kosovës.

Autorët e këtij libri, duke qenë se për një kohë kanë qenë në krye të menaxhmentit të ndërmarrjes "Trepça", në këtë studim, krahas njohurive teorike dhe praktike, kanë shkruar edhe përvojën e tyre menaxheriale, duke na ofruar kështu një elaborat të mirëfilltë shkencor.

Prof.dr. Alaudin Kodra
Prof.dr. Bajram Shabani

HYRJE

Republika e Kosovës, si shteti më i ri i Evropës, domosdoshmërisht duhet të hartojë legjislacion dhe politika zhvillimore, të cilat do t'i japin vendit hov të madh zhvillimor. Për t'u realizuar kjo, ekonomisë së shtetit të ri i duhet të përcaktojë në rend të parë prioritetet zhvillimore si dhe të caktojë resurset që mund të jenë potencial për zhvillim të shpejt. Nisur nga aspekti i resurseve, Kosova është vend i pasur me resurse natyrore, sipërfaqësore dhe nëntokësore, me klimë dhe pozitë gjeografike shumë të përshtatshme. Mbështetur në shumë studime shkencore dhe ekonomike, një ndër sektorët me potencialë zhvillimor është:

Sektori i minierave dhe energjetikës

Në kuadër të këtij libri do të ndalemi te një pjesë e kapaciteteve minerare që ka Republika e Kosovës, pra te potencialet minerale të Pb-Zn që mbi 80 vjet identifikohen me ndërmarrjen "Trepça".

Kjo ndërmarrje ka kaluar etapat e zhvillimit maksimal në dekadat e fundit, si dhe ka pësuar goditjet të rënda të dëmtimit tekniko-teknologjik, xehetar dhe human. Megjithatë, ajo po mbijeton, po ringjallet dhe ka filluar të ristrukturohet. Në këtë proces me rëndësi vitale për ekonominë e ndërmarrjes dhe Kosovës, është e nevojshme ekspertiza shkencore në mënyrë që hapat e mëtutjeshëm të jenë strategjikë. Në kuadër të këtij teksti studimor do të mundohemi të japim maksimumin në lidhje me temën:

Trepça –ristrukturimi, sfidat dhe perspektiva

Shpresojmë dhe besojmë që libri ynë do t'i jap rezultatet e dëshiruara, të cilat do të jenë në shërbim të menaxhmentit, ekspertëve të fushave përkatëse dhe instancave tjera vendimmarrëse, që e trajtojnë problematikën e ristrukturimit. Ky libër do të trajtohet dhe mbështetet në burime zyrtare dhe shkencore dhe në analizë autoriale.

Në fund, mbështetur në rezultatet e arritura, do t'i japim rekomandimet për mënyrën dhe hapat operacionalë, duke i identifikuar sfidat primare dhe alternativat për zgjidhjen e tyre.

KAPITULLI I

1. NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR KOMPLEKSIN MINERAR "TREPÇA"

1.1 Historiku

Historia e "Trepçës"- njërit nga prodhuesit më të mëdhenj të plumbit dhe zinkut në Evropë, ka qenë shumë e bujshme, siç kanë qenë të bujshme edhe kohët në të cilët është formuar e zhvilluar ky gjigant i ekonomisë kosovare. "Trepça", e vjetër më se 2000 vjet, mban mend ilirët, romakët, sllavët, turqit, austro-hungarezët, anglezët, gjermanët, e më në fund prapë ilirët (pasardhësit e tyre shqiptarët). Të gjitha këto periudha kohore në një mënyrë kanë lënë gjurmët e veta në "Trepçë".

Që në kohërat e lashta është ditur për vendburimet polimetalore të sulfureve të Pb, Zn, Ag, Au, në Kosovë. Këtë e kanë vërtetuar zbulimet e shumë punimeve të vjetra minerare: galeri, puse, vegla të punës, që janë përdorur në kohëra të ndryshme gjatë shfrytëzimit të mineralizimeve të këtij lloji dhe mbetjet nga shkrirja e tyre. Disa nga vendburimet sulfure të këtij lloji edhe sot, pas luftës së fundit në Kosovë (1998/99), janë në shfrytëzim, si: miniera "Trepça" në Stantërg, ato në Belloberdë, Cërnac dhe Përroi i Ngjyrosur-Artanë, të cilat gjenden në kuadër të kompleksit "Trepça". Ndërkaq, vendburimet si: Hajvalia, Badovci dhe Kishnica, janë të zhytura në ujë dhe kanë mbetur pa kurrfarë mbikëqyrjeje edhe pse para luftës (periudha 1998/99), ishin prodhues të rëndësishëm të xehes së plumbit, zinkut dhe argjendit etj.

Për herë të parë në literaturë, emri "Trepça" përmendet në vitin 1303, në dokumentet që ruhen në arkivin e Dubrovnikut (Republika e Kroacisë). Për zhvillimin e xehetarisë në territorin ku gjenden minierat e "Trepçës", dihet qysh në kohën ilire e romake, e që vazhdon deri në Mesjetë. Ndërkaq, më vonë, zhvillimin më të vrullshëm xehetaria e arrin në shekullin XIII.

Hulumtimet e para gjeologjike filluan në vitin 1924, atëherë kur gjeologët anglezë filluan kërkimet gjeologjike për mineralizimet polimetalore sulfure të Pb- Zn, në suaza të fushës xeherore të "Trepçës" në Stantërg. Më vonë, në vitin 1926, në Londër formohet një shoqëri aksionare e njohur me emrin "Trepça Mines Limited", e cila merr me koncesion shfrytëzimin e këtij vendburimi për 50 vjet.

Xeherorët e "Trepçës" kanë nisur të shfrytëzohen që në kohërat e lashta. Hulumtimet arkeologjike të bëra në këtë territor, thonë se banoret më të vjetër ishin dardanët, të cilët i tërhoqi mundësia e zhvillimit të bujqësisë. Në territorin e sotëm të trevës së Mitrovicës, janë zbuluar disa gjurmë ndërtesash, një nekropol ilir, statuja të ndryshme prej balte e prej plumbi, një sarkofag, figura e Terpsikorës (Muzës së vallëzimit) etj. Por, me ardhjen e romakëve, ky rajon shndërrohet në një postë ushtarake dhe vend përpunimi i metaleve. Pas sundimit romak, ky territor bie nën sundimin e Carit bullgar, Simeonit (879-927). Ky sundim, me vonë zëvendësohet nga Njermaniqët serbë. Gjatë sundimit të Njermaniqëve, ky territor mbushet me ardhacakë sllavë. Në Mesjetë, nga minierat e "Trepçës", përveç vendësve, kanë nxjerrë dhe kanë përpunuar metale edhe sasët, një fis gjerman, që ishin spostuar në rajon, dhe që u bënë të njohur si xehetarë dhe metalurgë të zotë. Në dokumentet mesjetare, miniera përmendet me emrin "Trepça", pastaj "Treipçe", "Tripçe", "Tripza" etj. Të dhënat historike nuk tregojnë për ndonjë eksplorim shkencor para atij të vitit 1924, kur nga gjeologët anglezë kishte filluar prospekcionin gjeologjik i fushës xehembajtëse të "Trepçës". Si rezultat i kësaj pune, në vitin 1927, në Londër u formua shoqëria aksionare "Trepça Mines Ltd", në bazë të koncesioneve të blera për shfrytëzim për një periudhë 50-vjeçare. Por puna prodhuese në minierën "Trepça" në Stantërg, filloi më 16 tetor të vitit 1930.

Historia tregon, se galeritë e para në minierën e Janjevës e të Kishnicës, i takojnë kohës së perandorit romak - Trajani (98-117). Në atë kohë, shfrytëzimi i xeheve të argjendit e të arit ka qenë intensiv dhe nga pasuria e krijuar romakët ngritën qendra të njohura si ajo e Ulpianës, që ndodhet në afërsi të këtyre minierave.

Kushtet e punës në miniera kanë qenë shumë të vështira. Puna është zhvilluar në ambient të rëndë e pa ajrosje, me ndriçim të dobët e duke punuar 12-14 orë në ditë. Minatorët punonin të shtrirë, për shkak se galeritë kanë pasur profile të vogla me lartësi 0,7-1,0 m, kurse transportin e xehes e bënin duke tërhequr me saja ose me bartje në shpinë të thasëve të lëkurës të mbushur me mineral.

Në kuadër të Kompleksit Industrial "Trepça", kanë funksionuar edhe Metalurgjia e Plumbit në Zveçan, Elektroliza e Zinkut, Industria Kimike në Mitrovicë, Industria e Akumulatorëve, Fabrika e Akumulatorëve, Fabrika e Baterive Industriale në Pejë, "Metaliku" në Gjakovë, "Famipa" në Prizren,

Fabrika e Lllamarinës së Zinkuar në Vushtrri, Fabrika e Municionit të Gjuetisë në Skenderaj, Fabrika e Baterive të Nikel-Kadmiumit në Gjilan, Fabrika e Pajisjeve të Procesit, "Energjetika" në Zveçan, "Trepça Komerc", etj.

1.2 E kaluara ekonomike dhe prodhimtaria

Në vitin 1930 fillon prodhimi provues i mineralizimeve sulfure të Pb dhe Zn në këtë vendburim. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, gjermanët e mbajnë minierën e "Trepçës" në Stantërg në gjendje pune, por me një nivel të zvogëluar të prodhimit. Ndërsa, nga viti 1945 e deri në vitin 1999, miniera ka punuar pandërprerë, me një kapacitet mesatar të prodhimit rreth 600.000 tonë në vit. Gjatë kësaj periudhe në shfrytëzim ishin këto miniera: "Trepça" në Stantërg, Cërnac, Belloberdë, Koporiq dhe Zhuta Perlla-Albanik (ish- Lepasaviq); Kishnicë, Hajvali, Badovc dhe Përroi i Ngjyrosur-Artanë.

Në vitin 1964 "Trepçës" i bashkohet fabrika e akumulatorëve "Elektron" e Somborit dhe miniera në hulumtim "Bobija" e Lubovisë. Viti 1966 ishte vit i lindjes së Kombinatit. Po në këtë vit edhe Industria Kimike, e njohur me emrin "Fafos", bëhet anëtare e familjes së madhe të "Trepçës", duke e zgjeruar asortimentin e prodhimeve të saja.

Ndërkaq, në vitin 1964 u themelua muzeu i kristaleve të "Trepçës" në Stantërg. Në atë kohë kishin filluar grumbullimet e para të mineraleve dhe më pas vendosja e tyre në muze. Fillimisht numri i kristaleve ishte i vogël, mirëpo me kalimin e kohës ky numër erdhi duke u rritur deri në ditët e sotme, me 1560 eksponate (evidentimi është bërë pas luftës në Kosovë 1998/99).

Me iniciativën e "Trepçës" është themeluar Shoqata e Prodhuesve dhe e Përpunuesve të Plumbit dhe Zinkut.

Kombinati "Trepça" në tërë periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore ishte bartës i zhvillimit, prodhimit dhe përpunimit të plumbit dhe zinkut.

Në vitin 1975 kombinati "Trepça" ka pasur 14 923 punëtorë. Gradualisht duke u rritur numri i punëtorëve, në vitin 1987 arrin shifrën 23 644 punëtorë.

Vlera e përgjithshme e prodhimeve (sipas çmimeve mesatare në bursën e Londrës për vitin 1991) shprehur në USD, ishte 262.282.000, shkalla e akumulimit 3,8% nga të hyrat e përgjithshme, ose në vlerë 10.000.000 USD. Eksporti mesatar vjetor i realizuar ishte 75.000.000 USD.

"Trepça-komerc" ishte organizatë punuese për realizimin e funksionimit të punëve qarkulluese në kombinatin e "Trepçës".

KAPITULLI II

2. FAKTORËT QË NDIKOJNË NË ZHVILLIMIN E SEKTORIT MINERAR (RASTI “TREPÇA”)

2.1 Faktorët ndikues

Si në veprimtarinë e çdo ndërmarrjeje tjetër, ashtu edhe në ndërmarrjet minerare, ndikojnë një numër i madh i faktorëve, të cilët, në rastet më të shpeshta, i grupojmë në faktorët e brendshëm dhe të jashtëm.

Faktorët e brendshëm kanë të bëjnë me kulturën dhe klimën organizative brenda ndërmarrjes (minierës). Këta faktorë ndikojnë në llojin e strukturës organizative, natyrën e ndërmarrjes, së shprehur përmes filozofisë menaxheriale, objektivave, madhësisë së vet ndërmarrjes, teknologjisë dhe teknikave, ndikimin e tyre në kryerjen e punëve, natyrën dhe llojin e njerëzve të punësuar.

Faktorët e mjedisit të brendshëm

Në grupin e faktorëve në mjedisin e brendshëm bëjnë pjesë:

- Njerëzit,
- Aktivitetet,
- Nivelet në ndërmarrje,
- Natyra e organizatës,
- Struktura organizative,
- Teknologjia dhe
- Metodat.

Faktorët e mjedisit të jashtëm

Në ndërmarrjet minerare ndikojnë një numër i caktuar i faktorëve, ku mjaft të rëndësishëm janë edhe faktorët e jashtëm, si:

- Ekonomikë,
- Teknologjikë,
- Politikë,
- Socialë dhe
- Ndërkombëtarë.

2.2 Korniza ligjore

Infrastruktura aktuale ligjore krijon mundësi të konsiderueshme për rregullimin shumë fushave të sektorit minerar. Mirëpo, e veçanta e kësaj infrastrukture ligjore, e cila ka ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin operacional të ndërmarrjes "Trepça" janë:

- Ligji për Miniera dhe Minerale 03/L-163,
- Ligji Nr. 04/L-034, mbi AKP-në,
- Ligji për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe
- Ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, për çështje që lidhen me AKP-në.

Veçanërisht, tri ligjet e fundit janë si produkt i nevojave për zgjidhjen e problemit të ashtuquajtur "pretendentë", ku llogaritet të zgjidhet ky problem në instancën e AKP-së dhe Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Për pasojë, ende në ndërmarrjen "Trepça" kemi të vendosur moratoriumin. Ky moratorium, është vazhdimësi apo përtëritje e moratoriumit të dalë nga Rregullorja Nr. 2005/48 e UNMIK-ut.

Shikuar nga aspekti zhvillimor-strategjik, ky moratorium, i cili për një kohë e ka mbrojtur "Trepçën" nga "kreditorët", më vonë është kthyer në pengesë dhe ngulfatës të zhvillimit të saj. Megjithatë, përkundër dobësive të mëdha që vërehen te Ligji për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Veçanta (që praktikisht është Rregullorja 2005/48), ekziston një mundësi dhe hapësirë që ndërmarrja mund të mos likuidohet në formën klasike dhe të fillojë me planin e ri për ristrukturim. Këtë plan, mbështetur në ligj, do të duhej ta miratonte Bordi i Aksionarëve, por sipas mendimit tonë, nëse themelohet ndonjëherë, këtë bord do të duhej ta udhëheqë Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht, Ministria e Financave, si aksionari më i madh që nga paslufta (1999), me rreth 100 milionë euro investime të bëra në "Trepçë".

2.3 Sfidat e “Trepçës”

Ndërmarrja “Trepça” vazhdon të përballët me problemet që i ka trashëguar nga e kaluara. E këto probleme janë: sociale, juridike, politike, mjedisore, teknologjike, shkencore etj. Janë probleme sociale, sepse një numër i madh i punëtorëve të “Trepçës”, të përzënë dhunshëm nga puna gjatë viteve të ‘90-ta, nuk kanë mundur të kthehen në ndërmarrjen e tyre. Probleme juridike, sepse ende nuk është definuar statusi i ndërmarrjes. Probleme politike, sepse ndërmarrja e ndanë fatin e qytetit të ndarë të Mitrovicës dhe nuk funksionon si tërësi. Probleme mjedisore, sepse ndërmarrja ka shkaktuar ndotje të shumta gjatë punës së saj përmbi tetëdhjetëvjeçare. Probleme teknologjike, sepse përkundër investimeve që ka bërë Qeveria e Republikës së Kosovës në “Trepçë”, prapëseprapë, teknologjia përpunuese e xeherorëve është e vjetruar, ndërkaq, metalurgjitë ende nuk punojnë. Janë sfida shkencore, sepse, kanë kaluar njëzet vjet që nuk janë bërë hulumtime në fushën e kërkim-zbulimit, për rritjen e rezervave minerale dhe kategorizimin sipas standardeve bashkëkohore të atyre ekzistuese.

2.3.1 Sfida sociale

Në tërësinë e vet, në vitet e tetëdhjeta të shekullit të kaluar, ndërmarrja “Trepça” kishte rreth 22.000 punëtorë të punësuar në miniera, metalurgji dhe në industrinë përpunuese. Mbi 13.000 punëtorë ishin shqiptarë, të cilët me vendosjen e masave të dhunshme në vitin 1989–1990 largohen nga puna. Pas luftës, nga viti 2000–2005, një numër i madh i tyre kthehen me shpresën për të filluar punën prej nga ishin larguar padrejtësisht. Mirëpo, kjo nuk ndodhi, sepse shumë njësi punuese ishin dëmtuar rëndë, të tjera fabrika e reparte mbyllën për shkak të problemeve mjedisore, ndërkaq, disa miniera ishin zhytur në ujë dhe dalë jashtë funksionit.

Institucionet vendimmarrëse të UNMIK-ut, e vendosin ndërmarrjen nën moratorium. Problemet e thelluara sociale (si pasojë e mos kthimit në punë të punëtorëve), tentohet të zbuten përmes pensioneve të parakohshëm dhe stipendioneve, që në fakt, ishin shuma simbolike, që një pjesë e ndante Qeveria dhe një pjesë ndërmarrja, por që në fakt, nuk zgjidhin problemin social të punëtorëve të dikurshëm.

Në çdo fazë dhe projekt që ka hartuar ndërmarrja në vitet e fundit, ka paraparë zgjidhjen e kësaj sfide përmes hartimit dhe kompletimit të legjislacionit, me ligj të veçantë, në mënyrë që ndërmarrja të lirohet nga kjo barrë dhe procesi zhvillimor të ishte më i lehtë. Zgjidhja e këtij problemi, qëndron në radhë të parë te kompletimi i legjislacionit për kategoritë sociale, ligjit për invaliditet në punë, ligjit për pensione si dhe rregullimin e çështjes së përvojës së punës etj.

2.3.2 Sfida tekniko-teknologjike

Dikur kompleksi "Trepça" ishte gjigant i madh tekniko-teknologjik, industrial mineral, i dizajnuar dhe projektuar jo vetëm për rajonin e Kosovës, por kapacitetet e tij ishin për tërë ish-Jugosllavinë.

Aktualisht një pjese e madhe e kësaj teknologjie i ka kaluar moshë dhe janë jashtë funksionit të përdorimit tekniko-teknologjik. Një pjesë tjetër e teknologjisë është plaçkitur e dëmtuar qëllimisht në përfundim të luftës nga pushtuesi. Pra, praktikisht kapacitetet kryesore metalurgjike janë jashtë funksionit.

Po ashtu, edhe industria përpunuese, karakterizohet me shkallë të lartë amortizimit, edhe te pjesët aktive në miniera, industri, etj. Andaj, në këtë aspekt, ndërmarrjes i duhet një proces rivlerësimi i të gjitha këtyre aseteve minerare dhe metalurgjike dhe aseteve përpunuese. Ky proces, apo studim fizibiliteti, do të qartësonte mirë vlerën dhe aftësinë e këtyre aseteve, rrugën e zhvillimit dhe procesin e ristrukturimit.

Prandaj, gjatë inventarizimit të aseteve, përkatësisht aftësisë tekniko-teknologjike të kompleksit mineral "Trepça", do të mund të kalkulohehin edhe shkalla e investimeve të nevojshme në procesin tekniko-teknologjik, duke u bazuar në rezervat minerale të plumb-zinkut në Kosovë dhe mundësinë e korrelacionit ekonomik dhe teknologjik për zhvillimin e sektorit mineral.

Sfida e vlerësimit dhe kategorizimit të rezervave minerale

Vendburimet dhe paraqitjet më të rëndësishme të plumbit dhe zinkut gjenden në të ashtuquajturin "Brezin Metalogjenik të "Trepçës", i cili shtrihet në pjesën verilindore të Republikës së Kosovës, duke filluar nga Leposaviqi gjerë në Gllamë (Gjilan). Gjatësia e këtij brezi është mbi 80 km, kurse gjerësia mesatare është rreth 30 km.

Tabela:2.3.2-1, Rezervat gjeologjike të Pb-Zn

Lokacioni	Xehesor (t)	Pb (%)	Zn (%)	Ag (g/t)
Vendburimet qendrore të Pb-Zn (Kompleksi i Stantërg)	35,081,000	3.85	3.85	65
Vendburimet veriore (Kompleksi Černac-Bellobërd)	7,544,227	6.85	5.07	96.13
Vendburimet Jug-lindore (Kompleksi Hajvali-Badovc-Artanë)	16,037,227	4.67	6.52	89.91
TOTAL	58,662,569	4.46	4.28	75.81

Burimi: Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012-2025

Vlerësimi i rezervave të Pb-Zn në Kosovë, mbetet sfidë jo vetëm për “Trepçën” si kompani minerare, por edhe për të gjitha institucionet minerare në vend.

Rezervat e paraqitura në tabelën e mësipërme, janë klasifikuar sipas sistemit të vjetër të vlerësimit dhe kategorizimit (sistemi i vendeve të lindjes).

Bazuar në të dhënat dhe mendimet e shumë ekspertëve vendorë, sa i përket saktësisë së rezervave të Pb-Zn në Kosovë, ky kategorizim dhe vlerësim i paraqitur në tabelën lartë, nuk është se paraqet ndonjë vlerësim jo real dhe dallim thelbësor me rezervat reale në vendburim.

Esenca qëndron në faktin se, çdo institucion financues ndërkombëtarë, në sektorin minerar, kërkon që vlerësimi dhe kategorizimi i rezervave minerale të jetë sipas standardeve tanimë të zbatueshme kanadeze, UNFC apo JORC. Rrjedhimisht, kategorizimi i këtillë i rezervave, paraqet vështirësi reale për investime private në vendburimet, përkatësisht minierat e kompleksit “Trepça”.

Prandaj, ndërmarrja “Trepça” ka nevojë për institucione financiare që e mbështesin në projektet e hulumtimeve e shkencore. Po ashtu, nisur nga fakti se sektori minerar në vend duhet të përcjell trendët globale të zhvillimit, rekomandohet mobilizim i institucioneve kompetente për sektorin minerar, për përgatitjen e rregullativës ligjore, për zbatimin e standardeve moderne për vlerësim dhe klasifikim të rezervave. Ndërkaq, gjatë procesit të ristrukturimit të kompleksit minerar “Trepça”, klasifikimi dhe vlerësimi i rezervave minerale sipas standardeve moderne, duhet të jetë një nga komponentët kyç për realizim.

Në procesin e ristrukturimit, çështja e vlerësimit dhe kategorizimit do të jetë sfidë më vete.

2.3.3 Sfidat juridike

Nisur nga e kaluara historike, dhe dokumentacioni historik, ndërmarrja “Trepça” nuk do duhej të kishte probleme të mëdha në kuptimin juridik. Problemet kanë lindur në këto tri dekadat e fundit, e veçanërisht u ashpërsuan pas vendosjes së masave të dhunshme në fillim të viteve ‘90-të. Në këtë fazë fillon degradimi jo vetëm social- ekonomik, por edhe juridik i ndërmarrjes. Në atë kohë fillon shpëputja nga trangu amë i shumë njësive punuese e afariste, të “Trepçës” anekënd ish-Jugosllavisë. Po ashtu, bëhen ndërrime të statuseve juridike të shumë njësive punuese që kishte themeluar “Trepça”. Lidhen kontrata dhe marrëveshje brenda dhe jashtë Jugosllavisë, me shumë kompani të huaja. Transformohet i tërë sistemi juridik i “Trepça-Comercit” si njësi financiare e ndërmarrjes. Lidhen kontrata fiktive me kompani greke, franceze, bullgare, serbe etj. Tentohet të legalizohen kreditor dhe investitor, siç është fondi për zhvillimin e Serbisë dhe të gjitha këto, në një periudhë kur nga “Trepça” punëtorët shqiptarë ishin dëbuar me dhunë nga vendet e tyre të punës, kur Serbia (Kosova e okupuar) ishin nën sanksione ndërkombëtare dhe Kosova sundohej me ligje lufte.

Këto dëme pronëso-ri-juridike dhe ekonomiko-financiare, fatkeqësisht, në një farë forme, do të legalizohen pas hyrjes së trupave ndërkombëtare në Kosovë dhe çlirimit të sajë. Ky legalizim, u bë nëpërmjet rregulloreve të shtyllës së parë dhe katërt të UNMIK-ut, dhe Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM-së).

Në emër të shpëtimit dhe mbrojtjes së "Trepçës", bëhet gabimi i rëndë strategjik, duke e vendosur nën moratorium ndërkombëtar, mbështetur në Rregulloren 2005/48. Kjo rregullore edhe pas shumë përpjekjeve të menaxhmentit të "Trepçës" për ta ndryshuar dhe hequr, ka arritur vetëm të shndërrohet në ligj, (Ligji për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Aseteve të tyre), i cili edhe pse është pak më i avancuar se sa rregullorja 2005/48, në fakt, nuk krijon shumë hapësirë për zhvillimin e kompleksit minerar "Trepça".

Prandaj, ndërmarrja "Trepça" ka nevojë për institucione financiare që e mbështesin në projektet e hulumtimeve e shkencore. Po ashtu, nisur nga fakti se sektori minerar në vend duhet të përcjell trendët globale të zhvillimit, rekomandohet mobilizim i institucioneve kompetente për sektorin minerar, për përgatitjen e rregullativës ligjore, për zbatimin e standardeve moderne për vlerësim dhe klasifikim të rezervave. Ndërkaq, gjatë procesit të ristrukturimit të kompleksit minerar "Trepça", klasifikimi dhe vlerësimi i rezervave minerale sipas standardeve moderne, duhet të jetë një nga komponentët kyç për realizim.

Në procesin e ristrukturimit, çështja e vlerësimit dhe kategorizimit do të jetë sfidë më vete.

2.3.4. Sfidat mjedisore

Gjatë veprimtarisë minerare mbi tetëdhjetëvjeçare (1930), të ndërmarrjes "Trepça", janë krijuar miliona tonelata të mbetjeve industriale, të depozituara përreth vendbanimeve, luginave e lumenjve, afër vendeve urbane, të cilat paraqesin kërcënim serioz për popullsinë vendëse.

Këto depozita të mbetjeve industriale, nuk janë trajtuar në aspektin teknologjik, asnjëherë gjatë historisë së krijimit të tyre.

Mbetjet industriale të krijuara kanë ndikuar dhe vazhdojnë të ndikojnë në shëndetin e popullsisë, përmes ndotjes së ujit, ajrit dhe tokës.

Ndikim negativ, ato kanë veçanërisht në shëndetin e foshnjave të porsalindura në spitalet përreth këtyre depozitave. Ndërkaq, rrezik të madh paraqet sasia e plumbit në gjak. Duke iu referuar raporteve dhe analizave të organizatave ndërkombëtare të OBSH-së, UNDP-së etj. konstatohet përmbajtje shumëfish më e lartë e këtij metali, se normat e lejuara.

Prandaj, trajtimi i këtyre mbetjeve, qoftë përmes riciklimit (për ato që kanë vlerë ekonomike) dhe rehabilitimi i depozitave të tyre, do të ndikoj jo vetëm në përmirësimin e shëndetit të popullsisë, por edhe në zhvillimin e bizneseve ekologjikisht të pastra, sipas standardeve ndërkombëtare

Në kuadër të ndërmarrjes “Trepça”, ekzistojnë depozita të mbetjeve industriale në sasi dhe përmbajtje që pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela: 2.3.4-1 Të dhënat për mbetjet industriale.

Vendi	Emri i depozitës	Materiali i deponuar	Statusi i depozitës	Sipërfaqja e depozitës në ha	Sasia, t
Leposaviq	Gornji Kmjin	Fundërrinë	Braktisur	6,5	2,6 x10 ⁶
Leposaviq	Bostanishte	Fundërrinë	Aktive	8-10	3,6x10 ⁶
Zveçan	Zhitkovc	Fundërrinë	Braktisur	26	8,5x10 ⁶
Zveçan	Gornje Pole	Fundërrinë	Braktisur	50	12x 10 ⁶
Kelmend	Kelmend	Fundërrinë	Aktive	8-10	3,6x10 ⁶
Graçanicë	Staro Jallovishtë	Fundërrinë	Braktisur	40	11x10 ⁶
Badovc	Badovc	Fundërrinë	Aktive	18	7,7x10 ⁶
Artanë	Artanë	Fundërrinë	Braktisur	4	1,8x10 ⁶
Zveçan	Gornje Pole	Zgjyrë Pb	Braktisur	4-6	2,5x10 ⁶
Zveçan	Zveçan	Hi	Braktisur	10-15	10x10 ³
Mitrovicë	PIM	Fosfogjips	Braktisur	10	4x10 ⁵
Mitrovicë	PIM	Pirit, pirotinë	Braktisur	9	5x10 ⁵
Mitrovicë	PIM	Jarosit	Jo aktive	5,4	1,2x10 ⁵

Problemet kryesore mjedisore që shkaktojnë këto mbetje, janë:

- Depozitat e parehabilituara minerare dhe zonat e ndotura minerare,
- Rrjedhat e ujërave acid nga minierat,
- Ndotja e ajrit gjatë kohës me erëra, nga depozitat minerare,
- Ndotja e ujërave sipërfaqësor nga depozitat e këtyre mbetjeve,
- Kontaminimi i ujërave nëntokësore nga precipitimi i metaleve dhe infiltrimi i ujërave nga depozitat e mbetjeve,
- Ndotja e ujërave sipërfaqësore nga erozioni i depozitave,
- Jo siguria e depozitave, rreziku nga aktiviteti sizmik dhe fatkeqësitë



Foto.2.3.4-1. Pamje e degradimit të mjedisit në Artanë.

Karakteristikat e përgjithshme kimike dhe sasiore të depozitave së mbetjeve minerare të kompleksit industrial "Trepça", janë dhënë në tabelën e mëposhtme:

Tabela: 2.3.4-2 Karakteristikat kimike të mbetjeve industriale.

Lloji	Depo- zita	Depo- zita	Depo- zita	Depo- zita	Depo- zita	Depo- zita	Depo- zita	Depo- zita	Mbe- tjet met. Në Zveçan	Mbe- tjet e Zinkut	Mbe- tjet e Zn
Loka- cioni	Kishni- ca (Graca- nica)	Kishni- caNë (Bad- ovc)	Artana	Gornje Polje	Zhitko- vac	Stan Tërg	Lepo- savic	Lepo- savic	Zveçan	Mitro- vica Parku Indu- strial	PIM
Statusi	Mbyllur	Aktive	Mbyllur	Mbyllur	Mbyllur	Aktive	Mbyllur	Aktive	Mbyllur	Mbyllur	
Masa Milion	11,5	8	4	12	9	9	2,7	3,7	2,6	0,5	0,13
Al ₂ O ₃ %	4,4	5,1	1,6	1,6		0,57	2,8		0,02	1,1	
Bi mg/kg	17	18		17		49	<10		25		
Cd mg/kg	47	34		<10		<10	18			2000	

Cu %	0,027	0,032		0,013	0,019	0,012		0,5
Fe ₂ O ₃ %	24,0	28		32	30	24	29	24
MgO %	3	4		<1	<1	3,9		0,7
Ni %	0,032	0,063		0,023	0,001	0,079		
Pb %	0,71	0,6	0,21	0,21	0,22	0,33	2,0	4,5
Zn %	0,69	0,56	0,14	0,14	0,12	0,26		21
ZnO %							12-Jul	
Ag g/t	17	12	20	12			256	50
Au g/t			1,3					
SiO ₂ %							18-20	
CaO %							20-22	

Sasia e materialit në depozitat e mbetjeve minerare vlerësohet diku rreth 60 milionë tonë, të shpërndara në lokacione të ndryshme. Këto depozita, në shumë vlerësime mjedisore, të institucioneve shkencore ndërkombëtare dhe vendore, janë cilësuar si “pika të nxehta” mjedisore, që duan trajtim adekuat.

Kjo është një barrë shumë e rëndë për “Trepçën” dhe si e vetme, nuk mund ta zgjidhë këtë problem, prandaj, i duhet ndihma e mekanizmave relevant shtetëror dhe donatorëve të mundshëm ndërkombëtar.

2.4 Institucionet e sektorit minerar

2.4.1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) – është themeluar me Vendim të Kuvendit nr. 218 të datës 24.02.2011, si dhe Rregulloren nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive.

MZHE është përgjegjës për hartimin e politikave dhe strategjisë për zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik, monitorimin e ndërmarrjeve publike, përgatit dhe implementon politikat dhe dokumentet e strategjive për sektorin e energjisë, minierave, sektorin postar, sektorin e telekomunikacionit dhe sektorin e teknologjisë informative, dokumentet e balancave të energjisë, efijencës së energjisë dhe burimeve të ripërtërishme të energjisë sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkëpunon në përgatitjen dhe implementimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në sektorët e zhvillimit.

2.4.2. Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), është organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht autonome. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna mbi ligj; si dhe të padis e të paditet në emër të saj.

Agjencia është pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), që është themeluar dhe rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 "Mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit", dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë asete dhe përgjegjësi të Agjencisë.

Në pajtim me kushtet e përcaktuara në këtë ligj, Agjencia është e autorizuar për administrim, duke përfshirë autorizimin për shitje, transferim ose likuidimin ndërmarrjeve dhe aseteve të përkufizuara në këtë ligj.

"Trepça", që nga paslufta, ndodhet nën menaxhimin e AKM-AKP-së dhe tash së fundi edhe nën moratorium, që nënkupton kufizime të mëdha për sa i përket të gjithë veprimtarisë së saj, ekonomike, menaxhuese etj. Këto kufizime janë pengesë për zhvillimin e ndërmarrjes si dhe për ripërtëritjen e vërtetë të saj.

Gabimi strategjik për "Trepçën" është bërë atëherë kur është lënë nën menaxhim të AKM-së-AKP-së, e jo ta administrojë Qeveria, si një ndërmarrje shoqërore, për çka direkt do të merrte obligime zhvillimore.

2.4.3. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM)

Roli i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale është implementimi i legjislacionit mineral, si dhe ekzekutimi i strategjive dhe politikave të Qeverisë për zhvillimin e sektorit mineral.

Komisioni rregullon dhe i mbikëqyrë:

- Eksplorimin dhe shfrytëzimin e rregullt të resurseve minerale në Republikën e Kosovës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- Shfrytëzimin optimal të resurseve minerale në të gjitha veprimet e shfrytëzimit të minierave dhe zvogëlimin e ndikimit të veprimeve të shfrytëzimit të minierave në mjedis dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare për veprimet në miniera dhe në gurore;

- Sigurinë gjatë veprimeve të nxjerrjes së mineraleve dhe në objektet e përpunimit, në pajtim me ligjin në fuqi dhe me standardet e nevojshme për sigurinë;
- Pajtueshmërinë e përgjithshme të veprimeve për shfrytëzimin e minierave me kushtet e licencave, marrëveshjeve për leje dhe të instrumenteve të tjera për autorizim.

Komisioni, në pajtim me ligjin në fuqi, është përgjegjës për kryerjen e funksioneve vijuese:

- Lëshimin, bartjen, pezullimin dhe tërheqjen e lejeve dhe të licencave për eksplorim dhe shfrytëzim;
- Lëshimin, bartjen, pezullimin dhe tërheqjen e lejeve dhe të licencave lidhur me shfrytëzimin e lëndëve plasëse, në veprimet për shfrytëzimin e minierave;
- Kryerjen e hetimeve lidhur me aksidentet që ndodhin në miniera dhe në gurore dhe veprimet e domosdoshme që nevojiten si pasojë e kësaj;
- Krijimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave për titullarët e mineraleve dhe të drejtave për shfrytëzimin e minierave;
- Ofrimin e ndihmës teknike Qeverisë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me minierat dhe mineralet në Kosovë.

2.5. Tregu dhe asetet

Ndërmarrja "Trepça" i ka kaluar me sukses vitet e krizës globale, krizë kjo që pat goditur rëndë tregun e metaleve. Kërkesat për metale dhe koncentre pothuajse kishin rënë në pikën më të ulët. Ata pak ofertues që kishin mbetur, ofronin çmime nën koston e prodhimit. Shumë ndërmarrje të sektorit minerar ishin goditur, kishin falimentuar ose ndërprerë prodhimtarinë për të mos krijuar humbje të mëdha. Megjithatë, në "Trepçë", falë masave operationale të menaxhmentit, prodhimi nuk ishte ndalur, por kishte vazhduar për të krijuar stoke koncentratesh, në mënyrë që ato të plasoheshin në treg në çastin kur çmimi të jetë i volitshëm. Mirëpo, situata tani ka ndryshuar rrënjësisht. Kriza ka kaluar. Tregu i metaleve po stabilizohet çdo ditë e më shumë. Kërkesat në tregun global po rriten. Faktorë ndikues në këtë situatë, në treg janë shtetet aziatike, siç janë: Kina dhe India, por edhe shtetet tjera që janë konsumues të fuqishëm të metaleve me ngjyrë. Nëse shikojmë relacionin e kërkesës dhe prodhimit, atëherë vërejmë një zbrazëti në relacionin kërkesë-prodhimtari të Pb-Zn, gjithnjë duke u mbështetur në të dhënat e institutit të Lisbonës.

Pra, kjo situatë e viteve të fundit, është në favor të ndërmarrjes “Trepça”. Ndërmarrja e ka rritur prodhimtarinë duke dalë në tregun evropian me koncentrate të Pb-Zn me parametra të lartë cilësor.

2.5.1. Asetet e ndërmarrjes “Trepça”

Dikur ndërmarrja kishte një kapacitet, vlerë, fuqi të madhe të aseteve të shtrira brenda dhe jashtë Kosovës. Aktualisht, ndërmarrja është e ndarë në dysh, si njësi në veri dhe njësi në jug, me situatë të paqartë, të pa definuar pronëso-ro-juridike. Po ashtu, ka shumë probleme në evidentimin dhe menaxhimin e aseteve brenda dhe jashtë vendit. Në kuadër të këtij kompleksi, mbështetur në strategjinë minerare, AKP-së dhe “Trepçës”, në vitin 2009/2010, asetet e ndërmarrjes janë ndarë në dy grupe kryesore:

Në asetet aktive – që përfshijnë të gjitha minierat dhe vendburimet, metalurgjitë dhe industrinë kimike, e mbështetur në hapat operacionalë, planifikohet të jenë dhe të menaxhohen nga institucionet shtetërore, duke llogaritur që rivitalizimi i tyre të bëhet me transparencë dhe standarde të ekonomisë së tregut të lirë.

Asetet pasive – janë industria përpunuese e metaleve e shtrirë anekënd Kosovës, industria e baterive, objektet sportive hoteliere dhe turistike etj. Po ashtu, mbështetur në draft-strategjinë e lartpërmendur, këto asete i ka ndarë nga “Trepça” dhe i ka dhënë autorizim AKP-së që t’i privatizojë. Pra, deri më tani janë privatizuar: “Famipa” në Prizren, Ni-Cd në Gjilan, Llamkos në Vushtrri, Extra e Vushtrrisë, ndërsa pritet të privatizohet “Metaliku” në Gjakovë, mandej fabrika e municionit në Skenderaj, fabrika e baterive industriale në Pejë etj. Ideja e privatizimit të këtyre aseteve është që të ndërpritet degradimi i mëtejshëm i tyre dhe që këto asete të jenë sa më parë në pronësi të investitorëve të biznesit privat.

KAPITULLI III

3. RISTRUKTURIMI SI KËRKESË EKONOMIKE DHE MENAXHERIALE

Shikuar nga prizmi i problemeve të shumta, “Trepçën” e presin sfida të shumta që duhet t’i tejkalojë. Prandaj, është nevojë e ngutshme që sa më parë të nisë rristrukturimi i mirëfilltë i ndërmarrjes, që është emëruesi i përbashkët i të gjitha sfidave.

3.1 Kriza e kompanisë

Secila kompani, e cila duhet të rristrukturuar dhe rehabilituar, përballet me situata krize. Kjo nënkupton një situatë jo të lehtë për t’u kontrolluar, me ekzistencë të rreziqeve për kompaninë. Prodhimi i saj është „ambivalent” dhe kështu rrezikon synimet e ndryshme të kompanisë. Një diferencim i tillë, të cilin e kemi përdorur në këtë libër, është sipas studimit të Mullerit. Synimet e rrezikuara të kompanive ai i ndan në:

- Kriza strategjike, ku kërcënohen potencialet e suksesit të kompanisë;
- Kriza suksesi, ku kërcënohen synimet e suksesit (të tilla si fitimi, qarkullimi, etj.), dhe
- Kriza likuiditeti, ku ekziston rreziku i delikuiditetit apo paaftësisë pagues dhe borxheve të kompanisë.

Në ecurinë e idealizuar kohore, kriza strategjike është vetë krizë suksesi, e cila më pastaj shndërrohet në krizë likuiditeti. Kriza e likuiditetit, nga ana e saj, mund të çojë në falimentim. Mirëpo, identifikimi i ecurisë së krizave, zakonisht ndodhë me renditjen e kundërt, d.m.th. kriza e likuiditetit identifikohet para krizës së suksesit.

3.2 Identifikimi i problemeve dhe vendosja e synimeve

E kaluara e ndërmarrjes “Trepça” është çështje ekonomike dhe politike, që domosdo reflekton në të sotmen, herë si krizë ekonomike, herë si krizë sociale, e shpesh si krizë edhe politike. Po ashtu, kjo e kaluar na ka sjell para një fakti, që sot “Trepça” të menaxhohet nga një konglomerat nivelesh menaxhuese. Shih fig. poshtë:




Figura: 2.5.1-1 Nivelet menaxhuese të ndërmarrjes “Trepça”.

Gjykata Supreme - Dhoma e Veçantë - Bordi i AKP-së - njësia për “Trepçën” si segment i AKP-së dhe menaxhmenti i “Trepçës”. Në një situatë të tillë nivelesh menaxhuese, domosdo lind nevoja për ridefinim të pozicionit menaxhues dhe politikave operacionale. Në të kundërtën, suksesi do të bie.

Në këtë relacion kompetencash, ndërmarrja “Trepça” s’do të mund t’i përballonte kërkesave të tregut, sepse asnjë vendim të rëndësishëm nuk mund ta marrë vet.

Teknologjitë e reja si dhe tregjet e reja, si Kina dhe India, sjellin ndryshime në mjedisin e shumë kompanive. Përmes këtyre ndryshimeve, si dhe përmes rritjes së presionit konkurrues, si pasojë e ritmit të përshpejtuar të globalizimit, shumë kompani po ballafaqohen me sfida të reja. Megjithatë, ato shpesh nuk

ecin në përputhje me to. Arsye kryesore për këtë, është shpesh pritja e tepërt rreth shitjes dhe qarkullimit. Mbi këtë bazë, po bëhen investime të cilat pastaj e humbin likuiditetin, e kështu, zakonisht shkaktojnë rritje afatgjate të kostove fikse të kompanisë. Kur qarkullimet e planifikuara nuk mund të realizohen, kompanitë hyjnë në një situatë të përkeqësuar dështimi, apo edhe u kërcënohet falimentimi, si *pasojë e (kërcënimit) paaftësisë për të paguar* ose si pasojë e borxheve bilancore. Këto janë shpesh arsyet e likuidimit, respektivisht të shkatërrimit të kompanisë.

Çdo vonesë e mosfillimit të procesit të mirëfilltë të ristrukturimit të ndërmarrjes “Trepça”, mbështetur në sa u tha më lartë, do t'i kushtonte shumë kësaj ndërmarrje.

Përmes falimentimit shkaktohet një mori e dëmeve ekonomiko-sociale. Kapitali i përdorur për financimin e kompanisë, i cili ofrohet nga kapitali vetjak dhe i huaj (kryesisht nga bankat dhe investitorët), me rastin e falimentimit pothuajse humbet tërësisht. Menaxhmenti dhe të paktën disa nga punëtorët, humbin vendet e tyre të punës. Konsumatorëve të kompanisë, e cila është në vështirësi, u humbet furnizuesi i tyre kryesor. Fondet e pensionit nuk marrin pagesa të tjera. Së fundi, **me falimentimin e kompanisë, shteti humb një tatimpagues dhe një punëdhënës.** Edhe pse tepër e vonshme, një mundësi për t'iu shmangur falimentimit është rehabilitimi i kompanive të kapluar nga kriza. Kjo mundësi mund të aplikohet vetëm nëse vlera e mbetur e kompanive (**vlera cash**), është më e madhe ose e barabartë me vlerën e falimentimit. Këtu megjithatë, duhet llogaritur edhe kostoja e rehabilitimit.

$$\text{Vlera kesh e kompanisë} \geq \text{Vlera e falimentimit} + \text{Kostoja e ristrukturimit} = \text{Ristrukturim}$$

Nisur nga këto fakte shkencore, tani të aplikuara në shumë shtete dhe kompani, konstatojmë se vlera cash e “Trepçës” është e garantuar dhe më e madhe se vlera e falimentimit duke llogaritur edhe koston e rehabilitimit. Këtë mund ta argumentojmë duke marrë parasysh regjistrin e aseteve të ndërmarrjes “Trepça”, faktorin e aseteve thelbësore siç janë: minierat, metalurgjitë, flotacionet dhe asetet tjera. Përkrah këtij kompleksi, është vërtetuar, se faktori kohë gjatë rehabilitimit, është një resurs jashtëzakonisht i rrallë.

- Në hulumtimet gjermane, rehabilitimit iu kushtua vëmendje e veçantë, sidomos në vitet 1980 dhe 1990.

Me planin e falimentimit në shumë raste krijohet mundësia e një zgjidhjeje miqësore për të trajtuar aftësinë paguese të kompanisë, e cila është drejtuar kah rikthimi i profitabilitetit dhe përmbushja e kërkesave të kreditorëve.

Ky proces i ofron, si kreditorit, ashtu edhe debitorit, përfitime të shumta. Kështu kreditorët e pasiguruar në procedurat e falimentimit, arrijnë një normë mesatare prej rreth 20% për kërkesat e tyre të pazgjidhura (zakonisht kjo normë arrin vetëm në 3-5%). Përveç kësaj, ata marrin paratë e tyre brenda një kohe shumë të shkurtër. Nga ana e borxhliut, profiti shihet nga fakti që marrëdhënia e punës mund të shkëputet me një afat tremujor paralajmërimi dhe sipas planit të falimentimit, pagesat kufizohen për dy herë e gjysmë nga të ardhurat bruto mujore. Për më tepër, përmbushja e plotë e kushteve të kontratës së pafavorshme për kompaninë mund të refuzohet nga likuidatori i falimentimit. Megjithatë, kjo metodë aplikohet shumë rrallë. Arsyet e mundshme për mospërdorim mund të jenë për shkak se procesi nuk është mjaft i njohur dhe likuidatorët janë të stërngarkuar me planin e komplikuar të falimentimit.

- Në rastin "Trepça", tashmë është në fuqi Kapitulli XI i Kushtetutës Amerikane që mendojmë se është metoda dhe mënyra jo më e mira për zgjidhjen e problemit për "Trepçën". Për arsye se Kapitulli XI zgjidh problemin e hekurudhave të ShBA-së në vitet '36-40. Ky kapitull, është në disproporcion nga aspekti kohor, social, politik dhe ekonomik. *(Sqarim: rreg. 2005/48 e shndërruar tashmë në Ligj për Ristrukturimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve të Veçanta, praktikisht është modeli i Kapitullit XI të Kushtetutës Amerikane).*

Puna aktuale ka për synim t'i trajtojë nga afër fushat e përzgjedhura të hulumtimit që lidhen me rehabilitimin e kompanive. Me rëndësi të veçantë është për t'u marrë me:

- Shkaqet e krizës së kompanisë që shpijnë deri në nevojën për rehabilitim;
- Strategjitë e rehabilitimit me të cilën mund të tejkalohet kriza si dhe
- Konfliktet e interesit në mes të palëve të përfshira në rehabilitim, gjatë përzgjedhjes dhe aplikimit të strategjisë për rehabilitim.

Aktualisht, "Trepça" nuk ka strategji të qartë ose të miratuar nga institucionet menaxhuese siç është AKP-ja. Hartimi i një strategjie dhe zbatimi i saj, do ta qartësonte rrugën e ristrukturimit, gjegjësisht rehabilitimit, duke përfshirë

koston, kohën, grupet e interesit, problematikat socio-ekonomike, mjedisore dhe metodologjinë e zgjidhjes së problemit “Trepçë”.

Në kuadër të hartimit të kësaj strategjie, e cila do t'i trajtonte tri komponentët e lartshënuara, që janë shkaqet e krizës, modelet e rehabilitimit dhe konfliktet e interesit në mes të palëve, do të jepej alternativa më kuptimplote dhe shkencore për daljen nga kjo situatë.

3.3. Fazat e zhvillimit dhe roli i “Trepçës” në ekonominë e Kosovës

“Trepça”, si ndërmarrje me traditë mbi 80-vjeçare dhe si vendburim i plumbit (Pb), zinkut (Zn), arit (Au), argjendit (Ag) dhe mineraleve tjera, duhet të jetë bartës kryesor i zhvillimit të sektorit mineral dhe metalurgjik. Kjo mund të ndodhë, sepse “Trepça” ka rezerva të konsiderueshme minerale, ekspertë, teknikë dhe xehetarë të kualifikuar. Po ashtu, një pjesë e industrisë përpunuese mund të hyjë në funksion, ndërsa investime të mëdha duhen bërë në riparimin e Elektrolizës së Zinkut (sipas ekspertëve të “Trepçës” rreth 30 mil. euro). Ndërkaq, metalurgjia e plumbit duhet të ndërtohet e re, varësisht nga kapaciteti dhe lloji i teknologjisë që përzgjidhet.


Hartimi i një strategjie të qartë, mbi bazën e parametrave ekonomikë dhe shkencorë për këtë sektor, si dhe kompletimi i legjislacionit, do të krijonin mundësi për zhvillimin e sektorit më strategjik të vendit-sektorit mineral.

Në këtë strategji zhvillimore do të inkuoroheshin sektori shtetëror-publik dhe ai privat, si dhe kapitali vendor dhe ndërkombëtar.

Fazë e parë e këtij zhvillimi, do të ishte riaftësimi i të gjitha minierave të Pb-Zn. Po ashtu, duhet dhënë licenca për hulumtime për të gjitha zonat e interesit mineral, veçanërisht atyre të Pb-Zn.

Faza e dytë do të ishte modernizimi i teknologjive përpunuese, i fabrikave ekzistuese të pasurimit me lotim, siç janë: në Kishnicë, Tunel të Parë, Leposaviq, por me kapacitete të shtuara. Këto fabrika të pasurimit të mineraleve, do të duhej të viheshin në dispozicion të pasurimit të mineraleve edhe për sektorin privat në perspektivë (zonat e interesit).

Faza e tretë, do duhej të ishte rindërtimi i metalurgjikëve të zinkut dhe plumbit me teknologji dhe parametra modern edhe në kuptimin mjedisorë, ku po ashtu, këto metalurgji do të ishin në dispozicion të sektorit shtetëror “Trepça”, por edhe të sektorit privat, qoftë atij vendor apo ndërkombëtar.



Skema: 3.3-1. Gërshetimi i sektorit privat (zonat e interesit) dhe sektorit publik, asetet e “Trepçës”.

KAPITULLI IV

4.1. TRENDËT BOTËRORE

Oferta dhe kërkesa e plumbit dhe zinkut duhet të vëzhgohet duke i pasur parasysh tregjet e këtyre metaleve. Duke qenë se plumbi dhe zinku iu takojnë grupit të mineraleve sulfure, prandaj, gjenden të bashkëshoqëruara në depozitimet xeherore. Po ashtu, ato bashkëshoqërohen në sasi më të vogla të metaleve të tjera, siç është argjendi dhe ari. Implikimet themelore të ndërvarësisë në raportin ofertë- kërkesë, është se ndryshimet e politikave që do të ndikojnë mbi plumbin, do të kenë efekte edhe mbi ekonominë e prodhimit të zinkut dhe anasjelltas. Karakteristikë tjetër e kësaj industrie është që në nivel botëror, dominojnë një numër relativisht i vogël i kompanive të mëdha multinacionale të integruara vertikalisht, të cilat janë të pranishme në shumë vende.

Tregu botëror i plumbit dhe zinkut, vlerësohet të jetë rreth 19 milionë tonë metal në vit (8.71 milion tonë metal për plumbin dhe 11.278 milion tonë metal për zinkun në vitin 2009). Në periudhën 2001-2009, shkalla mesatare vjetore e rritjes së prodhimit të metalit arrin 3.07% te plumbi, ndërsa 2,6% te zinku. Rritja vjetore e kërkesave për këto metale, arrin rreth 150-200.000 mijë tonë. Ndërkaq, nga riciklimi përfitohen dhe tregtohen rreth 100-150.000 mijë tonë.




Fig.4.1-1.
Trendi global
vjetor i prodhimit
të Pb-Zn.

Mineralet e plumbit dhe të zinkut eksploatohen dhe përpunohen në shumë vende të botës. Por, vetëm një numër i vogël i vendeve, paraqiten me pjesëmarrje më të madhe vetjake. Në këtë rast, tregu global i koncentratit, është i orientuar drejt Azisë (Kina, India dhe Japonia).

Çështja e ndotjes së mjedisit nga metalet, që një kohë të gjatë është objektiv i përpjekjeve për zvogëlimin e rreziqeve kimike nga metalet. Shumë organizata ndërkombëtare (OKB dhe Programi Mjedisor i OKB-së, Komisioni Evropian dhe OECD etj.), analizojnë dhe përcjellin ndikimin e metaleve bazë në shëndetin e mjedisit jetësor, si dhe nevojën për përpjekje dhe aktivitete të përqendruara ndërkombëtare, për zvogëlimin e prodhimitarisë, përdorimin dhe ruajtjen e metaleve. Komisioni Evropian ka miratuar disa direktiva në lidhje me përdorimin e plumbit, bakrit dhe zinkut, gjatë shfrytëzimit të tyre për prodhimtarinë e lëndëve të dedikuara për konsum të gjerë.

Përpjekjet që bëhen në nivel botëror, kanë për qëllim të zhvillohet ndërgjegjja ndërkombëtare, politika dhe rregulloret në lidhje me zvogëlimin e rreziqeve kimike. Politika për zvogëlimin e rreziqeve lidhur me përdorimin e plumbit, pasqyrohet mbi prodhimtarinë dhe shitjen e plumbit dhe zinkut. Këto orvatje, për menaxhimin e rreziqeve në lidhje me ekspozimin përballë plumbit, pritet të ndikojnë në zvogëlimin e kërkesave nga njëra anë dhe ta rrisin koston prodhuese për plumbin, sidomos në vendet e zhvilluara anëtare të OECD-së. Kjo do të kontribuojë që konkurrenca e vendeve të OECD-së, në këtë industri të zvogëlohet, ndërsa prodhimtaria e plumbit të përhapet në vendet më pak të zhvilluara, ku standardet lidhur me mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve janë më të ulëta.

Përveç kësaj, nxitja e riciklimit të plumbit, mund të ndikojë mbi vëllimin e prodhimitarisë dhe të çmimeve të plumbit primar dhe sekondar.

Marrë në përgjithësi, të dhënat tregojnë se disa faktorë kanë ndikim vendimtar në formimin e tregut të plumbit dhe zinkut. Zhvillimi global botëror dhe kërkesa në industrinë kryesore konsumatore, së bashku me shkallën e rritjes ekonomike të vendeve kryesore, konsumuese së këtyre metaleve, do të kenë ndikim udhëheqës në formimin e ofertës, kërkesës dhe çmimeve të këtyre metaleve. Lëvizja dhe ndryshimi i çmimeve të metaleve alternative, sidomos i argjendit, bakrit dhe arit, do të ndikojë gjithashtu në rentabilitetin përfundimtar dhe profitabilitetin e industrisë së plumb-zinkut. Stoqet e metaleve në Bursën e Metaleve të Londrës (LME), kanë ndikim të rëndësishëm në formimin e çmimeve dhe në disponimin e mjeteve për investime në këtë veprimtari, para së gjithash për hapjen e minierave të reja dhe riaktivizimin e atyre ekzistuese.

Analiza e trendëve botërore të ofertës dhe konsumit të plumbit dhe zinkut, së bashku me lëvizjen e çmimeve të këtyre metaleve, janë të domosdoshme në përcaktimin e nevojës për riaktivizimin dhe ristrukturimi i minierave të "Trepçës". Përpjekja për të bërë analizë më të thellë të tregjeve të këtyre metaleve, paraqet bazë të mirë për marrjen e vendimeve lidhur me ristrukturimin e thellë dhe prodhimtarinë e xeheve, të koncentratit dhe të metalit.

Në raportet statistikore ndërkombëtare për prodhimtarinë e xeherorëve së plumbit, zinkut, arit, argjendit, koncentrateve dhe të metaleve, për konsum dhe për tregti me to, nuk ka të dhëna nga Kosova.

Mund të thuhet se, të dhënat për industrinë minerare për Republikën e Kosovës, mungojnë në raportet statistikore botërore. Gjendja e këtillë e vështirëson analizën për vendin tonë, rolin dhe perspektivat e industrisë së metaleve me ngjyrë, në kuadër të ekonomisë së Kosovës.

4.2. Përcaktuesit themelorë, rrjedha e prodhimtarisë dhe e konsumit të plumbit dhe zinkut

Pjesa më e madhe e prodhimtarisë primare botërore të plumbit dhe zinkut vjen nga xehet sulfure, të ngjashme për nga aspekti gjenetik, me xeherorët e kompleksit të minierave të "Trepçës".

Rreth 60% e prodhimtarisë botërore së xeherorëve së plumbit vjen nga minierat që përmbajnë edhe sasi të caktuara të zinkut dhe argjendit. Metale tjera që i bashkëshoqërojnë xeherorët e plumbit dhe të zinkut janë: ari, kadmiumi, antimoni, bismuti, galiumi, germaniumi etj. Për shkak të pjesëmarrjes së këtyre metaleve dytësore, ekonomia e prodhimtarisë së plumbit nuk mund të analizohet në mënyrë të izoluar nga prodhimtaria e metaleve që i shoqërojnë ato.

Duhet të kemi parasysh, se pjesëmarrja sasiore e disa metaleve të caktuara në strukturën e xeherorëve, lëviz në trupat minerar, varësisht nga gjeologjia e ndërtimit të vendburimit. Gjatë këtyre viteve të fundit, kërkesat për metale me ngjyra janë rritur. Prandaj, me përmirësimin e teknologjisë së pasurimit të xeherorëve me flotim, do të prodhoheshin koncentrate të të gjitha llojeve të metaleve që gjenden në minierat e "Trepçës". Kjo do të rriste vlerën ekonomike të ndërmarrjes dhe rentabilitetin e saj. Po ashtu, çmimet e këtyre metaleve në tregun global, janë faktorë me ndikim që duhet të merren parasysh. Kështu, varësisht nga ndryshimet e çmimeve të metaleve, disa sosh, kontribuojnë më shumë në prodhimin e përgjithshëm, se sa tjerat, etj.

Proporcionet mund të ndërrohen në varësi nga përbërja e vendburimit, thellësia e shfrytëzimit, ndryshimet në përbërjen e xeherorëve, teknologjisë, kërkesës dhe çmimeve. Nëse çmimet e plumbit zvogëlohen dukshëm, atëherë rentabiliteti i xeherorëve të plumbit (metalit) mund të rrezikohet. Megjithatë, prodhimtaria e metaleve të tjera, mund ta kompensojnë, në njëfarë mase çmimin e ulët të plumbit. Kjo do të thotë, se vendimi për hapjen e minierave të plumbit-zinkut, merret duke u bazuar në vlerën ekonomike të të gjitha metaleve pjesëmarrëse në xeheror. Ndërkaq, çdo rënie e madhe e çmimeve të cilitdo metal, do të ndikojë në rentabilitetin e minierës në tërësi.

Duke pasur parasysh, se në rentabilitetin e minierave, ndikim të rëndësishëm ka pjesëmarrja e të gjitha produkteve që përfitohen nga xeherori, shkaktohen

vështirësi të mëdha, kur çmimet nuk janë të qëndrueshme dhe luhaten shpesh. Gjendja e këtillë shkakton jostabilitet dhe pasiguri.

Në rast se çmimi i ndonjë metali zvogëlohet dukshëm, në kushte të çmimeve të pandryshuara të metalet tjera, kompania mund të ketë humbje financiare.

Mosshfrytëzimi i trupave xeherorë të varfër dhe trajtimi i tyre, do të shkaktojë shpenzime shtesë në procesin e eksploatimit. Kjo do të thotë, se fakti që përmbajtja e metalit nuk është e barabartë në kuadër të gjithë vendburimit, mund të sjellë deri në shfrytëzimin të trupave xeheror me përqendrim më të lartë të metalit.

Prodhimtaria e xeherorëve të plumbit, metalit të plumbit dhe konsumit të këtij metali, shënojnë dinamikë të ndryshme të rritjes në dyzet vitet e shkuara. Te plumbi, karakteristikë kryesore është rritja më e vogël e prodhimitarisë së këtij metali dhe shpenzimit të tij. Kështu, sipas të dhënave të Buletinit të Grupit Ndërkombëtar Studimor për Plumb dhe Zink (ILZSG-International Lead and Zinc Study Group), periudha 1972 – 2009, prodhimtaria e xeherorëve të plumbit realizoi rritje të indeksit 107,4. Ndërkaq, prodhimtaria e metalit në periudhën e njëjtë shënon indeks të rritjes prej 181,6 pikë, ndërsa konsumi i metalit të plumbit 177,4 pikë. Dallimi i madh mes prodhimitarisë së xeherorëve të plumbit nga njëra anë dhe prodhimitarisë së metalit dhe konsumi nga ana tjetër, sqarohet me pjesëmarrje gjithnjë e më të madhe të plumbit të ricikluar, në sasinë e përgjithshme të plumbit të prodhuar, sidomos nga riciklimi i akumulatorëve për automobila.

Dallimet e mëdha në rritjen e prodhimitarisë së xeherorëve të plumbit, prodhimit dhe konsumit të këtij metali, manifestohen edhe në shkallën mesatare të rritjes, të cilën ata e realizojnë. Kështu, prodhimi i xeherorëve të plumbit, në periudhën 1972-2009, shënon shkallë mesatare të rritjes prej 2,83 për qind pikë, ndërsa shkalla mesatare e rritjes së prodhimitarisë së metalit arrin 4,78 pikë, ajo e konsumit të metalit 4,67 pikë.

Prodhimi i xeherorëve të plumbit në periudhën e viteve 1972-1993, shënon shkallë negative të rritjes, e ky rast, edhe pse në shkallë më të ulët, përsëritet edhe në vitin 2002. Natyrisht, u zvogëlua edhe prodhimi dhe shpenzimi i këtij metali. Megjithatë, periudha pas vitit 2003, karakterizohet me shkallë pozitive të rritjes, të cilat në disa vite janë mjaft të larta. Kjo dinamikë sqarohet me rritjet pozitive dhe fuqizimin e ekonomive të shumë shteteve të botës.

Është interesant të theksohet fakti, se kur në vitin 2008 dhe 2009, ekonomia botërore u përball me recesion dhe me krizë të madhe financiare, nuk ndikoi në shfrytëzimin e xeherorëve dhe prodhimin e metaleve. Vetëm në vitin 2009, vërehet zvogëlim i konsumit prej 0.3%, së këtyre metaleve. Nga kjo, mund të nxirret konkluzioni, se në periudha afatgjata, duhet të pritet rritje relativisht mesatare e prodhimit të xeherorëve, metaleve dhe të konsumit të plumbit dhe zinkut. Mbi lëvizjet e këtilla pozitive, ndikim të fuqishëm do të ketë sidomos zhvillimi i industrisë së automobilave dhe shitja e tyre në ekonomitë e mëdha

në rritje, siç është: Kina, India, Brazili, Rusia etj. Sipas të dhënave në figurën 3.2, ndryshimet në prodhimtarinë botërore janë dukshëm më të mëdha pas vitit 2003. Kështu, në periudhën 2001–2009, prodhimi i xeherorëve, metalit dhe konsumit të metalit të plumbit, realizojnë indeks mjaft të lartë të rritjes prej 127,9 pikë, 232,4 pikë dhe 133,1 pikë.




Fig. 4.2-1 Indeksi global i prodhimit dhe konsumit të plumbit (1972–2009).

Sipas të dhënave të tabelës së mësipërme, bota realizon dinamikë të shpejtë të rritjes, sidomos pas vitit të 2003, në kushtet kur ka një tendencë të zvogëlimit të pjesëmarrjes të së ashtuquajturës “Bota Perëndimore”, në prodhimtarinë e përgjithshme dhe konsumin e plumbit. Pjesëmarrja e të ashtuquajturës “Bota Perëndimore” në prodhimtarinë botërore të xeherorëve është zvogëluar nga 74,7%, sa arrinte në vitin 2001 në 52,6% në vitin 2009. Ndërsa, pjesëmarrja në prodhimin e metalit ka tendencë të ngjashme të zvogëlimit (nga 75,% në 52,%). Zhvendosje më të mëdha paraqiten në konsumin e metalit të plumbit, e cila në “Botën Perëndimore” në vitin 2001 arrinte 84,2% të konsumit botëror, ndërsa në vitin 2009 ajo merrte pjesë me 51,6% nga konsumi i përgjithshëm botëror. Ndryshimet në pjesëmarrje, janë rezultat i rritjes dukshëm më të shpejtë, të tri dukurive ekonomike të analizuara në botë (indeks 127,9 pikë, 132,4 pikë dhe 133,1 pikë, në krahasim me realizimet në “Botën perëndimore”, të cilat realizojnë 90,2 pikë indeksi, 91,9 pikë dhe 81,6 pikë).

Tabela 4.2-2 Indeksi i prodhimit dhe konsumit për plumb.

Viti	Statistikat në nivel botëror					
	Prodhimi i xeherorëve	~+ / - %	Prodhimi i metalit	~+ / -	Konsumi metalit	~+ / - %
2001	3.009	-2,1	6.588	-1,2	6.480	-0,5
2002	2.843	-5,5	6.676	1,3	6.635	2,4
2003	3.122	9,8	6.793	1,8	6.844	3,1
2004	3.130	0,3	7.005	3,1	7.297	6,6
2005	3.423	9,4	7.624	8,8	7.786	6,7
2006	3.526	3,0	7.935	4,1	8.062	3,5
2007	3.626	2,8	8.121	2,3	8.177	1,4
2008	3.749	3,4	8.654	6,6	8.647	5,7
2009	3.850	2,7	8.721	0,8	8.625	-0,3

Bazuar në tabelën e mësipërme, ku do të shihet grafiku i ndryshimeve të indeksit në prodhim të xeherorëve, prodhimit dhe konsumit, për metalin e plumbit.




Fig. 4.2-3
Grafiku i indeksit të ndryshimit të prodhimit dhe konsumit për metalin plumb (2001-2009).

Prodhimi i xeherorëve të zinkut, metalit dhe konsumi i zinkut, shënojnë dinamikë të ndryshme të rritjes gjatë periudhës 1972-2009. Për dallim nga plumbi, karakteristika kryesore e realizimeve globale në fushën e zinkut paraqet rritje relativisht të madhe të prodhimitarisë së xeherorëve, prodhimitarisë dhe konsumit të metalit. Kjo, në pajtim me të dhënat e ILZSG, në periudhën 1972 – 2009, prodhimtaria e xeherorëve së zinkut realizoi rritje prej 194,0 pikë indeksi, prodhimtaria metalit në periudhën e njëjtë shënon rritje prej 204,5 pikë, ndërsa konsumi i metalit të zinkut 190,7 pikë indeksi. Si rezultat i shkallëve të larta të rritjes, të cilat realizohen te prodhimtaria e xehe së zinkut, të metalit, të konsumit së këtij metali, gjatë viteve 1972-2009, shkallët mesatare arrijnë 5,1 % te prodhimtaria e xeherorëve, 5,1% te prodhimtaria e metalit dhe 5% te konsumi i metalit.

Dallimi i madh mes realizimeve në fushën e zinkut, krahasuar me plumbin, në pjesën më të madhe janë rezultat i vëllimit më të vogël të riciklimit së zinkut dhe kërkesave relativisht më të mëdha për këtë metal. Gjithashtu, rrjedhat afatgjate të prodhimitarisë dhe konsumit të zinkut, janë me ndikim më të vogël nga ato që vërehen te plumbi. Lëvizjet ciklike dhe dukuritë recesione te zinku, kanë intensitet relativisht më të vogël në krahasim me plumbin.

Karakteristikë kryesore afatgjate e prodhimitarisë së xeherorëve së zinkut, prodhimitarisë së metalit dhe konsumit së këtij metali, është tendenca e rritjes së vazhdueshme. Dukuritë e zvogëlimit të prodhimitarisë, si rezultat i recesionit i përkasin një viti, ndërsa rrallë në dy vite të njëpasnjëshme. Kështu, në periudhën 2001-2009, prodhimtaria e xeherorëve realizoi rritje mesatare vjetore prej 2,9%, prodhimtaria e metalit prej 2,6%, ndërsa konsumi i metalit prej 2,1%.

Ngjashëm me realizimet te plumbi dhe zinku, duhet të kihet parasysh se ndryshimet që paraqiten në suaza të prodhimitarisë botërore dhe konsumit, pjesën më të madhe e përcakton ekonomia e Kinës. Shifrat konfirmojnë, se shkallë të larta vjetore të rritjes së ekonomisë së këtij vendi, në pjesën më të madhe janë shkaktar për ndryshimet në fushën e prodhimit të zinkut.

Në bazë të të dhënave në grafikun 4.2-4, mund të konstatohet se pjesëmarrja në të ashtuquajturën “Bota Perëndimore”, në prodhimitarinë e zinkut, është zvogëluar nga 74,1%, sa arrinte në vitin 2001, në 64,8% në vitin 2009. Megjithatë, te prodhimtaria dhe konsumi i metalit të zinkut, pjesëmarrja e të ashtuquajturës “Botë Perëndimore”, shënon zvogëlim dukshëm më të madh edhe te prodhimtaria e metalit të zinkut prej 67,8% në vitin 2001, në 58,3% në vitin 2009. Ndërkaq, shpenzimi i metalit në periudhën e njëjtë, është zvogëluar nga 77,4% në 52,6%.




Fig. 4.2-4 Rënia e prodhimit dhe konsumit të zinkut nga "Bota Perëndimore".

Spostimet e këtilla janë rezultat i shkallëve relativisht të larta të rritjes, të cilat realizohen në botë (127,4 pikë indeksi të prodhimit të xehorëve, 121,6 pikë të prodhimit të metalit dhe 121,3 pikë të shpenzimit të metalit të zinkut). Për dallim nga realizimet në nivel botëror, në të ashtuquajturën "Bota Perëndimore", përveç prodhimit të metalit, paraqitet zvogëlim në vlerë prej 96,6 pikëve, ndërsa të konsumit të metalit të zinkut, zvogëlimi është akoma më i shprehur, 82,5 pikë (indeksi).

4.3. Riciklimi i plumbit dhe zinkut

Riciklimi dhe prodhimi i plumbit sekondar, ka rol të rëndësishëm në tregun e plumbit. Kjo prodhimi u shndërrua në vendburim të rëndësishëm të plumbit të ofruar (për herë të parë prodhimi i plumbit sekondar e tejkaloi prodhimin primar në vitin 1989). Në disa vende, për shembull në SHBA dhe në Francë, prodhimi sekondar i plumbit është burim shumë i rëndësishëm dhe zotërues në ofertën e plumbit të rafinuar. Për dallim nga plumbi, të zinku, riciklimi ka rëndësi dukshëm më të vogël, që paraqitet si rezultat i vështirësive teknologjike në procesin e riciklimit të metaleve, të cilat përmbajnë zink. Për shembull, në vitin 1993, zinku sekondar, arrinte vetëm 8% nga prodhimi i zinkut të rafinuar.

Shkalla e lartë e riciklimit të plumbit, paraqitet për disa arsye: Së pari, plumbi i ruan cilësitë kimike dhe fizike gjatë riciklimit. E dyta, shumë prodhime

me plumb, mund të riciklohen lehtë. Kjo, në radhë të parë ka të bëjë me akumulatorët e plumbit, të cilët përfshijnë rreth 80% nga përdorimi i plumbit. Vetëm rreth 8% nga konsumi i plumbit shfrytëzohet për qëllime kur nuk është i mundur riciklimi (aditivë të benzines, ngjyra, xhami, glazura qeramike, si dhe materialet për municion). Së treti, rregullimi gjithnjë e më i madh në lidhje me mbetjet metalike të akumulatorëve, si rezultat i rritjes së ndërjegjes për mbrojtjen e mjedisit jetësor, kontribuoi për përmirësimin e sistemit të grumbullimit të akumulatorëve me afat të skaduar të përdorimit, në numër gjithnjë e më të madh të vendeve.

Për shkak të faktit se prodhimtaria primare dhe sekondare e plumbit, janë substitute të përsosura në numrin më të madh të aplikacioneve, tregjet e tyre janë të pavarura dhe mund të trajtohen së bashku. Oferta dhe konsumi janë përcaktuese, që do të thotë se mbeturina e plumbit e përcakton derdhjen e materialit për riciklim. Kjo varet nga shekulli i kohëzgjatjes së produktit, mbi të cilën ka ndikim çmimi i metalit (për shembull, akumulatorët kanë relativisht afat të shkurtër të përdorimit prej 4-7 vjet, për dallim nga produkte të tjera me plumb, të cilat kanë jetë prej 50 dhe 100 vjet). E dyta, oferta e metalit të ricikluar, është faktor i rëndësishëm në përcaktimin e konsumit të metalit primar të plumbit. Për "Trepçën", kjo ka rëndësi të madhe, duke pasur parasysh faktin se prodhimtaria e metalit primar do të mbetet në kuadër të Kosovës.

Edhe pse metali i plumbit i përfituar nga proceset primare dhe sekondare, shitet në tregje të njëjta dhe përballen me kushtet e njëjta të kërkesave, prodhimi dhe struktura e kostove të këto dy lloje të plumbit janë të ndryshme. Prodhimtaria e plumbit primar është e ndërlidhur me lëvizjen e çmimeve të metaleve të tjera, sidomos të zinkut dhe të argjendit, të cilat së bashku me plumbin shfrytëzohen dhe procedohen. Për dallim nga plumbi primar, vendimi për prodhimtarinë e plumbit sekondar përcaktohet vetëm nga çmimi i plumbit. Si rezultat i kësaj, prodhimtaria në industrinë sekondare (ricikluese), është shumë më tepër e varur nga çmimi i plumbit, sesa të prodhimtaria primare ku duhet të merren parasysh edhe çmimet e metaleve të tjera. Natyra e përpunimit të plumbit sekondar e bën prodhimtarinë e këtij metali shumë më fleksibil nga ai primar, duke pasur parasysh se volumi i hyrjeve dhe kostoja e riciklimit të mbetjeve mund të përputhen. Në rast të sasisirave të ulëta të riciklimit, volumi i plumbit të prodhuar sekondar, mund të lëvizë shumë, si rezultat i ndryshimeve relativisht të vogla në çmime. Kjo, sepse pjesa më e madhe e plumbit sekondar vjen nga akumulatorët, të cilët kanë çmime të barabarta të grumbullimit dhe riciklimit, në kushte të afatit të shkurtër të përdorimit në industrinë rritëse automobilistike.

Por, nën volum të caktuar, çmimet e plumbit sekondar mund të dukshëm të rriten për shkak të kostove më të mëdha për përfitimin e plumbit nga mbetjet. Këto dallime në prodhimtari dhe në strukturën e kostove mund të kenë efekte të ndryshme mbi tregun primar dhe sekondar. Megjithatë, duhet të

merret parasysh se masat, të cilat kanë për qëllim që të zvogëlohet rreziku nga plumbi, mund ta kufizojnë përdorimin e këtij metali në produktet, që në periudhë afatgjatë, mund të pasqyrohet mbi kërkesën e përgjithshme për të.

Të dhënat statistikore e përfshijnë riciklimin e plumbit në të ashtuquajturën "Bota Perëndimore", në të cilën janë të vendosura vendet, ish-të ashtuquajturat vende socialiste. Në tabelat për riciklim nuk është futur Kina, e cila paraqitet si konsumuese e madhe e metalit të plumbit dhe e cila në masë të madhe e përcakton kërkesën ekzistuese dhe të ardhshme afatgjatë të industrisë së plumb-zinkut.

Rritja e ndërgjegjes dhe kujdesi gjithnjë e më i madh për ruajtjen e mjedisit jetësor, kontribuojnë për rritjen e vëllimit të riciklimit të plumbit dhe zinkut. Pjesëmarrja e metaleve të ricikluara në industrinë përpunuese, ka tendencë të rritjes, e cila në mënyrë të veçantë është e shprehur te plumbi.

Kështu, sipas të dhënave në dispozicion (jo të plota) për mbarë botën, pjesëmarrja e plumbit të ricikluar në prodhimtarinë e përgjithshme të metalit në periudhën 2002-2009, e rriti pjesëmarrjen nga 63,0% në 73,0%. Tendanca e kështillë e rritjes së prodhimtarisë së plumbit të ricikluar (indeksi 107,9 pikë në periudhën 2002-2009), kontribuoi për zvogëlimin e prodhimtarisë së përgjithshme të metalit në vendet e të ashtuquajturës "Bota Perëndimore" (indeks i rritjes prej 92,3 pikë në periudhën e njëjtë).




Fig.4.3-1 Trendët e riciklimit të plumbit dhe zinkut (2002-2009).

Riciklimi i zinkut ka vëllim relativisht më të vogël dhe atë gjatë periudhës analizuuese arrin rreth 30% nga prodhimtaria e përgjithshme e këtij metali, të realizuar në të ashtuquajturën “Bota Perëndimore”. Me këtë rast, duhet të merret parasysh edhe tendenca e zvogëlimit të prodhimtarisë së përgjithshme të metalit zink, ndërsa edhe të metalit të ricikluar në këto vende, të cilat realizuan indekse negative të rritjes prej 90,0 pikë të zinku i ricikluar, ndërsa 91,1 pikë indeksi, të prodhimtaria e metalit. Edhe në rastin e zinkut, sikur edhe të plumbi, duhet të mbahet llogari për të dhënat jo të plota statistikore, si në lidhje me përfshirjen e vendeve, ashtu edhe për besueshmërinë e të dhënave.




Fig.4.3-2 Trendi i rritjes së riciklimit për metalin e plumbit.

Riciklimi i plumbit në botë shënon rritje mesatare (107,9 pikë indeksi) në periudhën 2002-2009. Pjesëmarrje prijëse në riciklim kanë vendet e zhvilluara, në radhë të parë në Amerikë (pjesëmarrje prej 46,6% në prodhimtarinë e përgjithshme botërore, në vitin 2009 dhe në Evropë me pjesëmarrje prej 29,9%.

Nga kontinentet tjera pjesëmarrje më të madhe në riciklimin e plumbit ka Azia me pjesëmarrje prej 19,8% në vitin 2009, (duhet të merret parasysh mungesa e të dhënave për riciklimin e realizuar në Kinë dhe disa vende të tjera aziatike). Pjesëmarrja e Afrikës dhe Oqeanisë (Australisë) është relativisht e ulët.

Gjatë periudhës analizuuese 2002-2009, riciklimi në Evropë ka trend të uljes me indeks të realizuar të rritjes prej 98,5 pikëve. Tendanca e këtillë e rritjes, mundet pjesërisht të sqarohet me bartjen e industrisë së ricikluar në kontinente

të tjera, dhe si rezultat i politikave të vendeve të zhvilluara për ruajtjen e mjedisit jetësor në hapësirat vetjake. Udhëheqëse në riciklim janë vendet e mëdha dhe të zhvilluara (Gjermania, Italia, Spanja, Mbretëria e Bashkuar dhe Franca). Nga vendet ballkanike, të dhëna për riciklim të realizuar ka për Greqinë (pjesëmarrje e realizuar prej 0,3% në vitin 2009 dhe për Maqedoninë me pjesëmarrje të pavërejtur në riciklimin e realizuar).

Riciklimi i zinkut realizohet me rafinimin e metalit të zinkut, shkrirjen e serishme të metalit të zinkut dhe legurave të zinkut, me përdorim të drejtpërdrejtë të materialeve sekondare (tabela 3.8). Riciklimi i zinkut është proces më i ndërlikuar se ai i plumbit, i cili angazhon më shumë resurse, që pasqyrohet direkt si në koston për riciklim, ashtu edhe në sasinë e materialit.




Fig.4.3-3 Riciklimi i zinkut i realizuar në tri forma.

Riciklimi i zinkut është në sasi më të vogël në krahasim me atë të plumbit, prandaj tregon shkallë negative të rritjes (90,0 pikë indeksi) gjatë periudhës 2002-2009. Kjo tendencë, me përjashtime të vogla është e pranishme në botë në të gjitha kontinentet. Për shembull, metali i rafinuar i zinkut shënon shkallë të rritjes prej vetëm 42,2 pikë indeksi. Në tri llojet e rafinimit të zinkut, më e madhe është pjesëmarrja në Evropë, Azi dhe Amerikë. Duhet të merret parasysh, se në riciklimin e zinkut, pjesëmarrje më të madhe ka përdorimi i drejtpërdrejtë i materialeve sekondare me 62,5% pjesëmarrje, në riciklimin e përgjithshëm

në vitin 2009. Pastaj pason rafinimi i metalit të zinkut, me pjesëmarrje 25% dhe metali zink/legurat e metalit të shkrira sërish me pjesëmarrje prej 14,9%.

4.4. Lëvizja e çmimeve botërore të plumbit dhe zinkut

Çmimet e plumbit dhe të zinkut shënojnë ndryshime të mëdha mujore, të cilat janë rezultat i shumë faktorëve, të cilët e përcaktojnë ofertën dhe kërkesën. Çmimet e plumbit dhe të zinkut janë të kushtëzuara nga çmimet e Bursës së Metaleve të Londrës (London Metal Exchange - LME), të cilat janë të kushtëzuara nga rritja ose rënia e konjunkturës së ekonomisë botërore. Ndryshimet e çmimeve të plumbit dhe të zinkut në kuadër të ekonomisë botërore, në masë të madhe ndikojnë në rezultatet ekonomiko-financiare të minierave të "Trepçës", si dhe të ekonomisë së përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Megjithatë, pavarësisht nga ky konstatim, që i karakterizon lëvizjet e përgjithshme të çmimeve të këtyre dy metaleve, në periudhën 2001-2010 vërehet rritje e madhe prej 499,6 pikë indeksi të plumbi, ndërsa 300,9 pikë të zinku. Sidomos, është e madhe rritja e çmimeve pas vitit 2003 (në periudhën dhjetor 2003-2010, çmimet e plumbit kanë realizuar rritje prej 349,6 pikë indeksi, ndërsa të zinku 233,5 pikë). Dinamika e këtillë e rritjes së çmimeve, është rezultat i rritjes së lartë vjetore të kërkesës për këto metale, ndërsa pjesërisht edhe të lëvizjeve spekulative në tregjet botërore. Por, konstatim i përgjithshëm për gjendjen në fushën e çmimeve të këtyre dy metaleve, është se: margjinat për prodhuesit e plumbit dhe zinkut janë rritur, ndërsa në disa vite, kanë arritur limite historike të panjohura për periudhën e kaluar.

Me këtë rast, duhet të përmendet se çmimet e plumbit realizojnë më shumë se dy herë rritje më të madhe, në krahasim me dinamikën e çmimeve të zinkut. Dukuria a këtillë, sqarohet me konsumin më të madh të këtij metali, i cili ka ndikim vendimtar në formimin e kërkesës dhe të çmimeve. Rritja relativisht më e shpejtë e çmimeve të plumbit krahasuar me çmimet e zinkut, sqarohet me efektet e kërkesës së këtij metali e kushtëzuar nga rritja e përsheptuar e industrisë automobilistike dhe nevojës për akumulatorë, para se gjithash në Kinë, në disa ekonomi të tjera, si dhe në vendet në zhvillim.

Për shembull, gjatë periudhës analizuese 2001-2010, çmimet e plumbit shënojnë rritje mesatare vjetore prej 116,95 pikë indeksi, ndërsa të zinku kjo rritje arrin mesatarisht 111,42 pikë. Shprehur në njësi parash (SHBA-dollarë), çmimi mesatar vjetor në këtë periudhë, arrin: për plumbin 1,225,34 dollarë, ndërsa për zinkun 1.631,26 dollarë.




Fig.4.4-1. Çmimi mesatar vjetor dhe rritja mesatare vjetore për Pb-Zn, periudha (2001–2010).

Të dhënat tregojnë se, rritja e këtillë e çmimeve, është bazuar në katër faktorë kryesorë:

- Rritja e madhe e mundësive për marrje të kredive nga ana e amvisërive dhe industrisë, si rezultat i risive në letrat me vlerë, çrregullimit të industrisë bankare, sigurimit të kredive dhe pranimin të përforcuar të rreziqeve;
- Rritja e fuqishme initiale e industrializimit të pjesëve të mëdha, para se gjithash të Azisë, si dhe zhvillimi i tyre në rajonin më të rëndësishëm botëror metal-prodhues. Vlerësohet se ndikimi mbi ekonominë botërore i këtij kontinenti, është më i madh nga çdo revolucion paraprak industrial;
- Rritja e madhe e produktivitetit, si rezultat i zbatimit të teknologjisë informative e cila siguroi rritje të madhe të komunikimeve, transmetimit dhe të deponimit të të dhënave për kostot minimale;
- Rritja e madhe e tregtisë ndërkombëtare, e cila në pjesë të madhe është e menaxhuar nga Organizata Botërore e Tregtisë (OBT). Rritja e realizuar kumulative prej 5%, nuk është vërejtur në historinë më të re ekonomike.

Në lëvizjet e rritjes së çmimeve të plumbit dhe zinkut pas vitit 2003, vërehet rritje më dinamike e çmimit të zinkut në krahasim me çmimin e plumbit. Dallimi në dinamikën e rritjes, në mënyrë të veçantë, është e shprehur në periudhën 2004–2007, kur çmimi i plumbit në nëntor të vitit 2006, arriti vlerë prej 4.381,7 dollarë amerikan për një ton. Ndërsa çmimi më i lartë i zinkut

është realizuar në tetor të vitit 2007, me vlerë prej 3.722,61 dollarë për ton. Ndërkaq, çmimi më i ulët i zinkut u shënuar në dhjetor të vitit 2001 në vlerë prej 757,97 dollarë për ton, ndërsa çmimi më i ulët i plumbit është realizuar në korrik të vitit 2001 në vlerë prej 444,73 dollarë për ton.

Analiza e ndryshimeve mujore të çmimeve, tregon luhatje të rëndësishme, të cilat në disa vite janë mjaft të larta, të kushtëzuara nga dinamika e rritjes së kërkesës, nga njëra anë dhe e ndikimeve spekulative nga ana tjetër. Lëvizjet e këtitilla të mëdha të çmimeve mujore, në pjesën më të madhe janë pasojë e ndikimeve spekulative, të cilat janë pasqyrë e ndryshimeve të rezervave të metalit, ndërsa edhe të ndikimit të ndryshimeve të kurseve të valutave, si rezultat i luhatjeve të vlerës së dollarit.

Kështu, sipas të dhënave në ILZSG, te plumbi, gjatë pjesës më të madhe të vitit 2002, paraqiten shkallë negative të njëpasnjëshme të rritjes. Dukuri e këtitillë të lëvizja e çmimeve të zinkut, paraqitet gjatë vitit 2001. Luhatjet e mëdha të çmimeve, më shumë janë evidente në periudhën 2003-2010. Gjatë kësaj periudhe, vërehen shkallë shumë të larta mujore të rritjes, prej dhjetë e më shumë për qind, por edhe të uljes së çmimeve. Kjo është dukuri tipike për një treg dinamik dhe jostabil, me ndikime të ndërsjella të shumta dhe të gërshetuara prej shumë faktorëve.

Kur vëzhgohen lëvizjet e çmimeve të plumbit dhe zinkut, për një periudhë të gjatë, vërehen ndryshime të mëdha dhe luhatje të çmimeve. Lëvizjet e këtitilla janë të kushtëzuara nga madhësia e kërkesës dhe e konsumit, por edhe nga lëvizjet ciklike të ekonomisë botërore, sidomos të vendeve me industri të zhvilluar.

Te zinku, pas vitit 1984, çmimet arrijnë 1.000 dhe më shumë dollarë amerikanë. Gjatë krahasimit të çmimeve të këtyre metaleve, për një periudhë afatgjate, duhet marrë parasysh vlerën e valutave, krahasuar me dollarin amerikan. Por te kjo valutë, e cila në masë të madhe e kryen funksionin e mjetit botëror për pagesa, është i pranishëm zvogëlimi i fuqisë së saj blerëse dhe zvogëlimi i besimit.

Deri në fund të vitit 2004, dinamika e rritjes së çmimeve të plumbit dhe zinkut, është relativisht e ngjashme. Megjithatë, gjatë viteve 2005-2007, çmimet e zinkut rriten dukshëm më shpejt nga ato të plumbit. Ky dallim në dinamikën e rritjes, më shumë është i shprehur në dhjetor të vitit 2006.




Fig. 4.4-2. Diagrami i çmimit të plumbit dhe zinkut (2001-2010).

Prodhimet të cilat janë realizuar nga aktivitetet përcjellëse, kanë pasur ndikim kritik mbi fitimin, si rezultat i së cilës, një numër i vogël i minierave kanë pasur rrjedha negative të parave kesh, në periudhën pas vitit 2004. Pothuajse të gjitha minierat e plumbit dhe të zinkut prodhojnë sasi të mëdha të paktën edhe të një metali bazik. Në shumë raste, prodhimi dhe shitja e metaleve të tjera ka ndikim të madh mbi kostot e përgjithshme të prodhimit, por edhe në profitabilitetin për një njësi të caktuar. Kjo do të thotë, se minierat polimetalore kanë më shumë variacione të shpenzimeve të përgjithshme.

Për minierat e "Trepçës", është karakteristike rëndësia relativisht e lartë e të ardhurave nga metalet përcjellëse, në radhë të parë të argjendit.

Në periudhën 1973-1977, në kompleksin metalurgjik "Trepça", janë prodhuar 494.5 tonë argjend, që ka përfshirë afër 70% nga prodhimtaria e përgjithshme e ish-Jugosllavisë. Analiza paraprake është e rëndësishme nga aspekti i argumentimit, se rentabiliteti dhe përfitimi në fushën e prodhimit të plumbit dhe zinkut, duhet të vëzhgohet nga aspekti i të gjitha metaleve të prodhuara. Kjo do të thotë, se xeherorët polimetalor kanë përparësi dhe mundësi për

realizimin e të ardhurave shtesë. Për shembull, në rritjen e fitimeve gjatë viteve 2005–2006, ndikim të fuqishëm kishte çmimi i lartë i zinkut. Megjithatë, duhet të merret parasysh, se edhe të ardhurat nga metalet tjera, të cilat fitohen gjatë shkrirjes së xeherorëve të plumbit dhe zinkut, kontribuojnë për fitimet e realizuara të kësaj industrie. Periudha e viteve 2008 dhe 2009, do të mbahet mend për rritjen e kërkesave së mallrave (metaleve), nga ana e vendeve në zhvillim. Mungesa e fuqisë punëtore të trajnuar, materialeve dhe pajisjeve, shkakton rritje dramatike të shpenzimeve në miniera, shpenzime për trajtim të mineraleve dhe të shpenzimeve tjera përcjellëse, duke shkaktuar rritje të kostos së prodhimit. Por, gjatë vitit 2009, ndodhi rënie e përnjëhershme e këtyre shpenzimeve, kështu që, margjinat për prodhuesit e zinkut dhe të plumbit sërish arritën nivele mjaft të larta.

Lëvizjet e kurseve valutore, gjithashtu, kanë realizuar ndikime të fuqishme në strukturën e shpenzimeve në këtë industri, që patën ndikim edhe në çmimet e këtyre dy metaleve. Nga njëra anë, kriza globale ndikoi që valutat e vendeve prodhuese të kontribuojnë dukshëm, që shkaktoi zvogëlim adekuat të shpenzimeve.

Procesi i urbanizimit të Azisë dhe industrializimi progresiv në vendet në zhvillim, do ta nxisin zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në dekadën vijuese, që gjithsesi do ta përcaktojë rritjen dhe lëvizjen e çmimeve.

Krahas kësaj, ndikim të caktuar më të madh mbi kërkesën, pritet të kryejë edhe rikuperimi i industrisë automobilistike dhe i ndërtimitarisë në Amerikën Veriore. Gjendjet e këtilla, padyshim do të pasqyrohen në lëvizjet e përgjithshme të prodhimitarisë së plumb–zinkut dhe gjithsesi edhe në çmimet e këtyre metaleve.

Konsumi i zinkut ka trend rritës, sidomos për shkak të përdorimit të tij për galvanizim. Vlerësohet se 2/3 e prodhimit global vjetor të zinkut, përdoren për galvanizim të çelikut, për ta mbrojtur nga korrozioni dhe që të rritet jetëgjatësia e tij, madje edhe për 500% (për galvanizimin e një ton çeliku nevojiten rreth 35 kg zink). Çeliku i galvanizuar përdoret më shumë në konstruksione të çatave, në industrinë automobilistike dhe në ndërtimin e banesave. Kjo do të thotë, se kërkesa e zinkut do të lëvizë paralelisht me rritjen e ndërtimit të shtëpive të banimit, industrisë automobilistike dhe ndërtimit të infrastrukturës rrugore (për shembull ura). Kërkesa për zink, për nevoja tjera, gjithashtu pritet të rritet. Kina është prodhuesi dhe konsumatori më i madh botëror i zinkut. Ky metal, më shumë përdoret në industrinë e çelikut, ndërtimtari dhe në industrinë automobilistike. Rritja e madhe e migrimit fshat–qytet në këtë vend, rritja e qyteteve, ndërtimi i infrastrukturës dhe industrisë automobilistike e cila realizon rritje prej 25% në vit, janë premisa për rritjen e mëtejshme të kërkesës dhe konsumit të zinkut. Në formimin e kërkesës globale për zinkun, do të

ndikojë edhe ekonomia e Indisë, ku paraqiten tendenca të ngjashme me të atyre që janë të pranishme në Kinë. Kërkesa e zinkut në SHBA dhe Evropë, vlerësohet se për periudhën afatmesme do të jetë relativisht konstante. Në periudhën afatmesme, realizimet e tregjeve do të përcaktohen nga shpejtësia e rikuperimit të recesionit global. Vlerësohet se implikimi më i madh i shtetit në ekonomi, dhe masat për nxitjen e ekonomive nacionale (lehtësime tatimore dhe të tjera), siç është procesi i urbanizimit të Azisë dhe industrializimi i përsheptuar i shumë vendeve në zhvillim, do të kontribuojnë për zhvillimin e BPV-së prej pothuajse 2% në vit, që është nën nivelet e realizuara në pesë vitet e fundit.

Sipas parashikimeve tjera, në periudhat e ardhshme afatgjate, duhet të priten shkallë të rritjes së BPV-së prej rreth 3% në vit.




Fig.4.4-3. Çmimi i Pb dhe Zn, \$/ton - periudha 2001-2010.

Parashikimet për rritjen e ekonomisë në Kinë, lëvizin prej 5% rritje mesatare vjetore, e deri në shkallë dyshifrore. Parashikimet e këtilla për rritjen e BPV-së, do të thonë rritje e matur, por relativisht e qëndrueshme e çmimeve të plumbit dhe zinkut.

Lëvizjet e tregut në periudhën e ardhshme do të përcaktohen nga shpejtësia dhe madhësia e rikuperimit të recesionit global. Kështu, viti 2009 konsiderohet si vit i vështirë për kërkesën globale të produkteve. Pamjet për vitin 2011 dhe vitet në vijim, vlerësohen si dukshëm më të mira. Parashikimet për lëvizjen e çmimeve janë mesatare, por te zinku, çmimet do të jenë nën ndikim të fuqishëm të kërkesës, e cila vlerësohet se do të vazhdojë të rritet me dinamikë relativisht më të shpejtë nga ajo e plumbit.

Dëshmimet paraprake për trendin rritës të çmimeve të plumbit dhe të zinkut, në masë të madhe, i konfirmojnë lëvizjet në pesë muajt e parë të vitit 2011. Gjatë muajve janar-maj të viti 2011, çmimi mesatar i plumbit në Bursën e Metaleve të Londrës, arrinte 2.594,79 \$ për ton, i zinkut 2.342,63 \$ për ton, ndërsa i argjendit 1.116,63 \$ për kilogram. Si faktorë më të rëndësishëm që ndikojnë mbi ofertën e tregut të zinkut, janë: ndryshimet në nivelin e rezervave në Bursën e Metaleve të Londrës, shkalla e rritjes ekonomike të vendeve të mëdha konsumuese, shkalla globale e rritjes ekonomike, kërkesat në industrinë më të rëndësishme, të cilat janë konsumuese të metalit të zinkut, çmimet e metaleve alternativ dhe qasja e mjeteve financiare për investim. Mbi projeksionet për çmimet e plumbit, zinkut dhe të argjendit, ndikojnë edhe faktorët të cilët janë të ndikuar nga çmimet e bakrit dhe të arit, rritja e bruto-prodhimit vendor në rajone të caktuara të botës, efikasiteti rajonal, qasja e kapitalit dhe luhatjet e shpenzimeve. Ndryshimet e këtyre faktorëve, pasqyrohen në çmimet e plumbit, zinkut dhe të argjendit, vëllimin e konsumit, prodhimit, rezervave të mineraleve dhe zgjerimin e kapaciteteve.

Në periudha afatshkurtra, janë të mundura lëvizje të caktuara dhe ulje të çmimeve të plumbit, si rezultat i rezervave të mëdha të këtij metali. Vlerësohet se oferta e tejkalon konsumin (të dhënat lëvizin prej 1-4,2%, oferta më e lartë se konsumi), që u pasqyrua në rënien e çmimeve të zinkut. Ulja e çmimit dhe të ardhurat më të vogla, shkaktuan ndërprerje të prodhimitarisë të disa prodhues të mëdhenj, si dhe anulim ose ndërprerje të projekteve. Vlerësohet se periudha e çmimeve relativisht të ulëta, do të ushtrojë presion mbi prodhuesit, për zvogëlimin e ofertës së metalit, që do të rezultojë me rritjen e çmimit të zinkut.

Nga përvojat botërore mund të konkludohet se çmimi i zinkut mbi 2000 dollarë për tonë, është çdo herë rentabël.

Dallimi mes kërkesave për zink dhe ofertës, parashikohet se do të jetë në rritje. Ky hendek ndarës mes ofertës dhe kërkesës së zinkut, duhet të pritet që të sqarohet pasi të hapen miniera të reja ose të aktivizohen të vjetrat dhe investohet në projekte të reja. Te plumbi, vlerësimet janë se oferta do të shkojë në hap me kërkesën, kështu që, nuk vërehet hendeku ndarës mes tyre. Nga kjo, mund të nxirret konstatimi se çmimet e plumbit do të realizojnë rritje mesatare. Të dhënat tregojnë se çmimet aktuale janë pothuajse dy herë më të larta, në krahasim me periudhën e para vitit 2005, kur një numër i caktuar i minierave ishin të mbyllura. Ulja e kostos së punës, çmimet më të ulëta të karburanteve nga njëra anë dhe rritja e çmimeve të këtyre metaleve në bursat botërore, pritet të kontribuojnë për riaktivizimin e disa minierave, zhvillimin e projekteve të reja, duke rritur në këtë mënyrë ofertën e përgjithshme për plumb dhe zink.

4.5. Lëvizja e ofertës së plumbit, zinkut dhe koncentratit

Mbi lëvizjen e ofertës dhe të prodhimtarisë së plumbit dhe të zinkut, ndikim të madh kanë realizimet e ekonomisë në Kinë. Sipas vlerësimeve statistikore, rreth 30% e kërkesës së metalit i përket Kinës. Ndikim të madh për kërkesën e plumbit dhe të zinkut në Kinë, do të ketë rritja e prodhimtarisë së automobilave dhe e ndërtimitarisë (parashikohet që të prodhohen rreth 40 milionë automobila në dhjetë vitet e ardhshme).

Mbi vëllimin e ofertës dhe prodhimtarinë e këtyre metaleve, fuqimisht do të ketë ndikim edhe industrializimi dhe zhvillimi i industrisë ndërtimore në shumë vende në zhvillim. Kërkesa e metalit të plumbit dhe të zinkut, në afat të gjatë është e përcaktuar nga vëllimi i lëvizjeve të konsumit për këto metale.

Vëllimi i ofertës varet nga prodhimtaria e metalit primar, vëllimit të ofertës sekondare, ofertës së xeherorëve të plumbit dhe zinkut nga minierat ekzistuese etj. Po ashtu, varet edhe nga prodhimtaria e xeherorëve nga minierat, që janë në fazë të aktivizimit ose mund të aktivizohen shpejt, projektet e parashikuara për hapjen dhe eksploatimin e minierave të reja etj.

Në periudhën afatshkurtër, krahas prodhimtarisë, vëllimi i ofertës varet edhe nga rezervat e metalit, të cilat i deponojnë prodhuesit dhe konsumatorët, rezervat në Bursën e Londrës së Metaleve (në pjesën më të madhe), si dhe rezervat te tregtarët (në një pjesë shumë të vogël).

Analiza e prodhimtarisë së xeherorëve dhe metalit të plumbit, tregon zhvendosje të vërejtura dhe ndryshime në nivel global. Te prodhimtaria e xeherorëve të plumbit, karakteristikë kryesore paraqet zvogëlimi i vëllimit të prodhimtarisë në Evropë (prodhimtaria është zvogëluar nga 324 mijë tonë sa arrinte në vitin 2001, në 317 mijë tonë në vitin 2009 ose me indeks të rritjes prej 97,8 pikëve). Në Amerikë, prodhimtaria është zvogëluar nga 1.092 mijë tonë, në 1.059 mijë tonë ose me indeks të rritjes prej 97,0 pikëve). Në Afrikë, prodhimtaria është zvogëluar nga 150 mijë tonë, në 107 mijë tonë ose indeks të rritjes prej 71,3 pikëve) dhe në Australi, prodhimtaria e xeherorëve është zvogëluar nga 714 mijë tonë, në 525 mijë tonë, me indeks të rritjes prej 73,5 pikësh). Ndërkaq, në anën tjetër ka ndodhur rritje mjaft e shpejtë e prodhimtarisë në Azi (rritje e prodhimtarisë nga 728 mijë tonë, në 1.843 mijë ose indeks të rritjes nga 253,2 pikë në periudhën e njëjtë).

Kur vëzhgohet bota si tërësi, prodhimtaria e xeherorëve të plumbit, në periudhën e theksuar, shënon indeks të rritjes prej 128,9 pikësh. Ndërsa, në të ashtuquajturën "Bota Perëndimore", prodhimtaria shënon indeks të rritjes prej 90,7 pikëve.

Zhvendosjet paraprake në prodhimtarinë botërore të mineraleve të plumbit, në pjesën më të madhe janë rezultat i ndikimit të kostove të prodhimit, në

profitabilitetin e disa minierave në vendet e zhvilluara (Australia, Evropa dhe Amerika Veriore), në pjesën më të madhe të shpenzimeve për fuqi punëtore. Rritja e prodhimit në Azi, në një pjesë të mirë mund të sqarohet me shpenzimet dukshëm më të ulëta të punës, në të cilat, kompensimet për rroga, kanë rreth tri herë pjesëmarrje më të ulët, në krahasim me ato në vendet e zhvilluara.

Gjendja e këtillë ndikoi që pjesëmarrja në Evropë, Amerikë, Australi dhe në Afrikë, të zvogëlohet për llogari të rritjes së pjesëmarrjes të prodhuesve nga Azia. Me këtë rast, zvogëlim më të madh në prodhimtarinë botërore, ka pjesëmarrja e prodhuesve nga Afrika (më tepër për shkak të ndërprerjes së prodhimit dhe mbylljes së minierave në Afrikën Jugore) dhe në Australi, ku paraqitet pothuajse e përgjysmuar pjesëmarrja në prodhimtarinë botërore. Si pasojë e lëvizjeve të këtilla, pjesëmarrja e të ashtuquajturës "Bota Perëndimore" në prodhimtarinë e xeherorëve të plumbit, është zvogëluar nga 75% sa arrinte në vitin 2001, në 53,1% në vitin 2009.

Në evidencën statistikore të prodhuesve së xeherorëve të plumbit nga Evropa, nuk është regjistruar Kosova. Siç është theksuar më lartë, kjo mund të sqarohet me inkuadrim eventual të prodhimit në kuadër të vendeve të ish-Jugosllavisë. Në kuadër të Evropës, si prodhues më të mëdhenj të xeherorëve së plumbit, në vitin 2009 paraqiten Federata Ruse, Suedia, Maqedonia, Irlanda dhe Polonia. Gjatë viteve 2001-2009, në mënyrë të veçantë është vërejtur rritja e prodhimit së xeherorëve të plumbit në Federatën Ruse (indeksi i rritjes prej 557,1 pikë), si dhe në Maqedoni (indeks i rritjes prej 260,0 pikë). Rritja e madhe e prodhimit së këtyre xeherorëve në këto dy vende, është rezultat i aktivizimit të serishëm të minierave, ku puna ka qenë e ndërprerë.




Fig. 4.5-1. Grafiku i prodhimit global të xeherorit së plumbit (2001-2009).

Te prodhimitaria e metalit të plumbit, në bazë janë të pranishme lëvizje të ngjashme. Po ashtu, është e pranishme rritje relativisht e lartë e prodhimtarisë në Azi (indeks 218,9 pikë, në periudhën 2001-2009), e cila është e përcjellë me zvogëlimin e prodhimtarisë në kontinentet tjera.




Fig. 4.5-2. Grafiku i prodhimit global të plumbit të rafinuar - metal (2001-2009).

Prodhimtaria e metalit në të ashtuquajturën “Bota Perëndimore”, ngjashëm sikur edhe te prodhimtaria e xeherorëve të plumbit, është zvogëluar në mbi 50% nga prodhimtaria e përgjithshme botërore.

Në kuadër të Evropës, te prodhimtaria e metalit të plumbit, paraqiten vende të cilat nuk janë prodhuese të xeherorëve. Dukuria e këtillë është rezultat i koncentrimin të prodhimtarisë në shkretoret me kapacitete të mëdha dhe zvogëlimin të shpenzimeve në kushte të vëllimit të madh të prodhimtarisë (për shembull, numri i vendeve prodhuese të xeherorëve arrin në 14, ndërsa numri i prodhuesve të metaleve në 23). Evropa është importuese e xeherorëve të plumbit nga Amerika Veriore dhe Jugore, si dhe nga Australia.

Si prodhues më të mëdhenj të xeherorëve të plumbit, në vitin 2009 në Evropë, paraqiten: Gjermania, Italia, Mbretëria e Bashkuar, Federata Ruse dhe Spanja. Nga prodhuesit e mëdhenj, rritje më të madhe kanë realizuar Federata Ruse dhe Polonia.

Ofertat dhe prodhimtaria e xeherorëve të zinkut dhe të metalit, janë relativisht më të mëdha se sa ato të plumbit. Gjendja e këtillë, është rezultat i rrethit më të gjerë të gamës së përdorimit të zinkut, para së gjithash, për

galvanizimin e çelikut. Në të ardhmen, pritet rritje e mëtejshme e konsumit dhe e ofertës së zinkut.

Në prodhimtarinë e xeherorëve të zinkut dhe të metalit të zinkut, ndikim të madh kanë mundësitë relativisht më të vogla për riciklim. Për dallim nga plumbi, ku riciklimi i disa prodhimeve është relativisht i shpejtë dhe i lirë, riciklimi i zinkut është i ndërlidhur me procedura më të ndërlikuara dhe me kosto të lartë.

Te prodhimtaria e xeherorëve të zinkut, vërehen luhatje më të vogla në kuadër të prodhimtarisë së përgjithshme botërore. Kështu, për dallim nga xeherorët e plumbit, zvogëlimet e prodhimtarisë së zinkut, janë relativisht më të vogla, ndërsa këto zvogëlime nuk janë të pranishme në të gjitha kontinentet (me përjashtim të Azisë). Gjithashtu, vërehet rritje e prodhimtarisë në disa kontinente, ku prodhimtaria e xeherorëve të plumbit zvogëlohet.

Prodhimtaria e xeherorëve të zinkut në botë, shënon indeks të rritjes prej 127,3 pikësh, në periudhën 2001–2009, ndërsa në vendet e të ashtuquajturës “Bota Perëndimore”, gjithashtu paraqitet rritje e prodhimtarisë prej 111,6 pikë indeksi (shih grafikun).

Dinamika e ndryshme e rritjes së prodhimtarisë së xeherorëve të plumbit, shkaktoi lëvizje në pjesëmarrjen e prodhimtarisë botërore, ku vend udhëheqës zënë vendet e Azisë. Kështu, pjesëmarrja e Azisë është rritur nga 26,9% në vitin 2001 në 40,9% në vitin 2009, pjesëmarrja e Amerikës është zvogëluar nga 42,2% në 36,9%, pjesëmarrja e Australisë është zvogëluar nga 16,5% në 11,2%, pjesëmarrja e Evropës është zvogëluar nga 11,8% në 8,6%, ndërsa pjesëmarrja e Afrikës është zvogëluar nga 2,6% në 2,5%. Në kuadër të Evropës, prodhues më të mëdhenj të xeherorëve të zinkut në vitin 2009, janë: Irlanda, Federata Ruse, Suedia dhe Polonia, të cilat realizojnë mbi 90% nga prodhimtaria e përgjithshme. Për dallim nga plumbi, prodhimtaria e zinkut të rafinuar është relativisht në mënyrë më të barabartë e shpërndarë në botë. Prodhimtaria e metalit të zinkut në botë, me disa përjashtime i përcjellë lëvizjet në prodhimtarinë e xeherorëve të zinkut (grafiku poshtë).

Prodhimtaria botërore shënon rritje prej 126,3 pikë indeksi, në të ashtuquajturën “Bota Perëndimore”, për 106,3 pikë. Zvogëlim i prodhimtarisë vërehet në Evropë dhe në Australi, ndërsa në kontinentet tjera, prodhimtaria e metalit të zinkut realizon shkallë pozitive të rritjes.




Fig. 4.5-3. Grafiku i prodhimit global të xeherorit së zinkut (2001-2009).

Për dallim nga prodhimtaria e xeherorëve të zinkut, prodhimtaria e realizuar e këtij metali në Evropë, është në mënyrë të barabartë e shpërndarë. Prodhuesi më i madh është Spanja, me një të katërtën e prodhimitarisë së përgjithshme evropiane në vitin 2009, e pastaj vijnë Finlanda (me pjesëmarrje prej 14,4%), Holanda 9,11%) dhe Federata Ruse (9,9%).

Hulumtimet tregojnë, se oferta e metalit të plumbit nga të gjitha vendburimet do ta përmbushë kërkesën. Ndikim më të madh mbi ofertën, do të ketë prodhimtaria e plumbit primar dhe sekondar, të cilat së bashku do të përbënin më shumë se 95% nga oferta.




Fig. 4.5-4. Grafiku i prodhimit global të zinkut të rafinuar-metal (2001-2009).

Me këtë rast, siç është theksuar, oferta e plumbit si produkt i blerë, do ta përcjellë ofertën e zinkut. Sipas parashikimeve, oferta e plumbit të rafinuar në vitin 2014 do të arrijë rreth 9,5 milionë tonë. Në strukturën e ofertës së këtillë, plumbi sekondar do të realizojë rritje për rreth 5,5 milionë tonë në vitin 2014 (në vitin 2000 prodhimtaria ka arritur rreth 4 milionë tonë në vit). Te prodhimtaria e plumbit primar të rafinuar, nuk priten ndryshime në vëllimin e përgjithshëm të prodhimtarisë dhe ajo të mbetet në rreth 2,5 milionë tonë prodhimtari vjetore, sa arrinte në vitin 2000.




Fig.4.5-4. Oferta për plumb.

Gjendja te oferta e zinkut, dallon dukshëm nga ajo e plumbit. Parashikimet tregojnë se pas vitit 2012, kërkesa do ta tejkalojë ofertën e këtij metali për diçka më pak se një milion ton. Parashikimet e këtilla bazohen në gjendjen në vitin 2006, ku çmimet e destimulonin prodhimtarinë, hapjen e minierave të reja dhe fillimin e projekteve të reja. Në vitin 2009 oferta arrinte rreth 9 milionë tonë, ndërsa në vitin 2014 pritet që ajo të arrijë rreth 10 milionë tonë.

Për dallim nga plumbi, te zinku, riciklimi ka ndikim dukshëm më të vogël në volumin e përgjithshëm të prodhimtarisë. Prodhimtaria nga minierat ekzistuese, parashikohet që të rritet për një milion tonë dhe të arrijë rreth 10 milionë tonë. Tre milion tjerë, pritet të përfitohen nga riciklimi, minierat e reja dhe nga projekte të reja.




Fig.4.5-5. Oferta për zinkun.

Përmbushja e ofertës dhe prodhimit të zinkut, përcaktohet nga disa faktorë, të cilat në mënyrë të veçantë dhe të përbashkët, mund të paraqiten si kufizues mbi vëllimin dhe lëvizjet e ofertës. Si faktorë kufizues janë:

- Barriera të pranishme për hapjen dhe eksplotimin e minierave të reja, që i zvogëlon mundësitë për rritjen e prodhimit të xehorëve të plumbit, zinkut dhe koncentratit;
- Diversifikimi i pranishëm në gjeologjinë dhe zhvendosjen e lokacioneve të vendburimeve minerale;
- Vëllimi relativisht i vogël i vendburimeve të mineraleve;
- Shpenzimi i kapitalit;
- Pritjet e larta për rritje të çmimeve;
- Mungesë nga konsolidimi dhe ekzistimi i numrit relativisht të vogël të kompanive liderë në industri.

Konsolidimi dhe përqendrimi në industrinë e plumbit dhe të zinkut rritet, (për shembull, në vitin 2003, 10 kompanitë më të mëdha kanë pasur 38% nga minierat, ndërsa në vitin 2006, kjo pjesëmarrje është shpërndarë në numër më të madh të minierave të vogla. Përqendrimi në xehetari gjithsesi se do të kontribuojë për rritjen e racionalitetit në punën dhe zvogëlimin e kostove prodhuese.

Por, në të njëjtën kohë, kjo do të thotë edhe rrezik i rritur nga sjellja monopole në kushte kur këto kompani janë shumënacionale dhe të pranishme në më shumë kontinente dhe vende. Kjo u mundëson shmangie dhe luajtje të rregullativës, sidomos në lidhje me standardet mjedisore në vendet më pak të zhvilluara, ku rregullativa juridike dhe aparati administrativ janë më të dobëta. Oferta e xehorëve të plumbit do të varet nga shkalla e prodhimit të zinkut, e jo vetëm nga kërkesa e koncentratit të

plumbit. Gjithashtu, mbi ofertën në periudhën e ardhshme do të ndikojë edhe prodhimtaria rritëse e plumbit të ricikluar. Në prodhimtarinë dhe ofertën e plumbit, ndikim të fuqishëm do të kenë realizimet dhe lëvizjet e ekonomisë në Kinë.

Në fund, duhet të kihet parasysh se, dukuritë e lëvizjeve ciklike të çmimeve relativisht të lira të këtyre metaleve, do të ndikojnë në drejtim të rritjes së rezervave të prodhuesit, konsumatorët dhe në Bursën e Metaleve të Londrës, të cilët janë poseduesit më të mëdhenj të këtyre rezervave.

4.6. Kërkesat për plumb, zink dhe koncentre

Kërkesat për plumb, zink dhe koncentre të tyre, sikurse dhe çmimet e tyre në bazë, përcaktohen nga shpejtësia dhe vëllimi i daljes nga recesioni aktual botëror. Stimulanset e planifikuara fiskale, para së gjithash në Kinë e SHBA dhe përmirësimi i kushteve ekonomike, do të kontribuojnë për rritjen e kërkesës dhe të besimit të konsumatorëve, që do të sjellë deri në rritje graduale të kërkesës gjatë vitit 2011.


Edhe pse plumbi dhe zinku, sipas rregullit, paraqiten së bashku, përdorimi i tyre është shumë i ndryshëm, si rezultat i veçorive natyrore të këtyre metaleve. Karakteristikë kryesore e strukturës së konsumit të plumbit, paraqet pjesëmarrja rritëse e përdorimit për akumulatorë. Sot, përdorimi i plumbit për prodhimtari të akumulatorëve përfshin rreth 80% nga konsumi i këtij metali, në prodhimtari të ndryshme. Plumbi përdoret rreth 6%, për ngjyra rreth 5%, për legura përdoret rreth 3%, për municion rreth 3%, për kablo rreth 1% dhe për nevoja të tjera rreth 2% .

Ndërkaq, zinku më tepër përdoret për mbrojtjen nga korrozioni përmes galvanizimit, si dhe për prodhime të ndryshme për amvisëri. Ai përdoret edhe për prodhimin e mesingut, në industrinë ndërtimore, atë kimike dhe është element i rëndësishëm në ushqim. Rreth 50% e zinkut shfrytëzohet për galvanizim, 17% përdoret për prodhimin e legurave dhe mesingut, 6% shfrytëzohet për përfitim të produkteve të ndryshme nga zinku dhe në industrinë kimike, ndërsa për nevojat tjera shfrytëzohet rreth 4%.

Konsumi i plumbit të rafinuar në periudhën 2001–2009 në botë, shënon indeks të rritjes prej 133,0 pikë, ndërsa në të ashtuquajturën “Bota Perëndimore”, ka indeks të rritjes 81,7 pikë. Ngjashëm me treguesit për prodhimtari, konsumi në të a.q. “Bota Perëndimore”, shënon trend të zvogëlimit të përsheptuar, prej 84,3% pjesëmarrje në konsumin botëror në vitin 2001, dhe 51,6% në vitin 2009

Përdorimi i metalit plumb në produktet finale

Fig.4.6-1.
Diagrami i përdorimit të
metalit plumb në produkte
finale.



Kur vëzhgohen lëvizjet e konsumit sipas kontinenteve, zvogëlim më të madh vërehet në Australi (indeks i rritjes 48,9 pikë gjatë periudhës analizuere) dhe Evropë (indeks i rritjes prej 74,2 pikëve). Rritje më e madhe e konsumit është realizuar në Azi prej 251,1 pikë indeksi, me ç'rast vend udhëheqës është Kina, me konsum të lartë të plumbit.

Prodhimi dhe konsumi i plumbit të rafinuar-metal (2002-2009)





Fig.4.6-2. Grafiku i prodhimit dhe konsumit të plumbit të rafinuar (2001-2009).

Përdorimi i metalit zink në produktet finale

Fig.4.6-3.
Diagrami i përdorimit të
metalit zink në produkte
finale.




Në Evropë, vendet me konsum më të madh të plumbit janë: Gjermania (20,7% viti 2009), Spanja (15,5%), Italia (13,7%), Mbretëria e Bashkuar (13,4%) dhe Franca (7,7%). Me konsum relativisht më të vogël të plumbit, mbeten: Republika e Çekisë (5,7%), Polonia (5,1%) dhe Federata Ruse (4,5%). Ndërkaq, vendet tjera të cilat sipas statistikave janë të regjistruara si konsumatorë të plumbit, shënojnë pjesëmarrje më të vogël, por më të barabartë në konsum.

Vendet me industri të zhvilluar automobilistike (Gjermania, Franca, Italia, Spanja, Çekia, në sasi të vogël Federata Ruse dhe Polonia), shënojnë konsum më të madh të metalit plumb nga prodhimi vetjak. Në vendet me konsum më të vogël të plumbit, dominon konsumi për qëllime të tjera, para se gjithash, në industri dhe në ndërtimtari.

Konsumi në (%) i metalit Pb në Evropë

Fig.4.6-4
Grafiku i konsumit së
metalit të plumbit në
Evropë.



Konsumi dhe prodhimtaria vjetore e plumbit janë përafërsisht të barabarta me ndryshime jo të mëdha vjetore. Gjatë periudhës analizuuese, viteve 2002-2007, konsumi është më i madh se prodhimtaria. Ky dallim është më i madh në vitin 2004, ku konsumi është më i madh se prodhimi për 4,3%. Mospërputhjet

e këtilla të konsumit me prodhimtarinë, gjegjësisht, të kërkesës me ofertën, në pjesën më të madhe janë rezultat i realizimeve vjetore të ekonomive prodhuese dhe konsumuesve më të mëdhenj të plumbit, ndërsa në një pjesë të mirë edhe të ndikimit të spekulimeve në këtë treg.

Realizimet në fushën e konsumit të zinkut, në thelb, i kanë karakteristikat e njëjta, sikur edhe ato të plumbit, me dallimet të cilat rrjedhin nga cilësitë e konsumit të këtij metali. Lëvizjet globale në konsumin e zinkut, karakterizohen me rritje relativisht më të matur të konsumit të përgjithshëm botëror, prej 121,7 pikë indeksi, gjatë periudhës së viteve 2001–2009.

Karakteristikë e përgjithshme e lëvizjeve të konsumit nëpër kontinente, ngjashëm me plumbin, është rritja mjaft e lartë në Azi (indeksi 185,2 pikë) dhe zvogëlimi i konsumit në kontinentet tjera.

Lëvizjet e këtilla kanë kontribuar, që pjesëmarrja në konsumin e të ashtuquajturës “Bota Perëndimore”, në konsumin e përgjithshëm të zinkut të zvogëlohet prej 77,3%, sa arrinte në vitin 2001, në 52,7% në vitin 2009.

Konsumi në (%) i zinkut të rafinuar-metal




Fig.4.6-5 Grafiku i konsumit global të metalit të zinkut.

Prodhues më të mëdhenj të zinkut në Evropë janë: Gjermania (pjesëmarrje në konsumin e përgjithshëm prej 19% në vitin 2009), Belgjika (pjesëmarrje prej 14,8%), Franca (pjesëmarrje prej 11,4%), Italia (pjesëmarrje prej 11,1%), Spanja (pjesëmarrje prej 7,6%) dhe Federata Ruse (pjesëmarrje 7,4%). Me konsum relativisht të madh të zinkut veçohen edhe Mbretëria e Bashkuar, Holanda dhe Polonia. Konsumi relativisht i madh i zinkut në këto vende në pjesën më të madhe është rezultat i shfrytëzimit të zinkut për galvanizim, si rrjedhojë e politikës së Bashkimit Evropian, për zvogëlimin e emisionit të CO₂, e cila shkaktohet me korrozionin e hekurit.

Konsumi në (%) i metalit Zn në Evropë




Fig.4.6-6 Grafiku i konsumit të zinkut në Evropë.

Konsumi dhe prodhimtaria e zinkut, ngjashëm me gjendjen te plumbi, lëvizin së bashku, me luhatje të vogla vjetore. Gjatë periudhës së viteve 2001-2009, vetëm në vitin 2004 dhe 2005, konsumi është më i madh nga prodhimtaria (ky dallim në vitin 2005 është më i madh dhe arrin 3,7%). Dallimet vjetore mes konsumit dhe prodhimit të zinkut, paraqiten për shkak të realizimeve të ekonomive të shteteve më të mëdha konsumatore dhe prodhuese të zinkut, ndërsa në një pjesë të mirë edhe si rezultat i spekulimeve, të cilat ishin të pranishme në tregun e zinkut.

Konsumi në (%) i zinkut të rafinuar-metal




Fig.4.6-7. Grafiku i konsumit global të zinkut.

Të dhënat statistikore tregojnë se trendët afatgjatë të konsumit të plumbit dhe të zinkut në botë, janë të varura nga shkallët e rritjes ekonomike. Madje, edhe në kushte të recesionit global, rritja mesatare e konsumit është më e

sigurt nga tkurrja. Për shembull, gjatë periudhës së viteve 2001–2009, te plumbi, në nivel vjetor, vetëm në vitin 2009 paraqitet zvogëlim i vogël i konsumit prej 0,3% në krahasim me vitin paraprak, ndërsa te zinku, brenda një viti, zvogëlimi i konsumit paraqitet në vitin 2006 prej 5,6% dhe në vitin 2009 prej 0,1%.

Në vitin 2010, si rezultat i nxitjeve fiskale në Kinë dhe në SHBA dhe nxitjet në ekonomitë tjera të mëdha, është realizuar rritje mesatare e kërkesës dhe konsumit. Në periudhën afatgjate, lëvizjet e kërkesës do të jenë përcaktuese, pavarësisht politikave ekonomike të konsumatorëve dhe prodhuesve më të mëdhenj. Kjo do të varet edhe nga shkalla e urbanizimit në Azi dhe procesi i industrializimit të vendeve në zhvillim. Megjithatë, është mendim i përgjithshëm, se rritja globale do të jetë relativisht më e ulët, nga ajo e dhjetë viteve të kaluara.




Figura 4.6-8 Trend i ardhshëm i konsumit të plumbit dhe zinkut.

Me këtë rast, në kushte kur koncentrat i plumbit gjithnjë e më shumë prodhohet si produkt ose në rastin më të mirë, si bashkëprodhim i koncentratit të zinkut, në shumë miniera të botës, do të thotë se prodhimtaria e minierave të plumbit, gjithnjë e më shumë është e varur nga kushtet e tregut të zinkut, ndërsa më pak, nga kërkesa e shkritoreve të plumbit.

Edhe pse plumbi sekondar shënon shkallë të lartë të rritjes dhe pjesëmarrje në prodhimtarinë e përgjithshme të plumbit, ende është e pranishme nevoja e prodhimtarisë primare të plumbit, që ta mbushë zbrazëtirën mes kërkesës dhe prodhimtarisë së plumbit sekondar. Kjo do të thotë, se kërkesa dhe çmimi i plumbit, do të jenë nën ndikim të fuqishëm të ofertës së plumbit primar.

Konsumi i plumbit në të kaluarën ka pasur përdorim më të gjerë. Në dekadat e fundit të shekullit XX, rrethi i përdorimit është zvogëluar, jo vetëm si rezultat i ndryshimeve teknologjike, por edhe për shkaqe shëndetësore dhe

mjedisore. Në fillim të shekullit XXI, përdorimi final i plumbit, në pjesën më të madhe është përcaktuar nga prodhimtaria e akumulatorëve. Kjo e bënë kërkesën e ardhshme për plumb, të ndjeshme dhe të varur edhe nga përdorimi i teknologjive alternative për akumulatorë dhe prodhim të automobilave hibridë.

Megjithatë, pavarësisht nga ndryshimet në përdorimin final të plumbit, trendët afatgjate të konsumit të plumbit, janë në rritje. Duke e pasur parasysh prodhimtarinë e ardhshme të automobilave dhe të akumulatorëve, në të gjitha format e tyre, si dhe rrjedhat e ekonomisë në Kinë, zhvillimi i ndërtimtarisë dhe industrializimit të vendeve në zhvillim, duhet të pritët rritje mesatare dhe e vazhdueshme e konsumit të plumbit.

4.7. Importuesit dhe eksportuesit kryesorë të plumbit, zinkut dhe rezervat e metaleve

Tashmë është theksuar se xeherorët e plumb-zinkut eksploatohen dhe shkrihen në shumë vende të botës, ndërsa një numër më i vogël i vendeve paraqiten me pjesëmarrje më të madhe dhe vetjake në shkrirjen, importin dhe eksportin. Rrjedhat globale të koncentratit janë të orientuara drejt Azisë (më shumë drejt Kinës dhe Japonisë), Evropës dhe SHBA-së, si pranuese. Si vende konsumuese paraqiten Amerika Veriore (Kanadaja dhe Meksikoja), ndaj SHBA-së, Evropës, Azisë; Australia dhe Amerika Jugore, janë konsumuese përballë Evropës dhe Azisë; si dhe Australia, përballë Azisë dhe Evropës. Rrjedhat e këtyre të shitjeve të koncentratit të plumbit dhe të zinkut, tregojnë se tregtia është e orientuar drejt vendeve të cilat janë konsumuese të mëdha të këtyre metaleve. Këto vende, nga njëra anë disponojnë industri të fuqishme për rafinimin e metaleve të plumbit dhe zinkut, por, nga ana tjetër, janë të varfra me xeherorët e këtyre metaleve.

Në përmasa botërore, importi i xeherorëve dhe i koncentratit ka trend rritës, i cili në periudhën e viteve 2001–2009, realizoi rritje prej 140,4 pikësh indeksi. Importuesit më të mëdhenj të xeherorëve së plumbit dhe të koncentratit, janë shtetet e Azisë dhe të Evropës. Azia shënon pjesëmarrje rritëse në importin e përgjithshëm botëror të xeherorëve dhe koncentrateve (nga 52,4% në 2001, në 75,1% në vitin 2009). Ndërsa, pjesëmarrja e Evropës ka tendencë të rënies (prej 39,7% në 20,1%). Pjesëmarrja e lartë dhe rritëse e Azisë, në pjesën më të madhe është rezultat i importit që e realizon industria kineze.

Eksportuesit më të mëdhenj të xeherorëve të plumbit dhe të koncentrateve, janë: shtetet e Amerikës, Australisë dhe të Evropës. Për dallim nga importi i xeherorëve së plumbit dhe koncentrateve, eksporti i përgjithshëm shënon indeks negativ të rritjes prej 92,1 pikë.




Fig.4.7-1 Indeksi i importit të xeherorëve, koncentratit dhe metalit të plumbit.

Karakteristikë është, se importi i vendeve nga Azia dhe Evropa, tregon tendencë të rritjes, ndërsa eksporti i vendeve të Amerikës, Afrikës dhe Australisë, ka parashenjë negative. Pjesëmarrja relativisht e vogël e eksportit të vendeve nga Azia, paraqitet si rezultat i konsumit të madh, të cilën e realizon industria shkrirëse dhe rafinimit në Kinë.

Në importin botëror të metalit plumb, është dominuese pjesëmarrja e vendeve nga Evropa, Azia dhe nga Amerika.

Ngjashëm me gjendjen e importit të xeherorëve të plumbit dhe koncentrateve, Australia paraqitet si importuese e plumbit. Njëkohësisht, ky kontinent është eksportues i madh, si i xeherorëve ashtu edhe metaleve. Me këtë rast, në suaza botërore, paraqitet indeksi negativ i rritjes së importit të metalit plumb prej 92,0 pikësh, në kushte të rritjes relativisht të vogël negative të eksportit prej 87,8 pikë indeksi. Eksportues më të mëdhenj të këtij metali, janë vendet e Evropës, Amerikës, Australisë dhe Azisë. Veçori për eksportin e plumbit është, se në periudhën pas vitit 2007, pjesëmarrja e Azisë ka tendencë të zvogëlimit, si rezultat, para se gjithash i eksportit të zvogëluar të metalit nga Kina.

Në tregtinë botërore me xeherorët e zinkut dhe të koncentrateve, është i pranishëm trendi rritës prej 119,2 pikë indeksi, në periudhën e viteve 2001-2009. Kjo rritje është realizuar si rezultat i importit të rritur të xeherorëve dhe koncentrateve të vendeve nga Amerika, para se gjithash nga Azia (Kina).

Importi i xeherorëve, koncentratit dhe metalit të plumbit (2001-2009)




Fig.4.7-2 Indeksi i eksportit të xeherorëve, koncentratit dhe metalit të plumbit.

Për shkak të dinamikës së ndryshme të rritjes së importit të xeherorëve të zinkut dhe koncentrateve, zvogëlohet pjesëmarrja e Evropës për llogari të pjesëmarrjes së rritur të vendeve nga Azia. Në eksportin e xeherorëve dhe koncentrateve, është dominuese pjesëmarrja e vendeve nga Amerika, me më shumë se gjysmën e eksportit të përgjithshëm botëror, të Australisë, me rreth një të katërtën dhe të Evropës me rreth 17%. Ndërsa, pjesëmarrja e vendeve nga Azia dhe Afrika është e vogël ose e parëndësishme. Te importi botëror i metalit të zinkut, dominojnë vendet e Evropës, Azisë dhe të Amerikës, ndërsa te eksporti, krahas vendeve nga këto kontinente, eksportues relativisht i vogël paraqitet Australia.

Vendet e Evropës paraqiten mes importuesve dhe eksportuesve më të mëdhenj të xeherorëve të plumb-zinkut, koncentrateve dhe të këtyre metaleve. Ky është rezultat i traditës së gjatë të xehetarisë në këtë kontinent dhe shkallës relativisht më të lartë të zhvillimit industrial. Megjithatë, për shkak të kushteve natyrore dhe pasjes së pasurive minerale, por edhe të shkallës së lartë të zhvillimit të industrisë, vendet e këtij kontinenti më shumë importojnë sesa që eksportojnë xeheror plumbi dhe koncentrate. Në periudhën pas vitit 2003, dallimi mes sasive të importuara dhe të eksportuara të xeherorëve dhe koncentrateve është zvogëluar, ndërsa në vitin 2009, pothuajse është barazuar.




Fig.4.7-3 Plumbi, importi dhe eksporti (xeheror dhe koncentrat) në Evropë.

Si importues kryesor të xeherorëve të plumbit dhe të koncentrateve, janë Gjermania dhe Belgjika. Në vitin 2009, këto dy vende realizuan së bashku rreth 80% të importit të vendeve nga Evropa. Me pjesëmarrje relativisht më të vogël në import, marrin pjesë Bullgaria dhe Italia. Si eksportuese të xeherorëve dhe koncentrateve nga Evropa, paraqiten shumë vende, nga të cilat, Belgjika, Federata Ruse dhe Irlanda realizojnë më shumë se 70% nga eksporti i përgjithshëm (të dhënat e vitit 2009).

Si eksportues relativisht të mëdhenj të xeherorëve dhe koncentratit janë edhe Polonia dhe Suedia, me mbi 20% pjesëmarrje në eksportin e vendeve të këtij kontinenti.

Në importin dhe eksportin e metalit të plumbit në kuadër të Evropës, marrin pjesë një numër relativisht i madh i vendeve. Gjendja e këtillë tregon sistemin e zhvilluar të bartjes, në rend të parë të koncentratit të plumbit dhe të industrisë së zhvilluar të shkrirjes dhe përpunimit. Me këtë rast, gjatë gjithë periudhës analizuuese, vendet e Evropës janë dukshëm importues më të mëdhenj të metalit të plumbit nga importuesit tjerë. Gjatë gjysmëvjetorit të parë të vitit 2008, importi dhe eksporti barazohen, ndërsa në gjysmën e dytë të vitit 2008 dhe muajt e parë të vitit 2009, eksporti është më i madh nga importi.




Fig.4.7-4 Plumbi, importi dhe eksporti (metal) në Evropë.

Importi i metalit të plumbit në Evropë, shënon dinamikë negative të rritjes prej 71.1 pikë indeksi, gjatë periudhës së viteve 2001-2009, që është rezultat i tendencës së zvogëlimit të importit pas vitit 2006. Si importues më të mëdhenj të metalit të plumbit paraqiten: Spanja, Gjermania, Italia dhe Republika Çeke, me rreth 70% pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm, në vitin 2009.

Për dallim nga importi, eksporti i metalit të plumbit në Evropë, realizon shkallë pozitive të rritjes prej 126,7 pikësh indeksi. Rritja më e madhe e eksportit është realizuar në vitin 2008 dhe 2009. Eksportues më të mëdhenj të plumbit janë Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar, me rreth 40% nga eksporti i përgjithshëm në vitin 2009. Si eksportues relativisht të mëdhenj, paraqiten edhe Belgjika, Federata Ruse dhe Bullgaria me rreth 37% pjesëmarrje.

Për dallim nga importi dhe eksporti i xeherorëve të plumbit dhe të koncentrateve, gjendja në importin dhe në eksportin e xeherorëve dhe koncentrateve të Zn në Evropë, karakterizohet me dallim dukshëm më të madh mes importit dhe eksportit. Kjo tregon mungesën e shprehur të xeherorëve të zinkut dhe koncentratit nga njëra anë dhe të varshmërisë më të madhe importuese të industrisë së shkrirjes së vendeve evropiane. Kështu, eksporti i xeherorëve dhe koncentratit, lëvizë në rreth 700 mijë tonë në vit, gjatë gjithë periudhës së viteve 2001-2009, ndërsa importi lëviz prej 2.200-2.500 mijë tonë, në periudhën e viteve 2001-2007, me trend të rënies gjatë viteve 2008-2009.

1x1000 ton

Importi dhe Eksporti i Konc. dhe xehe. së Zn në Evropë (2001-2009)




Fig.4.7-5 Zinku, importi dhe eksporti (xeheror dhe koncentrat) në Evropë.

Importi i metalit të zinkut të vendeve nga Evropa, në periudhën e viteve 2001-2009, shënon indeks më të vogël negativ të rritjes, në krahasim me atë të xeherorëve dhe koncentrateve, 95 pikë. Te eksporti i metalit vërehet pothuajse indeks i njëjtë i rritjes, me atë të realizuar të xeherorëve dhe koncentrateve, 108,9 pikë. Për dallim nga importi dhe eksporti i xeherorëve të zinkut dhe koncentrateve, importi dhe eksporti i metalit të zinkut në Evropë, karakterizohet me barazim relativ me periudha të eksportit më të lartë nga importi dhe anasjelltas. Kështu, në vitet 2003-2005 dhe 2009, nga Evropa më shumë është eksportuar metal zinku, sesa që është importuar, ndërsa viteve tjera, importi ishte më i madh nga eksporti.

Lëvizjet e këtilla në import dhe eksport të metalit të zinkut në Evropë, mund të sqarohen me lëvizjet ciklike afatshkurtra të ofertës dhe të kërkesës së metalit. Me këtë rast, duhet të merret parasysh shkalla relativisht e lartë e zhvillimit të industrisë së shkrirjes në Evropë dhe industrisë së përpunimit. Në mënyrë të veçantë, është i rëndësishëm përdorimi i zinkut për galvanizim të çelikut, në kuadër të politikës së Bashkimit Evropian, për zvogëlimin e emisionit të CO₂. Gjithashtu, duhet të merret parasysh edhe zbatimi relativisht më i gjerë i zinkut dhe i vëllimit të eksportit të produkteve, për prodhimin e së cilës ai përdoret, para se gjithash në shtetet e Afrikës dhe të vendeve në zhvillim.




Fig.4.7-6 Zinku, importi dhe eksporti (metal) në Evropë.

Si importues më të mëdhenj të metalit zink, nga vendet evropiane, janë: Gjermania, Belgjika dhe Holanda, me rreth 60% të importit të realizuar gjatë vitit 2009. Krahas këtyre vendeve, importues të mëdhenj janë: Franca, Italia dhe Mbretëria e Bashkuar, me rreth 27% të importit në vitin 2009. Eksportues më të mëdhenj të metalit të zinkut në Evropë, janë: Holanda, Finlanda dhe Spanja, me rreth 60%, nga eksporti i realizuar në vitin 2009. Si eksportues relativisht të mëdhenj, paraqiten: Norvegjia, Polonia, Federata Ruse dhe Bullgaria.

4.8. Oferta dhe kërkesa për xeherorë të plumbit, zinkut dhe të këtyre metaleve në rajon

Rajoni i Ballkanit është prodhues i rëndësishëm i xeherorëve të plumb-zinkut dhe të koncentratit. Karakteristikë kryesore e industrive për plumb dhe zink në këto vende, është pjesëmarrja relativisht e lartë në prodhimtarinë e xeherorëve dhe concentrateve në kuadër të Evropës nga njëra anë dhe pjesëmarrje më të vogël në prodhimtarinë e metalit, nga ana tjetër. Në mënyrë të veçantë, kjo vjen në shprehje në prodhimtarinë e xeherorëve të plumbit. Në trajtimet e mëhershme të kësaj çështje, është theksuar se mungojnë të dhëna për prodhimtarinë e realizuar në Kosovë. Kjo ka ndodhur, sepse për njëfarë kohe, pas rifillimit të punës së minierave në Kosovë, për shkak të statusit të saj, i gjithë prodhimi i këtyre minierave, është evidencuar si prodhim i Serbisë.

Sipas të dhënave në dispozicion nga evidenca statistikore e ILZSG, pjesëmarrja e vendeve në rajon (Bosnjë e Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Maqedonia, Rumania dhe Serbia, gjatë periudhës analize 2001-2009, në prodhimtarinë e xehorëve në Evropë, vërehen dallime të mëdha. Trendi i rënies së pjesëmarrjes zgjat deri në vitin 2005, kur është realizuar pjesëmarrje më e vogël prej 11,7%. Pas këtij viti, prodhimtaria në këto vende rritet, që të arrijë pjesëmarrje prej 28,1% në vitin 2009s. Pjesëmarrja individuale e vendeve në prodhimtarinë e xehorëve të plumbit, tregon dinamikë të ndryshme, që mund të sqarohet me problemet e tranzicionit dhe të privatizimit të minierave dhe metalurgjive. Megjithatë, në pjesën më të madhe të këtyre vendeve vërehet, trend i rritjes së prodhimtarisë së xehorëve, me përjashtim të Greqisë dhe Rumanisë. Gjatë vitit 2009, si prodhues më i madh në rajon paraqitet Maqedonia, me pjesëmarrje prej 16,4% në prodhimtarinë e përgjithshme të realizuar në Evropë (ose 60,5% nga prodhimtaria e të gjitha vendeve të rajonit), Bullgaria me 5,7% dhe Greqia me 3,8%. Për t'u theksuar është zvogëlimi i prodhimtarisë së këtyre xehorëve në Rumania, e cila ka rënë nga 7,4% në vitin 2003, në prodhimtarinë e parëndësishme në vitin 2009.




Fig.4.8-1 Prodhimi i xehorëve të plumbit në rajon.

Pjesëmarrja në prodhimtarinë e metalit të plumbit të vendeve nga rajoni, në prodhimtarinë e realizuar në kuadër të Evropës, është dukshëm më e vogël, në krahasim me prodhimtarinë e xehorëve. Gjatë periudhës analize arrin rreth 7%. Prodhues më i madh i metalit në kuadër të vendeve të rajonit është Bullgaria, me pjesëmarrje prej 5% në prodhimtarinë e përgjithshme evropiane të plumbit në vitin 2009, ose 79% nga prodhimtaria e vendeve në rajon. Për t'u theksuar është rasti me Maqedoninë, ku pas vitit 2004 nuk rafinohet plumb, si rezultat i ndërprerjes së punës së shkretoreve "Zletovë" në Veles.

Pjesëmarrja relativisht më e vogël e vendeve të rajonit në prodhimtarinë e metalit, sqarohet me (mos)zhvillimin e kapaciteteve në shkritore. Nga të gjitha vendet, vetëm Bullgaria shënon afërsisht pjesëmarrje të njëjtë në prodhimtarinë e xeherorëve dhe të metalit. Në vende të tjera, prodhimtaria e xeherorëve është dukshëm më e vogël nga prodhimtaria e metalit. Kjo mund të sqarohet pjesërisht, me nivelin e zhvillimit të kapaciteteve të shkritoreve dhe të politikës industriale të këtyre vendeve, me ndërprerjen e punës së shkritoreve në Maqedoni, Kosovë dhe me prodhimtarinë e vogël të Serbisë.

Analiza e raportit të prodhimtarisë së xeherorëve dhe të metalit, tregon se vendet e rajonit janë relativisht më pak të varura nga importi i këtyre xeherorëve, në krahasim me gjendjen e shteteve të Evropës. Kjo sqarohet me prodhimtarinë relativisht më të madhe të xeherorëve të vendeve nga rajoni. Kështu për shembull, në Evropë, prodhuese të metalit të plumbit, janë vende të cilat nuk kanë miniera të veta dhe tërësisht janë të varura nga importi i xeherorëve dhe koncentrateve. Prodhimtaria e xeherorëve të zinkut dhe metaleve në rajon, ngjashëm me prodhimtarinë e xeherorëve të plumbit, ka tendencë të rënies në periudhën 2001–2005 dhe të rritjes në vitet e më vonshme. Megjithatë, pjesëmarrja në prodhimtarinë e përgjithshme të xeherorëve të zinkut në rajon, është dukshëm më e vogël në krahasim me gjendjen e prodhimtaria e xeherorëve të plumbit, e cila arrin 7% në vitin 2009. Në pjesëmarrjen e disa vendeve nga rajoni në prodhimtarinë e xeherorëve të zinkut, prin Maqedonia, e cila arrin 3,3% nga prodhimtaria e përgjithshme e Evropës, në vitin 2009 ose 47,1% nga prodhimtaria e të gjitha vendeve të rajonit. Si vende prodhuese të xeherorëve të zinkut, veçohen Greqia dhe Bullgaria, ndërsa prodhimtaria në vendet tjera është e vogël (grafiku poshtë).




Fig.4.8-2 Prodhimi i xeherorëve të zinkut në rajon.

Prodhimtaria e metalit të zinkut të rafinuar në rajon, arrin mesatarisht rreth 6% në vit, nga prodhimtaria evropiane dhe është pak më e vogël nga pjesëmarrja e rajonit në prodhimtarinë e metalit të plumbit, të realizuar në kontinent. Me këtë rast, si prodhues dominues i zinkut të rafinuar në rajon, por edhe të plumbit, paraqitet Bullgaria me 4,5% pjesëmarrje në prodhimtarinë e realizuar në Evropë, apo 95,8% nga prodhimtaria e vendeve të rajonit. Pjesa tjetër e zinkut të rafinuar prodhohet në Rumani, ndërsa në Maqedoni, Serbi dhe Kosovë, për shkak të ndërprerjes së prodhimtarisë së shkretoreve dhe elektrolizës, zinku i rafinuar nuk prodhohet.

Në kuadër të analizës së prodhimtarisë së zinkut të rafinuar në rajon, duhet të vërehet se ngjashëm edhe sikur te plumbi, prodhimtaria e metalit është më e madhe nga prodhimtaria e xeherorëve. Megjithatë, te zinku, ky dallim është më i vogël, ndërsa gjendja është pothuajse e njëjtë, kur krahasohen vendet në rajon, mesatarisht të realizuara në suaza të të gjitha vendeve në Evropë, të cilat disponojnë me miniera dhe industri të plumb-zinkut.

Po ashtu, vërehet rëndësia gjithnjë e më e madhe e riciklimit të plumbit dhe të zinkut me vëllimin e prodhimtarisë së përgjithshme në botë, sidomos në vendet e zhvilluara industriale. Sipas të dhënave të ILZST, në saje të rajonit, riciklimi i plumbit është i pranishëm në Greqi (1,0% në plumbin e përgjithshëm të ricikluar në kuadër të Evropës) dhe në Maqedoni në sasi jo të mëdha.

Është karakteristikë, se riciklimi në Greqi, shënon indeks të lartë të rritjes prej 200 pikëve, ndërsa në Maqedoni ka trend të rënies. Riciklimi i zinkut në rajon nuk është i pranishëm në të dhënat statistikore.

Konsumi i metalit të plumbit dhe zinkut në rajon, është më shumë se përgjysmë më i vogël nga prodhimtaria e realizuar, si rezultat i së cilës, pjesëmarrja në konsumin e përgjithshëm në Evropë, arrin rreth 3%. Ndërkaq, konsumi është në mënyrë të barabartë i sistemuar te vendet si: Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Maqedonia, Rumania dhe Serbia (deri në vitet 2001-2004 Serbia dhe Mali i Zi). Gjendja e këtillë është e përcaktuar nga zhvillimi dhe struktura e industrisë përpunuese të disa vendeve, sidomos në industrinë e metalit, zhvillimit të ndërtimtarisë dhe shkallës së urbanizimit të këtyre vendeve. Për shkak të mosekzistimit të industrisë së zhvilluar automobilistike në vendet e rajonit, me përjashtim të industrive të këtilla në Rumani dhe në Serbi. Konsumi i përgjithshëm është i përcaktuar, para se gjithash, nga qëllimet tjera, të cilat kanë pjesëmarrje relativisht më të vogël në përdorimin final. Me këtë rast, duhet të kihet parasysh edhe ekzistimi i industrive për prodhimtarinë e akumulatorëve në disa vende të rajonit, por ato kanë kapacitete relativisht të vogla ose nuk janë aktive.




Fig.4.8-3 Trendi i konsumit të metalit të plumbit në rajon.

Sa i përket zinkut, vendet e rajonit konsumojnë relativisht sasi më të vogël për galvanizimin e çelikut, por edhe për qëllime të tjera, të cilat janë karakteristike për këtë metal. Gjendja e theksuar, lidhur me konsumin e metalit të zinkut, tregon se vendet në rajon, të cilat paraqiten si prodhuese të xeherorëve dhe metalit, janë eksportuese të këtyre dy metaleve.

Konsumator më i madh i metalit të zinkut në rajon është Greqia edhe për kundër krizës së njohur ekonomike në këtë vend, përderisa Rumania shënon rënie në konsum.




Fig.4.8-4 Trendi i konsumit të metalit të zinkut në rajon.

Te zinku, në vendet e rajonit, është relativisht më i vogël përdorimi për galvanizimin e çelikut, ndërsa edhe për qëllime të tjera, të cilat janë karakteristike për këtë metal. Gjendja e theksuar, lidhur me konsumin e metalit të zinkut, tregon se vendet në rajon, të cilat paraqiten si prodhuese të xeherorëve dhe metaleve, janë eksportuese të këtyre dy metaleve.

Raporti i prodhimit dhe konsumit të metalit të plumbit dhe të zinkut në vendet e rajonit e pasqyron strukturën e industrisë në këto vende, ku është e madhe pjesëmarrja ose mbisundon prodhimtaria dhe eksporti i lëndëve të para dhe i gjysmëfabrikateve. Gjendja e tillë i bën ekonomitë e këtyre vendeve të ndjeshme ndaj lëvizjeve ciklike të ofertës-kërkesës dhe ndaj lëvizjeve spekulative të çmimeve. Këto janë karakteristike për këtë veprimtari, në mënyrë të veçantë ishin të fuqishme gjatë periudhës analizuese të viteve 2001-2009.

Në këto korniza, duhet të theksohen edhe efektet nga ndryshimet ndërvalutore të kurseve të valutave botërore, sidomos në SHBA, dollari përdoret më shumë në pagesat botërore.

Ndryshimi i strukturës së konsumit dhe eksporti më i madh i prodhimeve të gatshme, në të cilat do të kyçen plumbi dhe zinku në strukturën e eksportit, do të thotë derdhje më e madhe valutore për vendet që e zhvillojnë këtë veprimtari, si dhe mundësi për realizimin e shkallëve më të larta të fitimeve të kompanive së kësaj industrie.

Në importin dhe eksportin e xeherorëve, koncentratit dhe metaleve të plumb-zinkut, merr pjesë një numër i vogël i vendeve të rajonit. Importues i xeherorëve dhe koncentrateve, paraqitet vetëm Bullgaria me pjesëmarrje prej 12,1%, në krejt importin e realizuar në Evropë, në vitin 2009. Sa i përket importit të metalit të plumbit, si importues nuk është regjistruar asnjë vend i rajonit, ndërsa eksportues vetëm Bullgaria me pjesëmarrje prej 10,9%, në eksportin e përgjithshëm, të realizuar nga ana e të gjitha vendeve evropiane gjatë vitit 2009.

Indeksi mesatar i prodhimit dhe konsumit Pb të rafinuar (2001-2009)




Fig.4.8-5.
Trendi i konsumit dhe prodhimit të plumbit të rafinuar në vendet e rajonit.

Indeksi mesatar i prodhimit dhe konsumit të Zn të rafinuar (2001-2009)




Fig.4.8-6.
Trendi i konsumit dhe prodhimit të zinkut të rafinuar në vendet e rajonit.

Importues të xeherorëve së zinkut, përsëri paraqitet Bullgaria (pjesëmarrje prej 4,6% në importin e përgjithshëm evropian në vitin 2009 dhe Serbia. Eksportuesi i vetëm i xeherorëve së zinkut dhe koncentrateve është Greqia, me pjesëmarrje prej 1,1% në eksportin botëror në vitin 2009. Importues i metalit zink është po ashtu Greqia, me pjesëmarrje prej 1,7% në importin e përgjithshëm evropian në vitin 2009, ndërsa si eksportues paraqitet vetëm Bullgaria, me pjesëmarrje prej 6,5% në eksportin evropian, në vitin e njëjtë.

Sipas analizës paraprake, për realizimet e vendeve në rajon, mund të konstatohet se: **Bullgaria është vend udhëheqës në industrinë e plumbit dhe të zinkut në rajon.** Veçanërisht, është e madhe pjesëmarrja e këtij vendi në prodhimtarinë e metalit, ndërsa paraqitet edhe importues i madh i xeherorëve nga shumë vende të rajonit, si dhe eksportues në rajon dhe në vende të tjera.

KAPITULLI V

5.1 MODELE TË RISTRUKTURIMIT

Përvojat e shumë vendeve treguan shumë shembuj të “mossuksesit të tregut” dhe të ndikimit të ekonomisë tregtare, ndërsa gjithashtu edhe kufizime të ndikimit të rregullimit (të shtetit). Konsiderohet se shteti (qeveria), duhet ta orientojë fokusin në rregullimin e këtyre fushave, në të cilat mossukseset tregtare janë të rëndësishme edhe për ato raste, ku me siguri mund të supozohet se intervenimi i saj dukshëm do të kontribuojë dhe do të ketë efekte pozitive. Kjo mundëson, që shteti të ketë rol aktiv në krijimin e kushteve makroekonomike për shfrytëzim të plotë të resurseve të zhvilluara të ekonomisë dhe mbajtjen e nivelit relativisht të lartë të punësimit dhe standardit jetësor të popullsisë. Kjo supozon se sektori privat, duhet të ketë rol udhëheqës në ekonomi, që do të thotë, mbështetje më e madhe në tregjet dhe mekanizmat tregtare.

Ekonomia në Kosovë ndodhet në fazën e transformimit të ndërmarrjeve publike në pronësi private. Privatizimi zakonisht ndërlidhet me format e joshtetëzimit të ndërmarrjeve publike shtetërore, çrregullimit dhe zhvillimit të përgjegjësisë publike (gjithëpërfshirëse). Procesi i privatizimit përfshin privatizim të ndërmarrjeve shtetërore dhe publike, likuidimin ose rristrukturimin e tyre.

Ky proces në Kosovë, është në kompetencë të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, (Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr.03/L-067).

Me qëllim që të realizohet harmonizimi i nevojshëm me rregullat dhe ligjet relevante ndërkombëtare, me praktika për eksploatim të sigurt, me standarde mjedisore, është miratuar Ligji për Miniera dhe Minerale, i cili rregullon gjithë punën e industrisë minerare.

Ky ligj, përfshin grumbullimin, menaxhimin dhe arkivimin e të dhënave gjeologjike-shkencore. Ligji ka të bëjë me të gjitha aktivitetet në lidhje me eksploatimin, hulumtimin dhe aktivitetet tjera që ndërlidhen me resurset minerale. Në mënyrë të veçantë është theksuar në këtë ligj, se asnjë person nuk mund të realizojë aktivitete në lidhje me hulumtimin, eksploatimin, kryerjen

e punëve xehetare, përpunimin e resurseve minerale, apo të realizojë çfarëdo qoftë aktiviteti, i cili nuk përfill këtë ligj.

5.1.2. Likuidimi ose sanimi i minierave dhe fabrikave të pasurimit

Sanimet paraqesin aktivitetet, të cilat janë të ndërlidhura me masat të cilat merren, që ndërmarrja të aftësohet sërish të realizojë të ardhura dhe përfitime. Sanimi përfshin shumë lloje të masave për mënjanimin e problemeve, të cilat janë të ndërlidhura me ekonomizimin e ndërmarrjes apo kompanisë, problemet në lidhje me tatimet dhe problemet të ndërlidhura me rregulloren juridike. Para se të merret vendim për jetën e mëtutjeshme të disa minierave dhe fabrikave të pasurimit me flotim të "Trepçës", nevojitet që të vërtetohet nëse ato janë të gatshme për sanim, si dhe të llogaritet vlera, respektivisht shpenzimet për realizimin e sanimit.

Që të vërtetohet gatishmëria për sanim, nevojitet që të bëhet analizë më e thellë e gjendjes ekonomike dhe financiare e të gjitha minierave dhe fabrikave të pasurimit të ndërmarrjes "Trepça". Kjo analizë e thelluar do të tregojë nëse minierat dhe fabrikat e pasurimit në tërësi, apo edhe veç e veç, janë të afta që me sukses së punojnë në periudha afatshkurtra apo afatgjata. Megjithatë, duhet të merret parasysh se vlerësimi i shpenzimeve të sanimit, paraqet detyrë komplekse, nga vlerësimi i gatishmërisë për sanim, duke marrë parasysh, se ka mundësi që faktorë të tjerë, jo vetëm ata ekonomikë, ndikojnë në miratimin e vendimit.

Vlerësimi nëse ndërmarrja mundet të mbijetojë në aspektin afatshkurtër ose afatgjatë, do të varet nëse do të jenë pozitive përgjigjet e të gjitha pyetjeve në lidhje me vlerën e sanimit. Në rast të përgjigjes pozitive, do të konsiderohet se minierat si tërësi, ndërkaq edhe veç e veç, mund të prodhojnë në mënyrë rentabile dhe të jenë ekonomike.

Përvoja e deritanishme dhe analizat e gjendjes ekonomike dhe financiare të ndërmarrjes "Trepça", tregojnë se:

- Ndërmarrja prodhon në kuadër të kushteve ekzistuese, të cilat janë dukshëm të pavolitshme;
- Se është i domosdoshëm intervenimi financiar, pa të cilën ndërmarrja nuk do të mundet të ekzistojë dhe të zhvillohet;
- Se pa transformim afatgjatë, ristrukturim, sanim apo privatizim, nuk do të mund të realizohet zhvillim me orientim marketingu;
- Se menaxhmenti i ndërmarrjes ka ndërmarrë masa të rëndësishme për përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe financiare.

Në periudhën e deritanishme, janë bërë shumë analiza nga kompani dhe institucione të huaja konsulente, me qëllim që të vlerësohet gjendja ekonomiko-

financiare dhe mundësitë për punën e ardhshme të minierave të “Trepçës”, shikuar në aspektin afatgjatë. Këto analiza, të cilat janë bërë në bazë të njohurive dhe përvojave të vendeve të zhvilluara, janë me rëndësi të madhe, nëse investitorët e huaj do të tregojnë interes për “Trepçën”. Nga kjo do të varet edhe konceptimi i strategjisë së ardhshme për zhvillimin e kësaj industrie në vend.

Çështja e mëtutjeshme në lidhje me sanimin, paraqet mënjanimi i përplasjeve së interesave rreth “Trepçës”. Me këtë rast, parashtrohet pyetja, cili është interesi i shtetit të Kosovës, në lidhje me ristrukturimin dhe sanimin e “Trepçës” për privatizimin e saj? Kjo lejon vlerësim e konflikteve të interesave, të cilat paraqesin pengesë në sanimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjes, në radhë të parë për shkaqe politike.

Për shembull, si potencial i mundshëm për konflikt interesash, është konflikti me Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, (mekanizëm i krijuar nga UNMIK-u në Kosovë), në lidhje me obligimet e vjetra kreditore dhe të kontraktuara, si dhe problemet tjera, të cilat akoma nuk dihen.

Vendimi i gjykatës, sipas së cilës, struktura pronësore dhe organizuese e “Trepçës” duhet të mbetet e pandryshuar deri në miratimin e aktvendimit, e pengon miratimin e çfarëdo qoftë vendimi për sanim ose ristrukturim. Ndryshimi i këtij vendimi, do t’i krijojë hapësirë menaxhmentit të “Trepçës” për vendimmarrje dhe veprim. Potencial tjetër për konflikt, është ai mes Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe menaxhmentit të “Trepçës”, në lidhje me udhëheqjen e ndërmarrjes dhe rregullimin e kredive të vjetra dhe obligimeve. Sipas mendimit tonë, në këtë rast, duhet të gjendet mënyra që menaxhmentit të “Trepçës” t’i jepet hapësirë për marrje të vendimeve dhe veprimit në mënyrë të pavarur.

Potencial të mëtutjeshëm për konflikt, paraqet menaxhimi i pjesës veriore të “Trepçës”, nga strukturat serbe, ku bëjnë pjesë të ashtuquajturat “Minierat Veriore”, ku hyjnë minierat: Cërnac, Belloberdë, fabrika e pasurimit me flotim në Leposaviq dhe njësite tjera afariste. Përveç kësaj, ekziston edhe ndarja territoriale mes pjesës veriore (serbët), nga njëra anë dhe pjesa qendrore dhe jugore (shqiptarët) të “Trepçës”, nga ana tjetër. Juridikisht të dyja pjesët administrohen nga AKP-ja, por si ndërmarrje të ndara. Drejtim i veprimit në të ardhmen, do të ishte që pjesa serbe e “Trepçës” të integrohet gradualisht dhe ndërmarrja të veprojë si e tërësishme.

Sanimi i “Trepçës” mund të kryhet në dy mënyra:

- (1) Sanim transmetues dhe
- (2) Ristrukturimi;

Sanimi i transmetuar do të thotë se ndërmarrja bie në duar të një pronari të ri, me ç’rast kërkesat e kreditorëve do të kënaqeshin nga çmimi blerës.

Ristrukturim do të thotë që ndërmarrja mbetet në pronësi të bartësit të deritanishëm juridik. Në këtë rast, kreditorët do të shpagueheshin nga të ardhurat, të cilat do t'i realizojë ndërmarrja e ristrukturuar.

Çështje e rëndësishme e ndërlidhur me sanimin dhe ristrukturimin e minierave dhe fabrikave të pasurimit së "Trepçës", paraqet mosekzistimi i evidencës së plotë të kontabilitetit për afarizmin. Po ashtu, pas vitit 1999, evidenca dhe dokumentimi tekniko-teknologjik është marrë apo shkatërruar, kështu që nuk ekziston dokumentacion për të gjitha minierat për periudhën para vitit 1999. Ndërkaq, ekziston dokumentacion i përgjysmuar, vetëm për disa miniera që janë aktive. Siç është theksuar më herët, disa miniera nuk janë aktive dhe periudha e gjatë e mospërdorimit të pajisjeve dhe impianteve të tjera ka ndikuar në prishjen e tyre të shpejtë.

Përveç kësaj, të shpeshta janë rastet e minierave të vërshuara nga uji dhe të dëmtuara, si dhe të ndotjes së mjedisit.

Vërtetimi i vlerës së sanimit nuk mund të bëhet pa vlerësim të resurseve të disponueshme. Mosekzistimi i dokumentacionit përkatës dhe të besueshëm, për punën ekonomiko-financiare, obligon vendosje të shpejtë të evidencës së këtillë për çdo minierë dhe fabrikë pasurimi. Kjo është e domosdoshme për shkak të vërtetimit të parametrave kryesore të efikasitetit ekonomiko-financiar, të çdo njësie afariste dhe reparti. Vlerësimi i pronës ekzistuese të të gjitha minierave dhe fabrikave të pasurimit, është i nevojshëm për shkak të saktësisë të gjendjes reale, mbi të cilën do të bazohet vëllimi i investimeve të reja, për modernizimin dhe rifillimin e punëve në miniera dhe pasurimin e xeherorëve të eksploatuar.

Me analizë të thelluar, duhet të bëhet koncepti i sanimit, i cili duhet ta rikuperojë gjendjen, ndërsa theksi kryesor duhet të vendoset në fushën e marketingut dhe vëllimin e prodhimit, shitjes, vlerës së të ardhurave, pozicionit tregtar në lidhje me konkurrentët, realizimin e të ardhurave të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve dhe realizimin e fitimit. Me fjalë tjera, kjo do të thotë, hartim i strategjisë, me të cilën do të fitohen më shumë përparësi në raport me konkurrencën, kështu që përmbushet kërkesa për koncentre të plumbit-zinkut të grupeve të interesit.

Vlerësimi i pronës dhe themelimi i evidencës së rregullt të kontabilitetit, duhet të bëhet për të gjitha minierat dhe fabrikat e pasurimit (miniera dhe fabrika e pasurimit në Stantërg, miniera dhe fabrika e pasurimit në Kishnicë dhe miniera dhe fabrika e pasurimit në Leposaviq). Në çdo njësi afariste, duhet të formohen grupe punuese për vlerësimin e tokës, pronës dhe të objekteve, për vlerësimin e makinave dhe impianteve dhe për problemet e mjedisit jetësor. Ky proces është në vijim, ndërsa përbëhet nga inventari i hollësishëm i të gjitha objekteve pronësore, makinerive, impianteve dhe infrastrukturën rrugore. Inventari përfshin edhe vlerësimin e mirëmbajtjes. Në lidhje me mbrojtjen e

mjedisit jetësor dhe problemet mjedisore, bëhet vlerësim i gjendjes dhe vlerësim i mjeteve të nevojshme financiare për rehabilitimin e zonave paraprakisht të përcaktuara si të ndotura.

Sipas mendimit tonë, procesi i sanimit të “Trepçës” duhet të përbëhet nga dy faza strategjike:

1. Faza e parë strategjike dhe
2. Faza e dytë strategjike

Faza e parë strategjike

Kjo fazë i përfshin punët përgatitore për sanim, ristrukturim dhe privatizim. Si shumë e rëndësishme paraqitet çështja e integritit të “Minierave veriore” dhe fabrikës së pasurimit në Leposaviq, në kuadër të ndërmarrjes “Trepça”.

Gjatë periudhës vijuese duhet të kryhen: vlerësimi i pronës, përpunimi i bilanceve të kontabilitetit, përpunimi i skemës organizuese të holdingut (koncernit) dhe të njërive të veçanta afariste (minierat, fabrikat e pasurimit etj.). Po ashtu, duhet bërë përpunimin e skemave të fuqisë së nevojshme punëtore, strukturës kualifikuese për të gjitha njësitet afariste dhe holdingun, përpunimin e programit për investimet e nevojshme, përpunimin e modeleve për ristrukturim dhe privatizim. Përveç kësaj, në këtë fazë hynë edhe kompletimi i kornizës ligjore.

Në vazhdim, aktivitetet do të orientohen në realizimin e investimeve në pajtim me standardet e vendeve të zhvilluara industriale, ndërsa në radhë të parë standardeve të BE-së.

Faza e dytë strategjike

Në këtë fazë, fillimisht parashikohet zbatimi i modeleve të balancimit dhe evidencës së të gjitha minierave dhe fabrikave të pasurimit, përpunimin dhe zbatimin e modelit të personelit të nevojshëm, furnizimin dhe lëshimin në punë, të pjesës tjetër, nga pajisjet dhe impiantet e porsablara. Në vazhdim të këtij procesi aktivitetet do të orientohen drejt realizimit të mëtutjeshëm të planit të zhvillimit të minierave dhe fabrikave të pasurimit.

5.2. Ristrukturimi i minierave dhe fabrikave të pasurimit me flotim

Minierat e "Trepçës" ndodhen në gjendje të ndryshme sa i përket funksionimit, pajisjeve, fuqisë punëtore dhe aspekteve tjera për punë normale dhe të suksesshme. Disa nga minierat ka pesëmbëdhjetë vjet që nuk punojnë, ndërkaq, disa prej tyre, punojnë me kapacitete më të vogla se sa kanë punuar më herët. Siç u tha më sipër, pajisjet në miniera dhe fabrikat e pasurimit janë të vjetruara, ndërsa investimet e deritanishme janë të vogla. Në programin për ristrukturim, nuk hyjnë shkretoret për plumb dhe zink, si dhe njësitë tjera afariste, të cilat në veprimtarinë e tyre nuk përfshijnë punën në miniera dhe të xeherorëve të plumbi-zinkut.

Ndërmarrja "Trepça" disponon me një numër të madh të kapaciteteve të papërdorshme dhe pjesërisht të shfrytëzuara, të cilat nuk bëjnë pjesë në veprimtarinë e xeheroreve, të cilat mund të veçohen ose të tjetërsohen. Kjo do t'i përkiste këtyre kapaciteteve:

- (1) Fabrika për bateri industriale në Pejë, fabrika për rimorkio në Mitrovicë, fabrika për akumulatorë në Mitrovicë, firma "Trepça-Komerc" në Mitrovicë, firma "Trepça-Standard" në Mitrovicë, firma "Trepça-Trans" në Zveçan, "Qendra Llogaritëse" në Mitrovicë, "Laboratori Trepça" në Zveçan dhe "Sigurimi Material" në Zveçan.
- (2) Shërbimet tjera: Shërbimi i sigurimit dhe Shërbimi zjarrfikës.
- (3) Patundshmëri: Stadiumi i futbollit "Mitrovica" në Kishnicë, Salla e sportit "Mitrovica" në Mitrovicë, hoteli "Trepça" në Stantërg, hoteli "Horizont" në Artanë, shtëpia e kulturës në Kishnicë dhe banesat e punëtorëve.
- (4) Repartet NSH: Instituti "Trepça" në Zveçan, Instituti i Shëndetit në Zveçan, banka "Trepça" në Zveçan, "Energjetika" në Zveçan.
- (5) Repartet artizanale: kantieret e ndërtimit në minierat dhe sektorët për meremetime në miniera dhe fabrika pasurimi.
- (6) Shërbimet shoqërore: Qendra për mjekësi të punës, kantinat e punëtorëve të "Trepçës" dhe banesat e punëtorëve të "Trepçës".

Duke pasur parasysh nevojat për investime të reja, me të cilat do të vendosen në funksion të gjitha minierat dhe fabrikat e pasurimit, për shkak të shfrytëzimit më të plotë dhe më optimal të pasurive minerale, janë të rëndësishme. Në investimet e reja, duhet të inkuadrohen edhe shpenzimet për pompimin e ujit nga minierat e përmytura, sanimi i depozitave të mbetjeve i industriale, si dhe punët tjera të domosdoshme, të cilat duhet të ndërmerren për fillimin e eksploatimit të pasurive minerale dhe pasurimin e tyre deri

në koncentrat. Ristrukturimi i minierave përfshin aktivitete në lidhje me përshtatjen e ndërmarrjeve në kushte të reja. Ato kanë të bëjnë me punët rreth riorganizimit, si dhe proceset në lidhje me transferimin e pronësisë.

Ristrukturimi përfshin riorganizimin dhe transferimin e të gjitha proceseve të ndërmarrjeve. Kjo do të thotë se aktiviteti dhe struktura e ndërmarrjes përshtaten në kushtet e ndryshuara të ekonomizimit. Ristrukturimi strategjik ka të bëjë me përzgjedhjen e strategjisë për zhvillimin e ardhshëm të ndërmarrjes, si dhe strategjinë për njësitë e veçanta afariste, të cilët veprojnë dhe janë pjesë përbërëse të ndërmarrjes. Strategjia për njësitë afariste, do t'i përkiste mënjanimit të atyre njësive, të cilat nuk bëjnë pjesë në veprimtarinë kryesore. Kjo do të thotë se, krahas mënjanimit të njësive afariste, të cilat nuk bëjnë pjesë në veprimtarinë kryesore të ndërmarrjes, strategjia mund t'i përkasë likuiditetit ose shitjes së tërë ndërmarrjes ose pjesëmarrje në pronën e ndërmarrjes. Në të do të merrnin pjesë investitorët privatë, si dhe investitorë institucionalë. Në rastin e "Trepçës" duhet të zbatohen katër shkallë strategjike të ristrukturimit:

- (1) Ristrukturimi strategjik,
- (2) Ristrukturimi operativ,
- (3) Ristrukturimi financiar dhe
- (4) Ristrukturimi i menaxhmentit.

Të gjitha masat e strategjisë së theksuar, duhet të zbatohen në rastin e "Trepçës". Kjo do të thotë, që ndërmarrja sërish të vendoset në funksion, me aktivitete afatshkurtra dhe efikase, të rritet prodhimtaria dhe shitja, të zvogëlohen shpenzimet që të ulët kostoja, të përmirësohet likuiditeti dhe të punohet me fitim.

Për forcimin financiar të ndërmarrjes, nevojiten masa për tërheqje të kapitalit vendor dhe të huaj. Në fund, përmirësimi i menaxhmentit është mjaft i rëndësishëm për rritjen e efikasitetit të punës. Strategjia operative e ristrukturimit të minierave do të realizohej, duke u nisur nga mundësitë për realizimin e të ardhurave, fitimit dhe likuiditetit të kënaqshëm. Strategjia operative përfshin katër lloje të modeleve, të cilat mes vete janë të ndërlidhura dhe të ndërvarura dhe atë:

1. Sanim i prodhimtarisë dhe shitjes;
2. Sanim i shpenzimeve;
3. Zvogëlim i mjeteve (aktivave) dhe
4. Kombinim i modeleve 1 - 3.

Gjendja e minierave dhe fabrikave të pasurimit së xeherorëve të "Trepçës", detyron zbatim të modelit 4, me të cilat zbatohet kombinim i modeleve 1 dhe 3. Kjo është e kushtëzuar nga gjendja në fushën e prodhimitarisë së xeherorëve dhe të koncentratit, e cila është dukshëm më ulët nga e mundshmja optimale. Me këtë rast, konsiderohet se vetëm ulja e kostos së prodhimit, nuk mjafton për sanimin e minierave dhe fabrikave të pasurimit. Gjithashtu, kombinimi i rritjes së shitjes, uljes së kostos së prodhimit dhe zvogëlimi i aktivitetit, imponohet edhe për shkak të faktit që likuiditeti mund të stabilizohet edhe në kushtet ekzistuese të shkallës së zvogëluar të dobi-efikasitetit kufitar (cut-off). Kombinimi i metodave do të varet nga kushtet konkrete. Për shembull, nuk duhet të ndërmerren aktivitete, nëse paraprakisht dihet se ato nuk do të kontribuojnë për sanimin e ndërmarrjeve.

Sanimi i prodhimitarisë dhe i shitjes, në periudhë afatshkurtër marrja e të ardhurave imponohet si detyrë parësore, duke e pasur parasysh gjendjen aktuale të minierave. Strategjia e sanimit të shitjes dhe prodhimitaria në periudhë afatshkurtër, duhet të realizohet me investime të vogla, nga të ardhurat e vet ndërmarrjes, ku për një kohë të shkurtër mund të rritet prodhimitaria. Përveç kësaj, duhet të hetohen të gjitha mundësitë që të rritet prodhimitaria me ndryshime teknologjike në kuadër të makinerive dhe pajisjeve ekzistuese. Kjo e përfshin edhe organizimin e punës, produktivitetin e punës dhe efikasitetin e fuqisë punëtore, në rend të parë të minatorëve. Në të njëjtën kohë, duhet të ndërmerren masa për sanim afatshkurtër dhe afatgjatë të prodhimitarisë, përmes investimeve përkatëse në repartet prodhuese.

Sanimi i shpenzimeve, duhet të realizohet njëkohësisht me rritjen e prodhimitarisë dhe të shitjes, imponohet në kushte kur puna e njëjësive afariste ndodhet afër pragut të rentabilitetit dhe në kushte të shpenzimeve relativisht të larta fikse dhe variable. Zvogëlimi i shpenzimeve imponohet si i domosdoshëm në kushte të resurseve të kufizuara financiare. Kjo mund të bëhet pavarësisht nga mundësitë për zbatimin e modeleve 1 dhe 3 (rritje e prodhimitarisë, shitjes dhe zvogëlimi të aktivitetit). Kështu, opsion do të ishte zvogëlimi i shpenzimeve në lidhje me personelin e punësuar përmes zbatimit të seleksionimit përkatës.

Zvogëlimi i aktivitetit realizohet, nëse ndërmarrja nuk mund të realizojë mjaftueshëm të ardhura dhe kur ka kapacitete të pashfrytëzuara. Drejt zvogëlimi të aktivitetit qaset kur rritja e shitjes dhe ulja e kostos së prodhimit nuk mjaftojnë për sanimin e ndërmarrjes. Përparësi e zvogëlimi të aktivitetit është, sepse mund të arrijë pajtueshmëri nga kreditorët në mënyrë autonome dhe pa kërkesë, ndërsa do të kontribuojë për përfitim të mjeteve likuiduese.

Megjithatë, duhet të merret parasysh, se për tjetërsimin e pajisjeve të ndryshme dhe të metaleve të tjera, zakonisht tregu është shumë i ngushtë, me ç'rast duhet të bëhen lëshime të larta në çmime. Dihet se pajisjet e vjetra të makinerive dhe zyrave, nuk vlejnë më shumë se vlera e mbeturinave. Në rastin e minierave të "Trepçës", pjesa më e madhe e pajisjeve dhe stacioneve janë të vjetra disa dhjetëra vite, me ç'rast një pjesë e madhe, fare nuk kanë qenë në funksion në periudhën pas vitit 1999. Ristrukturimi financiar ka të bëjë me pronarët dhe dhënësit e kapitalit. Masat për ristrukturim financiar mund të kenë të bëjnë me kapitalin vetjak, të kapitalit të huaj, si dhe të dyja burimeve të kapitalit. Kështu, në anën e pasivës, që i përket kapitalit vetjak, intervenimet mund të bëjnë rritjen e kapitalit, përmes pagesave të pronarëve ekzistues, si dhe me kyçjen e investitorëve të rinj. Me këtë rast, duhet të kihet parasysh se për shkak të ardhurave të ulëta të "Trepçës" dhe prodhimtarisë së përgjithshme të zvogëluar në vitet e para të punës, nuk duhet të priten vlera të mëdha të mjeteve financiare nga akumulimi afarist. Nga burimet vendore, mund të priten kapital nga ndërmarrje apo kompani tjera dhe kuptohet nga shteti, duke pasur parasysh rëndësinë strategjike të "Trepçës" për ekonominë e Kosovës.

Në periudhën afatmesme dhe atë afatgjatë, mjete më të mëdha financiare duhet të priten nga investitorë të huaj. Këto mjete, pjesërisht do të ishin në llojin e kapitalit aksionar, pavarësisht nga ajo nëse merret në pronësi pjesa dërmuese apo e tërësishme e minierës përkatëse apo fabrikës së pasurimit. Lloji i dytë i burimeve financiare janë kreditë e huaja afatshkurtra dhe afatgjata, nga bankat dhe institucionet e ngjashme të dedikuara për investim dhe sanim të kapaciteteve. Me këto kredi, nuk do të ndryshojë struktura pronësore e "Trepçës" në tërësi ose në njësitë përkatëse afariste (miniera dhe flotacione). Shkalla e përkrahjes së këtyre burimeve financiare, do të varet nga politika e debisë, nga fluksi i parave kesh dhe nga shitja e koncentratit. Duhet marrë parasysh, se efektet e kësaj mbështetjeje financiare, janë të vogla, duke pasur parasysh bartësit e huaj të kërkesave përballë "Trepçës", i njohin mundësitë për prodhimtari dhe shitje të kësaj ndërmarrjeje.

Ristrukturimi i menaxhmentit, si në nivelin qendror, ashtu edhe në nivelet tjera, paraqet një nga parakushtet themelore për sukses, të gjithë procesit të ristrukturimit të ndërmarrjes në tërësi dhe njësitë të veçanta afariste të saj. Ndryshimi i modelit të menaxhmentit, është punë shumë e rëndësishme dhe nga kjo, do të varet shpejtësia dhe sukcesi i ristrukturimit, duke pasur parasysh masat drastike dhe jopopullore që do të duhet të ndërmerren.

Ndryshimi i mënyrës së menaxhimit ndërlihet me vendosjen e modelit sipërmarrës të menaxhimit, në vend të mënyrës qeveritare. Me këtë rast, duhet të merret parasysh, se menaxhmenti paraprak, zakonisht nuk i ka njohur

metodat bashkëkohore të menaxhimit dhe nuk ka mundur që realisht ta vlerësojë gjendjen e ndërmarrjes në mjedisin e ri tregtar. Përveç kësaj, janë të shpeshta dukuritë, që një pjesë e menaxhmentit të mos mundet t'i ndryshojë shprehitë dhe sjelljen dhe të përshtatet me kërkesat e kohës moderne. Por, pavarësisht nga disa dobësi, kjo korrespondon me përvojën e çmueshme në këtë veprimtari. Për këtë duhet të mbahet llogari, se ndërrimi i gjithë udhëheqjes së lartë, do të thotë humbje e madhe e diturisë dhe zotësisë, të cilat janë të çmueshme dhe duhet të ruhen. Që të shmanget kjo, nevojitet mbajtja e kuadrove të këtilla, për shembull, si këshilltarë ose përfshirje e këshilltarëve të jashtëm, të cilët do t'u ndihmonin menaxherëve ekzistues.

5.3. Privatizimi i minierave dhe fabrikave të pasurimit me flotim

Privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore dhe publike paraqet detyrë të madhe e të vështirë, për çka nevojitet kohë, krijim i rregullativës solide dhe të institucioneve (shërbime publike), të cilat në mënyrë konsekuente do ta sendërtojnë. Privatizim, do të thotë transformim i ndërmarrjeve shtetërore (shoqërore) dhe publike, në private.

Qëllimi kryesor i privatizimit është avancimi i konkurrencës, rritje të efikasitetit ekonomik dhe zvogëlim të implikimit të shtetit në përparimin dhe menaxhimin e ndërmarrjeve. Me privatizimin e këtyre lloj ndërmarrjeve, mundësohet veprim i mekanizmave tregtarë, në drejtim të rritjes së motivacionit të menaxherëve, si dhe të punësuarve, për efikasitet më të lartë ekonomik në punë. Po ashtu, te ndërmarrjet private, qëllim kryesor paraqet realizimi i rezultateve pozitive financiare, ndarja e dividendës, evitimi i gjendjes së jolikudimit, falimentimit dhe zhvillimi i vetë ndërmarrjes. Ndërmarrjet publike furnizojnë kapital për financim të tregjeve financiare, që do thotë se shteti është i lirë nga obligimi për ndarje të mjeteve investuese, për financimin dhe zhvillimin e tyre. Kjo, sipas rregullit, e rrit racionalizmin në alokacionin e kapitalit.

Megjithatë, privatizimi shërben edhe për realizimin e qëllimeve të tjera. Përveç përmirësimit të efikasitetit ekonomik, realizohet ndryshim i udhëheqjes, përmirësimi i kontrollit, realizimi i të ardhurave për shtetin etj. **Megjithatë, konsiderohet se privatizimi nuk është mënyra e vetme për zvogëlimin e përzierjes së shtetit në punën e ndërmarrjeve publike.** Kjo nuk paraqet mënyrën e vetme të mundshme për ristrukturimin e ndërmarrjeve publike dhe rritjen e efikasitetit të tyre. Këtu duhet të theksohet, se krijimi i kushteve të konkurrencës, është parakusht mjaft i rëndësishëm për rritjen e efikasitetit në punën. Është dëshmuar, se në kushte të konkurrencës, rritet efikasiteti si në ndërmarrjet private, ashtu edhe në ato shtetërore.

Ndryshimi i formës së pronësisë, nga shtetëror dhe publik, në privat, nuk do të thotë se do të rritet efikasiteti dhe produktiviteti.

Ekzistojnë shembuj të shumtë të ndërmarrjeve shtetërore shumë efikase, si dhe të ndërmarrjeve private joefikase. Efikasiteti në masë të madhe varet edhe nga konkurrenca, rregullimi, tradita dhe menaxhmenti. Duhet pas parasysh, se përmes ndërmarrjeve publike (shtetërore), janë realizuar shumë qëllime shoqërore: të ardhura për buxhetin shtetëror, krijim i vendeve të punës, zhvillim i rajoneve jo të zhvilluara, realizim i të ardhurave valutore etj. Kështu, në ato vende jo mjaft të zhvilluara, ku infrastruktura tregtare nuk është shumë e zhvilluar, ndërmarrjet publike luajnë rol të rëndësishëm në realizimin e këtyre qëllimeve. Në këto raste, efikasiteti ekonomik i punës, si qëllim, mund të vijë në konflikt me të ashtuquajturat qëllime shoqërore.

Një nga shkaqet për privatizim, paraqet realizimi i mjeteve financiare për shtetin, të cilat do të fitoheshin me shitje. Mjetet të cilat duhet të fitohen nga privatizimi, paraqesin përmbledhje të profiteve, të cilat ndërmarrja do t'i realizojë në të ardhmen.

Në lidhje me të ardhurat e shtetit nga privatizimi, theksohet se me shitjen e ndërmarrjeve profitabile, shteti për një kohë të gjatë privohet nga grumbullimi i mjeteve.

Në këtë rast, shteti i jep përparësi efekteve afatshkurta financiare, ndërsa i neglizhon ato afatgjate. Përveç kësaj, kritikët konsiderojnë se kjo do ta privojë shtetin nga mundësia që të zhvilloj strategji afatgjate dhe koherente të zhvillimit ekonomik në vendit, me çka rrezikohen interesat nacionale.

Për këtë çështje, e rëndësishme në procesin e privatizimit është çmimi, sipas të cilit do të kryhet shitja dhe transferimi te pronarët privat. Përvoja ka treguar, se sipas rregullit, transferimi i pronësisë kryhet me çmime relativisht më të ulëta nga ato reale. Përveç kësaj, çështje e rëndësishme është që shiten, respektivisht blihen, ndërmarrje, të cilat janë profitabile, derisa investitorët nuk tregojnë interes për ndërmarrjet e pasuksesshme, ku nevojiten investime të shpejta për modernizim, intervenime më të mëdha për ristrukturim, zvogëlim i fuqisë punëtore etj.

Krahas kësaj që u theksua më lartë, në literaturë theksohen edhe shpenzimet që shteti i bën për përmirësimin e imazhit të ndërmarrjeve publike, përmes investimeve për përmirësimin e performansave të tyre (në numër më të vogël të rasteve) ose zvogëlim i debisë së tyre (në pjesën më të madhe) të rasteve. E gjithë kjo bëhet, me qëllimin që korrelacioni i mjeteve dhe obligimeve të ndërmarrjes të mos paraqesin pengesë dhe të mos i kthejë mbrapsht investitorët e mundshëm.

Organizatave ndërkombëtare zhvillimore dhe financiare, si dhe organizatat e shteteve të veçanta, krahas aktiviteteve tjera, në programet e tyre kanë të

përfshirë mbështetje në proceset e privatizimit të vendeve jo mjaft të zhvilluara dhe vendeve në tranzicion. Kështu për shembull, Banka Botërore dhe agjencitë e saj, parashikojnë kredi për aftësim strukturor të ndërmarrjeve publike para se të kryhet privatizimi, me qëllim që të rritet efikasiteti i këtyre ndërmarrjeve dhe pavarësia e tyre financiare, që do të kontribuonte për rritjen e interesit së investitorëve privatë. Banka ka programe për zbutjen e efekteve sociale nga privatizimi, ndërsa në rend të parë të papunësisë, përmes programeve për rikualifikim të të punësuarve nga ndërmarrjet publike, që janë privatizuar, mjete për kompensim të punonjësve të pushuar etj. Krahas kësaj, Banka Botërore ka programe me të cilat ndihmohet vendosja e institucioneve për privatizim, njësitë për vlerësim të pronës së ndërmarrjeve të cilat privatizohen, për progresin e efikasitetit të shërbimeve shtetërore, etj.

Ta zëmë, Korporata Ndërkombëtare Financiare (International Financial Corporation-IFC) e cila është njësi e Bankës Botërore, investon drejtpërdrejt mjete në ndërmarrjet që janë në proces të privatizimit të tyre. Me programin e saj, ndihmohet përgatitja e aspektit ekonomik për privatizim, si për shembull, zhvillimi i tregjeve të kapitalit, tërheqja e investitorëve privat, transferimi i teknologjisë, përmirësimi i rregullativës etj. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), aktivitetet e ka orientuar drejt mbështetjes së programeve, të cilat realizohen në kuadër të Bankës botërore dhe Korporatës Ndërkombëtare Financiare.

Privatizimi si proces, përkrahet edhe nga programe të qeverive dhe organizatave ndërkombëtare. Kjo ka të bëjë me programe të Bashkimit Evropian, të SHBA-së dhe ekonomive tjera të zhvilluara, me të cilat mbështeten proceset e privatizimit direkt ose indirekt.

Kosova, ngjashëm me shumë vende të rajonit, bën pjesë në vendet jo mjaft të zhvilluara. Procesi i privatizimit është proces i ndërlikuar, ku janë të prekura interesat e shumë grupeve të popullsisë, që do të thotë se janë të mundura kundërshtimet gjatë procesit të privatizimit. Përvoja e disa vendeve, tregoi se privatizimi nuk ka qenë i suksesshëm, pikërisht për shkak të mosekzistimit të kushteve të domosdoshme dhe stabilitetit makroekonomik. Në privatizimin e suksesshëm ndikojnë: përgatitja e mirë e kryer në fushën e procedurës (rregullimit), administrata e trajnuar dhe e plotësuar, e cila do ta aplikojë në jetë procesin e privatizimit, si dhe përgatitjet e mira të ndërmarrjes, të cilat do të jenë lëndë të privatizimit. Theksohen edhe problemet financiare të këtyre vendeve, në lloj të mungesës të mjeteve financiare në vend, mosekzistimi ose moszhvillimi i tregut të kapitalit dhe të institucioneve financiare.

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), ka mandat dhe autorizim që të menaxhojë, t'i shesë ndërmarrjet shoqërore-shtetërore ose pronën e tyre, të investitorët privat, si dhe t'i transferojë ose likuidojë ato ndërmarrje. Agjencia në kuadër të resurseve të saj të kufizuara, mund t'i kryejë aktivitetet ndihmëse, me qëllim që të ruhet ose rritet vlera e pronës së ndërmarrjeve, në pronësi

shoqërore ose shtetërore. Përveç kësaj, AKP ka autorizim që t'i shlyej kërkesat të cilat dalin nga menaxhimi, shitja, transferimi ose likuidimi i sipërmarrjes përkatëse ose pronës. (Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr. 03/ L – 067, Neni 2)

Kosova është e pasur me resurse minerale, kështu që, sektori mineral paraqet një nga industritë e rëndësishme. Përvojat nga shumë vende (Gjermani, Norvegjia, Suedia, Kina, Rusia, Franca, Finlanda etj), tregojnë se lëndët minerale dhe energjia, janë veprimtari kyçe për zhvillimin e ekonomisë nacionale, kur janë në duart e shtetit. Xehetaria paraqitet si furnizuese e industrive tjera, me lëndë të para dhe repromateriale, sidomos të industrisë së shkritoreve dhe industrive për prodhimin e lëndëve për konsum të gjerë. Sipas rregullit, mineralet dhe industritë që mbështeten në të, kanë ndikim të madh mbi mjedisin jetësor.

Industria minerare dhe industria përpunuese e saj, kanë rëndësi vitale për ekonominë në Kosovë. Krahas numrit të madh të punësuarve, kombinati "Trepça" ka qenë bazë në të cilën është mbështetur zhvillimi i shumë veprimtarive ekonomike, kështu që, efektet e tyre kanë qenë të mëdha. Lidhur me ristrukturimin e "Trepçës", imponohen tre variante: 1. Privatizim pa ristrukturim; 2. Transformim në ndërmarrje shtetërore dhe ristrukturim; 3. Privatizim dhe ristrukturim dhe 4. Dhënie e licencave (koncesion).

(1) Privatizimi pa ristrukturim – Veprimtaria kryesore e industrisë minerare si tërësi ose pjesë të saj u shitet investitorëve. Me këtë rast, investitorëve privat, paraprakisht u shiten njësitë afariste dhe repartet, të cilat nuk hyjnë në veprimtarinë minerare. Përparësitë e modelit të këtillë të privatizimit janë, se nuk nevojiten mjete financiare nga shteti dhe nga kompensimi i fituar nga kjo shitje, mund të paguhen një pjesë e borxheve të vjetra dhe rreziqeve eventuale.

Mangësitë e këtij modeli janë: asnjë veprimtari e rëndësishme ekonomike në Kosovë, me rëndësi strategjike për gjithë ekonominë nuk zhvillohet, por tjetërsohet. Nuk realizohet ristrukturim dhe sanim, të cilat do të mundësonin rritje e të ardhurave për shtetin. Pas shitjes, shteti nuk ka ndikim mbi ndërmarrjen dhe zhvillimin e tyre, ndërsa imponohet nevoja e kontroleve shtesë në lidhje me mbrojtjen e mjedisit jetësor. Kjo do të thotë, se me problemet rreth mbrojtjes së mjedisit jetësor, problemet sociale dhe të tjera, do të përballlet shteti dhe do të jenë probleme të tij.

(2) Transformim në ndërmarrje shtetërore dhe ristrukturim – Veprimtaria minerare, në tërësi transformohet në shoqatë aksionare në 100% pronësi shtetërore. Si dhe gjatë variantit të parë, paraprakisht, investitorëve privat u shiten njësitë afariste dhe repartet, të cilat nuk hyjnë në këtë veprimtari.

Përparësitë e modelit të këtillë, janë në atë që, veprimtaria minerare mbetet si njësi e vetme afariste. Me mënjanimin e njërive dhe reparteve, të cilat nuk bëjnë pjesën në veprimtarinë minerare, përforcohet rentabiliteti i ndërmarrjes, kështu që mbetet si bosht rreth së cilës do të zhvillohen aktivitete tjera ndërmjetësuese ekonomike. Shteti nuk fiton vetëm të ardhurat nga shitja, por edhe nga tatimet dhe një pjesë e profitit që do të realizohej. Mungesat e këtij modeli, qëndrojnë në nevojën e mjeteve të veta për sanim dhe investime të rëndësishme për modernizim, të cilat shteti, nuk do të mundet në një periudhë afatshkurtër t'i sigurojë. Më tej, të gjitha problemet në lidhje me mbrojtjen e mjedisit jetësor, problemet sociale dhe të tjerat mbeten barrë e shtetit.

3. Privatizim dhe ristrukturim – Veprimtaria minerare e “Trepçës”, në tërësi transformohet në shoqëri aksionare. Shteti si pronar 100% merr pjesë si investitor privat. Paraprakisht u shiten investitorëve privat njësitë afariste dhe repartet, të cilat nuk hyjnë në veprimtarinë thelbësore minerare. Nga mjetet e fituara financohen projektet në lidhje me mbrojtjen e mjedisit jetësor, obligimet sociale dhe rreziqet. Sanimi do të realizohej me mjete vetjake.

Përparësitë e modelit të këtillë janë, se veprimtaria minerare mbetet si njësi e vetme dhe e veçantë afariste. Me ndarjen e veprimtarive, të cilat nuk bëjnë pjesë në veprimtarinë minerare, përmirësohet rentabiliteti i “Trepçës”, i cili mbetet boshti rreth së cilës do të zhvillohen aktivitete tjera ndërmjetësuese ekonomike. Shteti fiton mjete nga aktivitetet shitëse të ndërmarrjeve, nga tatimet, si dhe nga profiti i realizuar. Pas ristrukturimit, ndërmarrja “Trepça” do të ketë nevojë për kapital vetjak për sanim, si dhe investime në modernizimin dhe zhvillimin teknologjik, të cilat do t'i sigurojnë investitorët privat, e për të cilat do të bëhen pronarë të një pjese të aksioneve, kuptohet, sipas vlerës së mjeteve të investuara. Mangësitë e këtij modeli janë: se shtetit i mbetet obligim mbrojtja e mjedisit jetësor, problemet sociale etj.

Sipas opinionit tonë, ky model, në masë të madhe i përmbush nevojat e shtetit dhe të “Trepçës”, dhe do të duhej të zbatohej në procesin e transformimit tekniko-teknologjik. Ky model, ofron kombinim të mirë të elementeve të motivacionit, pjesëmarrjen e sektorit privat, ndërsa në masë të madhe përmbushë kërkesat dhe nevojat e shtetit në raport me realizimet e të ardhurave, kontrollit dhe përmbushjes së standardeve të nevojshme në punë.

4. Dhënie e licencës (koncesion) – Veprimtaria minerare u shitet si tërësi ose në pjesë, investitorëve privat. Paraprakisht shiten njësitë afariste dhe reparte, të cilat nuk bëjnë pjesë në veprimtarinë thelbësore minerare.

Përparësitë e këtij modeli janë, se për investime nevojiten mjete nga shteti. Nga të ardhurat e realizuara nga licenca e dhënë (koncesioni), financohen pjesë në lidhje me borxhet e vjetra, projektet për mbrojtjen e mjedisit jetësor, si dhe obligimet sociale dhe rreziqet.

Mangësitë e këtij modeli janë se: nuk zhvillohet industria përpunuese, që është shumë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit. Po ashtu, nuk realizohet ristrukturimi i rregullt dhe sanimi në interes të rritjes së të ardhurave të shtetit.

Ristrukturimi i minierave të plumbit dhe zinkut në Kosovë

Pas shitjes, shteti nuk ka kontroll mbi ndërmarrjet private të cilat janë pronare të një veprimtarie mjaft të rëndësishme të ekonomisë së përgjithshme. Imponohet edhe nevoja e kontrollit shtesë në lidhje me mbrojtjen e mjedisit jetësor. Të gjitha problemet në lidhje me mbrojtjen e mjedisit jetësor, problemet sociale dhe të tjerat, të cilat nuk mund të financohen nga të ardhurat e realizuara nga koncesioni, mbeten barrë e shtetit.

Ekzistojnë më shumë metoda dhe teknika të privatizimit, të cilat zbatohen varësisht nga kushte konkrete dhe nga qëllimet, të cilat duhet të realizohen. Cilat metoda dhe teknika të privatizimit të cilat zbatohen, nuk është çështje e karakterit teknik. Ndërsa, duke pasur parasysh faktin që privatizimi i ndërmarrjeve publike (shtetërore) paraqet çështje komplekse, me ç'rast duhet të merren parasysh si nga aspekti politik, ashtu edhe nga ai juridik dhe social. Përvoja e deritanishme nga privatizimet e kryera, tregon shembuj të shumtë të privatizimit jo të suksesshëm për shkak të metodave dhe teknikave të aplikuara në mënyrë jo të përshtatshme të aparatit administrativ, zhvillimit të tregjeve financiare, zhvillimit dhe gjendjes së ekonomisë, konceptit të politikës zhvillimore makroekonomike dhe të tjera.

Nga shumë metodat dhe teknikat e privatizimit, në rastin e "Trepçës", mund të aplikohen ato të cilat korrespondojnë me veprimtarinë të cilat mund të zbatohen me sukses. Për shembull, shitja e plotë përmes emisionit të aksioneve të tregut të kapitalit, do të varet nga zhvillimi i tregjeve financiare. Ky është shkaku, që kjo metodë përdoret më shumë në ekonomitë e zhvilluara tregtare. Me metodën e shitjes së pjesërishtme të ndërmarrjes, me dhënien e aksioneve, shitet një pjesë e vlerës së përgjithshme të ndërmarrjes. Në këtë rast, konsiderohet se gjatë shitjes së ndërmarrjeve të mëdha, përnjëherë është i pranishëm rreziku i mënjanimit nga çmimi real, i cili mund të arrihet në treg, si dhe nga mosekzistimi i vëllimit të këmbës të kërkesës së tregut të kapitalit.

Implementimi i kësaj metode, mundëson grumbullim të mjeteve financiare, inkuadrim në kapitalin privat, ndërsa edhe mbajtje të interesave të qeverisë në

ndërmarrje. Metoda e shitjes së pjesëve të veçanta të ndërmarrjes së sektorit privat, mund të zbatohet për njësi afariste, të cilat ekonomizojnë si ndihmëse në kuadër të ndërmarrjeve më të mëdha, ndërsa kanë rëndësi periferike për sektorin shtetëror.

Zbatimi i metodës së shitjes të ndërmarrjes, menaxherëve dhe të punëtorëve, do të varet nga madhësia e ndërmarrjes, nga interesimi i punëtorëve dhe i të punësuarve. Metoda e mënjanimet të ndërmarrjes ndaj të punësuarve pa kompensim, zbatohet në kushte kur ndërmarrja punon me humbje, ndërsa shteti lirohet nga detyrimi që financiarisht ta mbështesë dhe t'i mbulojë humbjet e saj.

Në fund, në "Trepçë" mund të zbatohet edhe metoda e tërheqjes nga veprimtaria dhe likuidimi i ndërmarrjes. Zbatimi i kësaj metode do të varet nga vlerësimi për ekzistencën e mëtutjeshme të njësive afariste dhe nga mundësitë që të ekonomizojë në mënyrë profitabile. Kjo mund të vlejë për disa nga minierat, të cilat janë të shfrytëzuara dhe eksploatimi i tyre i mëtutjeshëm nuk është ekonomik, në disa nga depozitat e mbetjeve industriale, ndërsa edhe në disa njësi ndihmëse afariste, të cilat janë në përbërje të minierave dhe fabrikave të pasurimit.

Në privatizimin e minierave dhe të fabrikave të pasurimit të "Trepçës", duhet të mbahet llogari për ekzistimin e tri njësive, të cilat ndodhen në lokacione të ndryshme dhe të cilat mund të ekonomizojnë në mënyrë të pavarur. Kështu, mund të ekzistojnë si njësi të pavarura afariste, ndërmarrje të pavarura "Minierat Veriore" dhe fabrikat e pasurimit në Leposaviq, miniera e Stantërgut "Trepça", me fabrikën e pasurimit në Tunelin e Parë dhe "Minierat Jugore" me fabrikën e pasurimit në Kishnicë. Këto tri njësi të pavarura afariste edhe pse kryejnë veprimtari të njëjta minerare, kanë disa specifika dhe mundet që transformimi i tyre i pronësisë, të realizohet në mënyrë vetjake, si dhe të zbatohen modele të ndryshme të privatizimit. Çështja, nëse do të shkohet në transformim të pronësisë të minierave në tërësi dhe të tre njësive të pavarura është e ndërlikuar dhe nevojitet analizë më e thellë para se të merret vendimi.

5.4. Partneriteti publiko-privat

Një formë e funksionimit të përbashkët korporativ, e cila ka përfaqësim të gjërë, paraqet partneritet publik privat (PPP). Ky lloj modeli, paraqet bashkëpunim mes sektorit publik dhe privat në planifikim, prodhimtari, financim, punë dhe pagesën e punëve publike. Me këtë rast, sektori publik paraqitet si prodhues dhe ofrues i bashkëpunimit, i cili i definon llojin dhe vëllimin e punëve ose shërbimeve, të cilat dëshiron t'ia bartë sektorit privat. Sektori privat, paraqitet si partner-ofrues i bashkëpunimit të këtillë, ndërsa me qëllim që të realizojë

interesa të veta afariste, me obligim që me kohë dhe në mënyrë cilësore t'i realizojë punët e fituara dhe të kontraktuara.

Kushtet ekonomike i kanë detyruar shtetet që të zbatojnë metoda të kombinuara në menaxhim, ndërsa përmes inkuadrimin dhe shfrytëzimit të resurseve private. Zbatimi i suksesshëm i PPP varet nga aftësia e pjesëmarrësve që ta kuptojnë dhe ta zbatojnë në mënyrë të rregullt thelbin e këtij partneriteti. Kjo sipas rregullit, shndërrohet në rregullore, me të cilën janë definuar obligimet dhe rregullat e pjesëmarrësve (partnerëve).

Në thelb, PPP paraqet raport të kontraktuar, në të cilin subjekti publik dhe ndërmarrja private i kombinojnë dhe i ndajnë resurset e tyre, rreziqet dhe beneficionet. Kjo bëhet, me qëllim që të arrihet efikasiteti i lartë, qasje më e lehtë dhe shfrytëzim më i mirë i kapitalit, fuqisë punëtore dhe resurseve. Ndërkaq, ka qëllimin e vetëm të kontribuohet në zhvillimin e ekonomisë dhe të standardit jetësor të popullsisë.

Zbatimi i gjerë i PPP, bazohet në nevojën e rritur për realizimin e rezultateve më të mëdha në përmbushjen e nevojave publike dhe obligimeve të cilat shteti ka përballë qytetarëve. Në literaturë theksohen shumë nga përparësitë e partneritetit të sektorit publik dhe privat. Kështu, përparësitë mund të definohen si:

1. PPP mund të kontribuojë për zhvillim dhe ndërtim të infrastrukturës;
2. Për implementim më të shpejtë të projekteve kapitale, në kushte kur shteti këtë nuk mund ta bëjë për kohë të shkurtër;
3. Për zvogëlimin e shpenzimeve, duke pasur parasysh se në projekte të caktuara, sektori privat më shumë është i motivuar që t'i zvogëlojë shpenzimet e përgjithshme të projektit përkatës;
4. Për shpërndarje më të mirë të rrezikut, kështu që çdo anë e kontratës së PPP-së më mirë mund të disponojë me rrezikun e vet, me çka do të arrihet transferim optimal, e jo maksimal të rrezikut për realizimin e vlerës më të mirë;
5. Për motivim më të madh për punë të sektorit privat për përmirësimin e menaxhimit dhe kryerjen e projektit të dhënë;
6. Përvojat ndërkombëtare, tregojnë se realizohet cilësi më e mirë e shërbimeve, që është rezultat i shfrytëzimit të përparësive gjatë dhënies së shërbimeve, si dhe motivimi më i madh për punë dhe dënime, që është pjesë e zakonshme e ndonjë marrëveshjeje;
7. Sektori privat është i aftë që të gjenerojë të ardhura shtesë nga palë të treta, ndërsa me këtë t'i zvogëlojë shpenzimet për subvencione nga sektori publik, përmes shfrytëzimit më të madh të kapaciteteve rezervë, ekzistuese ose me mënjanimin e tepricës së mjeteve;

8. Përmirësimi i menaxhimit publik përmes transferimit të përgjegjësisë për kryerjen e funksioneve publike, me ç'rast nëpunësit publik kanë rolin e rregullatorit dhe mund të fokusohen në planifikimin e shërbimit dhe të mbikëqyrjes.

Në fushën e interesit ndërkombëtar për PPP, theksohen tre përfitime themelore:

1. Investimi në infrastrukturë dhe atë në të gjitha fushat (sektorin për transport, sektorin komunal, infrastrukturën sociale e të tjera);
2. Efikasitet më i madh në shfrytëzimin e mjeteve. Përvoja nga privatizimi tregoi se një numër i madh i aktiviteteve, madje edhe ato, të cilat tradicionalisht i kryen sektori publik, mund të kryhen me kosto më të ulët dhe me efikasitetin e nevojshëm nga ana e sektorit privat;
3. Krijimi i vlerës komerciale së mjeteve të sektorit publik, me angazhimin e fuqisë profesionale punëtore nga sektori privat. Kjo ka të bëjë me sistemet e teknologjisë së veçantë avancuese, ku me angazhimin e sektorit privat bëhen kursime dhe rritet efikasiteti i shfrytëzimit të këtyre sistemeve. Duke u nisur nga natyra e marrëdhënieve financiare dhe organizuese, theksohet tipologjia e ardhshme e PPP.

Tabela: 5.4-1 Tipologjia e PPP në bazë të marrëdhënieve financiare dhe organizuese.

Financim/Organizim	Raport i fuqishëm organizues	Raport i dobët organizues
Marrëdhënie të fuqishme financiare	Kompanive për investime të përbashkëta	BOOT, BOT,
	Shoqëria aksionare	Shitje dhe ankand
	Projekte të përbashkët	
Marrëdhënie të dobëta	Komuna	Rrjet i pjesëmarrësve

Në Bashkimin Evropian (BE), shfrytëzohen disa modele të partneritetit mes sektorit publik dhe privat: Marrëveshje për shërbime me qëllim që të shfrytëzohen shkathhtësitë dhe inovacionet e sektorit privat, si dhe të arrihen kursime të shpenzimeve, për kryerje të disa shërbimeve publike.

- Marrëveshje të menaxherëve, me të cilat përgjegjësia për punë, transferohet në sektorin privat. Me këto marrëveshje, dëshirohet të rritet efikasiteti përmes shfrytëzimit më të madh të mjështërive të sektorit privat, në menaxhimin me objektin dhe dhënien e shërbimeve. Obligimi për investime i mbetet sektorit publik, edhe pse është i mundur varianti i marrëveshjes, me të cilin parashikohet edhe pjesëmarrja në investim dhe në sektorin privat.
- Te marrëveshja për lizing, sektori privat të ardhurat i realizon nga objekti në pronësi publike, ndërsa në zëvendësim për pagesë fikse të kësteve për lizing, përballë sektorit publik dhe obligimit që të menaxhohet me objektin, i cili është lëndë e marrëveshjes për lizing. Te kjo marrëveshje, për dallim nga marrëveshja menaxheriale, rreziku bartet në sektorin privat, me ç'rast aftësia e shfrytëzuesit të lizingut, që të realizojë përfitim, ndërlidhet me aftësinë që t'i zvogëlojë shpenzimet operative për vëllim të njëjtë të shërbimeve.
- Investimet e përbashkëta të sektorit publik dhe privat, karakterizohen me themelimin e institucioneve të përbashkëta, për shkak të realizimit të ndonjë projekti publik ose për dhënien e shërbimit publik.
- Formë e kontraktuar e PPP, me ç'rast si modele njihen modeli koncesionues dhe modeli i nismës private financiare.

Përvojat e deritanishme nga PPP kanë treguar se është pak e sigurt që sektori privat mundet më lehtë të ndërtojë ndonjë objekt nga sektori publik, ndërsa duke pasur parasysh se sektorit privat huazon mjete me kushte më të shtrenjta (normë interesi më të lartë dhe kushte tjera më të vështira), që është rezultat i rrezikut më të madh, me të cilën do të përballlet dhënësi i mjeteve financiare. Përveç kësaj, firmat private, për dallim nga sektori publik, presin përfitime dukshëm më të mëdha nga mjetet e investuara. Në fund, duhet të kihet parasysh se përgatitja e PPP zgjat relativisht gjatë, për shkak se krijojnë shpenzime së larta.

Një mënyrë për vlerësim dhe analizë të ekonomizimit të PPP paraqet llogaritja e quajtur "krahasim me sektorin publik" (Public Sector Comparator – PSC), me të cilën krahasohen shpenzimet e PPP, me ato të cilat, kur projekti i njëjtë do të zbatohet përmes furnizimit publik. Megjithatë, në shumë shembuj të PPP-së, në Evropën Qendrore dhe Lindore nuk janë bërë aspak vlerësime të këtilla të ekonomizimit.

Një lloj i PPP-së paraqet implikimi i shtetit në promovimin dhe mbrojtjen e ndërmarrjeve, të cilat kanë rëndësi strategjike për shtetin, sidomos kur sektori privat nuk ka resurse përkatëse të kapitalit, siç është rasti me shumë vende

në zhvillim ose ndërmarrjet, të cilat kanë falimentuar, siç tregojnë shembujt në disa vende industriale. Kështu, në vendet në zhvillim edhe pse sektori privat konsiderohet se është nxitësi i zhvillimit, ai nuk mund të angazhohet në procesin e zhvillimit dhe të krijimit të rrethit të ndryshueshëm pa mbështetje të madhe publike. Në vendet e zhvilluara, bashkëpunimi mes sektorit publik dhe privat, realizohet përmes formimit të korporatave holding, nga ana e shtetit dhe investimeve publike në kompani, nga fusha e financave, transportit, telekomunikimeve, energjisë elektrike dhe prodhimtarisë.

Në këtë rast, shteti vepron me sipërmarrjet. Me krijimin e shoqërisë së re, në lloj të koncernit, shteti ka kontroll mbi punën e shoqërisë përmes këshillit mbikëqyrës, me ç'rast nivelin më të ulët e përbëjnë shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat përbahen në shoqëritë në rrethin e ardhshëm, respektivisht shoqëritë aksionare. Në këtë mënyrë, krijohen kushte për garë të shëndoshë të më shumë ndërmarrjeve, me çka krijohen vende të reja pune, ndërsa shteti mund të tërhiqet, tërësisht ose pjesërisht, kur do të vlerësojë se njësitë në koncern, në mënyrë individuale janë të aftë të dalin dhe vetë të garojnë.

PPP paraqet mjet të dobishëm e cila jep rezultate të mira dhe në mënyrë më intensive zbatohet në kushte të ndryshimeve sistematike në shtet, ndërsa edhe në kushte të krizave ekonomike, kur sektori privat nuk është mjaft i fuqishëm ose nuk ka interes të marrë pjesë në mënyrë të pavarur në disa veprimtari, të cilat janë të rëndësishme nga aspekti i ekonomisë së vendit në tërësi. Gjithashtu, në kushte të krizës ekonomike, kur shteti dëshiron t'i zvogëlojë shpenzimet vetjake, një nga mënyrat për realizimin e këtij qëllimi paraqet kyçja e sektorit privat përmes PPP-së.

Përparësitë e PPP-së, kanë të bëjnë me përshpejtimin e implementimit, me çka sektori privat do të motivohet për pjesëmarrje në projekte të rëndësishme për shtetin në tërësi, me çka do të zvogëloheshin afatet kohore për shfrytëzim më të plotë të resurseve në dispozicion. Po ashtu, një përparësi tjetër paraqet zvogëlimi i shpenzimeve të përgjithshme, duke pasur parasysh faktin, që sektor privat është më shumë i motivuar për zvogëlimin e shpenzimeve për investime dhe eksploatim. PPP mundëson shpërndarje më të mirë të rreziqeve mes sektorit publik dhe privat, kështu që, të arrihet transferim optimal, e jo maksimal i rreziqeve në funksion të arritjes së rezultateve më të mira financiare.

PPP mundëson motivacion më të madh duke pasur parasysh se shpërndarja e rrezikut të projektit i nxit dy palët në përmirësimin e menaxhimit. Kyçja e sektorit privat, në aktivitetet që i udhëheq shteti, kontribuon për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, gjenerimin e të ardhurave shtesë për sektorin publik, si dhe përmirësimin e menaxhimit me projektin përkatës. Në mënyrë të veçantë, është e rëndësishme çështja që përmes PPP-së mundësohet shfrytëzimi më efikas i resurseve në ekonominë nacionale, në kushte kur sektori privat nuk

është mjaftë i fuqishëm financiarisht, ose nuk ka resurse tjera të domosdoshme (menaxhment dhe ngjashëm), që vetë të kryejë disa aktivitete ose të angazhohet në aktivitetet ekonomike me rëndësi të jashtëzakonshme për ekonominë nacionale, siç është rasti me aktivizimin dhe procesin e ristrukturimit të minierave të “Trepçës” në Kosovë.

Lidhur me PPP dhe koncesionet, Republika e Kosovës ka miratuar ligj të veçantë (Ligjin për partneritet publik-privat dhe koncesione në infrastrukturë dhe procedurën për shpërndarjen e tyre – Ligji nr. 03/L-090). Qëllimi i ligjit është vërtetimi i kornizës juridike për dhënie të partneritetit publik-privat dhe koncesionet për ndërtim, shfrytëzim, eksploatim të infrastrukturës publike dhe dhënien e shërbimeve.

Në Nenin 2 të këtij ligji, janë të rregulluara të drejtat për shfrytëzimin, eksploatimin dhe dhënien e shërbimeve publike në sektorët e veçantë shoqërorë dhe ekonomik. Në pikën 5 të Nenit 2, theksohet se ky ligj nuk do t’u përket minierave, xeherorëve si dhe të drejtës për prodhim të pronës nëntokësore. Në pikën 3, theksohet se ligji nuk do të implementohet për aprovimin e licencave, me përjashtim deri në shkallën kur licenca është lëshuar në suaza të koncesionit ose marrëveshjes për partneritet publik-privat.

Megjithatë, disa dispozita kanë të bëjnë edhe me aktivitetet, të cilat janë të ndërlidhura me veprimtarinë minerare, e që lë hapësirë për zbatim të këtij ligji. Kështu, Neni 2, pika, 1.12, e rregullon të drejtën për shfrytëzim dhe dhënie të shërbimeve publike në fushën e “rehabilitimit të tokës dhe pyjeve”, ndërsa në pikën 1.4, trajtohet mundësia për “prodhimtari, distribuim, trajtim, grumbullim dhe menaxhim të ujërave, ujërave të zeza, drenazh, ujitje, kanale dhe diga”, kurse në pikën 1.5 parashikohet që PPP në fushën e “grumbullimit, transferimit, përcjelljes dhe menaxhimit të mbeturinave të ngurta dhe riciklimit”.

6.0 Qëllimet e ristrukturimit

Analiza e ristrukturimit të ndërmarrjes “Trepça”, ka të bëjë me gjashtë minierat e saj: Hajvalisë, Artanës, Badovcit, Belloberdes, Cërnacit dhe Stantërgut. Minierat Hajvali, Artanë dhe Badovc, për pasurimin e xeherorëve e shfrytëzojnë fabrikën në Kishnicë, minierat Belloberdë dhe Cërnac i pasurojnë xeherorët në Laposaviq, ndërsa miniera Stantërg, e ka fabrikën e pasurimit në Tunelin e Parë.

Ristrukturimi ka për qëllim që t’i aftësojë minierat për prodhimtari rritëse dhe për shfrytëzim më të plotë të pasurive minerale. Po ashtu, në analizën e pasurive minerale, është theksuar se përmbajtja e metalit në xeheror, mundëson punë të mëtutjeshme rentabile, sidomos në periudhën para vitit 2000, kur minierat kanë qenë aktive. Pas vitit 2005, disa nga minierat janë riaktivizuar edhe pse prodhimtaria vjetore dhe numri i të punësuarve janë dukshëm më të vogla, në krahasim me periudhën e mëhershme.

Në kuadër të këtij kapitulli, fillimisht do të analizohet marketingu i minierave, të cilat do të jenë lëndë të hulumtimit, me qëllim që të shqyrtohen bazat e marketingut dhe të shitjes së plumbit dhe zinkut. Në vazhdim do të bëhet fjalë për vërtetimin e optimalet të kapaciteteve të minierave dhe fabrikave të pasurimit, shkallës së finalizimit të produktit, si dhe mjetet e nevojshme financiare, të cilat duhet të sigurohen për investim në pajisje, impiante, mjete qarkulluese dhe fuqi punëtore. Për këtë qëllim, do të shfrytëzohet program i veçantë "Eksel", që të vërtetohet profitabiliteti dhe rrjedhat e parave kesh, për secilën minierë të përmendur më lartë.

6.1. Marketingu i minierave për plumb dhe zink "Trepça"

Më parë është theksuar, se pjesa më e madhe e prodhimit të primare të plumbit dhe zinkut, vjen nga mineralet sulfure, çfarë i kemi në minierat e "Trepçës". Më lartë është theksuar, se fabrikat e pasurimit, janë të ndërtuara pranë minierave. Produkti i fituar, pra koncentratit, shitet si franko-produkt, deri te shkretoret në vendet e huaja.

Duke i pasur parasysh investimet e larta që janë të nevojshme për modernizimin e shkretores së plumbit në Zveçan, për përmbushjen e standardeve të nevojshme mjedisore dhe për arritjen e nivelit të nevojshëm kompetitiv metalurgjik të performancave edhe për një kohë, sasitë e prodhuara të koncentrateve do të ripërpunohen në shkretoret jashtë Kosovës.

Variant tjetër është që koncentratet të barten për përpunim të mëtutjeshëm në metalurgjitë e Rumanisë dhe Bullgarisë ose të transportohen përmes hekurudhave dhe kamionëve deri te portet e Selanikut e Tivarit. Transporti i koncentrateve deri te këto dy porte detare, mundëson qasje deri te gjitha shkretoret më të mëdha në Evropë dhe në Mesdhe. Duke e pasur parasysh këtë gjendje, supozohet se sasia e përgjithshme e prodhuar e koncentrateve të "Trepçës" tërësisht do të pranohet nga kapacitetet e huaja përpunuese.

Vëllimi dhe dinamika e shitjes së koncentrateve nga "Trepça", do të përcaktohen nga shpejtësia e ristrukturimit të minierave dhe aftësimin të tyre për prodhimtari të rregullt dhe rritëse. Kjo në mënyrë të veçantë është e rëndësishme për minierat që janë përmytur, ku nevojiten investime më të mëdha fillestare për aftësimin e punishteve për shfrytëzim, furnizim dhe instalimin e pajisjeve dhe impianteve të nevojshme. Në këtë tekst, supozohet se të gjitha minierat gradualisht do ta rrisin prodhimtarinë mesatare vjetore të koncentratit, me përmbajtje përkatëse të plumbit, zinkut dhe të argjendit, për çdo minierë veç e veç.

Në fakt, ekzistojnë tri mundësi të ndryshme për shitjen e koncentrateve. Koncentratit mund t'i shitet një brokeri ose një tregtari, t'i dërgohet një shkretoreje

kundrejt një pagese, me kusht që metali t'i kthehet prodhuesit të xeherorit për shitje. Shitja përmes brokerëve ose tregtarit e zvogëlon pjesëmarrjen e minierave dhe të shpenzimeve të tyre të brendshme për administrim, transportin, formalitetet importuese dhe eksportuese, si dhe negociatat me shkritoret. Shpenzimet i paguhen brokerit gjatë procesit të bisedimeve, ndërsa provizioni paguhet gjatë çdo dërgese. Opsioni i këtillë është tërheqës për kompani relativisht të vogla, të cilat nga njëra anë kanë përvojë dhe njohuri për industrinë minerare dhe prodhimtarinë e koncentratit, ndërsa nga ana tjetër, informacione të vogla në fushën e tregtisë.

Kompanitë e mëdha minerare, zakonisht i shesin koncentratet drejtpërdrejt në shkritoret, duke pasur parasysh se e kanë përvojën dhe njohurinë e nevojshme komerciale. Sasitë e mëdha të koncentrateve që i porosisin, u mundësojnë pozicion më të mirë negociues me shkritoret. Në fund, disa kompani bëjnë aranzhmane të trajtimit të taksës doganore (toll treatment), të koncentrateve të tyre, me kusht që shkritorja ta kthejë metalin, prodhuesit të kompanisë minerare, duke i llogaritur me këtë rast shpenzimet e përpunimit. Praktikën e këtillë e shfrytëzojnë kompanitë, të cilat shesin, por edhe blejnë metal, të cilave u nevojitet metali për përmbushjen e obligimeve të tyre kontraktuese.

Duke e marrë parasysh ndjeshmërinë gjeopolitike të rajonit, si variant i mundshëm, që do të kishte përparësi gjatë plasmanit të koncentrateve, mundëson që të njëjtat të shiten me ndërmjetësim të brokerëve, gjegjësisht, kompanive tregtare, të cilat janë të kyçura në tregtinë me koncentratet. Këto kompani, janë të specializuara në tregtinë me metale dhe koncentrate, ndërsa rrjeti i tyre i degëzuar i filialeve dhe lidhjeve afariste, u mundëson shitje fleksibile shumë shkrioreve në Evropë dhe Azi. Për angazhimin e këtyre kompanive, nevojitet të lidhet marrëveshje me të cilën do të përcaktohet çmimi blerës i koncentrateve, shpenzimet e transportit etj.

Ato do të ishin të obliguara për aranzhim të afateve të dërgesave, që t'i sigurojnë dokumentet e nevojshme, të caktojnë persona për matje dhe verifikim të ekzemplarëve. Provizioni i kërkuar për angazhimin e agentëve do të ishte më së tepërmi një për qind (më i ulët 0,25-0,5%), varësisht nga vëllimi i dërgesës, prodhimtarisë vjetore, kohëzgjatjes së marrëveshje etj. Në financimin e projekteve mund të përfshihen edhe kompani të veçanta, të cilat sigurojnë pako të teknologjisë dhe pajisjeve të nevojshme, me të cilat do të modernizoheshin minierat dhe fabrikat e pasurimit.

Pavarësisht mënyrës, në të cilën është kryer shitja e koncentratit, vlera që do të realizohej është e varur nga kushtet përkatëse dhe trajtimi gjatë shkrijës. Struktura e kushteve të shkrijës, në bazë ka mbetur konstante disa vite, por, vlera luhetet si rezultat i ndikimit të ofertës dhe kërkesës në lidhje me kapacitetet e shkrioreve.

Karakteristikat kryesore të kushteve të shkrites:

- Shpenzimet për përpunim janë të kushtëzuara nga kostot operative dhe profiti i shkrites;
- Vlera e përmbajtjes së metalit, për të cilën shkritesja do të paguajë e shpreh prodhimtarinë e metalit në shkrites;
- Penalet që paguhen për elemente të caktuara të papastra i përcaktojnë shpenzimet për trajtim të tyre dhe sistemim në mënyrë të pranueshme.
- Shpenzimet për rafinim të llogaritura në uncë për metal të pagueshëm, vetëm për metale të caktuara i shprehin shpenzimet për rafinimin e tyre.

Shpenzimet për shkrirje dhe përpunim, llogariten për çdo ton koncentrat, që është porositur në shkrites. Marrë në përgjithësi, këto shpenzime bazohen në peshën e koncentratit, e ajo obligon mbajtjen e lagështisë në nivel të ulët. Kur oferta e koncentratit është madhe, kostoja e përpunimit të tyre në metalurgjitë përkatëse kanë tendencë të rritjes. E kundërta ndodhë, kur ka ofertë jo të mjaftueshme, shkriteset janë të detyruara të garojnë për marrje të ofertave, si rezultat i së cilës kostot e përpunimit kanë tendencë të rënies.

Gjatë 25 viteve të fundit, shkriteset kanë qenë objekt i ndikimit të ndryshimeve të çmimit të metalit, përmes mekanizmit pjesëmarrës të çmimeve. Kështu, marrëveshja e cakton çmimin fillestar për metalin dhe përqindjen e pjesëmarrjes në çmim. Për shembull, nëse shpenzimi kryesor për trajtimin e koncentratit të plumbit arrin 150 \$/t, ndërsa çmimi bazë arrin 500 \$/t, atëherë për çmimin valid prej 600 \$/t të datës së porositjes, nëse përqindja e participimit arrin 15%, shpenzimet e përpunimit do të arrinin 165 \$/t (respektivisht, 150+15% nga 600-500).

Klauzola për pjesëmarrje pagesash të koncentratit, mundëson që shpenzimet për shkrirje të rriten ose të shënojnë rënie, ose mundëson vetëm rritje të shpenzimeve për trajtim të metalit mbi çmimin fillestar. Çmimet e përpunimit të koncentratit të plumbit, në vitet e fundit kanë lëvizur mes 125 \$ amerikan, deri në 200 \$ për ton, ndërsa çmimet për trajtim të zinkut, kanë lëvizur mes 160\$ deri në 200 \$ për ton.

Vlera e metalit të cilën shkritesja e fiton nga koncentratit, varet nga procesi që shfrytëzohet, cilësia e flotimit dhe nga efikasiteti operativ e teknik i shkrites. Shkriteset të cilat përdorin proces të njëjtë, këmbëngulin të llogarisin përqindje të njëjtë të metalit të pagueshëm edhe pse në kushte të efikasitetit më të madh, realizojnë prodhim më të madh, me çka i rrisin fitimet e tyre. Koncentratet të cilat janë më të varfra me metal, përmbajnë më shumë material mbeturinë, ndarja e së cilës do të shkaktojë humbje të një pjese të mirë së metalit.

Që të kompensohet kjo, në çdo rast të veçantë, llogaritet zvogëlim minimal i përmbajtjes së metalit në koncentrat i shprehur në pikë të përqindjes. Për shembull, impiantet e elektrolizës së zinkut, zakonisht llogarisin 85% zink të pagueshëm, gjatë zvogëlimit minimal të mundshëm prej 8 pikë në përqindje. Koncentrati që përmban 60% zink, në këtë rast do të përmbajë 51% zink të pagueshëm, ose 85% nga zinku i cili është përmbajtjesor, ndërsa koncentrati me përmbajtje prej 40% zink, do të ketë vetëm 32% zink të pagueshëm ose 80% nga përmbajtja e zinkut.

Kushtet për pagesë të metaleve, të cilat paraqiten si bashkë-produkt, dukshëm ndryshojnë. Kjo varet nga teknologjia që përdoret. Pagesa për argjend me koncentrat të plumbit, është lëndë e zvogëlimit standard, zakonisht për një uncë ose 30 deri 35 gramë për një ton. Ndërsa përqindja që paguhet, lëviz varësisht nga sasia e arit. Kjo zakonisht lëvizë rreth 90% për përmbajtje të arit mes 1 dhe 3 gramë për ton, ndërsa deri në 98%, kur përmbajtja e arit është më e madhe se 40 gramë për ton. Bakri në koncentrat të plumbit, zakonisht është lëndë e një për qind pikë zvogëlimi standard, për të cilën pagesa kryhet për 40% në diferencë.

Shkritoret e zinkut në përgjithësi, nuk paguajnë për plumbin ose metalet fisnike, edhe pse disa prej tyre paguajnë për argjendin, me ç'rast deduksioni standard arrin 100 gram/ton, ndërsa pagesa kryhet në 65% nga diferenca.

Zakonisht paguhet për kadmiumin me zbatimin e deduksionit standard prej 0,2 pikë përqindje dhe pagesa në 60% të diferencës.

Shkritoret për plumb dhe zink, llogarisin penale për praninë e metaleve të papastra në koncentrat, duke pasur parasysh se shkaktojnë shpenzime shtesë gjatë trajtimit. Zakonisht vendosen limite të epërme të papastërtive të pranueshme, mbi të cilat shkritoret nuk pranojnë të procedojnë koncentrate. Përveç kësaj, ekziston prag i përmbajtjes së metalit, në të cilën nuk paguhen penale. Shpenzimet llogariten në dollarë amerikan për një ton koncentrat, për çdo përqindje ose pjesë prej një milion tonë të metalit, nën pragun e definuar. Gjatë 45 viteve të kaluara, niveli i pragut shënon rënie, ndërsa duke pasur parasysh faktin që shkritoret janë lëndë e kufizimeve rritëse, në lidhje me emisionin e materieve të dëmshme, si dhe në lidhje me sistemimin e mbetjeve industriale. Ky trend pritet të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Shkritoret për plumb, zakonisht llogarisin penale për metale toksike të avullueshme, siç është arseniku, antimoni dhe zhiva. Ndërkaq, duke pasur parasysh se këto metale i ndotin rrjedhat e gazit, për shkak të së cilës duhet të mënjahen para se gazi të hyjë në impiantet me acide. Në të kundërtën, acidet nuk do të mund të shiteshin. Kostoja për shndërrim të këtyre metaleve në produkte për shitje, zakonisht e tejkalon vlerën e tyre.

Shkritoret llogarisin shpenzimet për trajtimin e arsenikut dhe hekurit. Hekuri hiqet nga shkriticorja për zink në formë të zharositit ose Geot'hitit (Jarosite or Goethite) të cilat janë kontaminuar me metale tretëse. Ekzistojnë kufizime rritëse për depozitim të këtyre mbetjeve, kështu që shkritoret përballen me përpunim të shtrenjtë dhe shpesh herë jopërfitues të mbeturinës, në materiale stabile. Kjo do të thotë se koncentrat i zinkut të "Trepçës" do të jetë lëndë e pagesës së penaleve, për shkak të pranisë së hekurit.

Shpenzimet për rafinim llogariten me njësi përkatëse për argjend ose ari në koncentratin e plumbit, gjegjësisht nga një sterlinë për kadmium në koncentrat të zinkut. Me rregull, në praktikë shpenzimet për rafinim të kadmiumit e tejkalojnë vlerën e kadmiumit të fituar, kështu që kadmiumi edhe pse i trajtuar si bashkë-produkt, në fakt paraqet element që penalizohet (ndëshkohet).

Çmimet e metalit, në bazë të të cilave do të bëhen llogaritë, bazohen në lëvizjen e Bursës Londineze të Metaleve (BLM), Bursës së Nju-Jorkut, të prodhimeve për çmimet e metaleve bazë dhe tregut londinez për çmimet e arit dhe të argjendit (London Metal Exchange - LME, New York Commodities Exchange - Comex, London Bullion Market - LBM). Këto tregje gjithmonë do të pranojnë metal me masë të aprovuar (approved brand), me ç'rast te ato janë regjistruar markat e të gjitha shkriticoreve.

Çmimi i çdo metali rritet ose bie në varësi nga lëvizja e ofertës dhe kërkesës. Në periudhën afatshkurtër, në çmimet mund të ndikojnë spekulantët, por, duke pasur parasysh sasinë e metalit, e cila është lëndë e tregtimit, me rregull, oferta dhe kërkesa i përcakton çmimet. Lëvizjet e çmimeve të plumbit dhe të zinkut, janë analizuar në kapitujt e mësipërm.

Transporti i koncentratit të prodhuar nga "Trepça", mund të realizohet me hekurudhë ose kamionë deri te porti i Tivarit në Mal të Zi dhe ai i Selanikut në Greqi, prej ku koncentrat i me anije do të dërgohej në shkriticoret evropiane ose mesdhetare për plumb dhe zink. Standardet për transport detar të koncentratit, detyrojnë tharjen e koncentratit, me qëllim që lagështia e saj t'i ketë standardet e kërkuara.

Llogaritë për profitabilitet të minierave, janë bërë me shfrytëzimin e programit të posaçëm eksel, në të cilat janë të përfshira të gjitha parametrat e rëndësishme, nga të cilat varet pagueshmëria apo profitabiliteti i tyre.

Llogaritë për të gjitha minierat janë dhënë në mënyrë të veçantë si më poshtë. Elementet hyrëse në bazë të së cilave bëhen llogaritë janë marrë nga dokumentacioni i "Trepçës".

Programi përmban kolonë me vlera fillestare (iniciale), në të cilën janë të futura ditët e punës, çmimet e metaleve, parametrat e veçanta prodhuese, parametrat për shpenzimet, rrogat, amortizimi, huat, normat e interesit, vitet e kthimit të huas, si sigurimi dhe tatimi i profitit. Llogaritë kryhen për një

periudhë 10 vjeçare. Programi bën llogari për vit (fillestar) zero dhe 10 vitet e njëpasnjëshme.

Në bazë të elementeve hyrëse, programi i llogarit koston për prodhimtarinë dhe të ardhurat e realizuara. Pas zbritjes të koston së prodhimtarisë dhe amortizimit, fitohen të ardhurat para normës së interesit. Pas zbritjes të normave të interesit, nga rezultati i fituar, përjashtohet tatimi dhe pagesa e borxhit, me çka fitohet neto-profiti dhe neto-flukset e mjeteve monetare. Në fund, programi e llogarit shkallën interne të prodhimtarisë (SHIP) së neto-profitit dhe të neto-flukseve të mjeteve monetare, ndërsa janë dhënë edhe disa variante të neto- vlerës aktuale (NVA) në neto-profitin të diskontuar me shkallën prej 8%, 10%, 12% dhe 16%.

6.2. Optimaliteti i kapacitetit të prodhimtarisë dhe periudha e eksploatimit të pasurive minerale

Nevojat rritëse për lëndët e para minerale, ndikojnë në rritje të prodhimtarisë dhe të produktivitetit në miniera. Kjo imponon, që minierat të disponojnë pajisje dhe makineri me performansa të larta tekniko-teknologjike, të cilat duhet të harmonizohen me karakteristikat e vendburimeve minerale, ku është e domosdoshme të realizohet siguria e lartë dhe mosndërprerja në kryerjen e detyrave të çdoditshme punuese.

Kushtet për punë në miniera janë nga më të vështirat, prandaj, krahas produktivitetit të lartë në punë, kërkohet mirëmbajtje e siguri në pajisje dhe impiante, së bashku me siguri të lartë në punë. Plotësimi i këtyre kriterëve është i lidhur ngushtë me konstruksionin dhe cilësinë e makinerisë e të impianteve.

Efikasiteti dhe efektiviteti i makinave minerare, varen nga performansat e tyre tekniko-teknologjike, sigurisë në punën e tyre, udhëheqjes, mirëmbajtjes, si dhe mbështetjes logjistike. Duke pasur parasysh mundësitë reale të avarive, pasojat nga ndërprerja e procesit të prodhimtarisë, rezultojnë me humbje në punë, për shkak të prodhimtarisë së zvogëluar ose të ndërprerë. Kësaj duhet t'i shtohen edhe shpenzimet për riparim të makinave, (shpenzimet për material, pajisje dhe fuqia punëtore e angazhuar në riparime etj.). Përveç kësaj, duhet të merren parasysh edhe humbjet eventuale nga stopimi i punës së makinave dhe stacioneve të tjera, të ndërlidhura në kuadër të procesit prodhues në minierë.

Kushtet ekstreme të vështira të punës në miniera, nga njëra anë imponojnë shkallë të lartë të sigurisë së pajisjeve dhe impianteve, ndërsa nga ana tjetër, mirëmbajtja e tyre të jetë e lehtë dhe e ndërlidhur me shpenzime relativisht të ulëta.

Pajisjet në minierat "Trepça", në masë të madhe janë vjetruar dhe harxhuar. Gjendja e këtillë është e kushtëzuar nga investimet e ulëta në modernizim, në periudhën para vitit 2000, nga pasojat që janë shkaktuar gjatë luftës, ku një pjesë e mirë e pajisjeve dhe stacioneve ishin shkatërruar nga ndërprerja e prodhimit në periudhën 2000-2005. Pas aktivizimit të disa nga minierave, nga viti 2005 e këtej, investimet në to janë relativisht të ulëta dhe kryesisht kanë pasur për qëllim vendosjen në punë të pajisjeve dhe stacioneve ekzistuese. Furnizimi me pajisje të reja, është dukuri e rrallë dhe ajo është e kushtëzuar nga vëllimi i mjeteve të disponueshme financiare dhe nga programi për ristrukturim të minierave të veçanta dhe fabrikave të pasurimit.

Shekulli shfrytëzues i makinave, është mjaft i gjatë (në disa raste edhe disa dhjetëra vite), gjatë të cilit ndodhin shumë ndryshime në ekonominë vendore dhe botërore me intensitet të ndryshëm të ndikimit, mbi kushtet e ekonomizimit. Ndryshimet e këtilla vazhdimisht pasqyrohen në punën e minierave, duke i detyruar ta ndërrojnë dhe përshtatin politikën e tyre afariste në kushtet e reja. Kjo do të thotë, se ndryshimet ndikojnë mbi vlerat e treguesve që përdoren gjatë vërtetimit të shekullit optimal të shfrytëzimit të makinave si dhe nevojën e bazës përkatëse informuese. Në këtë kuptim, në mënyrë të veçantë është e rëndësishme analiza e shpenzimeve të ciklit jetësor të makinave.

Shkaqet për zëvendësimin e makinave në miniera janë të ndryshme: vjetërsimi fizik i makinave, shpenzimi "moral", vjetërsia tekniko-teknologjike dhe vjetërsimi funksional (mospërshtatja).

- Makinaria është fizikisht e vjetruar në rastet kur nuk është e mundur përmes mirëmbajtjes dhe zëvendësimit të pjesëve vitale, ose përmes remontit, të sigurojë aftësi të saj prodhuese mbi nivelin minimal të nevojshëm.
- Ndonjë makineri konsiderohet e harxhuar "moralisht" kur do të vërtetohet se eksploatimi i saj nuk është më ekonomikisht i justifikuar. Vlerësimi për mosshfrytëzimin mund të potencohet nëse në treg paraqitet makineri e njëjtë ose më e përkryer që ka çmim më të ulët dhe mundëson efikasitet më të madh punues.
- Vjetërsia teknike-teknologjike e makinerive kemi kur performansat teknike-teknologjike dhe prodhuese-ekonomike ngecin dukshëm prapa makinerive tjera, të cilat mund të blihen në treg.
- Vjetërsia funksionale ose mospërputhja, paraqet shkak potencial për zëvendësim të makinerisë. Kjo vjetërsi mund t'i përket ndryshimeve në raport me kërkesat për mënyrën e punës në minierë, nëse makineritë janë funksionale. Mospërputhja ka të bëjë me kushtet e minierës ose me sistemin tekniko-teknologjik në kuadër të së cilit zbatohet makineria. Në këto kushte, edhe pse makineria nuk është vjetruar, ajo nuk i përgjigjet kushteve për punë në minierën e theksuar, duke pasur parasysh strukturën dhe përbërjen e pajisjes dhe të impianteve të tjera.

Koha e përshtatshme për zëvendësimin e ndonjë makinerie, varet nga "shekulli i saj optimal shfrytëzimit", i cili është i përcaktuar nga ekonomizimi i shfrytëzimit. Me këtë rast, nevojitet informacioni për shekullin optimal të ndonjë makinerie, të dihet gjatë montimit të saj, me qëllim që të vërtetohet strategjia përkatëse dhe politika për eksploatimin e saj.

Faktorët që ndikojnë mbi "shekullin shfrytëzues" të makinerive minerare, janë të shumtë dhe varen nga kushtet e mjedisit punues, kushtet klimatike, faktorët teknologjik, kushtet ekonomike, konstruksioni i makinerisë, logjistika, mirëmbajtja, udhëheqja me makinerinë dhe intensiteti i punës. Sipas natyrës dhe ndikimit fizik mbi kohëzgjatjen e makinave, faktorët e theksuar paraprakisht dallohen. Me këtë rast, duhet të merret parasysh se për shkak të cilësive të këtylla, është vështirë ose e pamundur që faktorë të caktuar në mënyrë të veçantë të klasifikohen apo drejtpërdrejt të definohet intensiteti e ligjshmëria e ndikimit dhe jetëgjatësia mbi "shekullin shfrytëzues" të makinave.

Vëllimi i prodhimtarisë së ardhshme të xeherorëve dhe të koncentratit në minierat e "Trepçës" në masë të madhe do të determinohet nga efikasiteti i pajisjes së vjetër dhe të rejtës së instaluar. Llogaritjet kanë të bëjnë për gjashtë minierat e "Trepçës": Hajvali, Artanë, Badovc, Belloberdë, Cërnac dhe Stantërg. Llogaritë janë bërë për periudhën 10 vjeçare, me ç'rast niset nga hulumtimet e bëra paraprakisht për madhësinë e vendburimeve minerale dhe përmbajtjes së tyre me metale. Rritja e prodhimtarisë parashikohet të arrijë 15% në vit, që do të thotë, indeks të rritjes prej 404,5 pikë gjatë periudhës analizuese. Dinamikë e këtyllë të rritjes së prodhimtarisë së xeherorëve parashikohet të realizojnë të gjitha këto miniera. Duhet theksuar se vlerësimet e profitabilitetit të minierave në këtë tekst, do të bazohen në vlerësime më të reja të bëra nga ekspertët vendor, për përmbajtjen e metalit në të cilat kanë marrë pjesë autorët e këtij libri.

Këto vlerësime, në masë të caktuar dallohen nga ato të hulumtuesve të huaj, por, mendojmë se më realisht e pasqyrojnë gjendjen ekzistuese në terren dhe se janë në funksion të përpunimit të variantit të "mesëm" të pagueshmërisë apo përfitimit. Në funksion të variantit të "mesëm", është edhe përdorimi i çmimeve për plumbin, zinkun, argjendin dhe arin, nga viti 2010, të cilat janë më të ulëta në krahasim me ato të vitit 2009.

Karakteristikë e mëtutjeshme e minierave të analizuara është prania e disa metaleve, të cilat si bashkë-produkte, mund të kontribuojnë për arritjen e rezultateve më të larta. Kjo, në mënyrë të veçantë arrihet, në kushtet e zvogëlimit të çmimeve të metaleve kryesore. Paraprakisht është theksuar, se "Trepça" paraqitet si prodhuese e madhe e argjendit, e cila është e pranishme në të gjitha minierat e saj, ku ka edhe prani të arit.

Në minierën e Hajvalisë, parashikohet rritje e prodhimitarisë së xeherorëve duke filluar prej 70.000 tonëve, në 283.190 tonë në fund të periudhës dhjetëvjeçare, me ç'rast prodhimtaria ditore do të rritet nga 200 tonë xeheror në 809 tonë (Shih grafikun). Përmbajtja e metalit supozohet se do të jetë konstante: Pb 9,65%, Zn 18,26%, Ag 126,4 (gr/t) dhe Au 1 (gr/t). Karakteristikë për këtë minierë është pjesëmarrja tejet e lartë e të gjitha metaleve, e sidomos e zinkut, e cila është pothuajse dy herë më e madhe nga përmbajtja e metalit të plumbit. Krahas kësaj, në xeheror vërehet pjesëmarrje e lartë e argjendit, ndërsa janë të pranishme edhe sasi të vogla të arit.

Përmbajtja e metalit të plumbit, gjithashtu është relativisht e madhe, mbi dy herë më e lartë, krahasuar me minierat tjera. Në bazë të përmbajtjes relativisht më të madhe të metaleve plumb-zink dhe pranisë së argjendit e të arit, mund të supozohen rezultate relativisht të mira financiare nga puna në këtë minierë. Me këtë rast, duke e pasur parasysh përmbajtjen e metalit të zinkut, rezultatet financiare të cilat do t'i realizojë miniera e Hajvalisë, do të varen nga lëvizjet e çmimeve të këtij metali.




Fig.6.2-1 Trendi i prodhimit në periudhën dhjetëvjeçare për minierën e Hajvalisë.

Miniera e Artanës – supozohet se në fillim të periudhës së analizuar, do të prodhojë 36.598 tonë xeheror, ndërsa në fund të periudhës dhjetëvjeçare prodhimtaria do të rritet në 148.059 tonë. Prodhimtaria ditore duhet të rritet nga 105 tonë, në 423 tonë. Karakteristikë për këtë minierë është prodhimtaria relativisht më e vogël e xeherorëve, që e bën më pak produktive në kuadër të të gjitha minierave të analizuarra të "Trepçës".

Përmbajtja e metaleve është relativisht më e varfër, nga ajo që është e pranishme në minierën e Hajvalisë dhe ajo arrin: Pb 3,70%, Zn 3,65% dhe Ag 88 (gr/t). Përmbajtja e metalit të plumbit dhe zinkut në xeheror është përafërsisht e njëjtë. Megjithatë, pavarësisht nga përmbajtja e metaleve kryesore në xeheror, përmbajtja relativisht e lartë e argjendit, paraqet përparësinë e kësaj miniere. Kjo përparësi, në mënyrë të veçantë mund të vijë në shprehje gjatë uljeve të mëdha të çmimeve të metaleve themelore, ndërsa argjendi e plotëson diferencën e përgjithshme të realizuara në këtë minierë nga metalet bazë.




Fig.6.2-2 Trendi i prodhimit në periudhën dhjetëvjeçare për minierën e Artanës.

Miniera e Badovcit - parashikohet të realizojë prodhimtari prej 60.000 tonë në vitin fillestar, ndërsa gjatë periudhës dhjetëvjeçare, prodhimtaria duhet vazhdimisht të rritet dhe të arrijë 242.733 tonë. Prodhimit ditor, në vitin fillestar është parashikuar në 171 tonë në ditë dhe duhet të rritet në 694 tonë në ditë, në fund të periudhës analizuere.

Duke e pasur parasysh përmbajtjen e metaleve, Badovci hyn në radhën e minierave relativisht të mëdha, në kuadër të kompleksit minerar të "Trepçës". Në këtë minierë, përmbajtja e metalit të plumbit është relativisht më e madhe nga përmbajtja e zinkut, që ndikon në përmbajtjen e argjendit. Kështu, përmbajtja e metaleve arrin: Pb 4,53%, Zn 3,88% dhe Ag 63 (gr/t). Ndryshimet e çmimeve të plumbit, do të kenë ndikim më të madh mbi të ardhurat që do t'i realizojë kjo minierë.




Fig.6.2-3 Trendi i prodhimit në periudhën dhjetëvjeçare për minierën e Badovcit.

Miniera e Belloberdës - bën pjesë në radhën e minierave më të vogla, me prodhimtari fillestare të parashikuar prej 48.000 tonë. Prodhimtaria ditore në fillim do të arrijë 137 tonë xeheror në ditë, e cila për dhjetë vjet duhet të rritet në 555 tonë/ditë. Përmbajtja e metaleve themelore është përafërsisht e njëjtë me minierat tjera dhe është vlerësuar: Pb 4,20%, Zn 4,10%, ndërsa Ag 75 (gr/t). Përmbajtja e këtillë e metaleve vlerësohet si relativisht e madhe. Për shkak të përmbajtjes përafërsisht të njëjtë të metaleve të plumbit dhe zinkut, ndryshimet e çmimeve të tyre do të kenë ndikim të barabartë në të ardhurat e ardhshme të realizuara nga shitja. Megjithatë, sasia e argjendit paraqet përparësi për këtë minierë, në kushtet e lëvizjeve të pavolitshme të çmimeve së metaleve bazë.




Fig. 6.6-6 Trendi i prodhimit në periudhën dhjetëvjeçare për minierën e Belloberdës.

Miniera Cërnac - është një nga prodhueset më të mëdha të xeherorëve, në kuadër të ndërmarrjes "Trepça", me prodhimtari fillestare prej 90.000 tonë xeheror në vit, e cila në fund të periudhës analizuuese, duhet të arrijë 323.645 tonë. Prodhimi ditor në fillim të periudhës analizuuese duhet të arrijë 229 tonë në ditë dhe të rritet në 925 tonë xeheror në ditë, në fund të periudhës dhjetëvjeçare. Karakteristikë për këtë minierë është përmbajtja relativisht më e madhe e metalit të plumbit, krahasuar me praninë e zinkut. Prania e argjendit është relativisht më e vogël, që e bën minierën më të varfër me këtë metal fisnik (Pb 4,50%, Zn 1,50% dhe Ag 55 (gr/t)). Sasia relativisht më e madhe e plumbit në xeheror, do të thotë se profitabiliteti i kësaj miniere, në masë të madhe do të jetë i përcaktuar nga ndryshimet e çmimeve të këtij metali në bursat botërore.




Fig.6.3-4 Trendi i prodhimit në periudhën dhjetëvjeçare për minierën e Cërnacit.

Miniera "Trepça" në Stantërg - Në bazë të prodhimtarisë së xeherorëve dhe rezervave të plumb-zinkut, miniera "Trepça" në Stantërg është më e madhja. Prodhimi fillestar parashikohet të arrijë 92.164 tonë dhe të rritet në 372.855 tonë, në fund të periudhës dhjetëvjeçare. Prodhimi ditor në fillim parashikohet të jetë 263 tonë xeheror në ditë, e cila në fund të periudhës analizuuese duhet të rritet në 1.065 tonë/ditë.




Fig.6.2-5 Trendi i prodhimit në periudhën dhjetëvjeçare për minierën e Stantërgut.

Përmbajtja e metaleve kryesore në xeheror, është përafërsisht e njëjtë (plumbi dhe zinku): Pb 3,70%, Zn 3,65%, ndërkaq Ag 76 (gr/t). Struktura e këtillë metaleve themelorë, do të thotë se mbi profitabilitetin e kësaj miniere, ndryshimet e çmimeve të plumbit dhe të zinkut do të kenë përafërsisht ndikim të njëjtë. Prania relativisht e madhe e argjendit, paraqet përparësi që mund të vijë në shprehje, në kushte të ndryshimeve të mëdha (uljes) së çmimeve të metaleve bazë.

6.3. Përcaktimi i shkallës së finalizimit të prodhimit

Më lartë është theksuar, se hulumtimet e prodhimit dhe të profitabilitetit do t'i përkasin gjashtë minierave, të cilat hollësisht janë prezantuar në këtë tekst. Në llogaritë tona për pagueshmërinë e punës së këtyre minierave, supozohet se prodhimitaria do të rritet për 15% gjatë dhjetë vjetëve, duke e pasur parasysh përmbajtjen e definuar më parë të plumbit, zinkut, argjendit dhe arit. Gjithashtu, supozohet se sasia e metaleve gjatë periudhës analizuuese do të jetë e njëjtë.

Kjo ka të bëjë, si për sasinë e xeherorëve në çdo vendburim, ashtu edhe për përmbajtjen e metaleve të caktuara. Është normale të pritët që gjatë dhjetë viteve të shfrytëzimit të minierave, të kemi përmbajtje të ndryshme të metalit.

Gjithashtu, duhet të merret parasysh se do të duhet të priten edhe përmirësime të caktuara në hulumtimin e pasurive minerale, në eksploatim, si rezultat i pajisjeve dhe makinerive moderne që janë blerë në këto vitet e fundit, vendimeve tekniko-teknologjike, avancimeve në organizim dhe menaxhment etj. Rezultatet e realizuara do të varen shumë nga përmbajtja e metaleve në xeheror, e cila me rregull, do të duhej të zvogëlohej me thellësinë e eksploatimit.

Në llogaritë për pagueshmërinë dhe profitabilitetin e minierave, supozohet se do të punohet 350 ditë në vit.

Si çmime fillestare të metaleve bazë janë marrë mesataret e tyre nga viti 2010 dhe atë: për plumbin 2.148(\$/t), zinkun 2.161.39(\$/t), argjendin 647.78(\$/kg) dhe arin 39.402.677(\$/kg). Çmimet mesatare të plumbit dhe zinkut janë më të ulëta në vitin 2010 në krahasim me ato të vitit 2009 (92,29% te plumbi, ndërsa 90,97% te zinku). Ndërkaq, çmimet e argjendit dhe të arit janë më të larta (114,01% për argjendin, kurse 413,76% për arin. Konsiderojmë se me çmimet, nga viti 2010, më realisht do të mund të vlerësohet profitabiliteti "i mesëm" i punës së minierave edhe pse realizohen parashikimet se çmimet do të shënojnë trend mesatar rritës gjatë viteve vijuese.

Në vazhdim, do të parashtrohen parametrat konstant për prodhimin e xeherorëve dhe të koncentratit, të cilat janë të njëjta për të gjashtë minierat e analizuara. Metali i pagueshëm në koncentratin e plumbit arrin 95%, ndërsa kaq arrin edhe argjendi i pagueshëm në koncentratin e këtij metali. Metali i pagueshëm në koncentratin e zinkut arrin 85%. Kjo pjesëmarrje i përcakton humbjet metalurgjike në koncentratet, të cilat në plumb dhe argjend arrijnë nga 5%, ndërsa tek zinku 15%. Shpenzimet për shitje supozohet se do të arrijnë 50% nga shuma e cila do të realizohet me shitjen e koncentratit të plumbit dhe zinkut.

Kostot e planifikuara të prodhimit janë përcaktuar për një ton xehe. Kostoja e prodhimit në minierat e SHBA-së është vlerësuar në 21\$ për një ton, ndërsa kostoja e pasurimit me flotim, është vlerësuar në 6.69\$ për ton.

Kostoja e përgjithshme e prodhimit të një ton xeherori në minierat e "Trepçës" dhe pasurimit me flotim, parashikohen të arrijnë në 14.90 \$/t. Me këtë rast, duhet të merret parasysh se volumi i përgjithshëm i shpenzimeve për çdo minierë, varet nga sasia e xeherorit të prodhuar. Gjatë periudhës analizuese dhjetëvjeçare, prodhimtaria do të rritet me shkallën e parashikuar prej 15% në vit. Shpenzimet për sigurim arrijnë 10%, aq sa është edhe tatimi në fitim, ndërsa shpenzimet për transport të koncentratit parashikohet të arrijnë 50 \$ për ton. Nga llogaritjet, supozohet se gjatë 10 viteve të analizuara, nuk do të ketë inflacion. Duhet të merret parasysh fakti se gjatë periudhës dhjetëvjeçare, do të ketë përmirësime në investime, si rezultat i makinerive dhe pajisjeve të blera, që duhet të kontribuojnë për zvogëlimin e shpenzimeve

të veçanta. Përveç kësaj, në drejtim të njëjtë, do të ndikojnë edhe përmirësimet në proceset tekniko-teknologjike, organizimin dhe menaxhmentin. Megjithatë, disa nga shpenzimet e prodhimit mund të rriten si rezultat i shumë faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, si për shembull, kur xeherori është më i varfër, çmimi i lartë i reagjensëve dhe materialeve tjera, etj.

Parametrat konstant për prodhimin e xeherorëve dhe të koncentratit

-Madhësi initiale (Viti 0)

Ditë të prodhimit dhe çmime	
Ditë / Në vjet	350
Pushime / Në vjet	15
Plumb (\$/t)	2.148,87
Zink (\$/t)	2.161,39
Argjend (\$/kg)	647,78
Ari (\$/kg)	39,402,67
Metal i pagueshëm në koncentratin e Pb (\$)	
Pb i pagueshëm në K/Pb (\$)	95,0%
Ag i pagueshëm në K/Pb (\$)	95,0%
Au i pagueshëm në K/Pb (\$)	0,0%
Metal i pagueshëm në koncentratin K/Zn (\$)	
Pb i pagueshëm në K/Zn (\$)	0,0%
Zn i pagueshëm në K/Zn (\$)	85,0%
Fe i pagueshëm në K/Zn (\$)	0,0%
Ag i pagueshëm në K/Zn (\$)	0,0%
Au i pagueshëm në K/Zn (\$)	0,0%
Humbje metalurgjike në K/Pb (%)	
Pb humbje (%)	5,00%
Ag humbje (%)	5,00%
Au humbje (%)	100,00%
Humbje metalurgjike në K/Zn (%)	
Pb humbje në K/Zn (%)	100,00%
Zn humbje në K/Zn (%)	15,00%
Fe humbje në K/Zn (%)	100,00%
Ag humbje në K/Zn (%)	100,00%
Au humbje në K/Zn (%)	100,00%

Kostoja e shitjes	0,50%
Kostot e planifikuara të prodhimit (\$/t)	
Shpuarje të thella (\$)	0,12
Përgatitje për mbushje të shpuarjeve (\$)	0,86
Shpuarje (\$)	0,48
Shpërthim (\$)	1,13
Ventilim (\$)	0,073
Transporti kryesor (\$)	1,34
Energjia elektrike (\$)	1,68
Hidrombushje (\$)	0,55
Të tjera (\$)	1,98
Kostoja e përgjithshme prodhuese në minierë (\$/ton)	8,21
Energji elektrike për flotacion (\$/ton)	1,62
Reagensë kimik (\$/ton)	0,49
Sfera çeliku (\$/ton)	0,49
Materiale (\$/ton)	2,3
Të tjera (\$/ton)	1,79
Kostoja e përgjithshme prodhuese e pasurimit (\$/ton)	6,69
Kostoja e përgjithshme prodhuese (\$/ton)	14,90
Sigurimi	10%
Tatime	10%

Minierat e analizuara kanë përmbajtje të ndryshme të metaleve, që do të pasqyrohen në vlerën e sasisë së metaleve që do të fitohen. Kështu, sipas kalkulimeve të paraqitura më lartë, miniera e Hajvalisë, që fillimisht do të nxjerr 70.000 tonë xeheror në vit, ka sasi më të madhe të metaleve në xeheror, se sa minierat tjera të "Trepçës". Ky përqendrim i metaleve, është për 2 deri në 5 herë më i lartë nga minierat tjera. Ky konstatim, sidomos ka të bëjë me zinkun dhe me argjendin. Përveç kësaj, në këtë minierë paraqitet ari. Ndërkaq, miniera më e madhe për nga sasia e metaleve në xeheror, por edhe rezervave, është miniera "Trepça" në Stantërg. Po ashtu, edhe për nga përmbajtja e argjendit, kjo është miniera më e pasur e kompleksit "Trepça". Me këtë rast, duhet të merret parasysh se sasi të lartpërmendura të metaleve i përkasin vitit fillestar, që ne e kemi emërtuar viti "0". Më tej, parashikohet rritje vjetore e prodhimtarisë prej 15%, kështu që, sasia e përgjithshme e metaleve do të rritet, ndërsa madhësia e metaleve në një ton xeherori mund të ndërrohet. Shfrytëzimi i xeherorëve të disa miniera të caktuara është i ndryshëm, te plumbi lëviz prej 85,0% në Hajvali, deri në 90,0% në Belloberdë dhe Cërnac. Shfrytëzimi i xeherorëve të zinkut, është i njëjtë në të gjitha minierat (85,0%), ndërsa te argjendi, kjo lëviz

nga 78,0% në Hajvali dhe Badovc, deri në 85,0% në Belloberdë, Cërnac dhe Stantërg. Shfrytëzimi i arit në xeheror arrin 73,5% dhe kjo është e pranishme vetëm në Hajvali dhe në Badovc. Sipas përqendrimit të metalit në xeheror, miniera e Hajvalisë është më e pasur, si për plumb, ashtu edhe për zink, argjend dhe ari. Nga minierat tjera, veçohen ajo e Stantërgut, me praninë e sasive më të mëdha të argjendit. Sasi të konsiderueshme të këtij metali fisnik, janë të pranishme edhe në minierat e Badovcit dhe Belloberdës.

Parametra për prodhimtari të xeherorëve dhe të koncentratit.

-Madhësi initiale (Viti 0)

	Hajvali	Artanë	Badovc	Belloberdë	Cernac	Stantërg
Indeks i realizimit të prodhimtarisë						
Prodhim vjetor (t)	70.00	36.60	60.00	48.00	80.00	92.16
Prodhim ditor (t/ditë)	200.00	105.00	171.00	137.00	229.00	263.00
Pb (%)	9,65%	3,70%	4,53%	4,20%	4,50%	3,70%
Zn (%)	18,26%	3,65%	3,88%	4,10%	1,50%	3,65%
Ag (gr/t)	126,4	88,0	63,0	75,0	55,0	76,0
Au (gr/t)	1000.00	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000
Sasi metali në xeheror						
Pb (t)	6.76	1.35	2.72	2.02	3.60	3.41
Zn (t)	12.78	1.34	2.33	1.97	1.20	3.36
Ag (Kg)	8.85	3.22	3.78	3.60	2.10	7.00
Au (Kg)	70.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Shfrytëzim i xeherorëve						
Pb (%)	85,0%	88,0%	85,0%	90,0%	90,0%	88,0%
Zn (%)	85,0%	85,0%	85,0%	85,0%	85,0%	85,0%
Ag (%)	78,0%	83,0%	78,0%	85,0%	85,0%	83,0%
Au (%)	73,5%	0,0%	73,5%	0,0%	0,0%	0,0%

Metal në koncentrat						
Pb (t)	5.74	1.19	2.31	1.81	3.24	3.00
Zn (t)	10.87	1.14	1.98	1.67	1.02	2.86
Ag (Kg)	6.90	2.67	2.95	3.06	1.50	5.81
Au (Kg)	51,45	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Cilësia e Pb në koncentrat						
Pb në K/Pb (%)	70,0%	68,0%	69,0%	67,0%	68,0%	70,0%
Zn në K/Pb (%)	1,20%	0,80%	1,20%	0,95%	0,91%	0,80%
Ag në K/Pb (gr/t)	940.00	1.05	650.00	75.00	55.00	1.05
Au në K/Pb (gr/t)	0,27	0.00	0,10	0,00	0,00	0,00
Cilësia e koncentratit të Zn						
Pb në K/Zn (%)	1,20%	1,00%	1,20%	2,16%	2,48%	1,00%
Zn në K/Zn (%)	48,00%	45,00%	47,00%	47,00%	48,00%	46,74%
Ag në K/Zn (gr/t)	43.00	45.00	35.00	45.00	43.00	45.00
Au në K/Zn (gr/t)	0,020	0.000	0,020	0,000	0,000	0,000
Sasi të koncentratit						
K/Pb (t)	8.20	1.75	3.35	2.71	4.77	4.29
K/Zn (t)	22.64	2.52	4.21	3.56	2.13	6.12
Sasi të metalit në koncentratin Pb						
Pb në K/Pb (t)	5.74	1.19	2.31	1.81	3.24	3.00
Zn në K/Pb (t)	98.00	14.00	40.00	26.00	43.00	34.00
Ag në K/Pb (Kg)	7.71	1.84	2.18	203.00	262.00	4.50
Au në K/Pb (Kg)	2,21	0.00	0,33	0.00	0.00	0.00
Sasi të metalit në koncentratin Zn						
Pb në K/Zn (t)	272.00	25.00	51.00	77.00	53.00	61.00
Zn në K/Zn (t)	10.87	1.14	1.98	1.67	1.02	2.86
Ag në K/Zn (gr)	973.00	114.00	147.00	160.00	91.00	275.00
Au në K/Zn (gr)	0,45	0.00	0,08	0.00	0.00	0.00

Vlera e metalit në xeheror						
Pb (\$)	70,0%	68,0%	69,0%	67,0%	68,0%	70,0%
Zn (\$)	1,20%	0,80%	1,20%	0,95%	0,91%	0,80%
Ag (\$)	940.00	1.05	650.00	75.00	55.00	1.05
Au (\$)	0,27	0.00	0,10	0,00	0,00	0,00
Cilësia e koncentratit të Zn						
Pb në K/Zn (%)	1,20%	1,00%	1,20%	2,16%	2,48%	1,00%
Zn në K/Zn (%)	48,00%	45,00%	47,00%	47,00%	48,00%	46,74%
Ag në K/Zn (gr/t)	43.00	45.00	35.00	45.00	43.00	45.00
Au në K/Zn (gr/t)	0,020	0.000	0,020	0,000	0,000	0,000
Sasi të koncentratit						
K/Pb (t)	8.20	1.75	3.35	2.71	4.77	4.29
K/Zn (t)	22.64	2.52	4.21	3.56	2.13	6.12
Sasi të metalit në koncentratin e Pb						
Pb në K/Pb (t)	5.74	1.19	2.31	1.81	3.24	3.00
Zn në K/Pb (t)	98.00	14.00	40.00	26.00	43.00	34.00
Ag në K/Pb (Kg)	7.71	1.84	2.18	203.00	262.00	4.50
Au në K/Pb (Kg)	2,21	0.00	0,33	0.00	0.00	0.00

Vlerësimet themelore të theksuara më lartë për sasinë e metaleve në bazë, kanë të bëjnë edhe me cilësinë e fabrikave të pasurimit të plumbit dhe të zinkut dhe për sasinë e metalit në koncentrat. Mbi sasi të përfundimtare të metalit dhe koncentratit, të cilat do të porositen dhe paguhen, do të ndikojë edhe vëllimi i zbritjeve dhe i humbjeve në fabrikën e pasurimit.

Sipas vlerës së metalit në xeheror dhe në koncentrat, miniera e Hajvalisë, dukshëm i kapërcen minierat tjera. Kjo ndodhë për shkak të xeherorëve relativisht të pasur me metalet kryesore plumb dhe zink nga njëra anë dhe nga prania e sasive të mëdha të metaleve fisnike, sidomos të argjendit, nga ana tjetër. Kështu, vlera e metalit në koncentratin e Hajvalisë në kushte të prodhimtarisë fillestare prej 70.000 tonë xeheror në vit, është vlerësuar 42.319.010, dollarë amerikan. Miniera e Artanës me prodhim fillestar prej 36.598 tonë xeheror, vlera e metalit arrin 6.746.409, dollarë. Në minierën e Badovcit me 60.000 tonë

xeheror, prodhim fillestar arrin 11.151.407 dollarë. Në Belloberdë me prodhim prej 48.000 tonë xeheror, kap shumën 9.496.690 dollarë. Në Cërnac, me 80.000 tonë xeheror, vlera e metaleve është 10.138.627 dollarë dhe në Stantërg, me prodhim fillestar prej 92.164 tonë xeheror, prodhim ky që është arritur dhe tejkaluar, kap vlerën e 16.394.712 dollarëve amerikan. Këto vlera, do të jenë më të mëdha gjatë periudhës analizuuese, ndërsa janë llogaritur, duke i pasur parasysh supozimet reale për vëllimin rritës të prodhimtarisë prej 15% në vit.

6.4. Përmbushje e standardeve mjedisore

Si rezultat i aktiviteteve minerare, të cilat kryhen në sipërfaqe relativisht të mëdha, mbi dhe nën tokë, shkaktohen ndryshime të mëdha në relievin. Ndryshimet janë të dukshme në hidrogeologji dhe në konfiguracionin e terrenit dhe vjen deri te një dukuri e ashtuquajtur "goditje malore". Po ashtu, rrjedhja e ujërave acid dhe emisioni i gazrave, të gjitha së bashku, kanë efekte të mëdha negative mbi mjedisin jetësor. Për shkak të gjithë kësaj, mbrojtja e mjedisit jetësor dhe e personelit, kanë rëndësi gjithnjë e më të madhe. Kjo do të ndikoj në rritjen e kostos së shfrytëzimit të pasurive minerale, të cilat domosdoshmërisht merren parasysh gjatë kalkulimeve për profitabilitetin dhe rentabilitetin e secilës minierë.

Eksplotimi shumëvjeçar i minierave të "Trepçës", ka shkaktuar dhe ende shkakton pasoja të mëdha mbi relievin, ndotjen e tokës, ujërave dhe ajrit, të cilat lënë pasoja mbi njerëzit, botën bimore dhe shtazore. Pasojat janë të pranishme edhe nën tokë, në minierat aktive, sidomos ato të braktisura dhe të mbyllura. Ndërgjegjja e re dhe rritëse për pasojat afatgjate nga nënçmimi i pasojave mbi mjedisin jetësor, ka imponuar rregulla të reja dhe gjithnjë e më rigorozë, të cilat duhet të respektohen dhe plotësohen. Kjo situatë, obligon që monitorimi dhe grumbullimi i informacioneve të fitojnë rëndësi, për shkak të aplikimit të masave të domosdoshme për mbrojtje, sanim dhe ripërtëritje të mjedisit.

Në këtë kuptim, theksohet rëndësia e metodës së "deteksionit të largët", e cila duhet të jetë efikase dhe ekonomike. Për këtë, zgjedhja e masave përkatëse për mbrojtje, sanim dhe rivitalizim, duke mbajtur llogari për racionalizimin e tyre, është i kushtëzuar nga: qasja me kohë e të dhënave, besueshmëria dhe tërësia e informacionit, lloji i informacionit dhe intensiteti i prishjes së kushteve natyrore. "Sistemi i monitorimit", zbatohet gjerësisht në sektorin minerar, për shkak të kompetencës së saj, shpejtësisë, thjeshtësisë dhe qasjes për shfrytëzim. Monitorimi i zakonshëm në praktikë, zbatohet në vëzhgim terreni. Krahas asaj që u tha, për definimin e shkallës së rrezikshmërisë së mjedisit jetësor, në xehetari duhet të zbatohet edhe "deteksioni i terrenit-të largët" (i ash.q. deteksion i kombinuar)

6.4.1. Përmbushje e standardeve mjedisore në miniera

Mbrojtja e mjedisit jetësor në industrinë minerare, bazohet në katër aspekte: hulumtimi i mbrojtjes së teknologjitë ekzistuese, hulumtimet gjatë zbatimit të teknologjive të reja, zbutjes dhe sanimit të dëmeve dhe edukimit. Në saje të teknologjisë ekzistuese, për eksploatimin e pasurive minerale, duhet shkuar drejt kufizimit racional të hapësirës së eksploatimit, zvogëlimit të ndotjes së ujit e ajrit në nivelin standard, rritjes së shkallës së trajtimit të ujërave të zeza, sigurimit të depozitave së mbetjeve industriale që dalin nga procesi i pasurimit, nga depërtimet dhe krijimi i tampon-zonave natyrore mes hapësirës së objekteve minerare dhe mjedisit urban.

Në minierat moderne ku zbatohen teknologji të avancuara, shfrytëzimi duhet të bëhet në atë mënyrë, që të sigurohet prodhim masiv dhe mbrojtje maksimale të mjedisit jetësor.

Sanimi ose zbutja e pjesërishme e pasojave nga aktivitetet minerare, duhet të realizohen në faza. Duke filluar me mbushje të plotë ose të pjesërishme të hapësira të shfrytëzuara në miniera, demontimit dhe mënjanimin e objekteve të panevojshme, përshtatjes së objekteve për qëllime të reja dhe rikultivimin e sipërfaqeve të degraduara. Me këtë rast, rezultate më të volitshme realizohen kur këto punë kryhen, krahas fazës së eksploatimit të xeherorëve.

Po ashtu, edukimi për mbrojtjen e mjedisit jetësor në miniera, paraqet çështje të veçantë dhe të rëndësishme në kompleksin e mbrojtjes së mjedisit nga aktivitetet minerare.

Çështjet mjedisore të shkaktuara nga eksploatimi i pasurive minerale dhe pasojat e ardhshme mbi mjedisin jetësor, imponojnë aktivitete për zvogëlimin ose eliminimin e pasojave të dëmshme. Në fushën e minierave dhe fabrikave të pasurimit, janë të domosdoshme shumë lloje të aktiviteteve, duke marrë parasysh ndikimin mbi fuqinë punëtore, ajrin, ujin, tokën dhe ndikimet tjera të mundshme. Mbetjet e materialeve nga punët minerare, paraqesin kërcënim për mjedisin jetësor, si për organizmat e gjallë në rrethinën e afërt, po ashtu edhe për organizmat në ujin e përrrenjve dhe bimët.

Pjesa më e madhe e aktiviteteve dhe masave që duhet të ndërmerren, në masë më të madhe ose më të vogël, paraqiten në të gjitha minierat. Me këtë rast, duhet të merren parasysh specifikat e çdo miniere, të cilat janë të përcaktuara nga relievi, pasuritë minerale dhe prania e metaleve, prania e acideve dhe materiet e dëmshme, etj. Prandaj, sa i përket masave të mbrojtjes në punë dhe zbatimit të standardeve mjedisore si model të përgjithshëm do ta marrim minierën "Trepça" në Stantërg, si miniera më e madhe e këtij gjiganti minerar.

Miniera “Trepça” në Stantërg – Aktivitetet për përmirësimin e mbrojtjes në punë dhe zbatimi i standardeve mjedisore kanë të bëjnë me fushat e ardhshme:

- Deponimi i eksplozivit, vajrave dhe kimikateve nuk kanë ndikim mbi njerëzit, ajrin, ujin, si dhe ndikime të tjera. Aktivitetet kanë të bëjnë me sigurimin e depozitave përkatëse dhe sigurimin e tyre.
- Në lidhje me eksplozivet, shpimet dhe transportin, në procesin e nxjerrjes së xeherorëve, duhet të pritet ndikim mbi njerëzit nga pluhuri dhe ajrit të ndotur në minierë. Ndikimi negativ i ajrit brenda në minierë do të jetë i lartë, ndërsa jashtë i ulët. Nuk duhet të pritet ndikim në ujin, si dhe ndikime të tjera. Masat që duhen ndërmarrë, kanë të bëjnë me përmirësimin e ajrimit të minierave, mbajtjen e maskave për frymëmarrje të minatorëve dhe veshjen adekuate të punës.
- Transporti i xeherorëve deri te fabrika e pasurimit me tren, nuk ndikon mbi njerëzit, ajrin, ujin, pra nuk ka ndikime tjera, prandaj nuk parashikohen masa të veçanta.
- Heqja e ujit nga minierat – Ujërat që rrjedhin nga minierat, ndikojnë mbi njerëzit vetëm nëse realizohet kontakti me të, ndikim mbi ajrin nuk kanë, ndikimi mbi rrjedhat ujore do të jetë i lartë, që do të varet nga përmbajtja e metaleve të rënda, kripërave dhe pH-së. Propozimet për marrjen e masave në këtë aspekt, konsistojnë në zbatimin e rregullave të veshjes adekuate, monitorimit të ujërave dhe vendosjes së sistemit për trajtimin e ujërave në të ardhmen.

6.4.2. Përmbushja e standardeve mjedisore në fabrikat e pasurimit

Fabrikat e pasurimit me flotim, si pjesë përbërëse të funksionimit të minierave, paraqesin burim të ndotjes së tokës, ajrit dhe mjedisit jetësor në përgjithësi. Masat e veçanta janë të domosdoshme për mbrojtjen e personelit të punësuar në këto fabrika.

Fabrikat e pasurimit në Tunel të Parë, Kishnicë dhe Leposaviq

Rreziqet e mundshme nga mbetjet industriale, që krijohen nga pasurimi i xeherorëve, kanë të bëjnë me ndotjen e ujërave nëntokësor, nga rrjedhja e acideve nga depozitat e mbetjeve minerare, ndotjen e ujërave sipërfaqësore nga materiali i cili shkakton erozion në digën e argjinaturës. Po ashtu, shkaktohet ndotje e ajrit përmes pluhurit nga mbetjet, në kushte të erërave të fuqishme dhe periudhave të thatësirës, ndotjes së tokës bujqësore përmes fundërrinës së pluhurit nga depozitat. Ndotja e tokës, ndodhë po ashtu, nga pluhuri i cili shkaktohet nga depozitat e mbetjeve, ujit të kontaminuar sipërfaqësor dhe sedimenteve nga ujërat e ndotura nëntokësore.

Aktivitetet për përmirësimin e mbrojtjes në punë dhe zbatimimi i standardeve mjedisore, kanë të bëjnë me sa vijon:

- Depozitimi i eksplozivit, vajrave dhe kimikateve- Nuk priten pasoja në njerëz, ajrin, ujin dhe ndikime të tjera negative. Masat kanë të bëjnë me sigurimin e depozitës përkatëse.
- Procesi i thërrmimit dhe bluarjes - Gjatë këtij procesi, ndikimi mbi njerëzit është i lartë për shkak të pluhurit. Ndikimi në ajër është i ulët, por varet nga funksionimi i sistemit të ajrimit dhe filtrave. Nuk priten pasoja në ujin dhe ndikime të tjera. Masat e ndërmarra kanë të bëjnë me ndërtimin e një objekti të mbyllur me sistem të mirë ajrimi dhe filtra, mbajtja e maskave për frymëmarrje nga punëtorët dhe veshje të përshtatshme për punë.
- Procesi i pasurimit të xeherorëve - do të ketë ndikim të lartë mbi njerëzit, për shkak të përdorimit të reagjensëve kimik helmues. Ndikimi mbi ajrin do të jetë i ulët. Ndikimi mbi ujin do të jetë i lartë, por ai duhet të riciklohet. Nuk priten ndikime tjera negative. Masat i përkasin sigurimit të veshjeve për punë, rikonstruksionit të objektit, riparimit të tubacioneve dhe sistemit për përpunimin e ujit.
- Transporti i mbetjeve me ndihmën e ujit dhe tubacioneve. Ndikimi në njerëzit do të jetë i ulët dhe do të varet nga kontakti i drejtpërdrejtë me ujin. Ndikim mbi ajrin nuk do të ketë për shkak të përpunimit të lagët. Ndikimi mbi ujin mund të jetë i lartë, varësisht nga infiltrimi dhe shtrydhja në zonat e depozitave. Ndikimet tjera do të manifestohen në ujërat nëntokësore dhe në sistemin e ujërave, varësisht nga infiltrimi dhe procesi i shtrydhjes. Masat kanë të bëjnë me monitorimin e procesit të depozitimit, mbrojtjes së depozitës nga erozioni i ujit, përmes sistemit për mbrojtjen e digave dhe sistemit rrethor të ujit.

Ndikimi i mbetjeve industriale mbi njerëzit, do të jetë i lartë për shkak të pluhurit. Ndikimi mbi ajrin do të jetë i lartë për shkak të erërave të fuqishme, ndërsa mbi ujërat për shkak të erozionit nga erërat dhe transporti deri të lumi. Ndikimet tjera do të jenë të larta mbi popullsinë, tokën, ujërat, bimët dhe kafshët. Masat që duhen ndërmarrë i përkasin rikultivimit, sigurimit nga përmytjet dhe dhënia e përparësisë së lartë, ruajtjes së mjedisit jetësor, si dhe ujitjes së depozitës gjatë periudhave të thata.

Rehabilitimi i minierave të "Trepçës" dhe aktivizimi i tyre, në masë të madhe i përkasin aftësisë së tyre dhe sjelljes në gjendje të pranueshme mjedisore. Një pjesë e këtyre aktiviteteve, janë të orientuara në mbyllje, rehabilitimin e depozitave të mbetjeve minerare pasive apo riciklimin e tyre. Në të kaluarën,

planifikimi dhe ndërtimi i këtyre depozitave nuk ka qenë adekuat, sepse nuk është marrë në konsideratë afërsia e tyre me përrrenjtë, lumenjtë, shpatet, erozioni, riorientimit të ujërave nga diga, që të zvogëlohet erozioni etj.

Jo të plota janë edhe të dhënat për rrjedhën e kanaleve dhe ndikimi i tyre mbi gjendjen e lumit Ibër, që është e nevojshme të vlerësohen periudhat vjetore të vërshimeve të mbetjeve industriale. Kontrolli kimik i ujit nga lumi Ibër, është kryer në rrjedhën e epërme dhe të poshtme, për mbetjet industriale nga Tuneli i Parë, Fusha e Epërme dhe Lepsaviqi. Ndërkaq, në Kishnicë i gjithë uji riciklohet dhe kthehet në fabrikën e pasurimit për procesin e flotimit, kështu që nuk ka lëshim rutinor dhe testim kimik të derdhjes së ujit. Në fund, nuk ka të dhëna për mënyrën se si janë projektuar, ndërtuar dhe si janë punuar depozitat e mbetjeve minerare.

Mbetjet minerare nga fabrikat e pasurimit ndahen. Kështu materiali i imët dhe i butë dërgohet në depozitën e mbetjeve minerare, ndërsa materiali i fortë përdoret për mbushje nëntokësore në minierat e "Trepçës". Për ndërtimin e digës së depozitës së mbetjeve industriale, janë shfrytëzuar këto mbetje si komponentë kryesore. Në digën kryesore të mbetjeve minerare, janë instaluar piezometra që të matet niveli i ujërave nëntokësore, në digën dhe shkëmbinjtë nën digë.

Materiali nga të cilat përbëhen depozitat e mbetjeve, është i thartë (acidik), ndërsa janë vërejtur edhe përqendrime të larta të metaleve të rënda. Me qëllim që të zvogëlohet ndikimi i acideve dhe dukuria e erozionit, këto mbetje duhet të rehabilitohen në harmoni me principet miqësore ndaj mjedisit. Për tu ndërprerë rrjedhja e ujërave të ndotur, duhet të mbulohen gjithë mbetjet minerare me shtresë dheu, që të zvogëlohet depërtimi i ujit dhe i oksigjenit. Mbulesa duhet të ketë trashësi minimale prej një metri, që të mundësojë vegjetacionin e bimëve.

Në fund, edhe pse aktivitetet minerare dhe shkrirja e xeherorëve, kryejnë ndikim të fuqishëm mbi mjedisin jetësor, zinku është metal, i cili ka përdorim të shumëfishtë mbrojtës. Po ashtu, ky metal është element natyror, i cili është i pranishëm në ajër, ujë në biomasë dhe në gjendje të fortë (në shkëmbinjtë). Si element natyror, zinku është i nevojshëm për të gjitha organizmat e gjallë për rritjen dhe zhvillimin e tyre. Në kushte të sotme të shqetësimit të përgjithshëm për ndryshimet klimatike dhe emisionit të CO₂, roli i zinkut është në mënyrë të veçantë i theksuar. Gjithashtu, materialet qëndrojnë më gjatë, kur mbrohen me zink kundër ndryshkjes. Me këtë parandalohet emisioni i CO₂, si pasojë e ndryshkjes, ndërsa zvogëlohet edhe zëvendësimi i çelikut të ndryshkur.

Informacionet tregojnë, se çdo ton zink që përdoret për galvanizim të çelikut, parandalon emision të qindra tonë CO₂. Dihet se në Gjermani, në 50 vitet e fundit, më shumë se 45 milionë tonë hekur është i mbrojtur nga ndryshkja përmes

galvanizimit. Me këtë është parandaluar emisioni i mbi 5 milionë tonëve CO₂. Përveç kësaj, përdorimi i zinkut vazhdimisht rritet në konstruksionet e çative të shtëpive, gjatë vendosjes së qelive për shfrytëzimin e energjisë diellore. Krahas kësaj, në të ardhmen parashikohet përdorim dukshëm i rritur i oksidit të zinkut.

Përzgjedhje e teknologjisë dhe mjeteve të nevojshme financiare

Rritja e kërkesës së metaleve në botë, nxitë rritje të prodhimtarisë së xeherorëve, që nga ana e saj, i bën më të ndërlikuara kushtet e shfrytëzimit të mineraleve xeherore. Gjendja e këtillë, në masë të madhe është rezultat i shfrytëzimit të xeherorëve në thellësi më të mëdha, por edhe nga zvogëlimi i përmbajtjes së metaleve në xeheror. Krahas kësaj, eksploatimin e pasurive minerale e ndërlikojnë edhe standardet gjithnjë e më të ashpra për ruajtjen e mjedisit jetësor. Shfrytëzimi në thellësi, varfërimi i përmbajtjes së metalit në xeheror, si dhe standardet e përforcuara mjedisore, kontribuojnë për rritjen e kostos së eksploatimit të mineraleve. E gjithë kjo ka imponuar nevojën e modernizimit të vazhdueshëm të pajisjeve dhe impianteve, të cilat përdoren në xehetari, me qëllim të arritjes së ekonomizimit të kënaqshëm, produktivitetit, rentabilitetit dhe profitabilitetit.

Me këtë rast, duhet marrë parasysh, se çdo shfrytëzim i veçantë nëntokësorë i xeherorëve, ka specifika të veta për të cilat duhet të mbahet llogari në përcaktimin e teknologjisë së eksploatimit, ndërsa me këtë edhe të performansave të pajisjeve. Specifikat e minierës e imponojnë përzgjedhjen e pajisjeve dhe të stacioneve, përzgjedhjen e ndërmarrjes apo kompanisë dhe të udhëheqjes me proceset prodhuese, si dhe numrin dhe profilin e personelit të angazhuar.

Minierat e "Trepçës" janë vendosura në lokalitete të ndryshme të territorit të Republikës së Kosovës. Të gjitha minierat kanë karakteristika të veta, të cilat imponojnë përzgjedhje të proceseve përkatëse dhe specifike të shfrytëzimit dhe optimalizimit të zgjedhjeve, me qëllim të realizimit të indikatorëve pozitiv të suksesit në punë.

Aspekt më të rëndësishëm së problemeve të tri fazave të "shekullit të jetesës së minierës" (vërtetimi i sasisë së mineralit të dobishëm në vendburime, përpunimi i studimit tekniko-teknologjik dhe periudha e eksploatimit), paraqet shkalla e pasigurisë së vlerësimit, si dhe koeficienti i rrezikut, që e përcjell çdo vendim të bazuar në vlerësimin. Kjo ndodhë, për shkak se çdo vendim i marrë gabimisht rezulton me shpenzime të panevojshme dhe humbje të shumta.

Me këtë rast, duhet të merret parasysh se kostoja financiare për grumbullimin e informacioneve në mineralogji, (shpime, objekt xeheror nën tokë, marrje mostrash dhe analiza) janë disa herë më të mëdha në krahasim me degët tjera industriale. Për shkak të gjithë kësaj, nevojitet racionalizëm më i madh në grumbullimin e informacioneve dhe vendosja e kriterëve të qarta, se si ato informacione do të shfrytëzohen.

Po ashtu, aspektet mjedisore kanë rëndësi gjithnjë e më të madhe dhe ndikim gjatë përzgjedhjes së metodave të eksploatimit dhe përzgjedhjen e impianteve e pajisjeve që do të përdoren. Për shkak të gjithë kësaj, një nga problemet kryesore në industrinë minerare, paraqesin depozitat e mbetjeve minerare. Për rastin e Kosovës, rëndësi primare paraqet respektimi i direktivave të BE-së për mbrojtjen e mjedisit.

Procesi i vlerësimit të efekteve në mjedisin jetësor, obligon qasje të integruar të disa disiplinave, që në procesin e projektimit, duke i marrë parasysh efektet ekonomike, sociale, etj. Këto projekte, zakonisht janë komplekse dhe të integruara, të cilat përfshijnë shumë aspekte, siç janë: qëllimet themelore mjedisore, përzgjedhja e lokacionit, aspekti i thërrmimit dhe bluarjes në mullinj, si dhe trajtimi apo rehabilitimi i mbetjeve minerare. Projekti duhet të japë përgjigje për ndikimin e mbetjeve minerale mbi fiziologjinë, klimën, cilësinë e ajrit, zhurmën, hidrologjinë, hidrogjeologjinë, jetën në ujërat, vegjetacionin, botën shtazore, si dhe ndikimet mbi shfrytëzimin e tokës.

Harmonizimi me kërkesën e direktivave të BE-së, ka të bëjë me më shumë çështje. Këtu bëjnë pjesë: sigurimi financiar, vlerësimet për ndikim në mjedisin jetësor, furnizimi dhe përdorimi i ujit, derdhja e ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor, riciklimi i ujit, përdorimi dhe dëmtimet e tokës. Po ashtu, menaxhimi i mbetjeve, ndikimi mbi vegjetacionin, flora, fauna, raportimi i rregullt, emisioni i pluhurit, avullit dhe helmeve, niveli i tolerancës së zhurmës dhe kundërmimeve, materialet dhe substancat e rrezikshme, njoftimi deri të rregullatori dhe kontributet vullnetare.

Financimi i pajisjeve, stacioneve dhe nevojave tjera, realizohet në shumë mënyra dhe me shfrytëzimin e burimeve të ndryshme, për të cilat më shumë do të bëhet fjalë në kapitullin e ardhshëm të këtij teksti. Financimi i projekteve investuese, paraqet përmbledhje të shumë aktiviteteve, për shkak të vërtetimit të strukturës dhe kushteve për shfrytëzimin e mjeteve financiare të nevojshme për financim. Kjo nxit aktivitete për vërtetimin e vëllimit të nevojshëm të mjeteve financiare, nga njëra anë dhe harmonizimin e tyre me mjetet e nevojshme (pajisje dhe impiante) nga ana tjetër.

Me këtë rast, duhet të mbahet llogari për qëllimin, për të cilin do të shfrytëzohen mjetet, sidomos nëse bëhet fjalë për financim afatgjatë, si dhe për kushtet me të cilat jepen mjetet. Në mënyrë të veçantë, duhet të mbahet

llogari për klauzolat e ndryshme, me të cilat kushtëzohet dhënia e mjeteve financiare, të cilat mund të kufizojnë sfera së veprimit të veprimtarisë afariste të shfrytëzuesit, sidomos në lidhje me marrjen e vendimeve të rëndësishme afariste dhe me shfrytëzimin e mjeteve personale.

Në këtë tekst, janë dhënë vlerësime për eksploatimin e minierave gjatë dhjetë vjetëve, si rezultat i punës hulumtuese të autorëve. Mjetet e nevojshme financiare parashikohet të sigurohen me debi, me afat të kthimit prej 7 deri 10 vjet, me normë interesi prej 8,25%. Për ato miniera ku nevojiten investime më të mëdha për riaktivizimin dhe rikonstruksionin e tyre, vlerat e huave janë më të mëdha, me ç'rast afati për pagesë arrin 10 vjet. Për minierat të cilat janë aktive, parashikohet që të investohen shuma relativisht më të vogla, ndërsa afati për kthimin e debisë është më i shkurtër dhe arrin 7 vjet.

Kuptohet se mund të përdoren edhe burime të tjera për grumbullimin e kapitalit financiar, sidomos emisioni i aksioneve dhe fletë-obligimeve. Megjithatë, konsiderojmë se në këtë fazë të zhvillimit të "Trepçës", lehtë do të mund të sigurohen hua. Ana pozitive e këtij procesi është, se minierat nuk kanë obligime afatgjate financiare, që nuk janë privatizuar dhe që shteti mund të paraqitet si garantues për shfrytëzimin e huave dhe për sigurimin e mbështetjes dhe lehtësimin në punësim, me qëllim të mbizotërimit të vështirësive dhe problemeve fillestare.

Sasia dhe qëllimi i mjeteve të nevojshme financiare për investime në miniera të caktuara, janë të ndryshme dhe ato varen nga gjendja në të cilën ndodhen pajisjet dhe impiantet, nevoja për zëvendësimin e tyre, lloji dhe përfshirja e riparimeve dhe aktivitetet tjera të nevojshme për krijimin e kushteve për punë normale etj. Në mënyrë të veçantë, janë problematike minierat e vërshuara nga uji, ku nevojiten mjete më të mëdha për pompimin (nxjerrjen) e ujit dhe për zëvendësimin e plotë të stacioneve, pajisjeve dhe riparimin e galerive etj.

Në kuadër të mjeteve të nevojshme, të cilat do të investohen, parashikohet edhe shuma e caktuar e kapitalit fillestar (start-ap), të cilat, si kapital qarkullues, është i domosdoshëm për vënien në funksion të mjeteve fikse dhe të faktorëve të tjerë të prodhimtarisë. Madhësia e kapitalit fillestar do të varet nga gjendja konkrete e çdo miniere në veçanti. Kështu, për minierat e përmytura, ku do të investohen mjete më të mëdha, parashikohet që ky kapital të arrijë rreth 20-25% nga investimi i përgjithshëm. Për minierat tjera, kapitali fillestar arrin 10-15% nga investimet e përgjithshme, ndërsa për një minierë nuk parashikohen mjete të këtilla. Nevojat për mjete financiare të minierës së Hajvalisë, janë vlerësuar në 18.900.000 dollarë amerikan dhe janë më të mëdha në kuadër të investimeve në miniera. Vlora e përgjithshme e debisë, është për shkak të gjendjes së keqe, në të cilën ndodhen pajisja dhe stacionet, si dhe galeritë në miniera. Pjesa më e madhe e kësaj vlere do të investohej në vitin e parë (viti zero).


Sipas përqendrimeve të metaleve të dobishme (plumb, zink, argjend dhe ari), miniera e Hajvalisë është më e pasura nga të gjitha minierat e kompleksit "Trepça". Prandaj, riaktivizimi i sajë, do të thotë derdhje e mjeteve më të mëdha financiare. Qëllimi i këtij investimi është: për riparime të hyrjes së galerisë (5,3%), ndërsa për impiante dhe pajisje nëntokësore do të shfrytëzohet pjesa më e madhe e mjeteve financiare (74,1%). Pjesëmarrja e lartë e mjeteve për punë nëntokësore, është kushtëzuar nga fakti që kjo minierë, më shumë se dhjetë vjet është e përmytur, si pasojë e së cilës nevojiten masa gjithëpërfshirëse për aftësimin e saj për punë normale. Për kapitalin fillestar (start-up), parashikohen 20.6% të mjeteve. Huaja do të paguhej në afat prej dhjetë vjetëve, me normë interesi prej 8,25% dhe anuitet vjetor prej 1.890.000 dollarësh.

Mjetet e nevojshme për investim në minierën e Artanës janë më të vogla, prej të gjitha minierave të "Trepçës", që do të ristrukturohen dhe arrijnë në 2.000.000 dollarë. Mjetet e huas parashikohet në tërësi të shfrytëzohen në vitin fillestar. Këto mjete, më shumë dedikohen në furnizim të makinerive minerare (50%) dhe pajisjeve për transport horizontal (37,5%), ndërsa pjesa tjetër është për blerje të vagonëve (10,0%) dhe për riparimin e objekteve elektrike (2,5%). Parashikohet që huaja të kthehet në afat prej shtatë vjetëve me normë interesi prej 8,25%, ndërsa anuiteti vjetor do të arrinte 285.714 dollarë.

Mjetet monetare të nevojshme për të gjitha minierat, vlerësohen në rreth 48.000.000 dollarë amerikan dhe parashikohen të investohen në dy vitet fillestare të periudhës analizuëse. Me këtë rast, 63% nga këto mjete do të investoheshin në vitin e parë (viti zero), ndërsa pjesa tjetër prej 37% në vitin e parë të punës, nga periudha e analizuar.

Pjesa më e madhe e mjeteve është parashikuar të investohen në minierat joaktive, Hajvali dhe Badovc, rreth 39,4%, përkatësisht 25%, duke pasur parasysh, se janë të vërshuara nga uji, është e nevojshme të bëhet riparimi i plotë i impianteve, makinerive, infrastrukturës etj. Nga minierat tjera, të cilat janë aktive, investime më të mëdha parashikohen për atë të Stantërgut, të cilat përfshijnë 18,3% nga mjetet e përgjithshme të parapara për investime. Pagesat e kredive janë vlerësuar në 5.530.000 dollarë, për kreditë me afat të kthimit prej shtatë vjetëve, ndërsa 3.090.000 dollarë, për kreditë me afat prej 10 vjetëve. Në shtatë vitet e para, mjetet e përgjithshme për pagesë të huave arrijnë 8.620.000 dollarë, ndërsa nga viti i tetë e deri në të dhjetin, do të duhej të paguhej vlera prej 3.090.000 dollarësh. Shpërndarja e këtillë kohore e pagesave të huave, do të thotë ngarkesë relativisht e madhe e parave kesh të huave dhe neto profitit, në shtatë vitet e para nga periudha e analizuar. Në vitet tjera (8 deri në 10 vite, flukset e parave kesh janë dukshëm më të mëdha, e kjo ka të bëjë edhe me shumën e neto profitit, të cilin do ta realizojnë minierat veç e veç.

Shpërndarja e Investimeve në [%], e investimeve totale prej rreth 48 milion \$, sipas minierave përkatëse



Më lartë është elaboruar çështja e pasojave mjedisore nga puna e minierave dhe fabrikave të pasurimit. Në suaza të këtij kompleksi çështjesh, vëmendje e veçantë i kushtohet depozitave të mbetjeve minerare, të cilat janë formuar në të kaluarën dhe atyre, të cilat shfrytëzohen në punën vijuese, si dhe problemet që në të ardhmen shkaktojnë këto depozita. Shpenzimet për mbylljen dhe rehabilitimin e depozitave të mbetjeve, janë bukur të larta dhe ato vlerësohen në 34.589.213 dollarë ose 25.247.600 euro, sipas kursit aktual. Këto shpenzime, do të thonë ngarkesë shtesë e buxhetit të përgjithshëm të “Trepçës” dhe të minierave të përmendura.

6.5. Resurse të nevojshme njerëzore dhe paga

Siç është theksuar më lartë, në vitet e tetëdhjeta ndërmarrja “Trepça” ka pas të punësuar 22.000 vetë. Ky numër kaq i madh të punësuarish, paraqiste kontribut të rëndësishëm për ekonominë nacionale të Kosovës. Ngjarjet pas fundit të viteve të nëntëdhjeta, degraduan në mbyllje të pjesës më të madhe të kapaciteteve dhe humbje të vendeve të punës për një numër të madh të punonjësve. Qëllimi kryesor i ristrukturimit të minierave “Trepça” është vendosja e tyre në punë, ku do të fillojë procesi për ripërtëritjen e tyre për shfrytëzimin e pasurive minerale. Aktualisht, numri i të punësuarve në miniera është i vogël. Me rifillimin e punës të disa nga minierave dhe furnizimin me pajisje të reja, parashikohet që për të gjashtë minierat, numri i të punësuarve në vitin fillestar parashikohet që të arrijë 1332 veta. Megjithatë, gjatë periudhës analizuese dhjetëvjeçare, parashikohet rritje e prodhimtarisë prej 15% që do të mundësojë punësim të personave të rinj.

Me këtë rast, duhet të merret parasysh se gjatë një periudhe të gjatë kohore prej dhjetë vjetëve, në të cilin analizohet profitabiliteti i minierave, është e domosdoshme që pagesat e të punësuarve të rriten, për shembull, prej rreth 5 % në vit. Përveç kësaj, në rritjen vjetore të vëllimit të mjeteve financiare për

paga, janë të kyçura edhe shpenzimet për trajnime të tjera të të punësuarve, si nga administrata dhe menaxhmenti, ashtu edhe për të punësuarit të angazhuar drejtpërdrejtë në procesin prodhues. Këtu janë marrë parasysh edhe trajnimet e personelit, i cili do të angazhohet në punë me pajisjet bashkëkohore që parashikohen të blihen. Gjithashtu, duhet të mbahet llogari, se për shkak të mos aktivitetit të disa minierave dhe prodhimtarisë më të vogël të xeherorëve, pjesa më e madhe e personelit, i cili më herët ka qenë i punësuar në miniera, është riorientuar në aktivitete të tjera, është pensionuar, është shpërngulur etj. Kjo imponon ndërtim të politikave afatgjate për punësim. Gjendja ekzistuese e bën të domosdoshëm punësimin e numrit më të madh të personave të rinj, të cilët, nuk kanë përvojë pune, e për të cilët do të duhet të organizohet trajnim adekuat i domosdoshëm për inkuadrimitin e tyre të suksesshëm, në veprimtarinë e çdo miniere dhe njësie organizuese.

Trajnimi permanent i personelit për të gjitha aktivitetet afariste është i domosdoshëm dhe duhet të jetë rezultat i planeve vjetore dhe mujore, në të cilat do të përfshihen të gjithë të punësuarit, pavarësisht nga vendi i punës dhe funksioni. Me këtë do të krijohen mundësit për përdorim më efikas të pajisjeve, impianteve, por edhe të orarit të punës, që do të rezultojë me kursime më të mëdha dhe rezultate më të mëdha prodhuese dhe financiare.

Po ashtu, është e ditur se menaxhmenti me resurset njerëzore, paraqet aspekt shumë të rëndësishëm të punës e organizimeve. Menaxhment i mirë me resurse njerëzore të kualifikuara, është parakusht për efikasitet më të lartë në punë, kursime më të mëdha, shfrytëzim më të mirë të orarit të punës dhe rezultate më të mira prodhuese dhe financiare. Ngjarjet nga fundi i shekullit të kaluar, janë pasqyruar në mënyrë të pavolitshme, në afarizmin e "Trepçës". Aktualisht, ndërmarrja ndodhet në fazën e ripërtëritjes së të gjitha funksioneve që janë me rëndësi vitale për punën e mirë të "Trepçës" dhe të njëjstive të saj përbërëse. Në këtë proces, hyn edhe ndërtimi i funksionit dhe shërbimeve, të cilat do të merren me menaxhimin e burimeve njerëzore.

Në minierën e Hajvalisë, parashikohet që në vitin zero të periudhës së analizuar të punësohen 147 persona. Në vitin zero (viti fillestar), të punësuarit të angazhohen 6 muaj, ndërsa gjatë vitit të 1 deri në 10-të, së periudhës së analizuar, nga 12 muaj në vit.

Kjo do të thotë se vlera e pagave prej 5,55 dollarë për një ton xeherori në vitin zero, kur parashikohen 6 paga, ndërsa 9,65 dollarë gjatë viteve 1 deri në 10-in, kur parashikohen nga 12 paga në vit. Pjesëmarrja e kompensimeve për paga në koston e përgjithshme prodhuese, vlerësohet të arrijë 20,45 dollarë në vitin e parë dhe 24,55 dollarë në vitet vijuese, 1 deri 10-të, nga periudha e analizuar.

Miniera e Artanë është aktive dhe ajo në vitin fillestar (zero) punëson 289 persona. Për shkak të numrit relativisht të madh të të punësuarve në raport me prodhimtarinë e xeherorëve, vlera e mjeteve për paga për një ton do të arrijë 19,34 dollarë në vitin zero, respektivisht 33,34 dollarë në vitet kur të punësuarit do të marrin nga 12 paga. Numri relativisht më i madh i të punësuarve do të pasqyrohet edhe në pjesëmarrjen e kompensimeve për paga në koston e përgjithshme prodhuese, të cilat vlerësohet të arrijnë 34,24 dollarë në vitin zero dhe nga 48,53 dollarë, në vitet e ardhshme të periudhës analizuere.

Fakti që Artana, punëson relativisht më shumë persona, krahasuar me prodhimtarinë e realizuar të xeherorëve, ndikon që në këtë minierë, kompensimet për paga të maten me suksesin e punës dhe të rezultateve të përgjithshme financiare. Vlerat më të larta, të cilat veçohen për paga, mund të paraqiten si pengesë serioze për furnizimin e pajisjeve të reja dhe stacioneve, si dhe modernizimin e minierës. Me këtë rast, duhet të merret parasysh pjesëmarrja e lartë e punëtorëve të pakualifikuar (59,5%) në numrin e përgjithshëm së të punësuarve.

Numri i parashikuar i të punësuarve në minierën e Badovcit arrin 96 persona për vitin e parë. Numri i këtillë i të punësuarve do të thotë që shuma mesatare e shpenzimeve për paga për një ton xeheror, të cilat arrijnë 4,14 dollarë në vitin zero dhe 7,21 dollarë, në vitet e ardhshme të periudhës analizuere. Sa i përket pjesëmarrjes të kompensimeve në koston e përgjithshme prodhuese, kjo është vlerësuar në 19,5 dollarë në vitin zero dhe 22,12 dollarë në vitet nga 1 deri në 10-të, nga periudha e analizuar.

Miniera e Belloberdës punëson 130 persona në vitin e parë, nga periudha e analizuar. Numri i të punësuarve krahasuar me prodhimtarinë e xeherorëve llogaritet mbi mesataren e zakonshme. Kështu, vlera e pagave për prodhimtari të një ton xeherori, arrin 7,61 dollarë në vitin fillestar, me gjashtë paga, që të rritet në 13,23 dollarë në vitet vijuese të periudhës së analizuar, kur parashikohen nga 12 paga. Sa i përket pjesëmarrjes së shpenzimeve për paga, në koston e përgjithshme prodhuese, kjo arrin 22,51 dollarë për vitin fillestar, ndërsa 28,14 dollarë për vitet pasuese, kur do të paguhet nga 12 paga në vit.

Miniera e Cërnacit është aktive dhe në vitin fillestar janë punësuar 150 persona. Raporti i vlerës monetare, i cili parashikohet për paga dhe prodhimtari të xeherorëve konsiderohet si mesatar. Ndërkaq, vlera për paga në prodhimtarinë e një toni xeherori është vlerësuar në 7,61 dollarë për vitin fillestar, ku janë parashikuar 6 paga për të punësuarit. Në dhjetë vitet e ardhshme nga periudha e analizuar (viti i parë deri te i 10-ti), këto shpenzime do të jenë më të mëdha dhe do të arrijnë 9,04 dollarë. Pjesëmarrja e kompensimeve për paga, në koston e përgjithshme të prodhimit, gjithashtu është mesatare dhe arrijnë 20,1

dollarë në vitin e parë dhe 23,94 dollarë në periudhën kur të punësuarit do të angazhohen për 12 muaj në vit.

Prodhimtaria e xeherorëve në minierën "Trepça" në Stantërg, është më e madhe, që imponon punësim të më shumë personave. Në vitin e parë 512 veta, nga periudha e analizuar. Numri relativisht i madh i të punësuarve, pasqyrohet në vlerën e përgjithshme të pagave për prodhimin e një ton xeherori, si dhe në pjesëmarrjen e pagave në koston e përgjithshme prodhuese.

Kompensimet për paga për prodhimin e një toni xeherori në minierën e Stantërgut, janë vlerësuar në 12,16 dollarë në vitin e parë dhe 24,31 dollarë në dhjetë vitet e ardhshme të periudhës së analizuar. Pjesëmarrja në kompensimet për paga në koston e përgjithshme prodhuese është vlerësuar në 28,88 dollarë për vitin e parë (6 paga për të punësuarit), respektivisht 39,22 dollarë në vitet vijuese, kur të punësuarit do të marrin nga 12 paga (vitin e parë deri të 10-in).

Pjesëmarrja relativisht më e lartë e kompensimeve për paga në minierën e Stantërgut, ngjashëm sikur edhe për minierën Artanës, në mënyrë jo të vlitshme do të pasqyrohet në qarkullimin e parave kesh, e me këtë edhe mbi mundësitë për vetëfinancim për furnizim me pajisje dhe makineri të njëjse punuese si dhe zhvillimit të kësaj miniere. Ngjashëm me gjendjen në Artanë, në Stantërg, është relativisht më i madh numri i punëtorëve të pakualifikuar, të cilët marrin pjesë me 47,5% në gjithsej të punësuarve.

Karakteristikë e përgjithshme është pjesëmarrja dominuese e punëtorëve të pakualifikuar, gjendje e cila është kushtëzuar nga karakteri i veprimtarisë, por edhe nga faktorë tjerë joekonomikë. Ndërkaq, duhet synuar rritjen e numrit të punëtorëve të kualifikuar, si politikë afatgjate të rikualifikimit, përkryerjes dhe trajnimeve, me qëllim që kjo strukturë të zvogëlohet dhe dërgohet në nivel të pranueshëm.

Siç është theksuar më lartë, me pjesëmarrje relativisht më të madhe të punonjësve të pakualifikuar, në numrin e përgjithshëm të punësuarve, veçohen minierat në Artanë dhe Stantërg. Me këtë rast, duhet të marrë parasysh, se këto dy miniera janë aktive dhe se aspekti social ka rëndësi relativisht më të madhe në politikën e punësimit, duke pasur parasysh shkallën e lartë të papunësisë me të cilën karakterizohet ekonomia e Kosovës. Pavarësisht nga nevoja e lartë për punësime të reja, politika zhvillimore e "Trepçës" duhet të jetë afatgjatë. Nëse ndërmarrja "Trepça" investon në mënyrë më intensive në zhvillim, kjo do të thotë hapje e vendeve të reja të punës dhe punësime të reja për një periudhë afatgjatë. Ky aspekt, shpesh herë parashikohet dhe i epet përparësi në zgjidhjen e problemeve sociale, të cilat kanë efekte afatshkurtra pozitive, ndërsa efekte negative në periudha afatgjate.

Sipas të dhënave statistikore, minierat me produktivitet më të lartë janë: Badovci, Cërnaci dhe Hajvalia, ndërsa me produktivitet më të ulët janë minierat e Artanës dhe Stantërgut. Kjo lloj gjendje imponon zhvillimin e një politike afatgjate në të gjitha minierat, me të cilën efikasiteti i personelit të angazhuar do të rritet, që është parashikim për rritjen e produktivitetit dhe afrimin në standardet botërore.

6.5. Profitabiliteti i rristurimit

Kërkesa e lartë për metalet dhe relativisht çmimet e leverdishme, krijuan një raport të kënaqshëm mes kostos së prodhimit dhe çmimeve të plumbit dhe zinkut në bursat ndërkombëtare. Më lartë u theksua se xeherorët e plumbit dhe zinkut paraqiten së bashku dhe se përmbajnë shumë metale të tjera. Të dhënat tregojnë, se rreth 60% e prodhimit botëror së xeherorëve të plumbit, përmbajnë një sasi të konsiderueshme të zinkut, bakrit dhe argjendit. Metalet e tjera ekonomike në xeherorët e plumbit dhe të zinkut janë: ari, kadmiumi, antimoni, bizmuti galiumi, germaniumi etj. Të gjitha këto ndikojnë që ekonomia dhe efektet financiare të prodhimit të plumbit dhe zinkut të mos mund të vëzhgohen në mënyrë të izoluar dhe pa përfshirjen e ndikimit të metaleve bashkëshoqëruese.

Kështu, nëse çmimet e plumbit ulen në mënyrë të konsiderueshme, leverdishmëria ekonomike e plumb-zinkut mund të rrezikohet. Përvoja tregoi një numër shembujsh kur prodhimi i metaleve të tjera ka kontribuar në realizimin e leverdishmërisë së përgjithshme të prodhimit të plumbit dhe zinkut. Mbi bazën e kësaj, mund të konstatohet se gjatë miratimit të vendimit për eksploatim të xeherorëve të plumb-zinkut, duhet patjetër të merren parasysh edhe derdhjet e parave kesh nga metalet e tjera, si dhe nga të gjitha produktet tjera. Kjo kontribuon që të realizohet përhapja e rrezikut dhe uljes së rrezikut, nga ndikimi vendimtar i efekteve jo të favorshme nga ndryshimet e çmimeve të një metali.

Në analizën e efekteve ekonomike dhe financiare të minierave të "Trepçës", është e domosdoshme që të merret parasysh, se leverdishmëria dhe derdhja e parave kesh në çdo minierë, varet nga përmbajtja e metaleve, e cila sipas rregullit është e ndryshme. Gjithashtu, përmbajtja e metaleve ndryshon në vetë minierat, që përcaktohet nga gjeologjia e vendburimit. Proporcionet e metaleve nuk ndryshojnë gjatë kohës, si rezultat i vendburimit që eksploatohet, thellësisë, teknologjisë, e cila zbatohet nën ndikim të kërkesës dhe të lëvizjes së çmimeve. Përsosja dhe avancimi i përditshëm i teknologjisë, zbatimi i makinerive dhe impianteve të reja për nxjerrjen dhe përpunimin e xeherorëve, kontribuojnë për uljen e vazhdueshme të humbjeve të metalit gjatë shfrytëzimit dhe pasurimit (flotimit). Kjo kontribuon edhe në uljen e shpenzimeve, që mundëson të shfrytëzohen më thellë, ku sipas rregullit, xeherorët janë më të varfër me metale.

Kërkesa e lartë për metalet e plumbit dhe zinkut, kontribuon me çmime relativisht të favorshme të këtyre metaleve. Sipas të dhënave që janë në dispozicion dhe analizave, kërkesa për këto metale dhe metaleve në përgjithësi, do të duhet që të rritet me shkallë mesatare në dhjetë vitet e ardhshme. Kjo është si rezultat i procesit të industrializimit dhe të urbanizimit i cili realizohet në vendet më pak të zhvilluara, para së gjithash në ekonomitë e mëdha zhvillimore në Azi, në Amerikën e Jugut dhe në Afrikë. Çmimet e favorshme kontribuojnë për leverdishmërinë e vendburimeve më të varfra minerale, për riaktivizimin e minierave ekzistuese të mbyllura si dhe inicimin dhe zhvillimin e projekteve të reja.

Në analizën e përmbajtjes së metaleve në minierat e "Trepçës", është treguar prania e sasive të konsiderueshme të metaleve të çmuara dhe metaleve të tjera. Çmimet e përshtatshme të argjendit dhe të arit, kontribuojnë që derdhja e parave kesh të jetë relativisht e madhe dhe të sigurohen shkallë të larta interne të kthimit. Për rezultatet relativisht të favorshme ekonomiko-financiare të minierave të "Trepçës", kontribuon edhe kostoja relativisht e ulët e prodhimit, veçanërisht të shpenzimeve që duhen për fuqinë e punës. Sipas kostove të realizuara të prodhimit, minierat e "Trepçës" numërohen në grupin me kosto relativisht të ulëta për prodhim.

Në përkufizimin e parametrave të programit që përdoret në verifikimin e leverdishmërisë ekonomike të minierave, nisët nga supozimi se nuk do të ketë inflacion. Po ashtu, tatimi i përfitimit do të jetë 10% dhe se ai nuk do të ndryshojë gjatë dhjetë viteve të analizuara dhe se shteti nuk do të kërkojë koncesione (royalties) për shfrytëzimin e pasurive minerale. Duke pasur parasysh se minierat janë në fazë të nisjes së prodhimit, me vështirësi fillestare të pranishme dhe se nuk janë privatizuar, mund të supozohet se, për një afat të shkurtër, të tilla imponime nga ana e shtetit nuk do të vendosen. Kjo gjendje është e favorshme për investim në zhvillim dhe për modernizimin e minierave dhe fabrikave të pasurimit. Përndryshe, në botë koncesionet dhe imponimet e shteteve paraqesin një dispozitë të rëndësishme e cila në masë të madhe i determinon treguesit financiarë të kompanive.

Në vlerësimin e profitabilitetit dhe leverdishmërisë të minierave të caktuara, duhet që të merret parasysh edhe vlera e dollarit amerikan, ku vlerat ndërmjet valutave kanë luhatje dhe janë të paqëndrueshme. Përveç kësaj, vlera e kësaj valute e cila më shumë përdoret në pagesat e tregtisë ndërkombëtare, tregon një trend valutator zhvlerësimi, që kushtëzohet nga gjendja e ekonomisë amerikane dhe të deficiteve të saj të mëdha. Kjo nënkupton, se çmimet e plumbit dhe të zinkut mund të jenë jostabile, të shkaktuara si nga lëvizja e ofertës dhe e kërkesës, por edhe si rezultat i ndryshimeve të tregjeve valutore botërore dhe të vlerës së dollarit amerikan.

Në vazhdim do të tregohen të dhënat më të rëndësishme ekonomike dhe financiare për minierën e: Hajvalisë, Artanës, Badovci, Cërnacit dhe Stantërgut. Parametrat kryesorë hyrës janë të njëjta për të gjitha minierat, duke marrë parasysh specifikat të cilat janë të veçanta për secilën prej tyre. Më lartë u theksua, se përllogaritjet për leverdshmërinë do të bëhen mbi bazë të çmimeve mesatare të vitit 2010: Për plumbin 2.148,87 dollarë për ton, zinkun 2.161,39 dollarë ton, për argjendin 647,78 dollarë për një kilogram dhe arin 39.402,67 dollarë për kilogram.

Bazuar në të dhënat që janë paraqitur në grafik, mund të konstatohet se miniera e Hajvalisë gjatë periudhës dhjetëvjeçare të analizuar, mund të jetë rentabile me shkallë interne të kthimit (SHIK), me normë të përfitimit neto nga 76% dhe SHIK të neto derdhjeve të parave kesh prej 109%. Këto shkallë janë të realizueshme në kushte të debisë së përdorur me vlerë prej 18.900.000 \$, me afat për kthim prej dhjetë vitesh. Por, duhet që të kihet parasysh, se kjo minierë është e përmbytur dhe nevojiten riparime themelore për furnizim me pajisje dhe impiante të reja. Për shkak të vlerës së lartë të debisë, shpenzimet vjetore të parave kesh, vlerësohen si të mëdha, që do të pasqyrohen në vlerën e derdhjeve neto të parave kesh, në tërë periudhën e analizuar dhjetëvjeçare.




Fig.6.5-1. Rrjedha neto e parasë për minierën e Hajvalisë.

Mbi neto fitimin e realizuar dhe neto qarkullimin e parave kesh, ndikojnë përmbajtja e lartë e plumbit, zinkut dhe argjendit. Gjithashtu, ndikojnë edhe çmimet e leverdishme të këtyre metaleve. Është theksuar disa herë në këtë tekst, prania e arit në xeherorin e kësaj miniere. Po ashtu, prania e metalit të argjendit, paraqet një karakteristikë të rëndësishme e cila duhet që të merret parasysh gjatë procedurës për privatizimin eventual, pavarësisht nga gjendja aktuale e humbjeve të argjendit dhe humbjeve të arit 100%. Për shembull, vlera e metaleve të çmuara në xeheror në vitin e parë është vlerësuar në 6.591.291 dollarë për argjendin, ndërsa 3.171.915 \$ për arin. Ndërsa në vitin e dhjetë, 23.187.347 \$ për argjendin dhe 11.158.404 \$ për arin. Vlera e përgjithshme e metaleve në xeheror, në vitin e parë të periudhës punuese, vlerësohet 58.227.085 \$, ndërsa në vitin e fundit (vitin e dhjetë), gjatë rritjes së parashikuar vjetore të prodhimit prej 15%, vlera e metaleve në xeheror arrin 204.835.693 \$. Shkalla e shfrytëzimit të metalit në xeherorët e Hajvalisë, është vlerësuar 71,4%.

Përfitimi neto i kësaj miniere, bazuar në çmimet mesatare të vitit 2010, vlerësohet se do të arrijë 20.618.892 \$ në vitin e parë, me prodhim prej 80.500 tonë dhe do të arrijë 82.066.638 \$ në fund të periudhës, kur prodhimi duhet që të arrijë 283.189 tonë. Qarkullimi i parave kesh është pozitiv pas vitit të dytë dhe do të rritet me shkallë relativisht të lartë, gjatë tërë periudhës së analizuar. Flukset e mëdha të mjeteve monetare që realizohen në kushte të shpenzimeve të konsiderueshme për pagimin e debisë, përkundër neto përfitimit pozitiv, paraqesin një karakteristikë veçanërisht pozitive për minierën e Hajvalisë.

Zakonisht kostot e ulëta të prodhimit kushtëzojnë rezultate pozitive ekonomike dhe financiare edhe kur janë çmimet e ulëta të metaleve. Kështu, gjatë simulimit të çmimeve prej 800 \$ për plumbin dhe për zinkun, gjatë vitit të parë dhe prodhimit prej 80.500 tonë xeheror, miniera mund të realizojë fitim neto prej 94.418 \$ gjatë vitit të parë, ndërsa flukset pozitive neto të mjeteve monetare, do të realizoheshin me çmimin e këtyre metaleve prej 1.300 \$ që parashikohet gjatë vitit të tretë të kësaj periudhe. Këto rezultate tregojnë se gjatë nivelit konstant të kostos së prodhimit, miniera e Hajvalisë mund t'iu përballoj ndryshime më të mëdha të uljeve së çmimeve të metaleve themelore.

Vlera aktuale neto (VAN) e përfitimit, të përlllogaritur neto gjatë periudhës prej dhjetë vitesh, do të jetë nën ndikim të inflacionit, shkallëve të kamatave dhe rreziqeve të tjera sistematike dhe josistematike. Fitimi neto i marrë është diskontuar me shkallët 8%, 10%, 12% dhe 16%. Duke pasur parasysh rreziqet që janë të pranishme në industrinë e minierave si dhe marrëdhëniet e pazgjydhura pronësore-juridike në "Trepçë", në relacion me pjesën veriore të ndërmarrjes, konsiderojmë se 12% është shkalla më përkatëse e diskontuar. Në pajtim me këtë shkallë, VAN, në neto prodhimin e minierës Hajvalia e cila do të realizohet gjatë dhjetë viteve, arrin 161.525.847\$.

Treguesit ekonomik-financiare për punën e minierës së Artanës- gjatë analizimit të periudhës dhjetëvjeçare, janë pozitive, me shkallë intence të rendimentit (SHIR) të neto prodhimit prej 64% dhe SHIR të fluksit të neto mjeteve monetare prej 84%. Miniera është operative edhe për modernizimin e saj është parashikuar përdorimi i një debie me vlerë prej 2.000.000 \$, e cila duhet që të kthehet në një afat prej shtatë vitesh. Duke marrë parasysh vlerën e ulët të debisë, shpenzimet vjetore të mjeteve monetare për pagesa vlerësohen si relativisht të ulëta.

Kjo minierë ka në dispozicion përmbajtje të ngjashme të metalit të plumbit dhe të zinkut, që nënkupton se ndryshimet e çmimeve të këtyre metaleve do të kenë ndikim jo të barabartë në të ardhurat nga shitja. Përmbajtja e argjendit në xeheror, vlerësohet si mbi mesataren, kështu që në vitin e parë, vlera e argjendit arrin 2.399.194 \$, ndërsa në vitin e dhjetë, vlera e këtij metali do të arrijë gjithsej 8.440.068 \$. Shkalla e shfrytëzimit të metalit në xeheror arrin 77,4%.

Përfitimi neto të cilin do të realizojë miniera në vitin e parë është pozitiv dhe është vlerësuar në 2.347.838 \$, ndërsa në vitin e dhjetë 9.722.815 \$. Të ardhurat neto të mjeteve monetare (parave kesh), janë pozitive në vitin e dytë dhe ka rritje me shkallë të larta vjetore gjatë periudhës së analizuar, kështu që në vitin e dhjetë, do të arrijë 208.921.959 \$. Vlerësimet paraprake për përfitimin e mundshëm të realizuar neto dhe qarkullimin neto të mjeteve monetare, tregojnë se miniera është profitabile dhe se ka flukse të mëdha të mjeteve monetare.




Fig.6.5-2. Rrjedha neto e parasë për minierën e Artanës.

Ngjashëm sikur te miniera e Hajvalisë edhe në këtë minierë, kostot relativisht të ulëta të prodhimit, kontribuojnë që të realizojnë rezultate pozitive financiare edhe me çmime të ulëta. Megjithatë, përmbajtja më e ulët e plumbit dhe e metalit të zinkut janë përcaktuesit kryesor të rezultateve më të dobëta financiare. Sipas simulimit të bërë, gjatë kostove fikse, kjo minierë do të realizojë përfitim pozitiv neto në vitin e parë, me çmime të plumbit dhe të zinkut me nga 1.100 \$, ndërsa flukset neto të parave kesh në vitin e dytë vlerësohet në të dy metalet bazë nga 1.700 dollarë. Neto vlera aktuale (NVA) e neto përfitimit në Artanë, e cila do të mund të realizohet gjatë periudhës së analizuar, me zbatimin e shkallës diskonte nga 12%, do të arrijë 17.839.632 dollarë. Duke pasur parasysh, se kushdo që do ta shfrytëzoj këtë minierë, afati i kthimit të parave shkon në shtatë vjet. NVA – ja në fund të vitit të shtatë, me zbatimin e së njëjtës shkallë diskonti, është vlerësuar në 10.599.906 dollarë. Miniera e Badovcit është jo operative dhe për vënien në punën të saj, nevojitet një investim relativisht më i madh, 12.000.000 dollarësh. Shkalla interne e kthimit (SHIK) për periudhën prej 10 vitesh, të neto-fitimit, është vlerësuar në 36%, ndërsa SHIK-u të flukseve neto të parave kesh, është vlerësuar në 56%. Investimet e larta, në kushte të përmbajtjes mesatare të metaleve themelore si dhe përmbajtja mbi mesataren e argjendit, janë përcaktuesit bazë të SHIK-it më të ulët të neto-fitimit dhe të neto-flukseve të mjeteve monetare.




Fig.6.5-3. Rrjedha neto e parasë për minierën e Badovcit.

Bazuar në koston e prodhimit, miniera do të realizojë fitim neto-pozitiv gjatë rritjes së prodhimit, me vlerë prej 4.128.954 dollarë në vitin e parë, ndërsa në vitin e dhjetë gjatë rritjes së prodhimit prej 15% në vit, neto-fitimi

arrin 21.866.826 dollarë. Shkalla e shfrytëzimit të metaleve në xeheror, arrin 88,3 %. Si rezultat i debisë së përdorur dhe shpenzimeve të bëra, flukset neto të parave kesh kanë qenë pozitive që në vitin e tretë, me vlerë prej 7.169.759 dollarë.

Në vitet vijuese, flukset e mjeteve monetare do të rriten me shkallë relativisht të lartë, për të arritur 415.688.921 dollarë në vitin e fundit, (vitin e dhjetë). Miniera e Badovcit do të ishte profitabile edhe në kushte të uljes së konsiderueshme të çmimeve të plumbit dhe zinkut. Në pajtim me simulimin e bërë, miniera do të realizojë neto-fitim pozitiv në vitin e parë, me çmim të plumbit dhe të zinkut prej 1.200 dollarësh, ndërsa neto të ardhurat e mjeteve monetare do të ishin pozitive në vitin e dytë me çmim prej 1.650 dollarë. HCB e përfitimit neto që do të realizohet gjatë punës dhjetëvjeçare, me zbatimin e shkallës diskonte prej 12%, vlerësohet në 29.719.134 dollarë.

Miniera e Belloberdës është operative, kështu që investimet në rikonstrukcion janë relativisht të vogla. Debia më e vogël (2.000.000 dollarë) me afat për kthim prej shtatë vjetësh, me përmbajtje mbi mesataren e metalit të plumbit dhe të zinkut. Këto së bashku me përmbajtjen e volitshme të argjendit, kontribuojnë për shkallën relativisht të lartë të SHIK, të përfitimit neto prej 84% dhe të flukseve neto të parave kesh prej 112%. Vlerat relativisht të ulëta të pagesave të debisë, do të nënkuptojnë shpenzime më të mëdha të parave kesh, që kontribuojnë në flukset e mëdha të neto-mjeteve monetare gjatë tërë periudhës së analizuar.




Fig.6.5-4 Rrjedha neto e parasë për minierën e Belloberdës.

Vlera e metaleve në xeheror vlerësohet në 12.555.407 dollarë në vitin e parë, me prodhimtari vjetore prej 55.200 ton xeheror, ndërsa në fund të periudhës 44.168.370 dollarë me prodhimtari vjetore prej 194.187 tonë. Shkalla e shfrytëzimit të metalit në xeheror, arrin 77,6%. Për shkak të shpenzimeve relativisht të vogla të parave kesh për pagimin e debisë, flukset neto të parave kesh janë pozitive në vitin e dytë, ndërsa në fund të periudhës së analizuar arrijnë 424.352.899 dollarë. Neto-fitimi në vitin e parë është vlerësuar në 4.692.543 dollarë në vit, ndërsa në vitin e dhjetë do të arrijë 18.466.075 \$. Simulimi i çmimeve, tregon se miniera e Belloberdës do të realizojë përfitim pozitiv neto, në vitin e parë të prodhimit në vlerë 1.200 dollarë, për plumbin dhe për zinkun, ndërsa flukset neto të parave kesh do të ishin pozitive në vitin e dytë, me çmime prej 1.500 dollarësh, për të dy metalet themelore. Neto Vlera Aktuale (NVA) e përfitimit neto, me zbatimin e shkallës diskonte prej 12% për dhjetë vite, do të arrijë 36.736.022 dollarë, ndërsa për shtatë vite, sa është edhe afati për kthimin e kredisë, përfitimi neto i diskutuar me të njëjtën shkallë do të arrijë 18.512.183 \$.

Miniera e Cërnacit, po ashtu bën pjesë në radhën e minierave aktive. Investimet për rikonstruksion dhe modernizim parashikohen të arrijnë 3.400.000 \$, me afat të kthimit të debisë për shtatë vjet. Shkalla interne e kthimit (SHIK) e fitimit neto do të arrijë 85%, ndërsa SHIK e fluksit neto të parave kesh, gjithashtu është e lartë dhe e vlerësuar në 112%.

Në thelb, aranzhimi lizing ndahet në: 1) lizing financiar, ku paraqiten tre pjesëmarrës, në kompani lizingu të specializuar, bankë ose institucion tjetër financiar, 2) Lizing operativ, në të cilin paraqitet vetëm dhënësi dhe përdoruesi i lizingut dhe 3) Shitja me lizing të rikthyeshëm, ku përdoruesi përkundër mjetit ka nevojë edhe për mjete monetare shtesë.

Sipas lëndës së lizingut, në thelb, ekzistojnë tre lloje aranzhimesh: 1) Lizing të impianteve dhe fabrikave (plant leasing), ku lëndë e marrëveshjes janë impiantet e fabrikave apo pjesë të tyre, depo, kapanone, dyqane etj, 2) Lizing i pajisjes (equipment leasing), ku lëndë e marrëveshjes janë makineritë, pajisjet, aparatet, sistemet kompjuterike etj. 3) Lizing së të mirave materiale që shpenzohen, ku lëndë e marrëveshjes janë automjetet, pajisjet për ftohje, video dhe teknikë e ngjashme.

Lidhur me kohën e zgjatjes së aranzhimit lizing, në praktikë paraqiten: 1) Lizing me afat kohor ku pas skadimit të afatit të dakorduar, marrëveshja nuk është më e vleshme dhe përdoruesi duhet që patjetër t'i kthejë mjetet e marra në lizing, 2) Lizingu me të drejtë të blerjes, ku pas skadimit të afatit të dakorduar, përdoruesi ka të drejtë që të blejë mjetin e marrë në lizing, 3) Lizingu i hapur ku marrëveshja në mënyrë automatike vazhdohet nëse një nga palët e dakorduara në afatin e përcaktuar nuk paralajmëron përfundimin e marrëveshjes.

Si mangësi të lizingut janë: është relativisht mënyrë më e shtrenjtë për financim, duke pasur parasysh ekzistimin e rrezikut që projekti të jetë i suksesshëm, mundësinë nga ndryshimi i shkallëve të kamatave për lizing, mundësinë për ndryshim të vlerës ndërvalutore të marrëveshjes, duhet që të paguajë provizion për anulimin e përkohshëm të aranzhimit, diskrepionit të detyrimeve për mbulimet e sigurimit të garantuar, shpenzimet për sigurim, përdoruesi nuk është pronar i mjetit, si dhe jo ekuilibrimi i palëve gjatë lidhjes së marrëveshjes.

Mungesa e madhe e mjeteve për investime kapitale, e bën lizingun tërheqës për financimin e zhvillimit të "Trepçës". Lizingu si mënyrë për financimin në sektorin minerar, mund të përdoret si nga ana e kompanive të mëdha ashtu edhe nga kompanitë e vogla. Nga të gjitha motivet e përmendura më lart për përdorimin e aranzhimeve lizing, në rastin e "Trepçës", më i rëndësishëm do të jetë aspekti investues, respektivisht, mundësia që të merren në lizing pajisje dhe impiante. Për shembull, ai është veçanërisht një instrument i përshtatshëm për financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë, që do të paraqiteshin si nën-kontraktues përcjellës të ndërmarrjes. Në botë janë të shumta dukuritë, që kompanitë e mëdha, që zakonisht i kanë të drejtat për veprimtari minerare, të angazhojnë shumë kompani më të vogla për kryerjen e aktiviteteve të caktuara.

Sipas rregullit, kompanitë nën-kontraktuese kanë nevojë për makineri të shumta për kryerjen e punëve. Këto makineri, kompanitë nën-kontraktuese, në të shumtën e rasteve i marrin në lizing, duke pasur parasysh çmimin e lartë, i cili duhet që të paguhet për furnizimin e tyre. Përparësia e mënyrës së tillë të financimit të furnizimit të pajisjeve, është që të merren makineri të reja, të shtrenjta, por edhe moderne, me efektivitet të lartë, për furnizimin e të cilave, përdoruesit zakonisht nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare. Lizingun e bën tërheqës edhe fakti që është siguruar mirëmbajtja dhe zëvendësimi i pjesëve rezervë për pajisjet moderne.

7.1.4. Kredi malli

Mënyra plotësuese e furnizimit dhe pagimi i cili përdoret në tregtinë ndërkombëtare paraqet shkëmbim të mallrave (kundër-tregti). Shkëmbimi i mallrave bëhet kur një firmë pranon diçka tjetër (prodhime ose shërbime), e jo para, për pagimin e të mirave dhe shërbimeve të saj. Kjo formë e shkëmbimit ndërkombëtar bëhet si trambë, ndërsa sot jemi dëshmitarë të aranzhimeve të shumta ndërkombëtare tregtare. Në këto aranzhime bëjnë pjesë: kompensimet, buy-back, offset purchase, tregti reciproke, variante financiare-ndërmjetësuese, të aranzhimeve të lidhura etj. Sipas vlerësimeve të bëra, marrëveshja për shkëmbimin e mallrave përfshin 15-20% nga shkëmbimet botërore edhe pse disa vlerësime arrijnë madje 40%. Marrëveshjet e mallrave janë të rëndësishme për vendet që kanë mungesë të valutave konvertibile dhe përdoren si mjete për uljen e derdhjes së valutave të huaja konvertibile të çmuara, që ka vendi në dispozicion. Shkëmbimi i mallit bëhet si rezultat i pagimit të vështirësuar të importit të shkaktuar nga kufizimi i valutave dhe mungesa e valutave konvertibile, para së gjithash në vendet ish-socialiste dhe vendet në zhvillim. Globalizimi ndërkohë, nxiti disa forma të shkëmbimit të mallrave, që sot përdoren gjerësisht në tregtinë ndërkombëtare. Korporatat multikombëtare, gjithashtu i përdorin aranzhimet e mallrave që të hyjnë në tregje të reja, ndërsa qeveritë e disa vendeve insistojnë në një vëllim të caktuar të shkëmbimit të mallrave, që korporatat ndërkombëtare duhet ta realizojnë që të hyjnë në tregun e vendit. Megjithatë, duhet të merret parasysh se aranzhimet e mallrave janë të ndërlikuara dhe mund të krijohen probleme gjatë negociatave, ose gjatë procesit të realizimit.

Për ndërmarrjen "Trepça" dhe ekonominë e Kosovës, shkëmbimi i mallrave ofron përparësi më tepër, të cilat pavarësisht nga ndërlikimi në këtë mënyrë të shkëmbimit ndërkombëtar, duhet që të merret parasysh dhe të shfrytëzohen. Ndërmarrja "Trepça" ndodhet në fazën e rinovimit dhe riaktivizimit të kapaciteteve, që për një kohë të gjatë nuk ishin në funksion. Në kushte të shkallës relativisht të ulët të prodhimit, pajisjeve të vjetruara dhe amortizuara, të akumulimit të vogël të valutave, punët kompensuese paraqesin një variant specifik të këmbimit të mallrave në shkallë ndërkombëtare. Ky këmbim përbëhet nga këmbimi direkt i prodhimeve dhe shërbimeve pa ose me pjesëmarrje shumë të vogël të parave, që nënkupton se është i lidhur me zgjidhjen e problemeve të kufizimeve valutore dhe mungesës së valutave konvertibile.

Forma e mëtejshme e këmbimit të mallrave është kompensimi me prodhimet e marra nga pajisjet ose teknologjia (buy-back) ose aranzhimi kompensues, kur një firmë shet mallra kapitale në një formë tjetër, ndërsa kjo është e

kompensuar me prodhimin e realizuar si rezultat i këtij aranzhimi. Për arsye se e lidh pagimin me prodhimin nga mallrat e shitura, ky lloj pagimi është veçanërisht i përdorshëm kur blerësi i prodhimeve ka nevojë që eksportuesi të sigurojë shërbimet e domosdoshme, siç është mirëmbajtja e makinerive ose dhënia e instruksioneve se si të përdoren pajisjet, etj. Ky model këmbimi mund të përdoret në "Trepçë", për furnizimin e pajisjeve dhe impianteve, ndërsa duke pasur parasysh, se në kushte të mungesës së devizave, pajisjet e domosdoshme dhe impiantet, do të paguhen me eksportin e koncentratit.

Format e ndryshme të kredive të mallrave ofrojnë më shumë favorizime për zhvillimin e ndërmarrjes "Trepça". Nevoja e kredive të mallrave është një formë e favorshme e nxitjes të zhvillimit të "Trepçës", duke pasur parasysh eksportin e koncentratit në tregjet e huaja konvertibile. Kompanitë multikombëtare dhe kompanitë e mëdha që paraqiten në cilësinë e eksportuesve të koncentratit të plumbit dhe zinkut, do të kenë interes që ta përdorin kreditimin e mallrave në vend të pagesës, me para kesh për sasitë e furnizuara të koncentratit.

Për "Trepçën" kjo nënkupton një mundësi për të blerë pajisje dhe impiante pa u ngarkuar bilanci i parave kesh dhe të vejë në rrezik likuidimin dhe aftësitë paguese. Këtu duhet që të merren parasysh edhe përparësitë tjera nga përdorimi i instrumentit të kredive dhe mallrave, që lidhen me shpenzime të ulëta, problemet me debitimin që mund të paraqiten te kreditimi, kufizimet e ndryshme që mund të vendosin bankat dhe kreditorët tjerë, lidhur me përdorimin e mjeteve, kontrollin etj.

7.1.5. Investime e huaja direkte

Lëvizjet e kapitaleve private ndërkombëtare, janë përcaktuar nga forca të caktuara dhe jo gjithmonë janë rezultat i pozicioneve të pagesave bilancore të vendeve të veçanta. Karakteristikë është, që transaksionet ndërkombëtare kapitale rriten në mënyrë të konsiderueshme nga transaksionet "reale" vijuese. Kështu, qarkullimi i përgjithshëm ditor në tregjet botërore të kapitalit dhe valutave, janë 20 herë më të mëdha nga vëllimi i transaksioneve tregtare ditore dhe transaksioneve të tjera vijuese. Kjo lloj gjendje, tregon se lëvizja ndërkombëtare e kapitalit zhvillohet në mënyra anonime, ndërsa si pasojë e forcave individuale lëvizëse. Si rezultat i kësaj autonomie, lëvizjet ndërkombëtare të kapitalit, d.m.th. debitë e dhëna ose themelimi i ndërmarrjeve jashtë vendit, shkaktojnë lëvizje induktive dhe të kompensuar të mallrave, ndërsa me valutat e marra prej tyre, paguhen debitë ose shpenzimet e kapitaleve të investuara nga investuesit e huaj.

Tregu financiar ndërkombëtar shënon ndryshime tepër të shpejta dhe shkallë të etjes. Në zhvillimin e këtij tregu ndikoi veprimi i disa organizatave ndërkombëtare, fillimisht i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), si dhe zhvillimi i përgjithshëm i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe tregtisë të nxitur nga Organizata Botërore e Tregtisë (OBT). Tregu ndërkombëtar financiar, gjithashtu është faktor dhe rezultat i procesit të globalizimit të ekonomisë botërore. Tregu financiar ndërkombëtar, krijon kushte për lokacion proporcional të parave dhe të kapitalit, në kuadër të ekonomisë botërore. Konsiderohet se kapitali paraqet faktorin më mobil të prodhimit.

Investimet e huaja direkte (IHD) paraqesin një formë të tillë të investimit, me të cilën ndonjë ndërmarrje merr kontrollin individual ndaj ndonjë tjetre. Këto janë forma të lëvizjes ndërkombëtare të kapitalit, por duke pasur parasysh kontrollin mbi ndërmarrjen në të cilën investohet, duke përfshirë në mënyrë të konsiderueshme disa elemente nga lëvizja e zakonshme e kapitalit ndërkombëtar. Rritja e shpejtë e IHD-së, në masë të madhe lidhet me aktivitetin e korporatave ndërkombëtare të vendeve të zhvilluara, ku në pjesën më të madhe ato janë lokuar. Vlerësohet se korporatat ndërkombëtare kontrollojnë rreth 90% nga lëvizja ndërkombëtare e kapitalit dhe rreth 80% nga transferi ndërkombëtar i teknologjisë, dijeve dhe përvojës. Në krijimin e prodhimit botëror shoqëror, marrin pjesë rreth 40%, ndërsa rreth gjysma e eksportit dhe importit realizohet me regji të këtyre korporatave.

Ekspansioni ndërkombëtar përmes IHD-së paraqet alternativë të zhvillimit të ndërmarrjeve në tregun e vendit. IHD-ja paraqet një zonë tepër të gjerë të përcaktimit strategjik, në marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare. Në literaturë hasen pesë dilema bazë strategjike gjatë vendimit, siç janë: 1) A duhet dhe ku duhet të investohet, 2) Mënyra e realizimit të investimit direkt, 3) Veprimtaria dhe drejtimi zhvillimor i IHD-së, 4) Shtrirja e IHD-së dhe 5) Shkalla e pavarësisë juridike të subjektit afarist jashtë vendit.

IHD-ja horizontale paraqet investim në vend të huaj në të njëjtin aktivitet ekonomik dhe industrial të ndërmarrjes, të vendit organizator. Me këtë përhapet e njëjta veprimtaria jashtë nga kufijtë e vendit. IHD-ja vertikale paraqet investim direkt në shkallë të ndryshme të aktiviteteve me faza të ndryshme të krijimit ndërkombëtar të vlerave. IHD-ja konglomerike paraqet investime në mallra, të cilat nuk përputhen me asortimentin e firmës të vendit organizator. Investimet kanë të bëjnë me aktivitete të reja dhe të pavarura, me të cilat korporatat ndërkombëtare e zgjerojnë veprimtarinë e tyre, me hyrje në degë të reja dhe veprimtari të reja, të cilat nuk kanë asnjë lidhje me aktivitetin ekzistues.

Motivet për IHD janë të shumanshme:

Një nga metodat kryesore paraqet përvetësimi i tregjeve të reja. Kjo ndodh kur zhvillimi i ndërmarrjes është i kufizuar në vend, qoftë për shkak të konkurrencës së fortë, ose për shkak të përfitimit të kënaqshëm. Kuptohet se hyrja në vendet dhe në tregjet e huaja, do të varet nga ekzistimi i barrierave dhe i faktorëve të tjerë kufizues. Ky motiv do të shprehet në zhvillimin e industrive shoqëruese, të cilat mbështeten në veprimtarinë bazë të "Trepçës".

- Hyrje në tregje ku do të realizohen përfitime më të larta. Kur korporata ndërkombëtare do të vlerësojë se në tregje dhe në vende të tjera mund të realizohet një përfitim më i lartë, ajo e shet biznesin dhe vendoset në vendin me çmime më të larta. Këtë motiv mund ta gjejnë korporatat ndërkombëtare për investim në "Trepçë", ndërsa kjo, në masë të madhe do të varet nga rregullativa dhe klima afariste në vend.
- Përdorimin e përparësive nga ekonomia në vëllim. Me vëllim më të madh të prodhimit dhe të shitjeve, korporatat ndërkombëtare realizojnë përfitime më të mëdha, si rezultat i çmimeve më të ulëta mesatare, sipas një njësie prodhimi. Ky motiv, në rastin e "Trepçës" mund të shfaqet te industritë përcjellëse që mund të zhvillohen me veprimtarinë bazë.
- Shfrytëzimi i faktorëve të huaj të prodhimit. Për shembull, çmimi i forcës së punës dhe çmimi i truallit, mund të kenë dallim të madh në vende të veçanta. Sot jemi dëshmitarë të zhvendosjeve të shumta të kapaciteteve, së korporatave ndërkombëtare, në vendet të cilat kanë çmim më të ulët të punës. Ky motiv mund të paraqesë një nga më të rëndësishmit gjatë vendim-marrjes të korporatave të huaja që të investojnë në "Trepçë".
- Shfrytëzimin e pasurive të lëndëve të para dhe pasurive të tjera natyrore të vendit nikoqir. Për shkak të shpenzimeve të larta të transportit, korporatat ndërkombëtare mund të investojë në vende të pasura me minerale dhe të organizojë prodhimin e mallrave të gatshme mbi bazën e mineraleve ekzistuese. Ky motiv, gjithashtu mund të paraqitet gjatë zhvillimit të veprimtarisë bazë dhe asaj përcjellëse të "Trepçës".
- Shfrytëzimin e teknologjive të huaja. Të njohura janë rastet e blerjes së kompanive në vendin e huaj me qëllim të vetëm që të përvetësohet teknologjia e cila tashmë është e zhvilluar dhe e vërtetuar. Kjo teknologji mund të përdoret për zhvillimin e njëjësive afariste individuale dhe filialeve në vende të tjera, ku korporata ndërkombëtare është e pranishme.

- Shfrytëzimi i përparësive monopoliste. Në rastin kur një korporatë ka përparësi të konkurrencës teknologjike dhe këtë përparësi me sukses e ka shfrytëzuar në tregun lokal, mund ta shfrytëzojë edhe në vendet e tjera përmes ndërtimit të një ndërmarrje të re, bashkimit ose ndërmarrjes së ndonjë firme ekzistuese në vendin ku qëndron. Ky motiv mund të jetë interesant për korporatat ndërkombëtare duke pasur parasysh se tregu në Kosovë është i vogël dhe i përshtatshëm për realizimin e pozicionit monopol.
- Përshtatjen e ndryshimeve të kurseve valutore. Nëse valuta e ndonjë vendi është nënvlerësuar, ky mund të jetë motiv që korporata ndërkombëtare të investojë në një vend me një valutë të tillë duke pasur parasysh shpenzimet relativisht më të ulëta. Përveç kësaj, korporata ndërkombëtare mund të ndërmarrë hapa duke u udhëhequr nga tendenca ndërvalutore e ndonjë valute ose nga rezultati i luhatjeve së vlerës së valutave. Në Kosovë si valutë përdoret euro. Duke pasur parasysh se tregtia e plumbit dhe zinkut, në masë të madhe realizohet në dollarë amerikanë, tendenca e uljes së vlerës të dollarit kundrejt valutave tjera, duhet që të merret parasysh gjatë kalkulimeve ekonomike, për leverdishmërinë për një afat kohor mestar dhe për një afat kohor të gjatë.
- Reagimi i restrikteve tregtare. Në disa raste, korporatat ndërkombëtare i përdorin IHD-të si strategji defansive. Për shembull, një korporatë ndërkombëtare investon në një vend të huaj për shkak të ekzistimit të barrierave tregtare për eksportin e prodhimeve të saj.
- Diversifikimi ndërkombëtar- Me një diversifikim më të madh dhe me praninë e disa vendeve, korporata ndërkombëtare mund të realizojë flukse më stabile të mjeteve monetare në krahasim me atë, nëse shet vetëm në një vend.

Vendi në të cilin bëhen IHD-të, ballafaqohet me disa rreziqe të ndryshme. Ato grupohen në rreziqe lidhur me sovranitetin dhe pavarësinë e vendit që pranon investime të huaja direkte. Prandaj, duhet parë se cili do të jetë ndikimi ndaj konkurrencës dhe kontrollit tregtar dhe si do të jetë ndikimi ndaj gjendjes së bilancit të pagesave për vendin pranues. Në të kaluarën, ekzistonte rregullativë restriktive për IHD-të, që ka qenë pasojë e frikës nga prishja e sovranitetit dhe pavarësisë së vendit pranues së investimit. Sot mbizotëron një frikë pozitive lidhur me IHD-të, duke qenë kështu dëshmitarë për të gjitha vendet, pavarësisht nga zhvillimi dhe madhësia, të konkurrojnë në tërheqjen e kapitalit dhe teknologjisë së huaj. Për këtë arsye, shtrohet pyetja e prejardhjes së kapitalit (të huaj apo të vendit), duke mbizotëruar qëndrimi se çfarë

rezultate arrihen dhe sa është dobja prej tyre. Vendet pjesëmarrëse në IHD-të janë të interesuara për realizimin e një kontrolli sa më të madh të mundshëm dhe përdorimit më të mirë të rezultateve dhe efekteve prej këtyre investimeve.

Efektet e IHD-ve mbi gjendjen e bilancit të pagesave janë veçanërisht interesante për "Trepçën" dhe për ekonominë e Kosovës

Megjithatë, duhet pasur parasysh se derdhja e kapitalit në vend dhe efektet pozitive ndaj bilancit të pagesave, mund të sillen në pikëpyetje në dy mënyra: Fillimisht, përmes transfertës tej mase të përfitimeve jashtë vendit, si dhe për shkak të furnizimit tej mase (importit) të pjesëve, lëndës së parë dhe repromaterialeve. Këto dukuri negative mund të ulen me vendosjen e kufizuar të transfertës së përfitimeve, detyrimin që një pjesë e prodhimeve, lëndëve të para dhe repromaterialeve të merren në vend, si dhe me vendosjen e detyrimit për ri- investimin e një pjese nga përfitimi.

Këtu më poshtë, theksohen faktorët që ndikojnë në kompletimin e buxhetit për projektet ndërkombëtare:

- Flukset e mjeteve monetare të firmës amë, duhet që të jenë të ndara nga mjetet monetare të projektit. Secila prej këtyre flukseve të mjeteve monetare, kontribuojnë për lloje të ndryshme të vlerës;
- Shpesh herë, flukset e mjeteve monetare të firmës amë, rrjedhin nga financimi. Kjo nënkupton se nuk mund të ndahen mjetet monetare nga financimi, kështu që, kjo mund të bëhet te buxheti kapital i vendit;
- Fluksi i mjeteve monetare nga investimi i filialit të huaj, mund të ndërmerret pjesërisht ose tërësisht nga ndonjë filial tjetër, që mund të rezultojë me atë që projekti është me leverdi për vetë filialin, por kjo nuk kontribuon në flukset e tërësishme të mjeteve monetare të korporatës ndërkombëtare;
- Firma amë, mund t'i riorientojë të ardhurat, duke i përdorur dallimet në sistemet tatimore, kufizimet legale dhe politike ndaj lëvizjeve të fondeve, rregullat lokale të biznesit si dhe dallimet në funksionimin e tregjeve dhe institucioneve financiare;
- Pagesat e shumta jo financiare, mund të gjenerojnë flukse të mjeteve monetare nga filialet, kundrejt firmës prind, duke përfshirë pagesat e licencave dhe pagesat për import të firmës amë;
- Menaxherët duhet që të jenë të ndërgjegjshëm për shkallët e ndryshme të inflacionit në vende të caktuara, duke pasur parasysh ndikimin e tyre ndaj pozitës konkurrense dhe flukseve të mjeteve monetare;
- Menaxherët duhet t'i kenë gjithmonë parasysh pasojat nga ndryshimet e kurseve valutore, duke pasur parasysh ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë mbi flukset lokale të mjeteve monetare, si dhe ndaj pozitës konkurrense të filialit;

- Përdorimi i tregjeve kapitale të segmentuara, mund të krijojë përparësi, por edhe shpenzime të paparashikueshme;
- Menaxherët duhet gjithmonë t'i vlerësojnë rreziqet e mundshme politike duke pasur parasysh pasojat;
- Vlera përfundimtare (likuiduese), është shumë vështirë që të konfirmohet, për shkak të mundësisë së involvimit të disa palëve (vendeve) ose të sektorit publik.

Për "Trepçën" është interesante hyrja e IHD-ve përmes bashkimit (akuzimit) të ndërmarrjeve, përkatësisht, të një pjese të kapaciteteve nga ana e korporatës së huaj. Ky lloj bashkëpunimi është një formë e njohur e IHD-ve (rreth 70-80% nga investimet e përgjithshme të këtij lloji). Në rastin e akuizimit të ndërmarrjes, filiali ose njësia afariste, e vazhdon ekzistimin në kushte të një identiteti të ri të ndryshuar dhe të zgjeruar, sepse me këtë proces, ndërmarrja lokale fiton vetëm pronar dhe menaxhment të ri. Menaxhmenti kryesor, përmes realizimit të strategjisë, kryen bashkimin e dy ose më tepër korporatave të ndara dhe të pavarura ndërkombëtare. Një pronësi e plotë mund të vijë edhe përmes investimeve të përbashkëta të domosdoshme, me blerjen e pjesës tjetër të partnerit të përbashkët.

Strategjia e bashkimit me blerjen e kompanisë ekzistuese në tregun ndërkombëtar, në kushte të respektimit të nevojave institucionale dhe dispozitave afariste, ka më tepër përparësi. Përvoja e vendeve në tranzicion dhe privatizimi, tregoi shembuj të shumtë të zbatimit të strategjisë së blerjes ose akuizimit nga ana e korporatave të njohura ndërkombëtare të vendeve të zhvilluara. Kështu që, për blerje, zgjidhen firma të cilat kanë mjete dhe resurse të konsiderueshme të përpunuara dhe të përdorura më parë. Kjo zbatohet me qëllim që të avancohet puna në ndërmarrjen e blerë, përmes transferimit të teknologjisë, kapitalit, aftësive menaxhuese dhe atyre të marketingut. Në rastin e "Trepçës", interesi i korporatave ndërkombëtare është në përdorimin e resurseve minerale dhe në mundësinë për zhvillimin e mëtejshëm, me avancimin dhe zgjerimin e aktivitetit (uzina për shkrirje dhe kapacitete të përpunimit). Praktika ndërkombëtare lidhur me akuizimet, me rregull, është negative. Ekzistojnë disa raste të ndërmarrjes së firmave, të cilat me akuizim janë më pak të suksesshme. Vlerësohet se vetëm një e treta e akuizimeve realizon rezultate të favorshme afariste, një e treta është në gjendje të mirëmbajtjes (riprodhim të thjeshtë), ndërsa një e treta punon me humbje. Arsytet për dështimin relativ të akuizimeve janë të shumta dhe duhet që të kërkojnë në mbivlerësimin e vlerës së firmës së blerë, problemet e fshehura afariste, përplasjen e kulturave kombëtare dhe afariste, harmonizimin burokratik si dhe mbrojtjen parandaluese joadekuate.

Për investimet grinfild të huaja, nevojiten disa supozime siç janë: kompania të ketë forca dhe resurse që në mënyrë të pavarur ta ndërtojë kapacitetin, ta njohë mirë tregun lokal, problemet infrastrukturore dhe kulturore. Përparësitë e investimeve greenfield janë në kontrollin e tërësishëm mbi firmën e re, mbrojtjen e përparësisë teknologjike, rrjetëzimin korporativ, decentralizimin e centralizuar dhe shmangien e përplasjes së kulturave. Mangësitë bazë të investimeve të tilla janë në shpenzimet e mëdha dhe rrezikun e lartë, me të cilat do të ballafaqohet investitori i huaj.

7.1.6. Investimet e përbashkëta

Formë të veçantë e investimeve direkte paraqesin investimet e përbashkëta (joint venture), të cilat janë një bashkëpunim afarist afatgjatë i partnerëve, nga vende të ndryshme, me qëllim, investimin e përbashkët të mjeteve dhe ndarjen e përfitimit, organizimin e prodhimit dhe ndarjen e përbashkët të rrezikut. Karakteristika bazë e këtyre investimeve është bashkëpunimi afarist me karakter afatgjatë, në të cilin partnerët marrin pjesë nga vende të ndryshme, mbi bazën e investimeve të përbashkëta të mjeteve.

Investimet e përbashkëta paraqesin një formë specifike të investimeve direkte, në të cilat pronari i kapitalit menaxhon me mjetet e investuara dhe kujdeset për përdorimin e tyre, ndërsa madhësia e përfitimit varet nga rezultatet e realizuara në punë. Për dallim nga investimet klasike direkte, në këtë rast, pronari i kapitalit nuk paraqitet në mënyrë të pavarur, por në bashkëpunim me partnerin nga vendi.

Pjesëmarrësit në tregjet ndërkombëtare të kapitalit, gjatë miratimit të vendimeve janë motivuar nga interesat e tyre afariste si ndërmarrjet, bankat, institucione tjera financiare, organe shtetërore, organizata ndërkombëtare ekonomiko-financiare dhe individë. Të gjitha këto subjekte juridike dhe fizike, në varësi nga qëllimet e themelimit dhe ekzistimit të tyre, kanë motive pronësore, sipas të cilave udhëhiqen gjatë vendim-marrjes për lëvizjen ndërkombëtare të kapitalit. Gjatë kësaj kohe, pjesëmarrja e personave fizik, është relativisht e vogël, ndërsa pjesëmarrja e kompanive trans-kombëtare dhe institucioneve bankare dhe jo bankare është dominuese.

Marrja e depozitave dhe dhënia e debive bankare, për një kohë të gjatë ishte metoda kryesore e lëvizjes së kapitalit ndërkombëtar. Megjithatë me zhvillimin e sistemeve financiare dhe tregjeve në vendet e zhvilluara, u bë diversifikimi i metodave dhe instrumenteve të ndërmjetësimit financiar dhe lëvizjes së kapitaleve dhe kjo fillimisht me emisionin e obligacioneve, me qëllim që të ulen shpenzimet e ndërmjetësimit financiar. Procesi i letrave me vlerë, solli zhvillimin e fuqishëm të investimeve portfolio.

Lëvizja ndërkombëtare e kapitalit shkakton ndryshime si në vendet eksportuese të kapitalit, ashtu edhe në vendet importuese. Efektet pozitive dhe negative janë të gërshetuara, ndërsa për vlerësim përfundimtar nevojitet një analizë më e thellë e çdo plasmani konkret. Si efekte pozitive nga importi i kapitalit përmenden: importi i akumulimit shtesë nga jashtë, rritja e investimeve në vend, ndikimi pozitiv ndaj bilancit tregtar, financimi i deficitit të bilancit të pagesave, përmirësimi i furnizimit të tregut të vendit, rritja e të ardhurave në buxhetin vendor, futja e teknologjisë së re, rritja e konkurrencës në tregun vendor, me çka nxiten ndërmarrjet e vendit për përmirësimin e punës së tyre etj.

Investimet e përbashkëta janë të lidhura me lëvizjen e të ashtuquajturit kapital i rrezikshëm, i cili në kërkim të përfitimeve të larta, kërkon mundësi në vend, por edhe jashtë tij. Ky kapital kërkon mundësi për investim dhe dalje nga firma, për 7-10 vite, kuptohet, pasi që të krijohen parashikimet lidhur me shkallët e realizuara të përfitimit dhe për vëllimin e përfitimit, që sipas rregullit, janë relativisht të larta. Shkallët më të larta të kërkuara të përfitimit, paraqiten për shkak të rrezikut më të madh të pranishëm. Rreziqet më të larta sipas rregullit janë të pranishme në vendet më pak të zhvilluara që pasqyrohen me sisteme joefektive ekonomike dhe juridike.

Investimet e përbashkëta paraqesin një lloj të shoqatave aksionare, duke pasur parasysh, se pjesëmarrja në menaxhimin me ndërmarrjen dhe ndarja e përfitimit, varet nga madhësia e pjesëmarrjes. Megjithatë, për dallim nga shoqatat aksionare, ku ka një numër të madh të investuesve (aksionarëve), që kanë në dispozicion letra me vlerë (LM) të transmetueshme dhe ku nuk ekziston kufizim kohor, te investimet e përbashkëta, në të shumtën e rasteve paraqiten dy partnerë, që të drejtat dhe detyrimet reciproke i menaxhojnë me marrëveshje me kohë të caktuar.

Kjo formë e lëvizjeve ndërkombëtare të kapitalit dhe të bashkëpunimit afarist, fillon të zhvillohet me hapa të shpejtë, nga vitet gjashtëdhjetë të shekullit të kaluar. Atëherë shumë vende në zhvillim dhe ish-vende socialiste i përdornin investimet e përbashkëta si forma përfitimi të angazhimit të kapitalit të huaj në ekonomitë e tyre kombëtare. Investimet e përbashkëta, sot gjerësisht përdoren si formë e transfertës ndërkombëtare të kapitalit.

Investimet e përbashkëta për vendet importuese nënkuptojnë realizimin e disa përparësive nga importi i kapitalit, nga njëra anë, në kushte të pengimit të efekteve negative për ekonominë vendore. Po ashtu, realizohet importi i kapitalit, teknologjisë moderne dhe dijeve, trajnimit të personelit, menaxhmentit e të tjera, me çka rritet pozicioni konkurrues i ndërmarrjes vendore dhe rritja e aftësive eksportuese të ekonomisë kombëtare. Shpesh herë, investimet e përbashkëta nuk janë të motivuara nga importi i kapitalit, por nga përdorimi

i dijeve, organizimit të prodhimit dhe të shitjes, rrjetit të servisit dhe emrin e investuesit të huaj.

Karakteristikë tjetër pozitive e investimeve të përbashkëta, është që nuk ekzistojnë detyrime fikse financiare lidhur me vendin e huaj dhe rritjen e debitimit, siç është rasti me kreditë. Realizohet nxjerrja e mjeteve jashtë vendit përmes përfitimit të përbashkët dhe kjo për pjesën që i përket investuesit të huaj. Importi, pasqyrohet mbi vëllimin e derdhjes së valutave të vendit nikoqir.

Jofavorizimet për vendin importues nga investimet e përbashkëta, manifestohen në dëshirën e investitorëve të huaj, që të investojnë në sektorët e vendit nikoqir të cilët janë më fitimprurës. Përveç kësaj, investohet në rajonet e zhvilluara, ku infrastruktura dhe kushtet e tjera janë të favorshme, ku rriten dallimet në zhvillimin rajonal. Gjithashtu, partnerët e huaj këmbëngulin që ta mbivlerësojnë vlerën e mjeteve të tyre, me qëllim që të sigurohet pjesëmarrje më e madhe në strukturën e përgjithshme të kapitalit. Kjo veçanërisht ka të bëjë me pjesëmarrjen e partnerëve të huaj në të drejtat e pronësisë industriale (patentat, licencat dhe know-how), ku nuk ekzistojnë kritere të sigurta për vlerësimin real të vlerës së investimeve. Përveç kësaj, partneri i huaj mundet që përmes çmimeve më të larta të pjesëve dhe komponentëve të pajisjeve dhe impianteve, të realizojë gjysmën e pozicionit. Kjo mund të realizohet edhe përmes çmimeve më të ulëta të dërgesës së partnerit vendor.

Interesante është edhe çështja e mbrojtjes së interesave kombëtare të vendit nikoqir, në rastin kur kapitali vendor dhe ai i huaj nuk marrin parasysh interesat kombëtare, por i japin përparësi interesave private. Që të ulet ky rrezik, legjislacioni kombëtar parashikon që marrëveshja për investime të përbashkët të parashtrohet për miratim te organi kompetent i vendit homolog. Për këtë qëllim, ky lloj bashkëpunimi afarist, është lëndë e rregullimit të detajuar dhe vlerësimit të efekteve pozitive dhe negative. Për shembull, përcaktohet se në cilat pjesë të ekonomisë kombëtare mund të hyjnë të huajt, me qëllim që të mbrohen sektorët vital të vendit. Po ashtu, kërkohet që partneri i huaj të mos ketë më shumë se gjysmën e investimit në ndërmarrje apo kompani dhe as shumicën në organet drejtuese. Përveç kësaj, kufizohet importi i makinerive, pjesëve dhe të tjera të ngjashme me këto, me qëllim që të nxitet ekonomia vendore, etj.

Njihen disa lloje të skemave (formave) të tërheqjes së kapital të huaj, me rrezik në ndërmarrjet e mëdha, të mesme dhe të vogla. Veçanërisht janë përpunuar skemat për nxitjen e kapitalit në firmat e mesme dhe të vogla, duke marrë parasysh mungesën e kapitalit fillestar për fillimin e biznesit. Shteti paraqitet si krijues i klimës favorizuese e cila do të jetë tërheqëse për investitorët dhe kjo në formën e trusteve, skemave për investime, inkubatorë etj.

Në këto korniza duhet të përmendet edhe ndikimi në rritje i globalizimit ndaj faktorëve të industrisë, në kushte të uljes së rëndësisë së faktorëve vendorë (lokal). Përmenden rezultate nga disa investigime sipas të cilave faktorët e industrisë përkatëse, kanë rëndësi relativisht më të madhe në krahasim me faktorët e vendit anëtar. Kjo nënkupton se industritë që tashmë janë të globalizuara, ekspozohen në diversifikim më të madh të rrezikut.

Dihet se në industrinë minerare, investimet janë të mëdha dhe se angazhojnë kapitale vëllimore për një periudhë më të gjatë kohore. Për këtë arsye, është tepër e rëndësishme që rregullacionet lidhur me të drejtat dhe detyrimet e partnerit të huaj, të jenë të qarta dhe precize, me qëllim që të mos ketë paqartësi dhe mundësi për interpretim vullnetar. Gjithashtu, rregullat nuk duhet që të ndryshohen shpesh, sepse krijon pasiguri, ndërsa në marrëveshjet të ketë klauzola, me të cilat do të garantohet se nuk do të krijohen ndryshime të pafavorshme validiteti të marrëveshjes. Në rregullacion, duhet që në mënyrë të hollësishme të përpunohet çështja për transferimin e përfitimit si dhe obligimit për ri-investimin e tij në tërësi ose pjesërisht. Në literaturë, theksohet se marrëveshja për investime të përbashkëta duhet që të bëhet në 5-7 vjet, me qëllim që të krijohet hapësirë për negociata të mëtejshme me partnerin e huaj dhe arritjen e një pozicioni favorizues.

Duke marrë parasysh rastin e Kosovës dhe të "Trepçës", konsiderojmë se rregullacioni duhet që të parashikojë disa lehtësime dhe nxitje, me qëllim që të tërheqë investues të huaj. Një pjesë e lehtësimeve dhe nxitjeve kanë hyrë në rregullativën aktuale. Më lartë, është treguar shfrytëzimi aktual i ulët i potencialeve në minierat e "Trepçës" dhe nevojës së sigurimit të investimeve më të mëdha, në periudhë afatshkurtër, për rikonstruksionin dhe restaurimin e kapaciteteve ekzistuese, për ndërtimin e kapaciteteve të reja. Minierat e plumbit dhe zinkut, paraqesin bazë për zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarisë së shkrirjes dhe të ndërmarrjeve përpunuese përcjellëse, ku do të rritej numri i të punësuarve dhe rrjedhimisht buxheti i shtetit.

Atraktiviteti i Republikës së Kosovës dhe ndërmarrjes "Trepça" për investimet e përbashkëta rritet, për faktin se si njësi monetare përdoret euroja. Duke pasur parasysh se euroja është një nga valutat më të qëndrueshme botërore dhe paraqet një nga valutat më të rëndësishme që përdoret në pagesat ndërkombëtare, praktikisht është zvogëluar rreziku i paraqitjes së inflacionit në ekonominë e vendit. Domethënë, dihen pasojat për investitorët e huaj, kur investojnë në ekonominë me shkallë të lartë të inflacionit si dhe nevojën e përshtatjes së lëvizjeve të inflacionit.

7.2. Institucione ndërkombëtare financiare multilaterale

“Trepça” si ndërmarrje ekonomike, do të mund të përdorë më tepër lloje të kredive dhe përkrahje financiare nga organizata të ndryshme ndërkombëtare financiare. Përveç kësaj, Kosova si anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës Botërore (BB), do të mund të përdorë kredi për një afat të shkurtër apo të gjatë, dedikuar ekonomisë kombëtare. Kjo ka të bëjë edhe me mjetet e qeverive dhe shteteve të veçanta, organizatave dhe institucioneve rajonale.

Edhe pse një pjesë e këtyre kredive dhe mjeteve financiare, mund të mos jenë në lidhje të drejtpërdrejtë me punën e “Trepçës”, ato mund të paraqesin bazë për përmirësimin e klimës ekonomike, që gjithsesi do të ndikojë edhe në punën dhe performansën e ndërmarrjes. Për shembull, përdorimi i mjeteve për ndërtimin e infrastrukturës, përmirësimin e efikasitetit të institucioneve të vendit, zhvillimit të sistemit financiar dhe tregjeve, trajnimet e ndryshme, programet për mbrojtjen e mjedisit jetësor etj. do të nënkuptojnë përmirësim të klimës afariste në vend, që do të ketë ndikim favorizues edhe për zhvillimin e punëve në “Trepçë”.

Për Kosovën dhe “Trepçën”, janë interesante debitë e Bankës Ndërkombëtare për Ripërtëritje dhe Zhvillim (International Bank for Reconstruction and Development – IBRD), e cila është degë e Bankës Botërore. Karakteristika bazë e këtyre debive, është zbatimi i programeve të stabilizimit dhe zhvillimit të ekonomive kombëtare dhe zbatimi i politikës ekonomike.

IBRD-ja siguron financimin e projekteve konkrete, ndërsa shumë rrallë projekte të zhvillimit të përgjithshëm. Projektet duhet të jenë të rëndësishëm për ekonominë kombëtare, për të cilat nuk është i interesuar kapitali privat, për shkak të joprofitabilitetit (për shembull objekte të infrastrukturës), si dhe për shkak të nevojës për vlera më të mëdha monetare për një periudhë më të gjatë, me të cilën rritet edhe rreziku. Kjo nënkupton, se IBRD-ja angazhohet në financimin vetëm të projekteve për të cilat nuk është e mundur që të sigurohen mjete nga burime private, në kushte “të arsyeshme”. IBRD-ja siguron debi për përshtatshmëri strukturore, që kanë të bëjnë me ngritjen e efikasitetit të prodhimit në industri dhe në bujqësi, përmirësimin e efikasitetit të investimeve, përdorimin më të mirë të kapaciteteve ekzistuese, disa ndryshime institucionale etj.

IBRD-ja është një institucion zhvillimor dhe financiar, që do të thotë se gjatë përzgjedhjes së projekteve që do t'i financojë, merr parasysh kontributin e projektit për zhvillimin e vendit, me krijimin njëkohësisht të kushteve për kthim dhe pagim të debive të përdorura. Debitë i jepen qeverisë të vendit përdorues,

agjencive të tyre ose ndërmarrjeve private, por me marrjen e garancisë nga vetë qeveria. Debitë, në radhë të parë, i dedikohen mbulimit të shpenzimeve valutore për furnizimin e mallrave jashtë vendit, ku merret parasysh edhe komponenti importues në prodhimet e vendit, që do të përdoren në realizimin e projektit.

Sot, debitë e IBRD-së janë të dedikuara, në radhë të parë, për nxitjen e zhvillimit të vendeve në zhvillim, që nënkupton se janë të përdorshme edhe për projektet nga Kosova. Për këtë, duhet të merret parasysh, se projektet duhet të jenë të suksesshme që të mundet të paguhen nga të ardhurat që i realizojnë. Domethënë, projektet rreptësisht angazhohen dhe vlerësohen nga ana e IBRD-së, për shkak të verifikimit të arsytimit dhe mundësisë për kthim të mjeteve të përdorura. Pikërisht për këtë kusht, disa prej vendeve më të varfra, nuk janë në gjendje që të përdorin debi nga IBRD-ja. Përveç kësaj, duhet pasur parasysh, se banka miraton kredi për kushte të tregut, që nënkupton, se debitë nuk janë të subvencionuara (shkalla e kamatës që e përllogarit banka është më e lartë, nga ajo që e paguan nga mjetet e grumbulluara). Por banka, relativisht me lehtësi i grumbullon mjetet e nevojshme, me emisionet e obligacioneve dhe kjo nën kushtet e favorshme.

IBRD-ja akordon debi me afat për pagesë prej 20 vitesh (ekzistojnë shembuj edhe për periudha më të gjata) dhe akordohet edhe "grejs" periudha prej pesë vitesh. Shkalla e interesit është e njëjtë për të gjitha vendet dhe ndryshon nga varësia e kushteve në të cilat bankat i gjejnë mjetet e tyre. Projektet që financohen, kalojnë disa faza, si: faza e identifikimit, përgatitja, vlerësimi, negociatat, miratimi, ekzekutimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi shtesë i projektit. Me qëllim që të sigurohet financimi i një numri më të madh të projekteve në vendet në zhvillim dhe një koordinim më të mirë, bëhet bashkëfinancimi në disa projekte.

Përdorimi i mjeteve për përshtatshmëri strukturore është i ndryshëm te vende të veçanta dhe në varësi të kushteve konkrete. Kështu për shembull, në Kosovë projektet e IBRD-së kanë të bëjnë me rritjen e efikasitetit të industrisë dhe të bujqësisë, rritjes dhe diversifikimit të importit mbi bazën e përparësive krahasuese, veçanërisht në fushën e sektorit minerar, përmirësimin e efikasitetit të investimeve, përdorim më të mirë të kapaciteteve ekzistuese etj.

Kosova si vend jo mjaft i zhvilluar, me shkallë të lartë të papunësisë, ka mundësi reale që të përdorë debi nga *Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (International Development Association - IDA)*, i cili përfaqëson një filial të IBRD-së dhe akordon debi me kushte më të favorshme nga IBRD-ja. Debitë e IDA-së, janë të dedikuara për vendet të pazhvilluara sa duhet. Projektet që financohen me mjetet e IDA-së, kanë për qëllim rritjen e punësimit, me të cilin do të kenë dobi shtresat më të gjera të popullsisë, duke pasur parasysh, se do

të kontribuojë për uljen e tensioneve sociale. Kjo nënkupton, se përparësi nuk kanë projektet me përfitime të mëdha, por ato me të cilat zgjidhen problemet sociale dhe punësimi. Kreditë jepen për një periudhë prej 35–40 vjeçare, me grejs–periudhë prej 10 vitesh, ndërsa kamata e debive të shfrytëzuara nuk paguhet, por paguhet provizioni i cili arrin 0,30%. Pjesëmarrja në debitë e IDA-së, në financimin e projekteve, arrin rreth 40%, ndërsa agjencia mund të marrë pjesë edhe në projekte me bashkëfinancim. Për debitë e IDA-së nuk nevojitet garanci shtetërore.

Korporata Ndërkombëtare Financiare (International Financial Corporation – IFC), ka si detyrë që ta përshejtojë zhvillimin e vendit, me nxitjen e plasmanit të kapitalit të huaj në sektorin privat. IFC-ja, gjithashtu përfaqëson filialin e IBRD-së, ndërsa mjetet sigurohen në llojin e kredive dhe në llojin e pjesëmarrjes. Megjithatë, shumë i rëndësishëm është roli i IFC-së, në lidhjen e ndërmarrjeve private, që kanë nevojë për kapital me investues të interesuar.

IFC-ja nuk i konkurren kapitalit privat, por krijon kushte për rritjen e plasmanit të tij në vendin respektiv. Korporata jep edhe ndihmë teknike, veçanërisht në krijimin e tregjeve financiare dhe në zhvillimin e institucioneve financiare të vendeve në zhvillim. Për përdorimin e kredive të IFC-së, nuk nevojitet garanci shtetërore, afati i pagesës arrin 7–12 vjet, ndërsa në disa raste mund të përcaktohet një afat prej 20 vitesh. Mjetet e debive mund të përdoren edhe për pagimin në valutën lokale. Procedura për identifikim, vlerësimi dhe miratimi i projekteve është i ngjashëm, me atë që zbatohet nga ana e IBRD-së.

Agjencia Multilaterale për Garantimin e Investimeve (Multilateral Investment Guarantee Agency – MIGA), ka për qëllim që përmes dhënies së garancive për rreziqet jo komerciale, të nxitë të ardhurat në kapitalin privat, në vendet në zhvillim. MIGA i jep informacione investitorëve potencialë për mundësitë për investimet në vendin respektiv në zhvillim, jep ndihmë teknike dhe paraqet vendin ku eksportuesit dhe importuesit e kapitalit do të mund të bashkëpunojnë. Agjencia vetë financohet nga primet e paguara për sigurimin e dhënë.

MIGA nuk paraqet zëvendësimin e skemave kombëtare të sigurimit, por i plotëson me sigurim dhe risigurim. Garancitë jepen për plasmane të llojit të investimeve afatgjatë, ndërsa nuk përfshihen kreditë e eksportit, që tashmë janë të siguruara te agjencitë kombëtare. Agjencia i përfshin llojet e mëposhtme të rreziqeve që janë: kufizimet kombëtare për konvertimin dhe transmetimin e valutave, kufizimin e pronësisë së të huajve, prishjen e marrëveshjes nga ana e qeverisë në dëm të investitorit, konflikte ushtarake, trazira dhe rreziqe të tjera jo komerciale që do të pranohen nga MIGA.

Banka Evropiane për Investime (BEI) - akordon debi dhe garanci të sektorit privat dhe atij publik, ku pjesëmarrja e saj në financim të projektit nuk mund të jetë më e madhe se 50%. Debitë mund të jenë në euro ose në valutë tjetër, në varësi nga dëshira e marrësit të debisë. Sipas rregullit, zbatohet shkallë interesi fikse, por mund të zbatohet edhe revizioni i shkallës së interesit, për një periudhë të caktuar (për shembull, për periudhën prej 4 deri në 10 vjet, konfirmohet shkallë fikse, e cila mund të ndryshohet). Kreditë e EIB-së jepen për projekte infrastrukturore (rrugë, hekurudha, etj), modernizimin e rrjetit të largpërçuesve dhe për dedikime të tjera.

Për shkak të dhënies së përkrahjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, nga ana e Këshillit Evropian, është formuar EIB Grupi (*EIB Group*), në të cilin bëjnë pjesë Banka Evropiane e Investimeve dhe Fondi Evropian për Investime (EIF). EIF-ja akordon debi afatmesme dhe afatgjatë, jep garanci dhe angazhimin e mjeteve në llojin e kapitalit sipërmarrës (investime të përbashkëta).

Banka Evropiane për Ripërtëritje dhe Zhvillim (European Bank for Reconstruction and Development – EBRD), akordon kredi për qeveritë, kredi të autoriteteve lokale dhe për firmat private. Kreditë jepen direkt ose përmes institucioneve financiare të vendit (bankave afariste) dhe dedikohen për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për përkrahjen e procesit të privatizimit dhe për investimet e përbashkëta. Banka bën sigurimin e investimeve të huaja, jep garanci dhe siguron shërbime këshillëdhënëse gjatë investimeve të kapitalit.

Organizatrat financiare ndërkombëtare të theksuara më lartë, në programet e tyre kanë parashikuar disa mënyra dhe burime të mjeteve për nxitjen e zhvillimit të vendeve jo shumë të zhvilluara dhe vendeve në tranzicion. Për shembull, emisioni i obligacioneve konvertibile, mund të paraqesë një nga mënyrat për grumbullimin e mjeteve për nevojat e "Trepçës", me mundësi që debia të shndërrohet në kapital aksionar. Kjo mënyrë e financimit të biznesit, do të mund të përdoret nga agjenci të veçanta të Bankës Botërore dhe Bankës Evropiane për Ripërtëritje dhe Zhvillim. Kështu, emisionet e obligacioneve konvertibile do të nënkuptojnë grumbullimin e kapitalit debitor i cili në kushte të caktuara do të shndërrohet në kapital aksionar. Me këtë rast, ndërmarrja nga njëra anë do të çlirohet nga detyra për kthimin e debisë, ndërsa nga ana tjetër aksionet e tij do të bëhen organizatat e njohura ndërkombëtare, me disa lloj përparësish, lidhur me prestigjin e kombinatit, ndikimin mbi menaxhimin, tërheqjen e investimeve etj.

7.3. Përkrhaje financiare e shtetit

Tregu financiar në Kosovë, në mënyrë të ngjashme, me pjesën më të madhe të vendeve në zhvillim dhe tranzicion, relativisht është i zhvilluar jo sa duhet dhe i bën hapat e parë në afrimin dhe harmonizimin me praktikën e tregjeve financiare bashkëkohore dhe të zhvilluara. Burimi kryesor i mjeteve financiare janë bankat, ndërsa institucione financiare jo bankare, për financimin e biznesit, mund të thuhet se nuk ka. Nga ajo që u përmend në këtë tekst, mund të nxirret si konkluzion, se: në një periudhë afatshkurtër, të mesme dhe afatgjatë, burimi kryesor i financimit në "Trepçën" do të jenë bankat. Ashtu siç është theksuar më parë, përkundër mjeteve të bankave, për financimin e nevojave zhvillimore të "Trepçës", burim i mundshëm paraqiten investimet e huaja, lizingu dhe format e ndryshme të *joint venture*. Në fund, si financues të zhvillimit mund të jenë institucionet e ndryshme ndërkombëtare financiare dhe donatorët.

Ndërkohë, nuk duhet që të harrohet edhe shteti i cili duhet që ta financojë rimëkëmbjen e "Trepçës", me qëllim që të krijohen kushtet themelore të punës si dhe për përshpejtimin e zhvillimit. Roli i shtetit mund të jetë afatgjatë dhe të përfshijë financimin direkt, dhënien e garancive, si dhe krijimin e kushteve të favorshme për tërheqjen e investimeve, qofshin ato të huaja apo të vendit. Roli i shtetit e theksojmë, duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që e ka "Trepça", për ekonominë e Kosovës, si bazë për zhvillimin e disa industrive përcjellëse, për punësimin dhe për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik.

Roli dhe raporti i shtetit janë shumë të rëndësishme për jetën ekonomike të çdo vendi. Shteti është përgjegjës dhe i detyruar që të krijojë kushte optimale të ekonomisë kombëtare. Kjo e formon sistemin ekonomik dhe rregullat lidhur me funksionimin e individëve afaristë, tatimet dhe kontributet, shkallën e hapjes së ekonomisë dhe ndikimin nga jashtë, investimet e huaja si dhe të drejtat – prerogativat (royalties), që i ka shteti në dhënien e koncesioneve për eksploatimin e pasurive natyrore, përfshirë këtu edhe pasuritë minerale.

Që të krijohet një imazh i plotë për ndonjë vend, lidhur me mundësinë për bashkëpunim afarist, nevojitet njohja e sistemit ekonomik, rëndësia dhe roli i planifikimit, rëndësia dhe roli i ndërmarrjeve shtetërore, gjendja sociale në vend, punësimi, kuptohet edhe zhvillimi dhe madhësia e tregut lokal financiar. Për shembull, për investitorët e huaj është e rëndësishme njohja e detyrave të planifikuara që i ka vendosur shteti. Nga planet, mund të vlerësohet rëndësia e degëve dhe veprimtarive të veçanta ekonomike. Cilat veprimtari do të stimulohen, në cilat rajone do të nxitet investimi, cilat lloje të kërkesave do të kenë prioritet etj.

Gjithashtu, politika e shtetit lidhur me ndërmarrjet shtetërore mund të ndikojë mbi vendet e investitorëve të huaj. Kështu, përforcimi dhe përhapja e ndërmarrjeve shtetërore në disa industri, do të nënkuptojë pozicionin e tyre të privilegjuar, në raport me ndërmarrjet private. Për këtë, duhet që të merret parasysh, se ndërmarrjet shtetërore, sipas rregullit, kanë trajtim të preferuar lidhur me ato private. Kjo gjendje ndërlikohet, në rastet kur në ndërmarrjet private merr pjesë edhe kapitali i huaj.

Atraktiviteti për investime në ndonjë ekonomi kombëtare për plasmanin e kapitalit të huaj, varet edhe nga shkalla e inflacionit. Shkallët e larta të inflacionit në vendin përdorues, nuk do të thotë që janë pengesë në zhvillimin e aktiviteteve afariste nga ana e investitorëve të huaj. Gjithashtu, investitorët e huaj duhet që të përshtaten në kushtet ekzistuese (vendore) të menaxhimit, me qëllim që të shmangët ndikimi i panevojshëm i inflacionit në ekonominë vendore. Në rastin e Kosovës, nuk duhet që të priten ndikime të inflacionit në ekonominë e vendit, duke pasur parasysh, se euroja paraqet valutën vendore dhe kjo përdoret në raportet dhe në transaksionet afariste. Me euron si valutë vendore, ekonomia e Kosovës është e lidhur për politikën monetare të Bankës Qendrore Evropiane, kështu që, nuk duhet të priten ndryshime më të mëdha, lidhur me ofertën e parave dhe dukurinë e lëvizjeve së inflacionit.

Megjithatë, përdorimi i euros krijon edhe rreziqe dhe jo gjithherë janë në dobi të "Trepçës". Kështu që, duke marrë parasysh se pagesat për dërgesat e koncentratit të plumb-zinkut, në përgjithësi kryhen në dollarë amerikanë, në kushte të vlerës jostabile të dollarit, gjatë konvertimit të dollarëve në euro, mund të paraqiten humbje, për shkak të tendencës së dobësimit të dollarit në raport me euron. Të tilla humbje, nuk janë rezultat i punës së "Trepçës", por krijohen për shkak të raporteve ndërvalutore mes dollarit dhe euros. Kjo imponon një politikë të caktuar për mbrojtjen dhe stimulimin e "Trepçës", me qëllim që të neutralizohen efektet jo favorizuese nga ndryshimet e vlerës së dollarit.

Spektori minerar është degë specifike industriale, ku pasiguria është mjaft e pranishme për shkak të ciklit të gjatë të investimeve, që mund të zgjasin 5 deri në 10 vjet. Nga eksplorimet e mineraleve e deri në eksploatimin e tyre, nevojiten disa vite, ku kompanitë investojnë shuma të mëdha financiare, para se të fillojë kthimi i mjeteve të investuara. Ky cikël i gjatë i investimeve të mjeteve financiare, paraqet rrezik nga ndryshimet në rregullativë, që mund t'i zhvendosë parametrat ekonomikë (ekonomizimin, rentabilitetin, produktivitetin dhe profitabilitetin) të projektit. Lidhur me rregullativën dhe kushtet për punë, tregohet se pasiguria rreth stabilitetit të tyre ka rëndësi kryesore gjatë vendim-marrjes, për aktivitetet investuese në industrinë minerare. Nga ana tjetër, pasiguria lidhur me rregullativën dhe ndryshimet e saj të shpeshta, lënë

hapësirë për manipulim dhe korrupsion. Nëse humbet besimi i investitorëve, për kthimin e tyre do të nevojiten disa vite.

Ndërtimi i një regjimi të mirë rregullativ, imponon respektimin e disa parimeve bazë. Këto parime, duhet që të merren parasysh, gjatë formatimit të sistemit të rregullacionit, veçanërisht gjatë përcaktimit të rentës minerare (royalties) nga shteti dhe të regjimit të tatimeve, me qëllim që të eliminohet pasiguria dhe të krijohet klimë e mirë për investime.

(1) Rregullatorët (shteti) duhet që të vendosë qëllime të qarta dhe transparente për të cilat angazhohet. Nëse nuk është e qartë ajo që rregullatori kërkon të arrijë, do të krijojë hapësirë për manipulime dhe për korrupsion, sepse secili do t'i interpretojë kushtet në pajtim me interesat e tij. Paqartësitë duhet që të shmangen sa më tepër që të mundet.

(2) Ndërtimi i një procesi transparent – Në mënyrë të ngjashme si rregullat, apo sistemi rregullator, procesi i rregullacionit, gjithashtu, duhet të jetë transparent. Investitorët duhet që të jenë të bindur se procesi (procedura) do të zbatohet në mënyrë korrekte. Kjo çështje është shumë e ndërlikuar edhe pse në pamje të parë duket se nuk është kështu. Domethënë, kompanitë minerare kanë sekrete afariste, kështu që, duhet të ekzistojnë mekanizma që të njëjtat të ruhen. Procesi transparent, imponon njohurinë për formatimin e rregullacionit në dokument të shkruar, si edhe zbatimin e tij në praktikë.

(3) I thjeshtë – Rregullacioni i komplikuar dhe proceset e komplikuar shkaktojnë paqartësi dhe konfuzion, ndërsa kjo shkakton pasiguri. Kjo veçanërisht pasqyrohet negativisht te ndërmarrjet më të vogla, që kryejnë eksploatimin e mineraleve, e që shpeshherë, nuk kanë kapacitet për vlerësimin e detajeve.

(4) Kornizë të qartë kohore – Anulimi i marrjes së pajtueshmërisë, mund ta shkatërrojë projektin. Korniza kohore duhet të respektohet, duke pasur parasysh se në rastin e kundërt mund të paraqiten pasiguri.

(5) Parashikueshmëria – Është një aspekt i rëndësishëm, sepse nëse aplikimi për marrjen e lejes i përmbush të gjitha kriteret, e njëjta duhet që të miratohet, ndërsa nëse nuk përmbushen kushtet, duhet të refuzohet. Kjo duhet që të zbatohet në të gjitha fazat e procesit të rregullaconit. Ekzistimi i parashikueshmërisë është i rëndësishëm për realizimin e të gjitha parimeve të tjera.

(6) Stabilitet – Ky parim është mjaft i rëndësishëm për industrinë minerare për shkak të periudhës së gjatë të investimit. Çdo lloj ndryshimi i rregullacionit edhe pse ato nuk janë të arsyetueshme, mund t'i zhvendosin planifikimet financiare të investimit. Zgjidhje e mundshme për këtë problem, paraqet lidhja e marrëveshjeve afatgjatë, për projekte të caktuara minerare, me çka do të sigurojë stabilitet të rregullacionit gjatë jetëgjatësisë së projektit.

(7) *Konkurrenca* – Rregullacioni është i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për industrinë minerare. Megjithatë, ai shkakton shpenzime që duhet të verifikohen me kujdes, me qëllim që të vlerësohet arsyetimi i tyre. Çdo shtet, duhet që të këmbëngulë që të ketë rregullacion konkurrent, me qëllim që të krijojë kushte për prosperitet të ekonomisë dhe punësim për komunitetin.

Periudha e eksploatimit të makinerive dhe zbritja e vlerës së tyre, ka të bëjë me shkallët e amortizimit dhe politikën e amortizimit që e vendos shteti. Teorikisht, amortizimi (zbritja e vlerës së mjeteve bazë), duhet që të realizohet përmes shkallës së përcaktimit të zbritjes së vlerës së mjetit bazë dhe periudhës së përdorimit të tij, me çka do të sigurohet furnizimi i mjeteve të ngjashme, pa ekzistimin e investimeve më të mëdha, që kanë karakter investues. Në praktikë zbatohet shkalla e uljes lineare të vlerës, ndërsa në pajtim me shkallën minimale të caktuar, miniera mund të zbatojë edhe shkallë degresive dhe progresive, që konfirmohet nga ana e menaxhmentit të minierës.

Për shembull, përvoja nga zbatimi i shkallëve relativisht të larta të amortizimit për pajisjeve, tregon se kjo kontribuoi për përlllogaritje fikse dhe veçimin e mjeteve financiare për amortizim, që ka pasur efekte pozitive ndaj aspektit ekonomik të punës së minierave. Veçimi i amortizimit, si shpenzim fiks, ndikon në formimin e çmimit të shitjes së lëndëve të para. Kjo lloj politike, kontribuoi që shlyerja e makinerive minerare, të jetë për 8 deri në 10 vjet, që të sigurohet një riprodhim i lehtë i pajisjeve dhe ripërtëritjes së tyre. Kjo kontribuoi, që amortizimi të jetë parakusht për avancim tekniko-teknologjik, duke pas parasysh, se pajisjet të cilat do të sigurohen në të ardhmen, të kenë nivel të lartë teknik.

Te minierat, ku pajisjet dhe makineritë e amortizuara janë ende në funksion, siç janë në rastin e “Trepçës”, pasojat janë dy lloje. E para, kostot fikse të prodhimit, nëse zbatohet amortizim linear, janë jo realisht të larta, duke pasur parasysh gjendjen faktike të vlerës së ulur të mjeteve bazë. Shkaku i dytë krijohet, nëse në çmimin e shitjes të lëndës së parë minerale nuk përfshihet amortizimi.

Në rastin e dytë, në koston e prodhimit, nuk duhet që të përfshihet amortizimi, me çka do të fitohet një çmim më i ulët prodhimit dhe një konkurrencë e realizuar. Në rastin e dytë, duhet që të ruhet përlllogaritja e amortizimit, me qëllim që të krijohet përfitim, me të cilin do të mundet që të sigurohen pajisjet e reja.

Amortizimi i pajisjeve në minierat e “Trepçës”, imponon zbatimin e politikës së përlllogaritjes së amortizimit edhe pse mjetet bazë janë zbritur. Gjatë kësaj kohe, duhet që të merren parasysh të gjitha investimet për rivitalizimin dhe rikonstruksionin e mjeteve bazë, që e rrisin vlerën furnizuese të mjetit. Gjithashtu, duhet që të merret parasysh edhe ndikimi i inflacionit mbi vlerën reale të mjeteve bazë.

Rritja e prodhimit global, do të shkaktojë rritjen e sektorit minerar dhe të projekteve për vendburime minerale. Kjo do të shkaktojë, rritje të shpenzimeve për hulumtime. Përvoja ka treguar, se të dhënat për hulumtime e ndjekin lëvizjen e rritjes së çmimeve. Kështu që, siç rriten çmimet, rriten edhe shpenzimet e përgjithshme për eksplorimin e mineraleve.

Po ashtu, duhet marrë parasysh, se minierat e reja të plumbit dhe të zinkut, zhvillohen në vendet me rrezik sovran (sovereign risks), relativisht të lartë në vend, të cilat manifestohen në lidhje me vendosjen e rregullave operative dhe të shkallëve të tatimit. Kjo nënkupton, se ka mundësi që të ndryshohen rregullat dhe lartësitë e tatimeve, pasi që projekti të ketë filluar. Të tilla dukuri, mund ta sjellin në pikëpyetje realizimin e projekteve të planifikuara e të filluara dhe të pengojnë nismat për investime të kapitalit.

Nxitjen e zhvillimit të industrisë së plumbit dhe zinkut, shteti mund ta realizojë edhe përmes disa masave të politikës së tatimit. Politika e tatimit përdoret gjerësisht në botë, me qëllim që të zhvillohet ndonjë veprimtari ose e njëjta të destimulohet. Duke e pasur parasysh rëndësinë e “Trepçës” për ekonominë e Republikës së Kosovës, konsiderojmë se shteti duhet që të krijojë një politikë tatimore relativisht të ulët ose heqjen e tyre, me qëllim që të nxisë investimin në veprimtarinë bazë të ndërmarrjes, por edhe në veprimtaritë përcjellëse. Tatimi paraqet një shpenzim të rëndësishëm për investimet. Prandaj, lehtësimet tatimore dhe nxitja për investime, duhet që të jetë edhe për investuesit vendorë edhe për ata të huaj.

Përkrahja konkrete e shtetit për “Trepçën”, mund të jetë e gjithanshme. Kjo rrjedh nga vetë statusi i ndërmarrjes nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Në analizën e gjendjes së minierave, fabrikave të pasurimit, metalurgjive dhe gjithë industrisë përpunuese, është vënë në dukje, se pajisjet, impiantet dhe makineritë janë të amortizuara. Prandaj, nevoja e investimeve për riaftësimin e minierave për rritjen e prodhimit është e madhe. Kjo lloj gjendje, imponon përkrahjen e shtetit për aftësimin dhe vendosjen në funksion të minierave, para së gjithash, që të vazhdojnë me procesin e ristrukturimit veç e veç. Përkrahja konkrete e shtetit për “Trepçën” mund të jetë direkte dhe indirekte.

Kështu që, shteti mund të paraqitet si garantues për marrjen e kredive të nevojshme, për furnizimin e mjeteve kryesore për punë. Si garantues të investimeve të huaja, shteti mund të paraqitet para organizatave financiare ndërkombëtare dhe qeverive të huaja. Gjithashtu, shteti si garantues, mund të paraqitet edhe para institucioneve financiare apo konzorciumeve dhe bankave, me çka do të lehtësohet marrja e debive.

Ky funksion i shtetit, tashmë është lehtësuar, me faktin që në vitin 2010, "Trepça" ka realizuar fitim në punën e saj. Përpjekjet për konsolidimin dhe rimëkëmbjen e ndërmarjes, si dhe një konjunkturë të favorshme për plumbin, zinkun dhe argjendin tashmë janë bërë. Po ashtu, trendi në rritje i çmimeve, janë konfirmim, se në vitet e ardhshme, do të realizohen rezultate pozitive financiare. Konsiderojmë se analiza dhe kalkulimet që janë bërë në këtë tekst, janë reale dhe se në vitet e ardhshme, përfitimi që do të realizojnë minierat, do të rritet, me rritjen e prodhimit të xeherorëve dhe në kushte të flukseve shumë të larta të mjeteve monetare.

Në materialet që për nevojat e "Trepçës" i përgatitën kompanitë e huaja konsultative, në disa vende shprehet detyrimi i shtetit, që të ndihmojë në vendosjen në funksion të minierave. Veçanërisht, theksohet nevoja dhe detyrimi i shtetit lidhur me mbrojtjen nga mbetjet industriale. Prandaj, lidhur me mbrojtjen e mjedisit jetësor nga këto mbetje, del se një pjesë e detyrave ekzistuese, janë përgjegjësi të "Trepçës" (shtetit). Këto obligime, kanë të bëjnë me sanimin e gjendjes prej rrjedhjes së ujërave acid nga minierat dhe pasojave tjera mjedisore.

Në këto korniza, duhet që të përmendet edhe përgjegjësia (interesimi) i shtetit, lidhur me strukturën e ardhshme organizative të "Trepçës". Vlerësojmë se një variant i mundshëm i ristrukturimit organizativ, është krijimi i shoqërisë aksionare si drejtori e përgjithshme e koncernit (Holding). Me këtë do të krijohet një trup drejtues, që do të mund të menaxhojë me koncernin. Ai do të kujdesej për marrjen e të gjitha licencave shtetërore të nevojshme për eksplotimin e mineraleve. Si detyrë fillestare e koncernit do të ishte përpilimi i një strategjie për investimin dhe zhvillimin e njësive të caktuara afariste dhe mënjanimin e këtyre njësive afariste, që nuk bëjnë pjesë në veprimtarinë bazë të koncernit.

Strategjia për ristrukturimin e minierave dhe fabrikave të pasurimit, do të lidhet me transformimin e çdo miniere, përkatësisht, fabrike pasurimi ose grupi minierash me flotim, në shoqëri të veçanta. Kjo do të ndihmonte krijimin e një strukture të ngjashme të mjeteve dhe burimeve, me qëllim që shoqëritë të aftësohen për prodhim dhe t'i përgjigjen kërkesave të tregut global. Po ashtu, duhet bërë mënjanimin e njësive që nuk bëjnë pjesë në veprimtarinë bazë. Kjo fillimisht nënkupton, program për investime për modernizimin e minierave, fabrikave të pasurimit, që të jenë në pajtim me standardet ndërkombëtare sa i përket ruajtjes së mjedisit jetësor. Prandaj, janë të mundshme forma të ndryshme të ristrukturimit pronësor, duke llogaritur interesin e shtetit por edhe të investitorëve potencial.

8. Konkluzione dhe rekomandime

- Ndërmarrja “Trepça” ka nevojë për rivitalizim;
- Hartimi i një strategjie të qartë, mbi bazën e parametrave ekonomikë dhe shkencorë për “Trepçën”, është i domosdoshëm;
- Kompletimi i legjislacionit, që nënkupton nxjerrjen e ligjeve të veçanta që rregullojnë sektorin minerar;
- Të kryhet një studim fizibiliteti për tërë ndërmarrjen “Trepça”;
- Të kryhet vlerësimi dhe kategorizimi i rezervave minerale sipas standardeve moderne ndërkombëtare;
- Ndërmarrjes “Trepça” duhet dhënë licencë afatgjate, në mënyrë që të krijojë mundësi hulumtimi dhe eksplorimi afatgjatë, si dhe t’i sigurojë investitorët për perspektiven e saj;
- Aktivizimi dhe riaftësimi i të gjitha minierave të Pb-Zn;
- Modernizimi i teknologjive përpunuese;
- Vlerësimi dhe studimi për mundësinë e aktivizimit apo rindërtimit të metalurgjive të zinkut dhe plumbit;
- Dhënia e licencave për zonat e interesit të Pb-Zn, të cilat do të ishin katalizator i zhvillimit të sektorit minerar dhe katalizator i tërheqjes së investimeve të huaja;
- “Trepça e Re” do të ishte një ndërmarrje me kapital të përzier sipas modelit të PPP-ve;
- I tërë ky proces, të jetë transparent, me një marketing vendor dhe ndërkombëtar, me një analizë të thellë nga grupe të ekspertëve, në mënyrë që procesi të jetë i suksesshëm;

9. LITERATURA

- [1] Abrams, R. (2000). *The successful business plan*.
- [2] Adam Wheeler and Agzim Muja. (2002). *Trepça resource and reserve study. Stan Terg mine*.
- [3] A. B. Cummins, I. A. Given. (1992). *SME Mining Engineering Handbook (Vol. 1 and 2)*.
- [4] Ernst & Yung. (October, 2009). *Mining and metals. The wall of debt*.
- [5] Alfaro, L. (2002). *Foreign Direct Investment and Growth: Does the Sector Matter?*
- [6] Anrold, G. (2007). *Essentials of Corporate Finance Management*.
- [7] Arthur Pflugrad; Frank Reisbeck. (2009). *Varijante transformacije i privatizacije u rudarstvu na primeru Trepçe. Prezentacija, (2009)*.
- [8] Assche, F. V. (2010). *Zinc in the Environment. Facts and challenges for the zinc industry*.
- [9] *Atlas imineraleve të Trepçës. (2010)*.
- [10] Atrill, P. (2003). *Financial management*.
- [11] (2006). *Annual Report. Equipment Leasing Association*.
- [12] *Handbook for underground mining methods. (2000). Atlas Copco*.
- [13] (2010). *Lead & Zinc Production Cost Reports & Databases. AME Mineral Economics*.
- [14] (2009). *"Lead and Lead compounds. Toxics Use Reduction Institute*.
- [15] (2001). *A challenge for those interested in the future of the minerals industries*.
- [16] (2010). *A report on the state of the Canadian mining industry*.
- [17] (31 December 2007). *Annual Financial Report. Kosovo Consolidated Budget. For the Year Ended*.
- [18] B. Nikolić and Lj. Jakšić. (2005). *Historical review and actual situation of metallurgy at Kosovo and Metohija*.
- [19] Bhar, R. (2009). *Lead& Zinc. Will the crisis result in permanent changes to lead & zinc supply and demand pattern?*
- [20] Bisev, G. (2010). *Kapital*.
- [21] Bisev, G. (2011). *Kapital*.
- [22] Borges, P. (2004). *General government expenditure and revenue in the EU in 2003*.

- [23] Bourassa, A. (2009). *Can the mining/metals sector contribute to sustainable development and poverty reduction?*
- [24] Brigham, E. (2003). *E. Brigham: Cases in Financial Management.*
- [25] Brininstool, M. (2010). *The Mineral Industry of Kosovo.*
- [26] Bruce Keith Menzies, M. C. Matthews, N. E. Simons. (2002). *A short course in geotechnical site investigation.*
- [27] Bruno Solnik & Dennis McLeavey. (2009). *Bruno Solnik & Dennis McLeavey Global investment.*
- [28] Z.Elezi & A. Kodra. *Gjeologjia e Kosovës* (2008).
- [29] (2003). *Case Study: Lead and Zinc Smelter.* EU.
- [30] Cheol S. Eun & Bruce G. Resnik. (2007). *International finance management.*
- [31] Christia Mattich & Ekkehart Seitz. (2005). *Trepca Zinc Plant Visit Report.*
- [32] (2009). *Consulting services for Environmental Assessment and Remedial Action Plan for Mitrovica Industrial Park.* Czech-UNDP Trust Fund. Daconta.
- [33] Craig, C. (2002). *A short course in geotechnical site investigation.*
- [34] Darrin Grimsey and Marvyn K. Lewis. (2005). *The Economics of Public and Private Partnership.*
- [35] David K. Eiteman; Arthur I. Stoehill; Michael H. Moffett. (2007). *Multinational business finance.*
- [36] Drucker, P. (1991). *Inovacija i preduzetnistvo.* Beograd.
- [37] Duncan, R. (2006). *Costs and consequences of the expropriation of FDI by host governments.*
- [38] Dushi, M. (2009). *The Mineral Resources of Kosovo (Vol. I).* (M. Berisha, Ed.) Prishtinë, Republika e Kosovës: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- [39] Dushi, M. (2009). *The Mineral Resources of Kosovo (Vol. II).* (M. Berisha, Ed.) Prishtinë, Republika e Kosovës: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- [40] (2009). *EU Response to Economic Crisis and relevant Policy issues for the Metals and Mining sector.* European Commission.
- [41] Fabozzi, F. J. (Ed.). (2002). *The handbook of financial instruments.*
- [42] Fred McMahon and Cam Vidler. (2008). *Building a sound mining policy. Annual Survey of Mining Companies 2007/2008.* The Fraser Institute.
- [43] Gauci, V. (2002). *The Future of Lead and Zinc – A Supplier's Perspective.*
- [44] Greve, G. H. (Ed.). (2005). *The Challenge of Public-Private Partnership.*
- [45] Guberman, D. E. (2010). *Lead.*
- [46] Hartman, H. L., & Mutmansky, J. M. (2002). *Introductory mining engineering.*

- [47] Harvey S. Rosen & Ted Gayer. (2009). *Javnifinansi*. Skopje.
- [48] (2001). *Health, safety and environment. Southern mines*. CSA.
- [49] (2001). *Health, safety and environment. Trepca North mines concept study*. CSA.
- [50] (2001). *Health, safety and environment. Trepca Stan Trg mine business concept study*. CSA.
- [51] Higgins, R. c. (2004). *Analysis for Financial Management*.
- [52] Horne, J. V. (2005). *Financial Management and Policy*.
- [53] Hustrulid, W. A. (2001). *Underground mining methods: engineering fundamentals and international case*.
- [54] (2001). *Integrated Pollution Prevention and Control (IPPC). Reference Document on Best Available Techniques in the Non Ferrous Metals Industries*. EU.
- [55] Ivanisevic, D. K. (2006). *Dragan Krasulja; Milorad Ivanisevic: Poslovnefinansije*.
- [56] Jonatan Berk and Peter De Marzo. (2011). *Corporate finance*.
- [57] K. Zager; L. Zager. (1999). *Analiza finansijskih izvestaja*.
- [58] Kadriu, S. (2002). *Javni te finansi sponsebeno svrtna Kosovo*.
- [59] Kelmendi, S. (2002). *Trepca, Feasibility Study*.
- [60] (2004). *Kompleks Trepčnih rudnika. Geotehnička ispitivanja*.
- [61] Konstantinova, E. (2011). *Elizabeth Konstantinova: Bulgaria's Inter trust May Suspend Lead Production on Pollution*.
- [62] (n.d.). *Kosova logistics analysis*. ITT Kosovo consortium Ltd.
- [63] Kostovski, N. (2007). *Metodi praktika na sovremenoto investiranje vo pretprijatijata*.
- [64] K.Zeqiri, B.Muqa, M.Shabani, (29-31 August, 2013). *Tailing Management in Kosovo, Based in Sustainable Development and Environment Friendly Principles*. Tiranë, INSTITUTI ALB-SHKENCA,(Konf. Shkencore).
- [65] Koushal Raj Saxena, V. M. (2003). *In-situ characterization of soils*.
- [66] Lead & Zinc Brochure. (2010). *AME Mineral Economics*.
- [67] (2009). *Lead & Zinc mine production cost reports & database*. AME.
- [68] (2009). *Lead & Zinc production cost report& databases*.
- [69] (2009). *Lead & Zinc. Post-Crisis Metals: What Will Be Different?*
- [70] (2009). *Lead and zinc forecasts*. ILZSG.
- [71] (2011). *Lead and Zinc Ores. Industry report (USA). Industry report (USA)*.
- [72] (December, 2009). *Lead and zinc production in Kosova. Actual situation and future*.
- [73] Lead and Zinc Statistics. (n.d.). *Monthly Bulletins*.
- [74] (2011). *Lead and zinc supply exceeded*. ILZSG.
- [75] *Lead.2007 Minerals Yearbook*.(2009).

- [76] (December, 2007). *Lead/Zinc. Metal and Equity Review.*
- [77] (2002). *Leposavic concentrator.* ITT Kosovo consortium Ltd.
- [78] (n.d.). *Logistics, Utilities and Marketing Assessment.* ITT Kosovo consortium Ltd.
- [79] Luis Montanheiro and Magaret Linehan. (2000). *Public and Private Sector Partnerships. The Enabling Mix.*
- [80] Luke Danielson & Patricio Leyton. (2001). *Sustainable development. Emerging concepts of governance in the mineral industries.*
- [81] Madura, J. (2000). *International Financial Management.*
- [82] Marius Leibold & Michae Gibbert. (2002). *Strategic Management in the Knowledge Economy.*
- [83] Mason A. Carpetner and Wm. Gerard Sanders. (2009). *Strategic management.*
- [84] Mecalum, R. (2007). *Zinc. Australian commodities (Vol. vol.14).*
- [85] Mencinger, J. (2003). *Does Foreign Direct Investment Always Enhance Economic Growth? .*
- [86] (March, 2010). *Metal Monthly.*
- [87] (2009). *Metals Despatch. Lead and zinc forecast.*
- [88] (2005). *Metals mining and sustainable development in Central America. An assessment of benefits and costs.*
- [89] Miller, M. (2000). *Credit Reporting System Around Globe. The State of art in Public and Private Credit Registers.*
- [90] (2002). *Mine closure plan.*
- [91] (2002). *Models of Public Budgeting and Accounting Reform.* OECD.
- [92] Mudder, T. I. (n.d.). *Poverty, pollution and prosperity.*
- [93] Neale, R. P. (2006). *Corporate finance and investment. Decisions and strategies.*
- [94] Nedanovski, P. (2000). *Ekonomski otrazvojjizivotnata sredina.* Skopje.
- [95] Nestorovski, M. (2000). *Ekonomija na investiciite.*
- [96] Nikolovski, D. (2001). *Modeliranje na rudarskite procesi.*
- [97] Novak, ". (2008). *Kosovo - A country without an economy?*
- [98] Paul Ludwig Nelles & Michael Diehl. (2007). *Trepca Resurgence?*
- [99] Pflugrad, A. (2009). *Naučneosnoveza o stvarivanje bilansa preduzeča koje se transformiše.*
- [100](ITT Kosovo consortium Ltd.). *Power Generation and Distribution in Kosovo.*
- [101](2010). *Processes of lead-zinc ore mining and processing methods. Part II .*
- [102]Pulpanova, L. (2004). *Trends in selected general government expenditure by function of EU Member States.*
- [103]Rakita, B. (2006). *Medjunarodni biznis i menadžment.*

- [104](2007). *Recycling rates by commodity*.
- [105](2005). *Regulation No. 2005/3. On mines and minerals in Kosovo*. UMNİK. UMNİK.
- [106]Richard J. Lambert; Wayne W. Valliant; Holger Krutzelmann: (2009). *Technical report on the Woodlawn tailings retreatment project*. New South Walles, Australia.
- [107]Ricky W. Griffin & Michael W. Pustay. (2000). *International business. A managerial perspective*.
- [108]Riesbeck, F. (2005). *Environmental Study*. Berlin.
- [109]Riesbeck, F. (2010). *Rudnici – Problemiokoline*.
- [110]Roberto Bouzas and Daniel Chudnovsky. (2003). *Foreign direct investment and sustainable development. The recent Argentine experience*.
- [111]Roberts, H. (2006). *The renaissance of the lead and zinc industries – what does the future hold?* CHR Metals.
- [112]S. Jurini J. Shohinger. (1990). *Teorijatrzistaicijena*.
- [113]S. M. Hyseni; B. N. Durmishaj; B. L Fetahaj; D. (2010). *Large: Trepca ore belt and lead and zinc distribution in Badovac mineral deposit, Kosovo (SE Europe)*.
- [114]Sa, P. D. (2009). *Outlook for the global economy and stimulus packages: Implications for mining and metals*.
- [115](2005). *Samples preparation and chemical analyses*.
- [116]Savage, J. (2009). *SLI collection & SLI aftermarket*.
- [117]Seadin Xhaferi; Dusko Nikolovski. (2007). *Menaxhimiiinvestime*.
- [118]Seidman, K. F. (2005). *Economic development finance*.
- [119]Shala, F. (2011). *Impact of Trepça's industrial waste dumps on the environmental pollution*.
- [120]Shaw, C. (2010). *Lead and zinc suppliers weighing on market*.
- [121]Signe Didde Frese – Rune Klitgaard – Eske Kock Pedersen. (2003-2004). *Environmental Management in Kosovo. Heavy Metal emission from Trepca*.
- [122]Siropolis, N. (1990). *Small Business Management*.
- [123]Skaer, L. (2002). *Mining and Sustainable Development*.
- [124]Slavevski, T. (1997). *Privatizacija, Pazar, Drzava*.
- [125]Slobodan Vujič, Radovan Stanojevič, Toma Tanaskovič, Borislav Zajič, Radmina Živojinovič, Svetomir Maksimovič. (2004). *Metode za optimizaciju eksploatacionog veka rudarskih mašina*.
- [126]Smale, D. (2005). *Perspectives sur le Plomb et le Zinc – Previsions a Court Term et Developments Futures*. ILZSG.
- [127]Smith, H. (2009). *The EU Environmental Liability Directive*.

- [128](2007). *Southeast Europe Investment Guide*.
- [129](2010). *Spring 2010 meetings/ forecasts*. ILZSG.
- [130]Stanley B. Block; Geoffrey A. Hirt. (2005). *Foundation of Financial Management*.
- [131]Starrett, D. A. (1997). *Dealing with Public Risk in Private Infrastructure*.
- [132]Stiglic, D. I. (2009.). *Ekonomija na javniot sektor*. Skopje.
- [133]Stiglitz, J. E. (2000). *Economics of the public sector*.
- [134]Stuart, P. (2002). *The Trepca mining complex: How Kosovo's spoils were distributed*.
- [135](February, 2005). *Summary description of the lead zinc silver resources and the Trepca mines in Kosovo*. UMNİK.
- [136](2002). *Summary of ITT Report on the mines*.
- [137]Sylejman Hyseni & others. (2010). *Trepca Ore Belt and Stan Terg mine – Geological overview and interpretation, Kosovo (SE Europe)*. Geologija, Ljubljana .
- [138](2009). *The Association of European Storage Battery Manufacturers*.
- [139](2005). *The Compilation of Geo-scientific Maps of Kosovo*.
- [140](2001). *The Law of Public Participation in Mining and Resources Development*.
- [141]Thorpe, Sally; Cox:NicoKlijin and Antony. (1995). *Lead*.
- [142]Tolcin, A. C. (2010). *Zinc*.
- [143](2000). *TransAPELL Guidance for Dangerous Goods Transport Emergency Planning in a Local Community*. UNEP.
- [144](2001). *TrepcaAjvalia Mine Concept Study*. CSA.
- [145](2001). *TrepcaArtana Mine Business Concept Study*. CSA.
- [146](2001). *Trepca Business concept study*. CSA Group.
- [147](2005). *Trepca Lead Plant Visit Report*.
- [148](2003). *Trepca mine information summaries*.
- [149](2000). *Trepca Mineral Belt*.
- [150](2002). *Trepca Mines Hand-out t- Hajvalija*. Kosovo Trust Agency.
- [151](2002). *Trepca Mines Hand-out - Belo Brdo*. Kosovo Trust Agency.
- [152](2002). *Trepca Mines Hand-out - Crnac*. Kosovo Trust Agency.
- [153](2002). *Trepca Mines Hand-out - Stan Terg*. Kosovo Trust Agency.
- [154](2002). *Trepca Mines Hand-out -Artana*. *Kosovo Trust Agency*.
- [155](2001). *TrepcaNorth , South and Stan Trg Mine Business Concept Study. Health, safety and environment*. CSA.
- [156](2001). *Trepca North mines concept study*. CSA.
- [157](2001). *Trepca Novo Brdo mine business concept study*. CSA.
- [158](2001). *Trepca South Mine Business Concept Study. Kisnica Concentrator Performance*. CSA.

- [159](2005). *Trepca Zinc Plant Visit Report*.
- [160](2001). *Tuneli-i-Pare Mill Performance*. CSA.
- [161]V.M. Sol, S.W.M. Peters and H. Aiking. (1999). *Toxic waste storage sites in EU countries. A preliminary risk inventory*.
- [162]White, G. (2009). *The Drazhnje Zinc-Lead Project Report*. Lydian International Limited.
- [163]White, P. (2007). *The boom in base metals - Analysis and outlook*.
- [164]White, P. (2008). *Calculating the Recycling Efficiency Rate for Lead*.
- [165]White, P. (2009). *World Lead and Zinc Supply and Demand for 2009 - 2010*.
- [166]White, P. (2010). *Review of the current lead and zinc situation and outlook for 2010*. ILZSG.
- [167]White, P. (2011). *An Overview and Outlook for the Global Lead, Zinc, Nickel and Copper Markets*.
- [168]Wilkinson, S. (2009). *Zinc and Nutrition*.
- [169]Wilkinson, S. (2010). *Zinc Energy Storage*.
- [170]Wilkinson, S. (2010). *The Zinc Nutrition Initiative*.
- [171]Wilson, D. N. (2009). *New and innovative applications for lead*.
- [172] www.eib.org
- [173] www.ifc.org
- [174] www.miga.org
- [175] www.worldbank.org
- [176] www.worldbank.org/ida/

Shkurtesat:

UNMIK - Misioni i Përkohshëm i OKB-së në Kosovë (*The United Nations Interim Administration Mission in Kosovo*)

AKM - Agjencia Kosovare e Mirëbesimit

AKP - Agjencia Kosovare e Privatizimit

OBSH - Organizata Botërore e Shëndetësisë

UNDP - Programi për Zhvillim i OKB-së (*United Nations Development Programme*)

MZHE - Ministria e Zhvillimit Ekonomik

KPMM - Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara

OECD - Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim (*Organisation for Economic Co operation and Development*)

LME - Bursa e Metaleve në Londër (*London Metal Exchange*)

ILZSG - Grupi Ndërkombëtar për Studime të Zinkut (*The International Lead and Zinc Study Group*)

OBT - Organizata Botërore e Tregtisë

IFC - Korporata Ndërkombëtare Financiare (*International Finance Corporation*)

FMN - Fondi Monetar Ndërkombëtar

BB - Banka Botërore

PPP - Partneriteti Publik Privat

BE - Bashkimi Evropian

SHIK - Shkalla Interne e Kthimit

IFC - Korporata Ndërkombëtare Financiare (*International Financial Corporation*)

PSC - Krahasim me Sektorin Publik (*Public Sector Comparator*)

LBM - Tregu Londinez i Shufrave të Arit (*London Bullion Market*)

NVA - Neto Vlera Aktuale

IHD - Investimet e Huaja Direkte

IBRD - Banka Ndërkombëtare për Rikonstruktim dhe Zhvillim (*International Bank for Reconstruction and Development*)

IDA - Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (*International Development Association*)

IFC - Korporata Ndërkombëtare Financiare (*International Financial Corporation*)

MIGA - Agjencia Multilaterale për Garantimin e Investimeve (*Multilateral Investment Guarantee Agency*)

BEI - Banka Evropiane për Investime

EBRD - Banka Evropiane për Rikonstruktim dhe Zhvillim (*European Bank for Reconstruction and Development*)

AUTORET



Ferat Shala

Ka lindur ne Vuçak të komunës së Drenasit, më 10 qershor të vitit 1964. Shkollën fillore e ka mbaruar në vendlindje, ndërkaq të mesmen në Drenas. Fakultetin e Xehetarisë dhe Metalurgjisë, drejtimi i Gjeologjisë, e ka mbaruar në Mitrovicë, në vitin 1991. Në vitin 2006 ka magjistruar në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës. Në mars të vitit 2013 ka doktoruar në universitetin "Goce Delçev" të Shtipit (Maqedoni). Është doktor i shkencave gjeologjike. Ferat Shala është profesor asistent në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanikënë Prishtinë. Më parë ka dhënë mësim në Fakultetin e Gjeoshkencave në Mitrovicë dhe kolegjin universitar Tempulli. Ai, po ashtu, ka qenë dhe vazhdon të jetë konsulent profesional i disa kompanive që merren me ndërtime dhe miniera. Për afër katër vjet (dhjetor 2008–korrik 2012), ka drejtuar ndërmarrjen Trepça. Ka botuar me dhjetëra punime shkencore nëpër revistat shkencore prestigjioze të vendit dhe botës, si: Shqipëri, Itali, Slloveni, Gjermani, Britani e Madhe, SHBA, Turqi, Austri etj. Ai, po ashtu, me punime shkencore ka marrë pjesë nëpër konferenca, seminare dhe forume shkencore, në shumë vende të ndryshme të botës. Aktualisht është zëvendësministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Sala Berisha-Shala

Ka lindur në Vasilevë të Drenasit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu Drenas. Ka studiuar dhe është diplomuar në degën e Gjeologjisë, në kuadër të Fakultetit të Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë. Studimet posdiplomike i ka përfunduar në Prishtinë në Fakultetin Ekonomik, drejtimi Menaxhment Ndërkombëtar.

Në vitet '90-të ka punuar mësues në shkollat e mesme të Drenasit, ndërsa pas çlirimit të vendit, fillimisht ka punuar si gjeologe e minierave në Korporatën Elektroenergjetike të Kosovës (KEK), më pas ka punuar gjeologe e lartë për resurse në Drejtorinë e Minierave dhe Mineraleve, tash KPMM. Sala Berisha-Shala ka botuar punime shkencore nga fusha e gjeologjisë, ekonomisë, mjedisit etj., nëpër revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. Përveç kësaj, ajo ka qenë mjaft aktive në jetën politike të vendit. Është ligjvënëse në tri legjislatura, nga viti 2004 deri në vitin 2014. Duke qenë deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka dhënë kontribut të çmuar për hartimin e ligjeve që rregullojnë disa fusha, sidomos atë të sektorit mineral, në kuadër të Komisionit funksional parlamentar, për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

Aktualisht është mësues në Kolegjin Evropian "JURIDICA".





Bislim Muqa

U lind më 11 shkurt të vitit 1965, në Vraniq të Therandës. Shkollën fillore e ka mbaruar në Bukosh, të mesmen në Therandë. Me profesion është inxhinier. Ka studiuar Gjeologjinë në Fakultetin e Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë. Më 1999 ka qenë pjesë e administratës së ish-Qeverisë së Përkohshme të Kosovës në komunën e Therandës. Gjatë periudhës së viteve 1999-2008 ka qenë bashkëpunëtor i disa mediave të shkruara të Kosovës. Që prej vitit 2008, punon në ndërmarrjen Trepça. Aty kryen funksionin e shefit të Zyrës për Marrëdhënie me Mediat dhe Publikun dhe është këshilltar i parë i menaxherit të përgjithshëm të Trepçës. Në Universitetin Politeknik të Tiranës vazhdon studimet e doktoratës në fushën e gjeomjedisit. Ka marrë pjesë në shumë konferenca e simpoziume shkencore, brenda dhe jashtë vendit. Po ashtu, ka kryer trajnime të shumta në fushë e menaxhimit të ndërmarrjeve dhe mbrojtjes së mjedisit, në shumë vende të botës: Austri, Çeki, Itali, Turqi, Britani e Madhe, Japoni etj.

Fjala e recensentëve	7
Hyrje	11
KAPITULLI I	13
Njohuri të përgjithshëm për kompleksin mineralar “Trepça”	13
Historiku	13
E kaluara ekonomike dhe prodhimtaria	15
KAPITULLI II	17
Faktorët që ndikojnë në zhvillimin e sektorit mineralar (rasti “Trepça”)	17
Faktorët ndikues	17
Faktorët e mjedisit të brendshëm	17
Faktorët e mjedisit të jashtëm	18
Korniza ligjore	18
Sfidat e “Trepçës”	19
Sfida sociale	19
Sfida tekniko-teknologjike	20
Sfida e vlerësimit dhe kategorizimit të rezervave minerale	20
Sfidat juridike	21
Sfidat mjedisore	22
Institucionet e sektorit mineralar	25
Institucionet e sektorit mineralar	26
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM)	26
Tregu dhe asetet	27
Asetet e ndërmarrjes “Trepça”	28
KAPITULLI III	29
Ristrukturimi si kërkesë ekonomike dhe menaxheriale	29
Kriza e kompanisë	29
Identifikimi i problemeve dhe vendosja e synimeve	30
Fazat e zhvillimit dhe roli i “Trepçës” në ekonominë e Kosovës	33
KAPITULLI IV	35
Trendët botërore	35
Përcaktuesit themelorë, rrjedha e prodhimtarisë dhe e konsumit të plumbit dhe zinkut	37
Riciklimi i plumbit dhe zinkut	42
Lëvizje e çmimeve botërore të plumbit dhe zinkut	47
Lëvizja e ofertës së plumbit, zinkut dhe koncentratit	54
Kërkesat për plumb, zink dhe koncentrate	61

Importuesi dhe eksportuesit kryesorë të plumbit dhe të zinkut dhe rezervat e metaleve	67
Oferta dhe kërkesa e xeherorëve të plumbit, zinkut dhe të metalit në rajon ...	73

KAPITULLI V81

Pjesa speciale	81
Modele të ristrukturimit	81
Likuidim ose sanim i minierave dhe fabrikave të pasurimit	82
Ristrukturimi i minierave dhe fabrikave të pasurimit me lotim	86
Privatizimi i minierave dhe fabrikave të pasurimit me flotim	90
Ristrukturimi i minierave të plumbit dhe zinkut në Kosovë	95
Partneriteti publiko-privat	96
Qëllimet e ristrukturimit	101
Marketingu i minierave për plumb dhe zink "Trepça	102
Karakteristikat kryesore të kushteve të shkrites	104
Optimaliteti i kapacitetit të prodhimit dhe periudha e eksplotimit të pasurisë xeherore	107
Përcaktimi i shkallës së finalizimit të prodhimit	114
Përmbushje e standardeve mjedisore	121
Përmbushje e standardeve mjedisore në miniera	122
Përmbushja e standardeve mjedisore në fabrikat e pasurimit	123
Përzgjedhje e teknologjisë dhe mjeteve të nevojshme financiare	126
Resurse të nevojshme njerëzore dhe paga	130
Profitabiliteti i ristrukturimit	134
Financimi për ristrukturim	145
Tregje private financiare	147
Kreditimi bankar dhe konzorciumi nga kreditorët	147
Emetimi i letrave me vlerë pronësore dhe debitore	153
Lizingu i pajisjeve	159
Kredi malli	162
Investime e huaja direkte	163
Investimet e përbashkëta	169
Institucione ndërkombëtare financiare multilaterale	173
Përkrahje financiare e shtetit	177
Konkluzione dhe rekomandime	183
Literatura	184
Shkurtesat	191

Atlantis 

© Copyright:
Atlantis Développement, Roscoff, France

ISBN: 978-2-9515997-0-3

Dépôt légal 2ème Semester 2014
Achevé d'imprimer le 27 mai 2014

ISBN 9782951599703



9 782951 599703